



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 31 TETOR DHE 1 NËNTOR 2018**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 31. OKTOBRA I 01. NOVEMBRA 2018. GODINE**

**TETOR/NËNTOR - OKTOBAR/NOVEMBAR
2018**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korrigjimit të kufijve” në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Dnevni red

1. Parlamentarna debata u vezi angazhovanja Predsednika Kosova u uključivanju “razmene teritorija” ili “korigovanja granica” u dijalogu između Kosova i Srbije

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Zëvendëskryeministra dhe ministra,
Aktualisht në sallë janë të pranishëm mbi 80 deputetë.

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me kërkesë të 42 deputetëve të Kuvendit.

Fillojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar lidhur me angazhimet e presidentit të Kosovës për përfshirjen e shkëmbimit të territoreve apo korigjimit të kufijve në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Të nderuar deputetë,
42 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë kërkuar debat parlamentar lidhur me angazhimet e presidentit të Kosovës për përfshirjen e shkëmbimit të territoreve apo korigjim të kufijve në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Avdullah Hoti, që të emër të propozuesit ta paraqesë çështjen, për të cilën është kërkuar debati parlamentar. Urdhëro, i nderuar Hoti!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,
Anëtarë të Qeverisë,
Të nderuar qytetarë,

Ka kohë që presidenti Thaçi angazhohet që shkëmbimi i territoreve apo korigjimi i kufijve të përfshihet në dialogun me Serbinë. Ai e ka paraqitur këtë propozim në një seri të konferencave për medie në Prishtinë. Ndërkaq, më 25 dhe 26 gusht 2018 në Vjenë, ka folur për këtë propozim në prani të zyrtarëve të Bashkimit Evropian, të Austrisë dhe të Serbisë.

Ky angazhim i presidentit Thaçi është kundërkushtetues dhe, rrjedhimisht, kundër shtetësisë të Kosovës.

Dëmet tanimë janë bërë nga këto veprime të Presidentit:

E para, është krijuar pasiguri qytetare, ekonomike dhe sociale, si asnjëherë më parë. Vlerësimet tregojnë se pakënaqësia e qytetarëve ka arritur nivelin rekord prej mbi 80% të qytetarëve që janë të pakënaqur me rrjedhat politike në Kosovë.

E dyta, janë stopuar të gjitha aktivitetet e diplomacisë së Kosovës dhe të shteteve mike për konsolidimin e shtetësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,

Është e qartë se këto veprime të Presidentit janë antikushtetuese.

Asnjëra nga kompetencat e Presidentit, të parapara në nenet 4, 83 dhe 84 të Kushtetutës, nuk ka natyrë të pavarur.

Në demokracitë parlamentare, shefi i shtetit nuk ka kompetenca që janë ekskluzive të sovranit dhe të përfaqësuesit të tij, që janë deputetët.

Territori i takon shtetit, e jo Presidentit, apo ndonjërit prej pushteteve. Esenca e rendit kushtetues të Kosovës qëndron në këto shtylla:

E para, çështjet e sovranitetit territorial i takojnë ekskluzivisht përfaqësuesit të sovranit, pra këtij Kuvendi.

E dyta, përfaqësuesit e sovranit, asnjë institucion tjetër nuk ka mandat të negociojë apo të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtare për çështjet nga neni 18.1 i Kushtetutës;

E treta, të gjitha çështjet nga neni 18.1 i Kushtetutës kërkojnë votat pro të 2/3 të deputetëve;

E katërta, për çështjet nga neni 18.1 i Kushtetutës mund të vendoset përmes referendumit, ku sovrani e ushtron pushtetin drejtpërdrejt. Por, në një Republikë parlamentare si Kosova, referendumin nuk mund ta thërrasë Presidenti, por vetëm përfaqësuesi i sovranit, dhe atë vetëm për çështjet që janë brenda kompetencave të tij, si përfaqësues i sovranit.

Të nderuar deputetë,

Diskursi i Thaçit për gjoja mbështetje ndërkombëtare të këtij procesi është mashtrim për tri arsye:

1. Shkëmbimi i territoreve nuk është rezultat i ndryshimit të politikës të partnerëve tanë. Kjo është ide e Beogradit dhe e Moskës, për të penguar konsolidimin e shtetit të Kosovës.
2. Shkëmbimi i territoreve nuk i siguron Kosovës anëtarësim në OKB. Pse Kina do të ndërronte qasje karshi kësaj çështjeje?
3. Shkëmbimi i territoreve nuk i siguron Kosovës perspektivë të qartë drejt Bashkimit Evropian, sepse qëndrimi i Spanjës karshi pavarësisë së Kosovës nuk ndryshon me shkëmbim territorësh.

Sjellja e Presidentit në Alpbach të Austrisë ka qenë skandaloze, kur ai flet në shumës, edhe në emër të Presidentit serb. Po e citoj si ka thënë, pak a shumë: “Na lini, ju lutem, vetëm, mua dhe Vuçiqin, që në mirëbesim t’i zgjidhim mosmarrëveshjet tona. Thotë, ne nuk jemi djem problematikë. Ne dëshirojmë të arrijmë marrëveshje”.

Me këtë qasje, Thaçi përjashton BE-në dhe SHBA-në nga dialogu.

Thaçi po bisedon për Kosovën sikur për një krijesë politike në formim.

Ai ka deklaruar se deputetët shkojnë e vijnë, por ai do të vazhdojë projektin e tij dhe këto janë deklarime vetëm të një monarku të shekullit XVII.

Të nderuar deputetë,

Ne jemi për dialog me Serbinë.

Por, për një dialog ndërmjet dy shteteve, që ka për qëllim mirëqenien e qytetarëve, paqen në rajon dhe përshpejtimin e integrimit në BE.

Ideja e korigjim të kufijve i vendos këto synime në pritje, i bën këto synime konfuze.

Korigjimi i kufijve është korigjim i Deklaratës së Pavarësisë.

Kundërshtimi ynë për korigjimin e kufijve është legjitim dhe kushtetues. Ky kundërshtim është në funksion të mbrojtjes së integritetit territorial të Kosovës. Ky kundërshtim e mbron Kosovën nga Presidenti, por edhe Presidentin nga vetja e tij.

Propozimi i Presidentit që të dialogohet me Serbinë, pa ndërmjetësimin e BE-së dhe SHBA-së, si koordinatorë dhe garantues të këtij procesi, nuk siguron asgjë.

Pas dy dekadave përpjekjesh për paqe dhe stabilitet, bazuar në garancitë nga BE-ja dhe SHBA-ja, kjo qasje është gjeopolitikisht e dëmshme për Kosovën dhe rajonin dhe na kthen prapa.

Në kohën kur do të duhej të ishim të bashkuar, pavarësisht dallimeve politike që kemi, propozimi për korigjim të kufijve na ka dobësuar në raport me Serbinë. Thaçi është afruar me Vuçiqin, por na ka larguar neve nga njëri-tjetri. Duke refuzuar propozimin për korigjim të kufijve, ne i mbrojmë serbët e Kosovës dhe komunitetet e tjera.

Me këtë refuzim, ne mbrojmë edhe shtyllat e shtetësisë tonë, që bazohen në parimet liberal-demokratike. Me këtë refuzim ne mbrojmë dhe gjeopolitikat euroatlantike në rajon, që është jetike për integritet tonë.

Të nderuar deputetë,

Jam i sigurt se të gjithë pajtohem se dialogu për kufijtë do të thotë dorëzim para politikave mohuese të Serbisë ndaj shtetit të Kosovës. I rrezikon arritjet që i kemi bërë me mbështetje të aleatëve tanë.

Dialogu për kufijtë i vë në dyshim themelet e shtetit të Kosovës. Rishikimi i kufijve nënkupton ribërjen e shtetit të Kosovës që nga fillimi. Prandaj, është mirë që të ndalim këtë dialog njëherë e përgjithmonë.

Të nderuar deputetë,

Pas debatit, Kuvendi duhet të miratojë rezolutën me vetëm një pikë, e cila thotë tekstualisht:

“Territori i Republikës së Kosovës është një dhe i pandashëm dhe as Presidenti, e askush tjetër nuk ka mandat të negociojë për territorin e Republikës së Kosovës”.

Me votën tonë për këtë rezolutë, ne krijojmë siguri për qytetarët e vendit, dërgojmë mesazh miqësor te partnerët tanë se populli i Kosovës nuk ka vullnet për të diskutuar për këtë çështje dhe dërgojmë gjithashtu një kërkim-falje për këtë episod joserioz të Presidentit, dërgojmë mesazh te shqiptarët në Luginën e Preshevës se do të kërkojmë të drejtat e tyre, bazuar në parimin e reciprocitetit, dërgojmë mesazh te Serbia se pajtimi nuk bëhet me platforma të tilla për copëtimin e Kosovës.

Me këtë rezolutë ne vendosim një vijë të kuqe, më të rëndësishmen në këtë proces, në kuadër të dialogut me Serbinë.

Rezoluta nuk ka për qëllim ndalimin e dialogut. Dialogu duhet të vazhdojë, duhet të vazhdojë pas zgjedhjeve të reja, nga institucione legjitime, që flasin në emër të shumicës së qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, në emër të Grupit, Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Procesi i dialogut në mes të Kosovës dhe të Serbisë, i filluar që nga viti 2011, me qëllim të normalizimit të marrëdhënieve në mes të dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, edhe pse i ashtuquajtur teknik, por duke kaluar shpeshherë me të panjohura dhe jotransparencë, duke u

shndërruar në politikë dhe njëherësh duke anashkaluar shumë fakte të së kaluarës, në nuanca edhe të dobësimit të subjektivitetit të Kosovës, brenda dhe jashtë saj.

E gjithë kjo ndërlidhet edhe me paaftësinë e Kuvendit të Kosovës që ta mbajë përgjegjëse Qeverinë e Republikës së Kosovës, qoftë për të raportuar për mbarëvajtjen e dialogut, por edhe rritjes së llogaridhënies dhe transparencës para qytetarëve të Republikës sonë.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës është i përgjegjshëm para këtij procesi të rëndësishëm, duke e ruajtur partneritetin e krijuar me BE-në dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si proces i ndërlikuar, me kompleksitetet e veta nga e kaluara e afërt, ku Kosova dhe populli i saj ishin viktimë e dhunës dhe gjenocidit, por me vizion të qartë se alternativa e dialogut është e paevitueshme me fqinjët, qoftë edhe me Serbinë, por njëherësh në garanci të plotë të ndërmjetësimit, duke e ruajtur kushtetutshmërinë dhe fuqizuar ligjshmërinë në Republikën e Kosovës, duke garantuar liritë dhe të drejta për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë.

Zonja dhe zotërinj,

Në kohën kur Kosova po kalon 10-vjetorin e shtetësisë së saj, tema e dialogut ka marrë kah tjetër, diçka e cila në vazhdimësi konsiderohej si rrezik jo vetëm për Kosovën dhe pjesën ku jetojmë, por edhe për Ballkanin në tërësi, siç është lëvizja me kufijtë shtetërorë, duke aluduar në shkëmbim, korrigjim kufiri, që për ne nënkupton një përshkallëzim të rrezikshëm dhe provokues ndaj vetë shtetësisë së Kosovës, por edhe krijim i njëfarë ideje të ndarjes së brendshme, duke ndërlidhur edhe pjesën etnike të Kosovës Lindore, Preshevën, Medvegjën e Bujanocin.

Kjo ide e proklamuar nga presidenti i vendit, Hashim Thaçi, edhe nëse është ide e tij si president i vendit, konsiderohet si ide e keqe, jo në favor të popullit të Kosovës dhe e cila shihet si ide përçarëse dhe e dobësimit të subjektivitetit të brendshëm të Kosovës, nga e cila tanimë dëmi vetëm sa ka marrë efektin e vet, njëherësh këtu duke marrë për bazë edhe faktin se kësaj shtate i ka ndihmuar edhe pozicioni i dobët i koalicionit qeverisës, duke mos marrë përgjegjësitë e saj kushtetuese e logjike, të sanksionuara edhe me rezolutat e Kuvendit të Kosovës mbi procesin e dialogut.

Në demokracitë parlamentare është obligim yni dhe i institucioneve demokratike që të përfillet vullneti i qytetarëve, sidomos kur në pyetje vihen interesa të mëdha shtetërore, diçka për të cilën munda dhe sakrifica e tyre është përtej mandatit tonë, qoftë president, qeveri apo Kuvend. Kjo është treguar edhe nga anketat serioze pothuajse në shumicë absolute, edhe qytetarët e vendit janë kundër idesë së Hashim Thaçit dhe kujtdo qoftë që pretendon ndarjen, shkëmbimin apo korrigjimin e territorit të Kosovës.

Kolegë deputetë,

Kosova duhet të kalojë edhe këtë sfidë aktuale, ndryshimin e kësaj qasje, e cila nuk është në favorin tonë, as politike e as gjeostrategjik, mund të jetë në favor të interesave të individëve të caktuar, por jo i Kosovës dhe popullit të saj. Kjo temë dhe ide, e cila nuk e ka as mandatin kushtetues të negocimit nga presidenti i vendit, po shkakton dëme të mëdha në jetën institucionale të Kosovës, përpos ndarjes së brendshme, edhe me temat zhvillimore, duke i dhënë mundësi rritjes së krimit të organizuar dhe korrupsionit, deformimit të institucioneve vitale të Republikës së Kosovës dhe krijimit të imazhit të keq para botës demokratike, ku konsekuencat e saj po i vuajnë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe pjesa e ndershme e politikëbërjes në Kosovë.

Ne duhet të bëjmë të qartë pozicionin tonë për arritjen e marrëveshjes përfundimtare në raport të njohjes mes dy vendeve dhe sigurimit të të drejtave të popujve që jetojnë në këto pjesë tona. Kjo kërkohet edhe nga miqtë e vërtetë të Kosovës, nga vendet e BE-së, NATO-s, dhe sidomos nga SHBA-ja.

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së i jep përkrahje rezolutës së paraqitur nga iniciuesit. Njëherësh kërkon që të mbështetet pa dallim nga të gjithë deputetët e Kosovës, kjo ndihmon politikën e brendshme, forcon pozicionin tonë politik si shtet i ri dhe njëherësh e bëjmë të qartë para gjithë botës se Kosova është një, e pandashme dhe e patjetërsueshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra,

Të nderuar deputetë,

Pothuajse gjatë gjithë këtij viti Partia Demokratike e Kosovës ka bërë thirrje dhe ka ndërmarrë iniciativa konkrete për të përafruar qëndrimet politike dhe ndërpartiake, si dhe për të arritur konsensusin e nevojshëm nacional për tema të rëndësishme nacionale, veçanërisht për të hartuar një platformë shtetërore për dialogun Kosovë-Serbi, në mënyrë që si shtet në këtë proces të kemi qasje edhe qëndrime sa më të unifikuara, ashtu që t'i arrijmë qëllimet tona që duhet të konsistojnë me përfundimin e konfliktit të ngrirë me Serbinë, përmes arritjes së marrëveshjes obliguese ndërkombëtare, njohjen e ndërsjellë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe përsheptimin e integritetit në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

Përkundër këtij insistimi konstant të Partisë Demokratike të Kosovës, por edhe të partive të tjera të koalicionit qeverisës, partitë opozitare kanë refuzuar deri tash që të bëhen pjesë e këtij

konsensusi të kërkuar nacional. Në emër të PDK-së, kryetari Kadri Veseli ka prezantuar publikisht dhe zyrtarisht një propozim-plattformë, të cilën ua kemi shpërndarë të gjitha partive politike dhe liderëve politikë. Fillimisht e kemi prezantuar në tryezën e 8 majit të këtij viti, të mbajtur në këtë Kuvend dhe më pas ua kemi dorëzuar zyrtarisht edhe më 13 korrik. Shumë kohë para se të propozohej në debat parlamentar, ky dokument i ka propozuar që nga parimet themelore e deri te vijat e kuqe për dialogun. Ne konsiderojmë se refuzimi për t'u bërë pjesë e dialogut mund të dëmtojë seriozisht pozicionin negociues të shtetit tonë në këtë proces dialogues dhe në ballafaqimin tonë si shtet përballë Serbisë. Ky refuzim mund të shihet edhe si refuzim ndaj partnerëve ndërkombëtarë të Kosovës, para së gjithash ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian, të cilët janë jo vetëm insistuesit më të mëdhenj për fazën finale të dialogut, por edhe garantuesit e këtij dialogu dhe marrëveshjes potenciale që mund të burojë prej tij.

Sa i përket dialogut me Serbinë, qëndrimi i Partisë Demokratike të Kosovës është konsistent dhe i qartë. Ne jemi pro dialogut, si mënyra më e mirë për arritjen e qëllimeve tona si shtet, por në asnjë mënyrë nuk do të lejohet cenimi i sovranitetit dhe i shtetësisë së Kosovës, integritetit territorial të shtetit tonë, i funksionimit unitar të shtetit dhe i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Po ashtu, çfarëdo marrëveshje që mund të arrihet me Serbinë, nuk mund të jetë e vlefshme pa u ratifikuar me votat e 2/3 të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Të gjithë ata që sot spekulojnë për ndarje të Kosovës, për shkëmbime terrioreve me Serbinë, pa asnjë bazë e pa asnjë fakt, janë duke shkaktuar qëllimshëm panik dhe huti në mesin e qytetarëve të Kosovës. Ne si Grup Parlamentar i PDK-së konsiderojmë se ngritja e kësaj teme të rrezikshme në diskursin e brendshëm politik do ta dëmtojë Kosovën në procesin e dialogut, duke krijuar argumente pikërisht në favor të preponentëve anti Kosovë që dëshirojnë ndarjen e Kosovës. Po ashtu, përveç temës së ndarjes, rreziku më i madh që i kanoset sot Kosovës është mundësia e krijimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive që do të shënonte edhe një lloj bosnjëzimi të Kosovës. Ky Kuvend do të duhej që në mënyrë të qartë dhe të vendosur të shprehë qëndrimin që një gjë e tillë nuk do të ndodhë. Prandaj, ne besojmë se konsensusi për dialogun me Serbinë është më shumë se i dëshirueshëm, është përgjegjësi e të gjitha partive politike, para së gjithash atyre të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, kontributin për këtë proces e shohim si një obligim që e kemi të gjithë karshi vendit dhe qytetarëve tanë.

Është e natyrshme dhe krejtësisht e mirëkuptueshme që të kemi dallime në vlerësimet tona për procesin e deritashëm, por edhe dallime në konceptet tona politike qeverisëse. Megjithatë, mbyllja e një kapitulli të mosmarrëveshjeve me një shtet fqinj, përfundimi i konfliktit të ngrirë që kemi me Serbinë, duhet të jetë pikë që na bashkon, para gjithash përcaktimi dhe arritja e qëllimeve konkrete nga përfundimi i dialogut, siç është anëtarësimi i Kosovës në OKB dhe procesi integruar i vendit tonë në BE, duhen të jenë pikat e konsensusit tonë të përbashkët. Është

qëndrim i qartë edhe i Partisë Demokratike të Kosovës që Kuvendi i Kosovës të ketë rolin e mbikëqyrjes dhe vendimmarrjes finale në këtë proces të rëndësishëm dhe mbi këtë parim, me të cilin besoj që duhet të pajtohemi të gjithë, duhet të ulemi dhe të punojmë bashkë, në mënyrë që të kemi një platformë të përbashkët dhe një ekip të përbashkët përfaqësues.

Edhe në të kaluarën marrëveshjet e arritura në Bruksel janë ratifikuar në këtë Kuvend me 2/3 e votave të deputetëve të tij, kjo do të ndodhë edhe me marrëveshjen që potencialisht mund të arrihet në përfundim të kësaj faze finale të dialogut. Por, dua të përsëris se kjo fazë dallon nga fazat e mëhershme, kjo fazë do ta përmbyllë dialogun me Serbinë dhe do të prodhojë një marrëveshje ndërkombëtare të obligueshme si për Kosovën, ashtu edhe për Serbinë, e njëjtë edhe për Bashkimin Evropian që do të jetë jo vetëm ndërmjetës, por bashkë edhe me SHBA-në, edhe garantues i zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Se cila do të jetë marrëveshja është një çështje që na takon të gjithëve këtu, por për ta nxjerrë më të mirën e mundshme neve na duhet që t'i qasemi bashkërisht dhe përtej pozicioneve partiake këtij procesi. Pozicioni i Kosovës në dialog fuqizohet vetëm nëse arrihet një konsensus apo një gjithpërfshirje. Ne do të jemi më të dobët nëse në Bruksel shkojmë në mënyrë të fragmentuar. Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë duhet të ndodhë, prandaj është mirë që koncentrimi ynë, fokusi ynë të jetë në përmbajtjen e dialogut, në qëndrimet e Kosovës në këtë proces. Nëse merremi vesh për këtë, është shumë më e lehtë të pajtohemi për formatin dhe për mënyrën e përfaqësimit tonë. E rëndësishme është që të mos i ikim përgjegjësisë asnjëri, sepse këtë herë s'po flasim për një temë që ka efekte për një mandat, e prej të cilave mund të humbë apo të përfitojë politikisht një parti apo tjetër. Sot po flasim për përmbylljen e konfliktit me Serbinë që do të duhej të ketë efekt të përhershëm dhe që do të krijonte një kontest të ri politik në rajon, që do të mundësonte paqen për të gjithë dhe integrimin e gjithë rajonit në Bashkimin Evropian.

Në kuadër të diskutimeve të sotme, në emër të koalicionit qeverisës, ne sot do të propozojmë pikat që mendojmë se duhet të jenë baza e një rezolute që mund të dalë nga debati i sotëm. Këto pika besojmë se përfaqësojnë mënyrën më të mirë, qëndrimet e shprehura publikisht nga pothuajse të gjitha partitë politike. Propozimet tona janë si vijon:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës i jep mbështetje vazhdimit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si mënyra më e mirë për arritjen e një marrëveshjeje ndërkombëtare obliguese ndërmjet të dy shteteve, që do të rezultonte me njohjen e ndërsjellë shtetërore të të dy palëve dhe me anëtarësimin e Republikës së Kosovës në OKB, si dhe me përshejtimin e integritit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

2. Kuvendi i Republikës së Kosovës do të angazhohet për arritjen e konsensusit të brendshëm politik për dialogun Kosovë-Serbi, duke përfshirë platformën e përbashkët për dialogun që do të

përmbajë parimet themeltare dhe pozicionet shtetërore të Republikës së Kosovës për të gjitha çështjet që ndërlidhen me këtë proces.

3. Kuvendi i Republikës së Kosovës themelon një komision të veçantë me përgjegjësi për ta monitoruar nga afër procesin e dialogut dhe punën e delegacionit të Republikës së Kosovës. Ky komision do të përbëhet nga kryetarët e grupeve parlamentare dhe do të udhëhiqet nga një përfaqësues i opozitës.

4. Delegacioni i emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, i plotësuar edhe me përfaqësues të partive opozitare, që do të përfaqësojë Republikën e Kosovës në dialog, do t'i raportojë rregullisht komisionit të veçantë për monitorimin e dialogut mbi ecurinë e këtij procesi dhe zhvillimet e tij.

5. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka rol qendror dhe vendimtar në dialogun Kosovë-Serbi. Marrëveshja eventuale që mund të arrihet nga faza përfundimtare e dialogut Kosovë-Serbi mund të jetë e vlefshme vetëm pas ratifikimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës me votat e 2/3 të të gjithë deputetëve ose nëse merr mbështetjen e shumicës së qytetarëve përmes referendumit.

6. Kuvendi i Republikës së Kosovës rithekson se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, sovraniteti shtetëror, integriteti territorial dhe karakteri shtetëror unitar i Republikës së Kosovës janë të pacenueshme dhe vetëm Kuvendi i Republikës së Kosovës ka autoritet dhe kompetencë për të vendosur për këto çështje.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, shpresoj se do të kemi një debat konstruktiv dhe me qëllim të sigurtë të arritjes së konsensusit politik për çështje që ndërlidhen me këtë temë kaq të rëndësishme dialogut Kosovë-Serbi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lëvizja Vetëvendosje, Glauk, se s'u lajmërua askush. Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,
Qytetarë të Republikës,

Nuk është krejt problemi te kjo çështja se Presidenti e ka hapur një temë të papranueshme, kjo është pjesë e problemit, por unë konsideroj që problemi shkon përtej kësaj. Nuk është, pra vetëm që Presidenti ynë e ka hapur një temë tronditëse, si lëvizjen e kufijve, po që mbi të gjitha, këtu kemi të bëjmë me lëkundjen dhe me shkundjen e sistemit politik të Republikës së Kosovës dhe të rendit kushtetues të Republikës tonë, të shtetit tonë.

Meqë ne e dimë se si është e rregulluar shteti ynë dhe me Kushtetutë i ka tri pushtete dhe presidenti nuk është pushteti i katërt, nuk është njëri prej pushteteve. Por, jo vetëm që është dhe

po sillet si njëri prej pushteteve aktualisht në Kosovë, po ai e ka keqkuptuar mandatin e tij si president. Po sillet bash sikur monark absolut, monarkët absolutë të para 200-300 vjetëve nëpër Evropë e kanë konsideruar territorin pronë të veten private, personale. Domethënë, kanë pasur të drejtë të bëjnë me territor çka të duan ata. Kur e dëgjon Hashim Thaçin, për shembull, që i thotë delegacionit gjerman se ‘unë e di çka bëj me territorin e Kosovës, sepse mua më takon kjo çështje’, kjo është tipike për një person, i cili e ka keqkuptuar mandatin e tij si President i Republikës së Kosovës.

Ky president ka bërë shumë dëme tashmë, të cilat i kemi vështirë t’i rikuperojmë në vitet e ardhshme, por sidomos unë e konsideroj dëmin e tij të parë para nja 2-3 vjetëve që e imponoi si terminologji politike, po ju kujtohet, koncepti i finales me Serbinë. Ky ishte shumë gabim i madh, finalen me Serbinë Kosova e ka kryer në vitin 2008 dhe Serbia është ankuar për rezultatin e ndeshjes, të cilin Kosova e ka fituar në vitin 2008, është ankuar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë për rezultatin e kësaj beteje. Edhe gjykata...

(Ndërhyrje)

Dardan, a mund të mos më pengosh kur jam duke folur! Jo, s’jemi në debat këtu.

KRYETARI: A ka mundësi të mos ketë ndërhyrje... Kur dëshironi fjalën, keni të drejtë. Urdhëro, kryetar i grupit!

GLAUK KONJUFA: Serbia është ankuar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë edhe gjykata i ka dhënë të drejtë fitores së Kosovës.

Këtu ka përfunduar finalja e Kosovës me Serbinë, nuk ka finale tjetër, kushdo që mundohet ta zbulojë mes Kosovës edhe Serbisë. Këtu ka përfunduar ndeshja kryesore mes Kosovës dhe Serbisë. Ai që thotë “do ta luajmë edhe një finale” dhe rezultati nuk dihet dhe nuk ka vija të kuqe e gjithçka është e mundshme, unë mendoj që ia ka shkaktuar dëmin më të madh shtetit të Kosovës, e ky është Presidenti që aktualisht është duke e bërë këtë punë. Siç dihet, krejt kjo filloi para tre muajsh, në qershor të këtij viti, kur Presidenti ynë doli e tha se nuk ka vija të kuqe me Serbinë. Çka i bie kjo? Kjo i bie që në tavolinë të bisedimeve mund të flitet gjithçka, kjo i bie që Presidenti ynë jo vetëm që nuk ka mandat, por nuk ka shkuar atje dhe me plan se çka duhet të mbrojtë dhe çka është e panegociueshme, ai mendon që gjithçka është e negociueshme, për shkak se kur thua ‘nuk ka vija të kuqe’ më dhe të gjitha zgjidhjet do të jenë në tavolinë, kjo i bie që as statusi i Kosovës më nuk është i padiskutueshëm. Në Kosovë gjithmonë kanë qenë të nënkuptueshme disa tema, të cilat nuk i kemi bërë as llaf, tash këtu përnjëherë u bënë të gjitha të diskutueshme. Kjo gjë është kthim prapa, kthim prapa për Kosovën në pozicionin e vet ndërkombëtar.

Gabimi më i rëndë i një udhëheqësi është kur me gojën e vet e qet në pikëpyetje shtetin që përfaqëson, atëherë kur i konteston kufijtë e vet. Kosovën gjithmonë e ka kontestuar veç Serbia, ne e dimë këtë gjë, me këtë jemi mësuar, ama për herë të parë një president i Kosovës i ka kontestuar kufijtë e vet. Kjo ia mundëson Serbisë që t'u thotë faktorëve ndërkombëtarë që për Kosovën diçka nuk është në rregull dhe që dialogu po vazhdon. Prandaj, kjo me të vërtetë i ngadalëson dhe ua jep një goditje të pakthyeshme edhe procesit të njohjeve të Kosovës, sepse nëse krejt njohjet kanë ndodhur për shkak se Kosova po e kompletton shtetin e vet, tash për një moment del edhe krejt drejtimi politik ndërron, krejt drejtimi politik i temave që ne i flasim në Kosovë. Me të vërtetë, kjo është... le të themi një favor i jashtëzakonshëm për Serbinë, jo vetëm në aspektin politik, por edhe në aspektin ekonomik me siguri që kjo e dëmton shtetin e Kosovës veç pse është hapur si temë, e dëmton shtetin e Kosovës sepse edhe investitorët e huaj natyrisht, se nuk kanë qejf të shkojnë në një shtet i cili ende nuk i ka rregulluar punët e veta dhe i ka të hapura shumë çështje, qysh po thotë presidenti, duke e përfshirë edhe çështjen e kufijve.

Këtu në Kosovë ne e dimë që ka ekzistuar gjithmonë, prej vitit 1999, një projekt i qartë, projekt edhe vendor edhe ndërkombëtar. Projekti i cili nuk ka pasur diskutim ka qenë “Kosova shtet i pavarur edhe republikë me sovranitet të plotë dhe të kompletuar dhe me subjektivitet në arenën ndërkombëtare”, ky ka qenë projekti i vetëm. Tash, në momentin që zbulohet një projekt tjetër edhe është alternativ ndaj këtij projekti politik, unë besoj që këtij të parit ia jep një goditje që është shumë e rrezikshme për vendin tonë. Pikërisht, pse ishte ky projekt prej vitit 2011 këtu na thanë që po e shpërbëjnë strukturat e Serbisë, po e bashkojnë veriun e Kosovës, u krijua edhe një fond zhvillimor për veriun e Kosovës, aty derdhen milionë euro që i kontribuon bashkimit të Kosovës, u hoqën barrikadat, po thonë bile që edhe ura mbi lumin Ibër ka për t'u hapur një ditë, kështu është projekti, anëtarët e BIA-s u integruan me uniforma në Policinë e Kosovës, pjesëtarët e inteligjencës u integruan në inteligjencën e Kosovës, mbrojtja civile thanë u shpërbë, më duket. E pas krejt këtyre gjërave, pas krejt këtij procesi të suksesshëm, ku edhe gjyqtarët dhe prokurorët e kanë bërë betimin para Hashim Thaçit, tash para krejt kësaj po u dashka me e nda Kosovën. Kjo është e paimagjinueshme, kjo është e pakuptueshme, e pafalshme.

Mendoj që Rezoluta aktuale është e mirë, por unë mendoj që edhe një pikë tjetër do ta bënte rezolutën edhe më të mirë, jo vetëm që thjesht Hashim Thaçit t'ia kufizojmë temat që ai i flet, por unë mendoj që me një pikë të rezolutës Hashim Thaçit duhet t'ia kufizojmë çdo takim me Serbinë. Vetëm atëherë kjo është rezolutë e vërtetë. Një pikë në rezolutë duhet të thotë që “Hashim Thaçi më kurrë nuk bën të takohet me Serbinë”, e para dhe “Asnjë vendim të mos e marrë në dialogun me Serbinë për Republikën e Kosovës.” Vetëm atëherë, kur të implementohet kjo pikë, ne si qytetarë të Kosovës mund të jemi të lirë në procesin e dialogut me Serbinë.

Unë e përshëndes përndryshe edhe qëndrimin e PDK-së këtu, që e kanë kuptuar që asociacioni është bosnjëzim i Kosovës. Këtë Vetëvendosja e ka thënë që 13 vjet, kështu që më vjen mirë që faktikisht edhe kjo çështja e asociacionit po interpretohet si bosnjëzim i Kosovës. Veç mos

harroni që Hashim Thaçi na pat thënë që kjo është një OJQ, nuk është hiq e rrezikshme, nuk i bën dëm Kosovës. Kur ju pat shti juve me votua me zor, ju pat shti me idenë që është OJQ, tash po më vjen shumë mirë që e keni kuptuar që nuk është OJQ, është projekt shumë i rrezikshëm për Kosovën dhe duhet të kundërshtohet me çdo mjet.

KRYETARI: Memli Krasniqi, replikë! Pastaj Visar Ymeri bëhet gati, Partia Socialdemokrate.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti Konjufca, për vlerësimin!

Në fakt, ka një dallim esencial në mes asaj që ti iu referove dhe që është mbështetur fillimisht nga Partia Demokratike e Kosovës, marrëveshjen e prillit 2013 dhe ku janë vendosur parimet për themelimin e asociacionit, i cili në asnjë mënyrë nuk mund dhe s'duhet të ketë as në perceptimin tonë kurrë nuk është mbështetur që të ketë çfarëdolloj kompetence përtej atyre që parashihen me ligjet e Kosovës dhe që nuk i japin asnjë mundësi kompetencave ekzekutive dhe në momentin e nënshkrimit e marrëveshjes tjetër, e cila i është dërguar Gjykatës Kushtetuese. Qëndrimi ynë ka qenë konsistent, që çfarëdo që thotë Gjykata Kushtetuese është obligative për secilin përfaqësues politik në Kosovë e para së gjithash, për deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Kështu që, Gjykata Kushtetuese në vlerësimin e saj i ka gjetur ato pika që kanë qenë në kundërshtim me frymën kushtetuese dhe qëndrimi i PDK-së ka qenë konsistent në mbështetje të asaj që është nënshkruar fillimisht e që s'i jep asnjë kompetencë ekzekutive dhe në kundërshtim të plotë me çfarëdolloj lëvizje, përtej atyre qëndrimeve që kanë qenë pjesë e marrëveshjeve origjinale. Në asnjë mënyrë nuk e kemi mbështetur gjenerozitetin që është treguar në marrëveshjen e dytë dhe që normalisht e ka pamundësuar dhe legalisht Gjykata Kushtetuese.

Kështu që, nëse u referohesh atyre diskutimeve të vitit 2013 ato qëndrojnë, por nuk mund t'u referohesh atyre diskutimeve duke u thirrur te vlerësimi që ka dhënë Gjykata Kushtetuese e i cili për ne është 100% valid. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kundërreplikë, Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Mendoj që kishim mundur të mos vinim hiq deri në këtë pikë të vështirë, sa i përket asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë. Pra, gabimi është bërë natyrisht në vitin 2013, kur këtu është miratuar me 80 vota një marrëveshje e cila jo vetëm që e themelon asociacionin e komunave serbe, por edhe disa fusha që i specifikon aty janë shumë problematike për Republikën e Kosovës dhe ne atëherë e kemi kundërshtuar këtë proces. Mirëpo, në vitin 2015 është bërë gabimi i dytë, kur është shkuar shumë më larg se sa kjo marrëveshje e vitit 2013.

Po të ishte Qeveria atëherë më e përgjegjshme dhe të mos kishte hyrë fare në bisedime me Serbinë, ku mund të përvijoheshin konturat e një niveli të tretë të pushtetit në Kosovë, ne do t'i kishim punët shumë më mirë sot.

KRYETARI: Visar Ymeri, nga Partia Social Demokrate, në emër të grupit parlamentar.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Është mirë, mendoj unë, që sot më në fund, do të thosha, po vijmë në Kuvend për të diskutuar një çështje e cila është jashtëzakonisht, edhe e rëndësishme, por edhe e ndjeshme për qëndrueshmërinë e Republikës së Kosovës, pra dialogu i shumëpërfolur me Serbinë.

Por, fatkeqësisht, sikur herët tjera edhe tash, diskutimin edhe e kemi hapur edhe e kemi kapur prej bishtit. Ka disa muaj tashmë që jemi përqendruar në atë se çka nuk pranojmë ne si Kosovë e kurrë nuk kemi marrë kohën të flasim për atë se çfarë duam, pra çka synojmë të arrijmë. Sikur herëve tjera, të tjerët kanë projekte e ne shndërrohemi në pranues, herë pasivë e herë aktivë, herë me kundërshtime e shpeshherë pa to, të projekteve të të tjerëve për vendin tonë. Këtë radhë e kishim mundësinë ta bëjmë ndryshe.

Që prej 12 korrikut grupi ynë parlamentar ka kërkuar debat e votim rezolute, përmes së cilës vendimmarrja për dialogun do t'i kalonte ekskluzivisht në përgjegjësi Kuvendit, kështu do t'i hapnim rrugë që Kuvendi ta diskutonte, përpilonte e miratonte platformën shtetërore për dialogun, e cila pastaj do t'i ravijëzonte qartë parimet udhërrëfyese të mbrojtjes së Republikës e avancimit të interesit të Republikës në këtë fazë të dialogut dhe si platformë e si Kuvend do të siguronim që kjo vërtet të jetë faza përfundimtare e dialogut me Serbinë, si dhe pastaj mandatimin e përfaqësimit të Kosovës në dialog.

Mirëpo, dhe këtë e them me fatkeqësi, shkurtpamësia dhe inatet fëmijërore në njërën anë, e joserioziteti, në anën tjetër, e spostuan këtë diskutim e vendimmarrje deri në këtë pikë ku jemi sot. Po, besoj, megjithatë kemi ende, por duhet ta dimë se jo edhe aq shumë, siç po mendojmë. Vullnet e seriozitet shpresoj të fillojmë të kemi nga sot.

Cili është diskutimi kryesor që duhet ta bëjmë? Çfarë shoqërie duhet të ndërtojmë në vendin tonë e pastaj çfarë shteti për këtë shoqëri duam ta kemi? Ne duhet ta mendojmë, mendoj unë, në shumë pika dhe ta rimendojmë Republikën tonë, në mënyrë që ajo të bëhet republikë e qytetarëve të barabartë, që i akomodon interesat e të gjithë qytetarëve pa dallim, që eliminon frikën dhe mbjell shpresën, që garanton siguri e mirëqenie për të gjithë. Kjo republikë duhet të garantojë drejtësi shoqërore e mbrojtje të veçantë për të gjitha grupet e marginalizuara e të

përrjashtuara, në mënyrë që ta krijojmë kështu një të tillë dinamikë shoqërore, që zhduk identifikimin etnik në politikë, në mënyrë që qytetaria të jetë marrëdhënia e vetme politike në mes individit dhe shoqërisë, individit dhe shtetit dhe individëve në mes vete.

Vetëm kjo republikë do të ishte interes i qytetarëve dhe i të gjithëve që jetojnë në të dhe kështu natyrisht, edhe i pakicave që jetojnë në të e veçanërisht i pakicave, do të thosha. Të drejtat e tyre nuk mund të mbrohen nga një shtet jofunksional, që nuk prodhon ekonomi as mirëqenie, që nuk e ka aftësinë të ofrojë siguri e drejtësi. Ne duhet të insistojmë që jemi përgjegjës për mirëqenien e secilit qytetar të Republikës. Ne nuk i dallojmë këta qytetarë në bazë të emrit e mbiemrit, as në bazë të gjuhës që flasin, ngjyrës së lëkurës që kanë, gjinisë së cilës i takojnë mënyrës se si besojnë e luten, përcaktimit të tyre seksual. Të gjithë njerëzit, pra janë të barabartë.

Kjo është e vërtetë në Kosovë, siç është e vërtetë në Shqipëri, siç duhet të jetë e vërtetë në Serbi, siç duhet të jetë e vërtetë në Maqedoni, në Mal të Zi e në secilin vend tjetër.

Të drejtat dhe mekanizmat institucionalë që akomodojnë veçantitë e grupeve kombëtare shoqërore në Kosovë, duhet të mirëmbahen dhe të avancohen përbrenda kornizës republikane të vendit tonë, karakterit unitar të saj, integritetit territorial e sovranitetit të vendit, barazisë së qytetarëve, të gjitha këto, natyrisht parimet bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të rendit kushtetues të kësaj republikës sonë.

Pra, përbrenda funksionalitetit të Republikës duke mos e cenuar dhe veçanërisht duke u kujdesur që të mos defunksionalizohet karakteri unitar e mirëqenia e hapësira për qytetarët në këtë republikë.

Mendoj që kjo duhet të jetë ajo Kosovë që e synojmë dhe është pikërisht kjo Republikë e Kosovës ajo që i pengon më së shumti Serbisë, sepse kështu ajo humb fuqinë e vet instrumentalizuese karshi serbëve në Kosovë, përmes të cilit instrumentalizim Serbia synon etablimin e pozitës hegjemone për vete karshi Kosovës e rajonit. Këtë duhet ta dimë të gjithë. Nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme, pa bashkëpunim të sinqertë e në kushte barazie në mes vendeve të rajonit. E nuk mund të ketë bashkëpunim pa marrëdhënie reciprociteti në mes vendeve të rajonit, siç nuk mund të ketë marrëdhënie reciprociteti e fqinjësie të mirë, pa njohje reciproke. Prandaj, njohja formale nga Serbia është kushti i domosdoshëm që duhet plotësuar përmes këtij dialogu. Duke qenë kusht i domosdoshëm është njëkohësisht edhe kusht i patejkalueshëm që duhet të jetë për Republikën e Kosovës e që duhet të jetë udhërrëfyese kryesor i këtij procesi të dialogut dhe qasjes së Republikës së Kosovës në të.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Sot megjithatë duhet se e kemi një situatë pak më ndryshe në Kuvendin e Republikës karshi kësaj çështjeje. Për shembull, jemi më shumë deputetë seç kemi qenë tash e një kohë. E dyta,

kam parë që grupet parlamentar, veçanërisht kur Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka filluar t'i pranojë parimet bazë të cilat i kishte propozuar Partia Socialdemokrate në një kohë shumë më gjatë, siç e përmenda prej 12 korrikut 2017. Tash natyrisht që duhet ta bëjë një evokim të shkurtër në kohë, për këtë kohë që e kemi humbur dhe për të treguar rëndësinë që e kemi pasur ose që e ka kjo kohë për këtë që po diskutojmë sot.

Po ta miratonim rezolutën më 12 korrik siç kemi kërkuar ne, që prej asaj dite, Kuvendi i Republikës së Kosovës do ta kishte edhe formalisht përgjegjësinë dhe rolin drejtues në procesin e dialogut me Serbinë. Që prej asaj dite, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të dakordohet dhe do t'i krijonte trupat të cilat do të merreshin me diskutimin dhe përpilimin e propozim platformës shtetërore e cila do të votohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Natyrisht që deri tash kur po flasim ne do ta kishim platformën e votuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe do ta kishim legjitimitetin e plotë demokratik për procesin e dialogut dhe do ta përmbushnim edhe pikën e tretë që është paraparë në rezolutën tonë e që ka qenë përfaqësimi i Republikës së Kosovës në dialogun me Serbinë.

Po ashtu, do ta kishim tashmë funksional Komisionin për mbikëqyrjen e procesit të dialogut.

Pra, Kuvendi i Republikës së Kosovës do t'i kishte përgatitur të gjithë mekanizmat e vet institucionalë të domosdoshme për këtë proces të dialogut si dhe më me rëndësi do të merrej vesh politikisht mes grupeve politike bashkë edhe me shoqërinë e Republikës së Kosovës për atë se çka propozon dhe çka dëshiron Republika e Kosovës të arrijë në dialogun me Serbinë si dhe cili është ai mision i joni politik për të ardhmen e Republikës së Kosovës që do të realizohej në udhërrëfyesin e platformës shtetërore në parimet udhërrëfyese që do t'i kishte kjo platformë.

Pra, sot do të diskutonim për diçka krejt tjetër prej asaj që po diskutojmë. Sot do të diskutonim për atë se sa kemi avancuar dhe sa jemi dakorduar ne se si do ta mbrojmë interesin e Republikës së Kosovës në këtë proces të dialogut e jo ende të ankohejmë këtu se si njëri prej nesh, pra në këtë rast Presidenti Thaçi po e shkel logjikën dhe funksionin institucional të Republikës së Kosovës, duke shkuar krye në vete dhe duke diskutuar tema të cilat qartazi janë të papranueshme për të gjithë ne këtu sa i përket dialogut me Serbinë dhe diskutimeve që po i bën Presidenti Thaçi atje. Pra, po të miratohej kjo rezolutë, sot ne do të ishim në një gjendje tjetër për sa i përket përgatitjeve për dialogun me Serbinë dhe do ta kishim një pozicion shumë më të fortë dhe më institucional karshi Serbisë në këtë proces të dialogut.

Prapë po them, nëse vazhdojmë të humbim kohë duke i mbajtur pak a shumë të njëjtat qëndrime dhe duke mos pasur gatishmëri që të ulemi bashkë dhe të merremi vesh për interesin e Republikës së Kosovës pikë së pari, atëherë natyrisht që në këtë proces të dialogut rrezikojmë të humbim shumë, jo vetëm territor e pjesë të shtetësisë tonë e ku ta di unë çka tjetër mund t'i bjerë në mend Hashim Thaçit gjatë këtyre ditëve për sa kohë ne po flasim.

Prandaj, edhe një herë unë bëj ftesë natyrisht që rezoluta e propozuar në këtë rast nga të tri grupet parlamentare, e që e lexoi zoti Abdullah Hoti, dhe për të cilën duhet të them megjithatë për hir të korrektësisë ka një ndryshim me të cilin Partia Socialdemokrate nuk është konsultuar fare. Po, kjo rezolutë është paraqitur nga të tria grupet në fillim, mirëpo pastaj ka pësuar disa ndryshime në formë, pra të jemi korrekt jo në përmbajtje, por për të cilat nuk jemi fare të konsultuar.

Sidoqoftë mendoj se kjo rezolutë është një rezolutë e cila duhet dhe bën të plotësohet. Pra duhet të plotësohet edhe me propozime të tjera të grupeve të tjera parlamentare në mënyrë që ajo pastaj të bëhet e votueshme nga të gjithë përfaqësuesit ose deputetët e grupeve parlamentare në këtë Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, kryetari i Grupit Parlamentar, Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: I nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar,

Ne jemi ngopur me rezoluta që disa muaj me radhë të sjella në Parlament nga secili grup parlamentar për të bërë protagonizëm dhe për të mbajtur fjalime patetike në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Qëndrimet janë krejt të qarta, nëse doni ta bëni një rezolutë të përbashkët, urdhëroni nga të gjithë propozimet që janë bërë, ulemi bashkë, e harmonizojmë rezolutën dhe Kuvendi e miraton. Nëse nuk keni ndonjë vendim tjetër për të bërë politikë sa për lojë.

Dihet qëndrimi kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës që përfaqëson Partinë Demokratike, e ka thënë publikisht, dihet qëndrimi i kryeministrit të Republikës së Kosovës, i cili e ka thënë shumë qartë dhe prerë se cili është mendimi ynë për çështjen e territorit të Kosovës, për çështjen e integritetit, sovranitetit dhe ruajtjes së vlerave të këtij shteti. E dimë edhe qëndrimin e Nismës si parti në koalicion, e dimë qëndrimin po ashtu edhe të partive të minoriteteve joserbe, e dimë edhe qëndrimin natyrisht të serbëve që ata e dëgjojnë Beogradin çka thotë dhe gjërat janë krejt të kthjellëta vetëm a duam ta kemi një rezolutë të përbashkët që obligohet delegacioni i Kosovës, i Qeverisë në këtë rast, i kompletuar edhe me përfaqësues të opozitës, që merr përsipër çështjen e bisedimeve me Serbinë, duke pasur parasysh se duhet të rezultojë me njohje reciproke të dy shteteve mes vete.

Po ashtu, kemi edhe platformën që mund ta bëjmë përmes rezolutës që nxirret në Kuvendin e Kosovës dhe shkojmë më tutje mos i terrorizuar edhe më tej qytetarët duke iu mbajtur fjalime koti, por hajde ulemi e bëjmë platformën, e bëjmë ekipin dhe i kryejmë punët tona.

Një gjë është themelore, është se Kushtetuta e Republikës së Kosovës e thekson shumë mirë se si duhet të mbrohet integriteti, sovraniteti dhe territori i vendit. Prandaj të mos bëjmë shumë fjalë sa për të luajtur politikë, por ta sqarojmë deri në fund, ta bëjmë rezolutën, ta votojmë në Parlamentin e Kosovës me dy të tretat e votave, ashtu siç po kërkohet, dhe shkojmë më tutje, dhe nuk ka nevojë të bëjmë më tutje seanca për rezoluta të partive të ndryshme që sjellin në Parlamentin e Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Lista serbe nuk është këtu. Atëherë, nga Nisma, Bilall Sherifi, kryetar i Grupit Parlamentar.

BILALL SHERIFI: I nderuar kryesues dhe Kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

I ka tre muaj që në këtë Kuvend kemi filluar të debatojmë se si ta ndalim Presidentin e Republikës së Kosovës që të flasë me Serbinë për territor.

Ka tre muaj që e bëjmë këtë debat në Kuvend, e bëjmë këtë debat në studio televizive, por nuk ka gatishmëri nga po ata që t'i hyjnë një debati si ta ndalim Serbinë. Kur vijmë këtu te kjo pikë themi njëherë duhen zgjedhje pastaj flasim për të tjerat. Si të themi, pikënisje pushteti.

Pra, me neve jemi të mirë mazhoranca që ta ndihmojmë opozitën ta ndalim Presidentin që të mos flet për territore, ama kur vjen puna që të bëhen bashkë me neve për ta ndalë Serbinë, thonë jo ju nuk jeni mirë, ju nuk mjaftoni më, duhet të shkojmë në zgjedhje.

Pra edhe një herë po e them, problemi zgjedhjet përmes të cilave derivon pushteti. Dakord, edhe këtu jemi në rregull. Ama nëse tash dëshironi që këtu të dilni si shpëtimtar të Kosovës, atëherë duhet të pranoni faktin se nuk jeni mjaft për ta shpëtuar Kosovën, ju duhemi ne. E po si mund të shpëtohet Kosova nga ju bashkë me ne të këqijtë, të cilët nuk po mundeshim të bëhemi bashkë ta ndalim projektin e Serbisë për të marrë territore për të krijuar Zajednica, për të krijuar komuna me shumicë, nëpërmjet të cilave nesër e ushtron influencën e vet.

Pra le të flasim hapur. Nuk jemi shumë të sinqertë në këtë çështje. Unë mendoj, në emër të Nismës këtu, se në emër tim do të kisha thënë ndoshta pak më shumë, por në emër të Nismës do të jem më korrekt dhe do të them kështu: nëse jemi gati që të ndalim një projekt për të cilin është folur gjithkrah joformalisht fatmirësisht, pra në aspekte joformale. Formalisht zyrtarisht përderisa ky Kuvend nuk ka marrë në vendim, askush nuk mund të llogaritet se dikush ka filluar një proces të tillë.

Atëherë le të mos kufizohemi vetëm në atë çka nuk kanë institucionet e tjera, përkatësisht Qeveria, Presidenti, çka nuk kanë të drejtë të bëjnë, por t'u tregojmë se çka ata duhet të bëjnë, t'ua shkruajmë të zezë në të bardhë se për çka kanë të drejtë të flasin, se për çka kanë të drejtë të arrijnë marrëveshje dhe çka eventualisht ky Kuvend do të mund të ratifikonte në një moment të caktuar kur një marrëveshje do të mund të arrihet.

Pra, le të lëvizim nga ky pozicion aktual të cilin e kemi dhe të le të shfrytëzojmë këtë moment, këtë seancë, që të bëjmë këtë rezolutë.

Gjithsesi ju keni parë që Nisma mbështet fuqishëm kërkesën që të mos flitet për territor. Të njëjtën gjë e kanë bërë edhe partitë e tjera të koalicionit, me një theks të shtuar edhe Kryeministri i vendit. Pra ajo pikë është në propozimet për rezolutën e juaj, që territori i Kosovës është i pacenueshëm, mund ta fusim edhe i panegocueshëm, asnjë problem nuk e kemi në atë, por rezoluta të jetë gjithëpërfshirëse edhe me pika të tjera.

Le të fillojmë nga ky moment, që përpos të ndalojmë, të tregojmë, t'i hedhim disa pika se çka duhet të diskutohet. Unë mendoj se në atë që e lexoi Memli, e kemi bërë së bashku, ato janë propozime tona të përbashkëta, që do t'ua paraqesim propozuesve të kësaj rezolute dhe të ulemi ta harmonizojmë pastaj të gjithë së bashku.

Thash, kthehem sërish në pikën fillestare, mund ta shpëtoni bashkë me neve nëse është në rrezik siç thoni ju, por nëse doni ta shpëtoni edhe nga ne, atëherë pse ju duhemi ne?

Pra nuk është korrekte të kërkohej nga partitë e mazhorancës të bëhen bashkë me ju për ta shpëtuar Kosovën nga vetvetja, nga ne pra. Nuk është e singertë.

Unë, në emër të Nismës jap, tregoj këtu një gatishmëri që të ulemi së bashku të gjithë kryetarët e grupeve parlamentare, të bisedojmë dhe të shohim se a mund të arrijmë një pozicion ku produkti i krejt këtij debati do të jetë i përbashkët, dhe produkti të jetë në funksion të mbrojtjes së interesave të Kosovës, jo të shtyrjes së interesave parciais partiake në këtë fazë. Vijnë edhe fazat e debateve dhe e asaj që është krejt normale për të shtyrë koncepte për zgjedhje, por këtu nuk jemi ende në atë fazë ende, kur të vijmë te ajo, secili pastaj ka të drejtë t'u drejtohet zgjedhësve të tyre se çka do të bënte nesër më mirë.

Për fund, ju kërkoj, apo bëj ftesë që të mos shtyhem me njëri-tjetrin se kush e do më shumë vendin, sepse jam i sigurt se të gjithë këtu e duam njësoj, por le të ulemi dhe le të shohim nëse duam që nga kjo seancë të dalim me një rezolutë të përbashkët.

Për mendimin tonë do të ishte ajo që parashohin dy dokumente kryesore mbi të cilat i ka themelet kjo republikë; pakoja e Ahtisarit e cila është shkruar në Kushtetutën e Republikës së

Kosovës. Pra, këto dy dokumente duhet të shfrytëzohen si bazë për të ndërtuar çfarëdo platforme për bisedime me Serbinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! 6+. Në emër të atyre pa grup, Ilir Deda.

ILIR DEDA: Kolegë të nderuar,

Përfaqësues të Qeverisë,

Ne po më duket erdhëm me më optimizëm në këtë seancë e tash e filluam këtë lojë kush kujt po ia lëshon. E kjo është marre për këtë Kuvend. Edhe për neve si njerëz të zgjedhur.

Nëse e shohim në bazë të deklaratave publike, për çka pajtohemi ne? Pajtohemi që asnjë bartës institucional nuk ka të drejtë të negociojë për territorin e Kosovës. A pajtohemi për këtë? Po! A pajtohemi që në parim duhet të ketë konsensus të forcave politike për dialog me Serbinë? Po! Dhe, këtu përfundon pajtimi ndërmjet nesh.

Unë ju kisha lutur që të mos bëhemi si një telenovelë e lirë dhe mos ta vazhdojmë këtë lojë kështu. Nëse të gjithë bashkohen rreth kësaj që asnjë bartës institucional nuk ka të drejtë të negociojë për territorin e Kosovës, kjo mjafton. Pra, rezolutën tonë dua ta aprovojmë, patjetër, patjetër, patjetër, sot.

Kemi me e marrë në qafë këtë vend nëse fillojmë tash me t'ia lëshojmë njëri-tjetrit. Se po sikur të kishte kesi vrulli kush është më i mençur në dialog me Serbinë, ne moti do ta kishim kryer këtë proces. Ky është ballafaqimi me vetveten. Edhe ballafaqimi në këtë Kuvend me lojërat të cilat nuk na përkasin karshi momentit. Dëgjoni, para nesh është një stuhi politike të cilën me ato rezultatet e saj ne do të jetojmë, dhe këtu nuk ka as votë e as parti politike e as përfitim elektoral. Po këtu duhet të ketë përgjegjësi. Dhe unë ju lus, më në fund u mbledhëm dhe e lus Partinë Demokratike që mos ta kushtëzojë aprovimin e kësaj rezolute.

Ne nuk mundemi në pikën e mbrojtjes së integritetit territorial ta dizajnojmë procesin për të cilin nuk pajtohemi. Ne në parim pajtohemi që duhet të ketë dialog me Serbinë, pajtohemi që duhet ta përfundojmë sa më shpejtë. Pajtohemi për OKB, por nuk pajtohemi larg nga pikat parimore. Atëherë, ta mbajmë në nivel parimor. Tash, a është ndonjë fjalë në këtë rezolutë e cila ju pengon juve, si është propozuar? Unë jam një nga propozuesit e saj. Ju pengon, ulemi flasim e rregullojmë. Por, nuk mundet një pikë e cila ka të bëjë me integritet dhe me ndalim eksplisit të kujt do në këtë shtet që është zgjedhur, edhe neve, se edhe ne jemi të zgjedhur, që të flasim për kufijtë e këtij vendi. Kjo duhet të përfundojë aty.

Nuk mundemi tash të themi; unë po dua që ta dobësojë gjuhën e kësaj rezolute çfarëdo apo të mbesim duke u munduar që t'ia lëshojmë njëri-tjetrit, kur kemi mundësi që t'i shtojmë edhe 15

pika të tjera. Tash, ja çfarë dua t'ju them prej Alternativës. Në qoftë se aprovohet sot teksti me një pikë, sepse për këtë jemi këtu sot, kurrkush nuk e rinegocion.

E para është kjo le të kalojë sot. Edhe kjo e zhblokon procesin në të cilin jemi. Kjo e hapë rrugën që nesër të ulemi dhe të fillojmë të diskutojmë për parimet e Kosovës, parimet udhëheqëse në dialog me Serbinë, që nesër, fjalë publike para popullit po flas edhe para jush. Po e aprovojmë një pikë pra edhe po vazhdojmë menjëherë me këtë pjesën tjetër. Sa duhet ne të merremi vesh për parime? Cilat do jenë parimet udhëheqëse të Kosovës në këtë proces? Ndoshta merremi vesh, edhe merremi vesh! E pastaj nuk e di. Po me rëndësi është që ky Kuvend ta thotë të vetën; 1 për territor, sepse tjetërkush e ka hapur këtë temë dhe duhet t'ia mbyllim ne së bashku dhe 2, çka na bashkon si e shohim ne vendin tonë në këtë proces me Serbinë në fund. Edhe ta aprovojmë në Kuvend.

E mandej kush është pjesë e ekipit të delegacionit shtetëror që do t'i zbatojë parimet për të cilat ne mund të dakordohemi ajo është pjesa terciare. Shikoni, Kadri ne jemi kryesorët në këtë vend, ky Kuvend. Ne marrim vendime. Edhe duhet t'i kthejmë të gjithë në binarë prej të cilëve kanë dalë vet! Unë nuk po mundohem ta acarojë më shumë. Interesi politik e shtetëror e nacional i të gjithëve është që sot të dalim me rezolutë e cila thotë: 'Asnjë bartës institucional nuk ka të drejtë të negociojë për integritetin, tërësinë territoriale të Republikës së Kosovës', dhe pastaj po vazhdojmë.

Kjo e hapë rrugën, ma merr mendja edhe të kthimit të normalitetit në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ne mund të debatojmë për çka do tjetër, po për territor nuk... Mos më provoko se dal menjëherë të kushëriri yt, i cili është duke e shkelur atë Kushtetutë. Po ju lus edhe njëherë që të jemi të gjithë racional (mos ndërhyini se nuk po ju ndërhy as unë juve), mos ta kushtëzojmë këtë proces përpara dhe të dalim faqebardhë para popullit tonë në fund të kësaj dite. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

E dëgjova me vëmendje zotin Deda e kam dëgjuar edhe në deklarime të tjera, dhe kishte një qasje shumë kushtëzuese që nuk besoj që i kontribuon arritjes së unitetit për të cilin secili që po e merr fjalën në foltore, pothuajse secili po flet.

Ju e dini që kanë kaluar dy muaj dhe ne nuk kemi mundur që të bëhemi bashkë në Kuvend që të vijmë ta diskutojmë këtë temë. Dhe sot kushtëzimi është recetë që mos kryejmë punë. Vetëm si them unë ose jo! Koalicioni qeverisës, deputetët tonë janë sot këtu, pikërisht për ta treguar vullnetin tonë dhe që të arrijmë mundësisht një konsensus, një unifikim të qëndrimeve.

Ne konsiderojmë që aq sa është e rëndësishme, pika të cilën e ka bërë propozuesi është e mangët që të trajtohet tema e dialogut. Me çfarë logjike ne mund të themi; hajt sot po e bëjmë këtë, nesër po bëjmë diçka, nesër pasnesër.

Ne e kemi një draft-rezolutë që e ka propozuar PSD-ja formalisht para të gjithëve, ende as në votim nuk është vendosur! Propozimi ynë në emër të koalicionit ishte i qartë dhe më thoni se cilën pikë e konteston dikush prej atyre që i lexova. A e konteston dikush që qëllimet edhe parimet kryesore që janë pika e parë, cilat janë pritjet e Kosovës prej këtij dialogu? Ose që Kuvendi ta ketë rolin kryesor. Ose që duhet të ratifikohet çfarëdo me 2/3. Ose që ekipi t'i raportojë Kuvendit edhe që duhet të jetë një komision...Cila pikë është e kontestueshme? Unë nuk e kuptoj se në bazë të cilës arsye doni ta refuzoni një qasje, absolutisht dhe sinqerisht konstruktive të koalicionit qeverisës që ka ardhur në seancën e opozitës që ta gjejë një unifikim.

Ju kisha lutur që të mos kemi qasje kushtëzuese prapë se atëherë i bie që kjo seancë është thirrur për politikë ditore e jo që të dilet nga situata e bllokuar edhe të gjendet një rrugëdalje një unifikimi për dialogun me Serbinë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti kryetar i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.

KRYETARI KADRI VESELI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Media të nderuara,

Qytetarë të Republikës,

Shumë i nderuari kryesues,

Kabinet qeveritar,

Ne jemi para qytetarëve tanë edhe natyrshëm loja politike nganjëherë edhe zhvillohet. E kuptoj edhe frustrimin e një pjese të kolegëve të opozitës që kemi qenë bashkërisht. Përmes një irracionaliteti ndoshta ndonjëherë ka përfituar edhe opozita e kaluar. Por ajo çfarë nuk e pranoj është se ne, të paktën megjithatë nuk duhet ta bëjmë të njëjtën kur është gabim edhe në qoftë se dikush tjetër ka përfituar.

Unë do të theksoja diçka, vetëm në këtë çka u bisedua tani aktualisht. Ne në qoftë se jemi të sinqertë, në qoftë se dëshirojmë t'ju dërgojmë mesazh qytetarëve tanë, mos t'i maltretojmë që të shikojnë se cila palë do të dalë e turpëruar nga kjo foltore. Nuk besoj që ka palë të turpëruar. Nuk është mirë që njëra palë ta vendosë tjetrën para një momenti që ta turpërojë, dhe ta konsiderojë fitore.

Ne këtë punë mund ta përfundojmë shumë shpjet për arsye se krejt ato diskutimet që u biseduan janë çështje për të cilat mund të ulemi bashkërisht dhe të bëhet një rezolutë, një platformë e përbashkët. Nëse vërtetë po mendojmë për integritetin, sovranitetin e Republikës së Kosovës,

nëse vërtetë po mendojmë sesi do të jetë e ardhmja e shtetit tonë të pavarur dhe sovran. Unë po e citoj propozuesin e seancës tha dy gjëra: “Jemi për dialog” dhe në të njëjtën kohë ishte “përfaqësimi nga sovrani, Kuvendi”, kjo është. Këto i vendosim!

Në të njëjtën kohë e pashë sot një progres të jashtëzakonshëm edhe nga Lëvizja “Vetëvendosje”. Për besë është lëkundje e shkundje! Ky është citati, po e përmendi kryetarin e grupit parlamentar. Është e jashtëzakonshme në kuptimin pozitiv; “Finalen me Serbinë e kemi kryer në vitin 2008”, kështu ishte, ka edhe protokoll.

Ejani të dalim me qëndrime të njëjta mos ta maltretojmë njëri-tjetrin, mos ta fyejmë njëri-tjetrin. Kemi për të shkuar në debat. Po frikësohemi që katërçipërisht vetëm do t’i zhgënjejme qytetarët më shumë. Sot në mëngjes një inovator, i cili ka bërë një punë të jashtëzakonshme në start up në aspektin e inovacioneve, Uraniku ma tha. A mundeni sot ta përfundoni këtë pjesë, hapni perspektivë tjetër vetës. Fat më të mirë rinisë, mos t’i zhgënjejme për arsye se ata po mendojnë që seriozisht ne e kemi shqetësimin këtu mes vete edhe Kosova po shitet.

Patriotizmi nuk është çështje sikur të matet individi, nuk mund të matet individi dhe po me vjen keq ta them; në fund të jetës sonë secili do ta ketë konton që ia jep përgjegjësinë ky vend. Për atë se çfarë kemi bërë dhe çfarë po bëjmë. Se nuk përfundon për njerëzit e gjallë deri në momentin sa ta përfundojë ciklin jetësor. Por, vërtetë kemi shumë gjëra...Sot seancë më së shumti kisha mbajtur për liberalizimin e vizave. Mesazh shumë i qartë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, që nuk është e drejtë që qytetarët e Republikës së Kosovës, studentët, ndërmarrësit të mbahen të izoluar. Përndryshe për të thënë në qoftë se ndodh ajo është racizëm.

Jo unë po e them çdoherë edhe do ta them çdo sekondë. Po në të njëjtën kohë për çështjen e sovranitetit, bisedojmë, ndërtoni projektrezolutën si të dëshirojmë bashkë. Ulemi një orë dy orë, flasim. Po veç një kundërshtar, qytetarë të Republikës së Kosovës, sot e ka pavarësia e Kosovës. Veç Serbinë. Edhe vetëm një president mendon çdo sekondë kundër pavarësisë së Republikës së Kosovës, kështu në mënyrë aktive, është Vuçiqi.

Ju kolegët e mi; Ahmet Isufi, kryetar i grupit parlamentar, po Bilalli në mënyrë më specifike, për besë ka shumë metamorfozë edhe të diskutimit. E rëndë është të mbahet barra vetëm nga njeri. Na lini pak t’ju ndihmojmë edhe ne. Bashkë ta marrim barrën, e mbrojmë Kosovën më mirë për besë. Dimë nga pak, do t’u ndihmojmë, hajde merrni, shkruani, flamurtar ju bëjmë, por që nga maji i vitit 2018 kemi vendosur një qëndrim.

Nuk po dua të them në mënyrë profetike, por ne jemi mësuar të abuzojmë me çështje të cilat nuk do të duhej të abuzojmë, siç është çështja e shtetit, sovranitetit, identitetit, simboleve, orientimet euroatlantik. Pse nuk jemi ulur në maj, pse nuk jemi ulur në qershor, pse s’jemi ulur në korrik, gusht, shtator, tetor, pse pretekstin po mundoheni ta gjeni në gjëra të paqena.

Presidenti i Republikës së Kosovës është president me legjitimitet nacional, qytetar, juridik, kushtetues që e ka votuar ky Kuvend, është figurë politike.

Hajde të merremi me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, jam shumë i bindur, jam shumë i sigurt se edhe presidenti i Republikës së Kosovës atë rezolutë që e aprovojmë këtu sot, do ta respektojë deri në fund. Por, në qoftë se është qëllimi të na vëni në situatë të keqe, në një tabor që nuk jemi, përgjegjësia është juaja. Po ju them sinqerisht, jo veç si politikan, është përgjegjësi juaja, për arsye se nuk e keni seriozisht atë që çfarë po e thoni.

Ejani, ulemi bashkërisht edhe një herë, të ndahen grupet parlamentare, të ulen, e konsumojmë debatin, krejt deputetët të flasin deri në fund, që të mos i mbetemi borxh askujt. Po ajo çka është kryesore, një marrëveshje duhet ta kemi sot. T'i çojmë mesazh një të riut në Kosovë, një ndërmarrësi në Kosovë, një partneri të Kosovës, se Kosova ka një qëndrim, këtë shumë mirë e tha propozuesi i seancës. Hiç s'po shkojmë më shumë nga ato çka i deklaroi.

E bëjmë një projekt-rezolutë të përbashkët, jemi për dialog, sovranin ta ketë Kuvendi i Republikës së Kosovës, t'i raportohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, të kemi propozim, ejani të marrim bashkë përgjegjësinë. Jo, nuk qenka zëvendëskryeministri këtu sot. Flasin në një seancë tjetër, e marrim bashkëpërgjegjësinë, opozita, shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e dha një propozim-rezolutë, ku opozita udhëheq atë komisionin raportues, të cilin është nga grupet parlamentare, kjo është shteti ynë, pozitë e opozitë ne ndërrohem, po në përgjegjësinë ndaj shtetit duhet të jemi bashkë.

Unë thërras për racionalitet, për ndryshe e kam këtë shqetësim edhe pas kësaj seance, do të vazhdojmë njëjtë. Ju do të thoni: "Ne nuk marrim pjesë në seanca plenare se ju nuk na latë të flasin. Ju nuk na latë të votojmë çka deshëm ne". Po veç edhe një, të keni parasysh, ne nuk jemi këtu t'ju dëgjojmë. Ne jemi ta dëgjojmë interesin e qytetarëve, të shkojmë për interesin e qytetarëve, Kushtetuta është pika e parë. Kushtetuta na kufizon secilin edhe në bisedime, edhe në dialog, edhe në komunikim me palën e tretë, po ne kemi mandat të qartë.

Pa pikë nevojë po e dëmtojmë vetë qenësinë e shtetit tonë dhe në të njëjtën kohë po i ndajmë qytetarët në taborë. Çka na ka ndodhur për tre vjet, mendoni që tre vjet çka na ka ndodhur. Unë sinqerisht e them, kam probleme me shqisat e të nuhaturit, po ky vend është i kontanimuar, i kam kërkuar edhe administratës t'i largojnë këta tepih se kanë erë gaz lotsjellësi. Pse ta dëmtojmë vetveten, të mos flas për reputacionin jashtë dhe më së tepërmi po i zhgënjejmë të rinjtë.

Nëse doni të bëhemi bashkë, të mendojmë seriozisht, e jo të luajmë lojën politike në këtë aspekt. Po dëshirat, ulemi, çdo gjë që e parasheh Kushtetuta, çka e mendoni që është në interes të shtetit, të Republikës së Kosovës, po jua jap fjalën se do t'i votojmë, ama ta shkatërrojmë një shtet

vetëm për hir të egove, në kuptimin edhe të merremi me individë, për besë, kjo është e papranueshme.

S'ka, s'ka asnjë prej neve, Republikë parlamentare jemi, përmes Kuvendit do të shkojnë të gjitha. Kërkoj falje, ndoshta edhe e zgjata, se po shkojnë minutat.

Po, të bëhemi bashkë, ju kisha lutur edhe një here, për hir jo të interesave tona, për hir të atyre qëndrimeve që po i proklamojmë çdo ditë nëpër televizione. Dje...

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Vazhdoja. Ta ka përmendur emrin, ke të drejtë. Zoti Glauk Konjufca, replikë!

GLAUK KONJUFCA: Meqë kryetari i Kuvendit më citoj, po ia kthej me një citim të tij: Para tri ditësh tha që “kjo ideja e shkëmbimit të territoreve vjen prej Rosisë dhe prej Serbisë”. Nuk na konvenon, domethënë nuk është në interesin e shqiptarëve. Unë pajtohem me këtë. Kjo është e vërtetë, domethënë edhe vetë e kam thënë kështu pikërisht siç e ka thënë ai.

Mirëpo, këtu tash, meqë kjo është e vërtetë, atëherë dalim te thelbi i problemit. Thelbi i problemit është që, nuk di ky a e ka dëgjuar, por presidenti ynë me të vërtetë e ka thënë ashtu, që është për shkëmbim të territoreve, edhe ky projekt është real. Bile edhe në konferencën më 11 nëntor është rrezik që të hapë këtë temë.

Atëherë, ne ku qëndrojmë këtu bashkë? Ne po qëndrojmë bashkë vetëm me deklarata, por kur po vjen puna të kundërshtohet presidenti me veprime konkrete, atëherë këtu në Kuvend po shpaloset e vërteta kush e ka përnjëmend e kë e ka presidenti në xhep ende.

Krejt mazhorancën presidenti e ka në xhep, edhe krejt Kosova është peng i presidentit, e unë mendoj që për t'u çliruar prej kësaj çështjeje, neve na duhet veç një pikë në rezolutë. Pika është kjo: “Presidenti Thaçi asnjë takim më me Serbinë, hiç asnjë”.

Edhe pika e dytë: “Asnjë vendim të mos e marrë presidenti Thaçi në dialog me Serbinë për Republikën e Kosovës”.

Në doni ta rregullojmë Kosovën, nëse jeni kundër idesë së Hashim Thaçit, kjo është pika e vërtetë. Ju flisni sa të doni pallavra në foltore, po ky është thelbi i problemit.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë ka zoti Veseli.

KADRI VESELI: Glauk, dua të të citoj edhe një herë, e ka pasur edhe një citat.

“Lëkundje dhe shkundje e shtetit ka qenë ideja e Presidentit t’i prekë kufijtë”. Imagjinoni, kur ka folur për Preshevë, Medvegjë e Bujanovc. Vetëm pak.

Kur ka folur për Preshevë, Medvegjë e Bujanovc, askund tjetër nuk folur presidenti i Republikës, që këto të jenë së bashku me Kosovën.

“Lëkundje e shkundje e shtetit...” Po çka po mërzitni për këtë çështje, ore, ne kemi ballafaqimin me Serbinë.

Edhe diçka, Glauk. Po ta them edhe një pjesë. Ti mendo si të duash, unë mendoj që Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është më patriot se ju, po sa ju, jam i sigurt me jetën time se e do atdheun, e mbron shtetin bash sa ju këtu. Me jetë personale familjare e marr, po ‘lëkundja e shkundja e shtetit’ menjëherë posa e ka përmendur Preshevën, Medvegjën e Bujanovcin. Po, do të flasim, o Glauk, se Serbia po flet çdo ditë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me grupet parlamentare dhe me deputetët. Fjalën e ka zoti Haxhi Avdyli.

HAXHI AVDYLI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Para 10 vjetësh ishte ky Kuvend dhe deputetët e atëhershëm që shpallën pavarësinë e shtetit të Kosovës me një deklaratë të qartë dhe me kufij të qartë.

Askush s’do të besonte që 10 vjet pas po ky Kuvend do të mbledhej për të mbrojtur kufijtë e jashtëm, edhe atë jo nga një armik i jashtëm, por nga i ashtuquajti president, i cili ka vendosur territorin e shtetit në tezgat e pazarit.

Askush s’do të besonte, as pesimisti më i madh, që ky president do të binte aq poshtë vetëm për t’i shpëtuar drejtësisë ndërkombëtare, por pyetja është me këto veprime a do të mund t’i shpëtojë drejtësisë vendore e populllore.

Në anën tjetër, të nderuar kolegë,

Është për respekt që asnjëri nga ju, nga ajo që dihet nga deklaratat tuaja, s’keni rënë pre e mashtrimeve, por jeni pro ruajtjes së themeleve të pavarësisë, integritetit, sovranitetit të vendit.

Prandaj, siç ishim bashkë më 2008 në shpalljen e pavarësisë, siç ishim bashkë edhe para disa ditësh për aprovimin e ligjeve për transformimin e FSK-së, ne duhet të jemi tani në ballë të detyrës si deputetë për t’i thënë ‘stop’ këtij aventurieri të vetmuar.

Sot është koha t'u themi 'stop' pazareve me territore dhe kontestimit që i bën shtetësisë i ashtuquajtur 'korrigjim i kufijve'.

Unë jam i bindur që kjo aventurë e korrigjimit do të dështojë, siç dështoi edhe aventura e dhjetorit të kaluar me korrigjimin e Ligjit për Gjykatën Speciale.

Por, a jemi të gatshëm t'i mbyllim sytë dhe ta tejkalojmë në heshtje edhe këtë tentim të dështuar. Mendoj se kjo ndërmarrje e tij s' duhet të falet, por organet më të larta të drejtësisë vendore duhet dhënë mendimin e vet, nëse kjo paraqet tradhti për interesat e vendit apo shkelje të parimit bazë të Kushtetutës.

Kurse ne si deputetë të zgjedhur të popullit, edhe nëse Qeveria për shkak të pafuqisë së vet ia lejon këtë aventurë Hashim Thaçit, ne duhet t'ia ndalojmë negocimin dhe të qenit kryenegociator, jo vetëm për ato që u thanë më lart, por edhe për ato që ka shkelur sovranitetin, integritetin, por edhe ky president është përgjegjës edhe për përçarjet që i kemi sot si shoqëri dhe si Kuvend, edhe si klasë politike, edhe përgjegjës edhe për shkak të dëmtimit të konsensusit në të gjitha temat.

Ai është përgjegjës edhe për dështimet edhe për dështimet në shumë sektorë, për korrupsionin, krimin e organizuar, izolimin e Kosovës dhe për prishjen me aleatët tanë strategjikë.

Tani ky president që pretendon të jetë kryenegociator, është përgjegjës edhe për procesin e dështuar të dialogut të deritashëm, për lëshimet e mëdha që ia kemi bërë Serbisë, thua se Kosova e pushtoi, e vrau, e dogji Beogradin, e jo anasjelltas.

Prandaj, shërbimin këtij vendi ne nuk do t'ia bënim me dhënien e mundësive për negociata të reja të deleguara nga një Qeveri e pafuqishme, por shërbimin më të mirë që do t'ia bënte ky president këtij vendi është dorëheqja e tij, sepse ashtu-kështu doli si president nga një koalicion që nuk ekziston dhe nga një Kuvend që nuk ekziston tani. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Arbër Rexhaj e ka fjalën.

ARBËR REXHAJ: Përshëndetje, të nderuar qytetarë,
Pas këtij debati që u zhvillua këtu, pra, Hashim Thaçi, ky president, i cili jo shumë në të kaluarën, si me rastin 'viar', "not problematik gejs" po na vërteton se është profesionalizuar edhe më shumë në vokacionin e tij të vjetër, gënjeshtren.

Ai po na e merr fytyrën kah do që po shkon, e të mos flasim se po e çon drejt theqafjes Republikën e Kosovës.

Ai akuzon të tjerët se po prodhojnë ‘face news’, por harron vetë se është prodhuesi më i madh i lajmeve të tilla, pra gënjeshtreve.

Më 27 dhjetor të vitit 2010 presidenti Thaçi garantonte se për 15 muaj të ardhshëm të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës do të lëvizin lirshëm në gjithë Evropën pa viza, me konceptin e tij, pra, tani mund t’i themi ‘face news’.

Më 25 shkurt të vitit 2012 deklaronte se fusnota forcon shtetin e Kosovës, e ne jemi dëshmitarë se që nga ajo kohë fusnota jo vetëm që nuk e forcoi, po përkundrazi, e rrezikoi: i uli njohjet ndërkombëtare, e pengoi pjesëmarrjen në organizmat ndërkombëtarë, pra “face news”.

Në vitin 2014 thoshte se do të hapte 200 mijë vende të reja pune dhe një fond të punësimit prej 1.5 miliard eurosh. Ku janë ato 200 mijë vende pune, ku është fondi i punësimit prej 1.5 miliard eurosh?

Natyrisht kjo vetëm që nuk u realizua kurrë, po rezultoi me ikjen masive të qytetarëve tanë drejt kampeve të Evropës, po “face news”.

Në shkurt të vitit 2014, në 6-vjetorin e shtetësisë së Kosovës, ky njeri premtojte se Kosova do ta ketë ushtrinë e saj, bile shkoi edhe më larg, duke thënë se nëse Kuvendi i Kosovës nuk e voton Projektligjin për formimin e ushtrisë, do të jepte dorëheqje, “face news”.

Më 25 gusht të vitit 2015 deklaronte se Asociacioni nuk paraqet asgjë më shumë se sa një OJQ.

Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj ligjor deklaroi se ky dokument i bashkimit të komunave serbe ishte në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Kosovës.

Sikur mos mjaftonte kjo, ky president ishte sponsori kryesor i marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi, ku Kosova i humbi 8200 hektarë tokë.

Në këtë aspekt po i marrim disa deklarata vetëm në muajin gusht, për ta parë demagogjinë dhe pafytyrësinë e tij, karakterin e këtij njeriu politik të padijshëm, arrogant, zhvatës e kolaborant.

Më 31 gusht Hashim Thaçi deklaroi se individë të caktuar në vendin tone, me veprimet e tyre po tentojnë të krijojnë panik dhe konfuzion.

Kosova, përkundër kësaj, mbetet e përkushtuar për dialog dhe arritje të marrëveshjeve paqësore përfundimtare.

Thirrjet për luftë dhe tragjedi të reja në Ballkan i takojnë mentalitetit të shekullit të kaluar dhe, si të tilla, meritojnë vetëm të hedhen në shportë.

Ky hiç president i gazit, i cili po shokon jo vetëm shqiptarët në Kosovë, po gjithandej edhe jashtë kufijve të njohur ndërkombëtarisht, akuzon të gjithë ata që mendojnë ndryshe nga ai. Se nëse nuk bëhet fjala e tij, mendimet e tilla përfundojnë në shportë.

Ndërsa po harron se Kosova nuk ka luks të humbë territor më shumë, ndërsa ai i cili duhet të hedhet në shportë, i pari është ai. Pastaj, të gjithë ata që po i qëndrojnë afër.

Ky president i Kosovës, prej se është në pozicione të caktuara në të kaluarën në Qeveri, tash në Presidencë, e ka shkundur themelinë e pavarësisë që është fituar me gjak, prandaj ajo që e quan ‘koncesion të dhembshëm’ shkakton luftë në Kosovë dhe nuk ndalet me aq.

Më 30 gusht të këtij viti deklaroi se Ushtria Çlirimtare e Kosovës është vlera më sublimë e shtetit të Kosovës. Kushdo që mundohet të abuzojë me të, meriton ndëshkimin maksimal të institucioneve të drejtësisë.

Ky president, i cili me gojën e vet, për t’i ikur Gjykatës Speciale deklaronte se kishte qenë larg vijave të luftës, po harron se po shkel me dy këmbë mbi gjakun e dëshmorëve.

Ia fali 8200 hektarë tokë Malit të Zi, me ndihmën e kryeministrit Ramush Haradinaj dhe të tjerëve. Ktheu mbrapsht qytetarët që ua mësynë shtëpive të tyre në veriun e Mitrovicës, ndërsa tani që nga mbarimi i luftës ka larguar ndërmjetësit ndërkombëtarë, sepse ka gjetur gjuhë të përbashkët me Vuçiqin. Asnjë dëshmor nuk negocioi për ta dhënë veriun e Mitrovicës, ndërsa ata që luftuan në Luginë, nuk vdiqën për shkëmbime, por për bashkim të Kosovës.

Më 28 gusht presidenti që nuk mashtron më askënd, deklaroi kështu. “Po bashkëngjitjes së Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës si tërësi me Kosovën. Po njohjes reciproke Kosovë-Serbi dhe anëtarësimit të Kosovës në OKB dhe organizata ndërkombëtare, jo ndarje, jo shkëmbim terriroresh”, të tjera “face news”.

Veç paramendoni këto më lart, ia nisi një herë duke përmendur koncesione të dhembshme, pastaj vazhdoi me përmirësim të kufijve, nuk e la me kaq dhe kaloi te shkëmbime të territoreve. Këto janë deklarata, të cilat mund t’i gjeni kudo ku kërkoni për këto.

Shtohet pyetja retorike. Kujt i shërben realisht ky president? Kosovës jo! Ndërsa “face news”-i është diskursi i tij, ndërsa veprimi i tij është antikushtetues, i cili tenton ta ndajë Kosovën dhe të bëjë koncesione të dhembshme me Serbinë.

Më 7 gusht deklaroi: “Një mesazh për ata që mendojnë se korrigjimi i kufijve në mënyrë paqësore është ide e keqe, përkundër faktit se e dinë që është mundësia e vetme që Presheva, Bujanoci dhe Medvegja t’i bashkohen Kosovës që të jemi të qartë. Unë kam hedhur poshtë me kohë opsionin të ndarjes dhe të shkëmbimit të territoreve, unë jam duke folur vetëm për korrigjim të kufirit në mënyrë paqësore dhe atë në favor të Kosovës. Ndërsa kundërshtuesit e këtij propozimi propagandojnë për ndarje dhe shkëmbim të territoreve”.

Paramendoni gjithë këto deklarata, të cilat nuk përputhen njëra me tjetrën dhe ka disharmoni totale mes tyre.

Edhe vetë Thaçi në deklarata e di që po gënjen dhe këtë gënjeshtër nuk mund t’ia shesë as Brojës së tij, sepse e di natyrën dhe karakterin e shtetit serb. Nëse do të ishte kështu, nuk do të kishim nevojë për luftë, nëse do të kishte mënyrë paqësore për ta çliruar Kosovën, nuk do të kishim dëshmorë, të cilët do ta jepnin jetën dhe kjo mënyrë paqësore sot do të ishte në favor të luftës së UÇPBM-së dhe as dëshmorët dhe domethënë as vëllezërit atje nuk do të vdisnin në këtë mënyrë, të cilin po e thotë ai.

Thaçi asnjëherë nuk e ka shprehur qartazi se çka nënkupton me gjithë këto koncepte, me gjithë këto terma, të cilat i ka vënë në opinionin publik, nuk e di, nuk e bën dhe se është komplet në projektin jo të tij, por të projektit serb, dhe i cili nuk është pjesë e vet e të cilën po do ta bëjë pjesë të vet. Faleminderit!

KRYETARI: Zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, Fatmir Limaj. Le të bëhet gati Daut Haradinaj.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI FATMIR LIMAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë të Qeverisë,

Besoj që kjo seancë e thirrur duhet të na shërbejë që të kthejmë në normalitet dhe në funksionalitet të plotë institucional këtë çështje shumë të rëndësishme për vendin.

Tash e shtatë vjet për këtë temë Parlamenti i Kosovës është kthye në një arenë të diskutimeve, të përplasjeve, të garës dhe të garës mes veti rreth asaj kush është më patriot dhe kush nuk është dhe, në fakt, çdo herë këto seanca kanë përfunduar pa rezultat.

Tash e shtatë vjet tema më e rëndësishme na ka dalë jashtë kontekstit, jashtë normalitetit institucional të vendit tonë.

Le të na shërbejë ky moment dhe kjo iniciativë që të gjithë së bashku të japim kontributin për ta kthyer në normalitet dhe në rrugë institucionale një çështje të rëndësishme, siç është çështja e dialogut.

Kosova ndodhet në një moment të rëndësishëm, shumë të rëndësishëm, të fillimit të një faze të re të konsolidimit të zhvillimit dhe afirmimit të vet. Për më tepër se shtatë vjet për shkak të papërgjegjësisë, jonormalitetit, individualizimit, papërgatitjes, të arrogancës e shumë e shumë të arsyeve të tjera, kemi zbehur të arriturat tona shtetërore, kemi zbehur argumentet, të cilat i kanë dhënë legjitimitet këtij shteti ku ne jetojmë.

Kemi lëshuar momente të rëndësishme në këto shtatë vjet, të cilat do të na shërbenin për ta afirmuar dhe fuqizuar shtetin tonë.

Ka edhe shumë gjëra shumë mund të flasim se çka ka ndodhur, në fakt, çka kemi humbur për shtatë vjet.

Sot besoj nuk i ndihmojmë as debatit e as asaj për çka po flasim në qoftë se kthehemi e bëjmë analizën vetëm të kaluarës dhe shkojmë përsëri në shtëpi, duke mos zgjidhur asgjë.

Le të na shërbejë një pikënisje të një bashkëpunimi dhe të një afrimi të qëndrimeve të asaj kah duam ta drejtojmë këtë vend. Le të na shërbejë si mesazh qytetarëve të Republikës së Kosovës, partnerëve tanë, se Kosova është e gatshme të kalojë në një hap tjetër të konsolidimit, të forcimit të shtetësisë së vet.

Në kohën kur ne me aq lehtësi kalkulojnë politikisht për poenë momentalë, me aq lehtësi me këtë temë, ta kemi parasysh që kjo do të na kushtojë në seriozitetin e këtij shteti në raport me atë që ne pretendojmë të jemi seriozë në raport me detyrat dhe orientimet tona strategjike.

Si mund të kërkojmë që Kosova të mos trajtohet ndryshe nga vendet e tjera të rajonit për liberalizimin e vizave, si ne mund të kërkojmë që vendi ynë duhet të jetë pjesë e Interpolit, si kontributdhënës në krijimin e sigurisë, në dhënien e kontributit të sigurisë si brenda Kosovës, në rajon, e më tej. Kur ne këtu për një temë kaq të rëndësishme, e dimë që është shumë e rëndësishme, absolutisht s'ka qëndrime të kundërta, nuk po duam ta kthejmë në normalitet. Është momenti i fundit që të gjitha institucionet e vendit të marrin përgjegjësinë që u takon, ashtu siç e ka shkruar Kushtetuta. Si mundet një Parlament, si institucioni më i lartë të mos i besojë Kushtetutës së vet, si mundet deputeti të mos ndjehet i sigurt me Kushtetutën e vendit të vet? Pse kanë ndodhur këto gjëra? Për shkak të së kaluarës!

Si mund të kërkojmë nga njerëzit, nga qytetarët e vendit tonë të respektohen ligjet dhe Kushtetuta, kur ne kemi dilema a ka këtu njerëz, të cilët nuk e respektojnë Kushtetutën dhe janë të gatshëm ta shkelin Kushtetutën, që qartësisht e rregullon funksionimin e këtij shteti, e mbron integritetin e këtij shteti, ndan kompetencat e organeve të këtij shteti dhe ne përtej kësaj themi “jo, nuk na mjafton Kushtetuta”. Çka na duhet? Duhet rezolutë, hajde të shkojmë edhe me një rezolutë pra! Të gjithë ne që jemi këtu deputetë pak më të vjetër e dimë për çka shërbejnë rezolutat, e dimë mirë dhe kur vijnë rezolutat. Si është e mundur të vijmë te kjo “hajde po e bëjmë një rezolutë...” që sa, qysh e thanë, ka pasur lloj-lloj propozimesh. Pse kemi ardhur? Kemi ardhur në një situatë për shkak se për 6-7 vjet gjërat i kemi nxjerrë jashtë sistemit dhe po tentojmë t’i shtimë në sistem, sistemi është, të kthehemi në Kushtetutë, të kthehemi në ligje, në Parlament, në rolin e institucioneve, detyrat që i ka, secili le t’i marrë detyrat e veta që i ka paraparë Kushtetuta dhe të ecim përpara. Secili që ka detyra dhe kompetenca për të zbatuar detyrat e veta, ka dhe përgjegjësinë për të llogaridhënie, për detyrat që i ka kryer ose s’i ka kryer në përputhshmëri me ligjet dhe Kushtetutën e këtij vendi.

Sot Parlamenti i Kosovës, Kosova ka nevojë për të gjithë bashkë në këtë temë për të cilën po flasim. Nuk është çështje e numrit, dje ky Parlament ka pasur një shumicë me 87 vota dhe s’kanë mjaftuar, s’është çështje numri dialogu me Serbinë, është çështje e nevojës, ta ndihmojmë njëritjetrit, ta ndihmojmë vendin tonë, sepse jemi të paktë, na duhet shumë njerëz, shumë energji, shumë ekspertizë, përvojë, të ndihmojmë e të mos gabojmë. Pak janë 87 vetë, pak janë edhe 120 sa jemi ne këtu, na duhen ekspertë jashtë Parlamentit, na duhen profesionistë, njerëz nga OJQ, na duhet të gjithë të bëhemi bashkë që të mund të dalim faqebardhë në procesin që po futemi. Nuk është këtu veç çështje e numrit, është çështje nacionale, nuk është çështje e numrit, përsëri po them 87 vota i ka pasur përbërja e kaluar, ka shkuar atje dhe kanë bërë gabime kardinale në Asociacionin. Nuk është numri. Kemi nevojë për ekspertë, kemi nevojë ne këtu bashkë me frymë pozitive t’i shërbejmë vendit ose ju të gjithë këtu i keni marrë mesazhet që duhet t’i marrim. Të gjithë e dimë çfarë obligimesh ka vendi ynë, t’i dalim e t’u themi njerëzve të Kosovës, qytetarëve të Kosovës: “Ne nuk jemi të gatshëm, jemi të papërgjegjshëm, nuk jemi të gatshëm të futemi në një sfidë të tillë”. Më së lehti e kemi të themi: “A e dini çka, atje ka shkuar një njeri, t’i mëshojmë atij”.

Mirë, po çka po bëjmë ne? E çka po bën Parlamenti i Kosovës? Pajtohem me krejt ato që u thanë nga të gjitha grupet, edhe propozimi për të cilin po flasim, jo korrigjim, e krejt e krejt. Krejt po, duam të bëjmë rezolutë, e bëjmë edhe rezolutën, për çka? E çka pastaj? Jo, Parlamenti i Kosovës, institucionet e Kosovës nuk janë këtu të refuzojnë e të tregojnë veç çka nuk duan, por këtu jemi para së gjithash që ta orientojmë vendin tonë kah duam ta çojmë, detyrë jona, e Parlamentit është. Ejani t’i marrim detyrat tona që na takojnë, si Parlament dhe si Qeveri. Qeveria e Republikës së Kosovës i ka marrë përsipër detyrat e veta, është e gatshme t’i zbatojë detyrat që ia parasheh Kushtetuta e Kosovës dhe të japë përgjegjësi për detyrat që i ka, edhe për hapat që i ndërmerr.

Por, Qeveria e Republikës së Kosovës qartë e ka deklaruar: “Ne mendojmë se për këtë temë duhet më shumë se kaq”. Ne duam të jemi të gjithë së bashku, të ulemi, ta ndërtojmë platformën, të tregojmë çka nuk mund të negociojmë, çka mund të negociojmë, nëse ka nevojë me ato rezoluta e bëjmë, unë besoj në Kushtetutën e Kosovës, që mendoj mjaftueshëm te çdo gjë dhe asnjë presje s’ka nevojë t’i shtohet asaj Kushtetute, por ka disponim të shkohet edhe me një dokument tjetër, shkojmë. Është afati i fundit të çohet mesazhi, Kosova po futet në një fazë të konsolidimit dhe afirmimit të vet. Nëse vazhdojmë me debatin kështu, ne jemi duke i zbehur argumentet tona. Ne do të vazhdojmë t’i përmirësojmë marrëveshjet e këqija, të vajtojmë për marrëveshje të këqija dhe institucioni më i lartë i vendit, i cili është këtu, mbledhet për t’i dhënë zgjidhje vendit, ka për t’u kthyer në një institucion të kukamës. Shtatë vjet ky Parlament veç ka ‘kukatur’, asgjë tjetër nuk ka bërë për shtatë vjet rreth dialogut të Kosovës. Bota po ecën, kurrkush s’e pret Kosovën. A është interesi të fillojnë bisedimet, a është interesi t’i vonojmë bisedimet, çfarë tema duhet të bisedohen, na takon neve të vendosim. Po ne duhet ta bëjmë hapin, nëse vërtet duam ta ndalojmë dhe ta kthejmë në normalitet këtë çështje, këtë temë kaq të rëndësishme për vendin, ejani ta luajmë rolin si deputetë të vendit dhe ta bëjmë adresën, të bëhemi bashkë, të marrim përgjegjësinë bashkë, po shkojmë në zgjedhje. Asgjë nuk e përjashton këtë çka po flas unë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdoja, ju lutem, regjia!

FATMIR LIMAJ: Asnjë gjë nuk përjashton proceset tona të brendshme kjo që po flasim, po sido që të jetë, rrethanat dhe forcat politike, mos harroni, gjithmonë kemi nevojë të jemi bashkë. Po, nuk është bashkë sikur sot, sikur nesër që mund të vonohemi dhe më shumë ia zbehim mundësinë negociuese, ose pozicionin e këtij vendi, edhe ashtu iu ka zbehur, sikur e thashë, për shtatë vjet.

Argumentet kryesore të shtetësisë, të cilën e kemi ne, për shtatë vjet i kemi zbehur me mospërgjegjësinë që e kemi treguar, tash kush ka pasur faj? Krejt kush kemi qenë deputetë të Parlamentit këtu kemi faj, në kuptimin kush më shumë e kush më pak, sepse s’kemi mundur ta ndalim. Prandaj, ftesa ime dhe apeli im, miq, le të shërbejë ky moment, ky propozim dhe kjo seancë e jashtëzakonshme që të dalim me një produkt, i cili jep lajmin vendimtar e shumë të rëndësishëm për vendin, që Parlamenti i Kosovës i nxori pikat çka është e paprekshme dhe çka mund të diskutohet dhe kështu së bashku të kemi adresën institucionale për t’iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave që ka vendi ynë në raport me dialogun dhe në raport me miqtë tanë ndërkombëtarë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Dardan Molliqaj e ka fjalën, Daut Haradinaj bëhet gati.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Dua të theksoj qysh në fillim atë që e tha edhe Visar Ymeri, është që për gati 4 muaj ka qenë një kërkesë jona që debati për dialogun të kthehet në Kuvend dhe për katër muaj nuk ka pasur gatishmëri dhe vullnet. Por, besoj që krejt pak u prek nga shefi i Grupit Parlamentar të Nismës problemi kryesor që sot e kemi në skenën politike në Kosovë.

Partitë politike në Kosovë nuk kanë dallime mes vete sa i përket çështjes së dialogut, kanë dallime me qëndrimin e presidentit, të paktën formalisht krejt partitë janë kundër presidentit sa i përket qëndrimit. Por, asnjë parti mes vete nuk ka dallim më, dallim substancial, edhe po mundohem në fillim ta nis duke i lexuar dy pika të rezolutave të ndryshme: rezolutës së pushtetit dhe rezolutës që sot ka ardhur nga opozita. Pika e 2, e rezolutës që është propozuar nga partitë në pushtet, në paragrafin e dytë thotë “sovrانيتeti, integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm, i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe ligj”. Në të njëjtën kohë “territori i Republikës së Kosovës është një dhe i pandashëm”. Pra, ku është dallimi substancial politik mes partive? Fare! Dallimi thelbësor që ekziston në skenën politike është që pushteti nuk i ka votat të shkojë në dialog vetë, sepse Qeveria e Republikës së Kosovës nuk i ka votat për dialogun, për shkak se Lista serbe nuk e voton ekipin negociator dhe për këtë arsye të gjithë drejtuesit e pushtetit vijnë e lusin opozitën sot. Para katër muajve nuk e kanë lutur, kanë shpërfaqur arrogancë prej Presidentit e teposhtë, sepse kanë menduar që nuk u duhet dhe krejt ky adresim sot nga drejtuesit e Qeverisë është krejtësisht i lidhur me mungesën e votave. Të mos paraqiten këtu që kjo është një sinqeritet, i cili është vlerë dhe parim i pushtetit. Fakt, vlerë e parim i pushtetit ka qenë arroganca dhe, si arrogancë e pushtetit, se gjithmonë përgjegjësinë e mban pushteti, kemi ardhur deri këtu.

Por, në anën tjetër, besoj që po ashtu deklarimi dhe rezoluta sot është e tejkaluar sipas qëndrimit tim. Besoj që kemi shkuar më larg, Kosova nuk ka më nevojë për rezolutë, se qysh po e shihni kurrë njëra prej rezolutave nuk po dallon, as e pushtetit, as e opozitës. Kosova sot ka nevojë të arrijë të ndërtojë platformë për dialogun. Pse kjo s’po ndodh? Sepse, opozita po thotë, meqenëse s’i ka votat Qeveria për dialog, se qeveria për qeveri i ka, por për dialog nuk i ka, ne duam zgjedhje legjitime. Pse po i duam zgjedhjet? Për të shkuar në pushtet, prapë legjitime. Pse s’po i do Qeveria ose pushteti zgjedhjet? Për të qëndruar në pushtet, edhe kjo është legjitime. Por, në anën tjetër, duhet të themi që dallimi thelbësor është sot se dikush do zgjedhje para dialogut, e dikush do zgjedhje pas dialogut, e mundësisht deri në fund të mandatit. Çka duhet të bëjmë në këtë situatë? Nëse opozita i krijon numrat për ta rrëzuar Qeverinë, ditën që e bëjmë, duhet ta rrëzojmë, por në anën tjetër, nëse s’i kemi numrat, dialogu vazhdon, e unë këtu dalloj me një pjesë të kolegëve të mi opozitarë, unë nuk e kuptoj frikën prej Hashim Thaçit, seriozisht fare nuk e kuptoj. E di që i ka i bërë shumë dëm vendit, e ka përçarë shumë këtë skenë politike, faktori kryesor përçarës në skenën politike, arrogancë gjithmonë ka treguar, ka marrë edhe vendime

shumë shpesh të gabuara, por kurrë më e fortë opozita s'ka qenë. Jo vetëm se i ka 57 numra, por pse pa 2/3 nuk kalon.

Opozita e kaluar është dashur të hedhë gaz e të protestojë, se ju i kishit 2/3, pushteti, sot s'ka 2/3, e unë po frikohem në mos kolegët e mi opozitarë në vend se t'i frikohen Thaçit, janë duke iu frikësuar vetes, se kanë drojën që gjithçka negocion Thaçi, në fund këta duhet ta votojnë. A, Partia Socialdemokrate e thotë publikisht: nëse s'pajtohet me çfarëdo rezultati të dialogut, nuk e votojmë. E lëmë edhe krejt politikën, por nuk e votojmë. E nëse ju nuk frikoheni prej vetes, s'ka çka na bën kjo Qeveri, as Hashim Thaçi sa i përket dialogut. Fare s'ka çka na bën, se s'ka ku t'i marrë votat, shkojmë në zgjedhje. Po supozojmë negociohet marrëveshja e keqe, ne vendosim të shkojmë në zgjedhje se s'ka vota Kuvendi, a jemi të bindur ne opozita që fitojmë, po! Prapë, pra ajo marrëveshje s'kalon, mbetet marrëveshja e Hashim Thaçit, qysh po mbetet marrëveshja e Isa Mustafës 'Zajednica'. Është veç marrëveshje e tij, demarkacionin e votuan, nëse ju frikoheni që mandatin e ardhshëm kur ne fitojmë si opozitë, e votoni ju, e atëherë ky është problem prapë juaji. Unë nuk frikohem që e votoj, s'e kam votuar as demarkacionin, nuk e votoj as 'Zajednicën' dhe duhet pas guximin të mos frikohesh prej kësaj fare pune.

Çka duhet tutje? Kolegë të LDK-së dhe të Vetëvendosjes, po e di që jeni lodhur e po doni të ktheheni në Kuvend, edhe shumë mirë që po ktheheni, nëse rezolutën e keni veç sa për t'ua çelë derën të ktheheni në Kuvend, po, po jua votojmë. Përndryshe rezoluta nuk ka kurrfarë efekti politik, asnjë gjë s'e ka. S'e votoni rezolutën e pushtetit, edhe ata thonë s'do të diskutohet për territore, votojani këtyre dhe u krye. Po, unë s'jam të votohet as e pushtetit, e as opozitës në këtë formë, normalisht që e votojnë të opozitës, se jemi në opozitë, se s'ka efekt. Kosova duhet të bëjë platformë për dialogun, e pas platformës, ekipin negociator. Nëse doni, rrimë e s'përfshihemi, por rezoluta nuk ka efekt përveçse të kthehen në Kuvend, e që doni të ktheheni në Kuvend, kthehuni, se po jua votojmë, po i bëjmë lutje pushtetit, votoni se po na duhet opozita në Kuvend, se mirë është të kthehet, po efekt tjetër nuk ka. E, nuk është marre të thuhet kam gabuar, dy muaj ditë jam end, s'kam pasur rezultat, po kthehem, se veç ashtu je i singertë me veten.

Tjetër tutje, çka unë po shoh këtu, po shoh diskutim, i cili i takon shekullit XIX dhe XX, dialogu me Serbinë ka vazhduar prej Rambujesë e tutje, me faza të ndryshme, me dëme, me gabime, por ka vazhduar. Ne mund të sillemi sot që Kosova s'ka nevojë, por kjo është mohim i realitetit. Unë besoj që është zgjidhja është ndryshe: të njihet realiteti, por të nxirret rezultati i mirë. Ata që e mohojnë realitetin, ata kanë vetëm një sjellje, të thonë "ne s'kemi gabuar kurrë, por Kosova vazhdon". Detyra e njerëzve në politikë nuk është veç të bëjnë me gisht, është edhe të bëjnë me gisht, edhe të bëjnë akuza, por mbi të gjitha është të ndërtosh dhe të ndalësh procese aq sa mundesh. Nëse kënaqësia e politikanit, deputetit, është që të thotë unë s'kam gabuar kurrë, unë s'kam votuar kurrë gabim, e ndërkohë pas 20 vjetëve janë bërë krejt ato çka ke kundërshtuar, faleminderit, mendoj që është gabim kjo qasje. Por e drejtë e secilit ta zgjedhë një gjë të tillë dhe në këtë aspekt unë besoj që Kuvendi i Kosovës, para se të votojë rezoluta, e para se të shohë

kush po turpërohet e kush s'po turpërohet, duhet të ndërtojë platformë për dialogun. Platforma për dialogun shkon veç kur s'kemi dallime. Ditën që e bëjmë zgjedhjet, atë ditë që bëhet platforma, nëse ne kemi vota si opozitë, atë ditë e rrëzojmë Qeverinë. Po platformën po e bëjmë, se nëse s'e bëjmë bashkë, e bëjnë vetëm dhe shkojnë vetëm, qysh edhe po thoni disa prej jush: "Shkoni ju negocioni, çfarëdo marrëveshje që e mbështet Amerika e Brukseli, ne e votojmë veç mos na shtini të ulemi afër". Nuk është në rregull kjo punë, ashtu nuk duhet të sillemi. Sjellja duhet të jetë ndryshe, pushteti s'mundet pa neve, ne s'i kemi ende votat ta rrëzojmë, dialogu po vazhdon, ejani të ulemi të bëjmë platformë, jo rezoluta. Mos t'ju vijë marre që jeni kthyer në Kuvend, se s'ka kurrgjë të keqe në këtë farë pune, edhe ne nganjëherë kemi dalë, nganjëherë jemi kthyer. A po kujtoni që me qejf po na lut Fatmir Limaj, a ? Jo, veç s'i ka votat për ekipin negociator, po t'i kishte 70 vota, s'na kishte lutur, kishte thënë "mirë është të vini, mirë është të jemi bashkë", por kishte vazhduar, sot do të ishte në Bruksel.

Hashim Thaçi ka nevojë për këtë Kuvend, se përndryshe ai gjithmonë e shkel. Kështu që, në këtë rast e kemi fuqinë si opozitë, s'kemi nevojë të përllahemi e të përçahemi, dy muaj ditë na keni thënë 'jeni patericë e pushtetit'. Pse u kthyet sot? A doni të ktheheni nesër? Po nëse unë jam patericë e pushtetit, dikush është patericë e 'Zajednicës' së Isa Mustafës. Edhe në rregull është, do të shihet në proces kush kujt po i ndihmon dhe kush çka po bën. Çdo vendim i Partisë Socialdemokrate është i pavarur, dikush ka menduar që dikë e mbështet për muri, por kanë gabuar krejt ata. Edhe pushteti së pari, që ka menduar që opozitën e mbështet për muri, e ka mbështet veten, edhe opozita që ka menduar brendapërbrenda opozitës që dikë e mbështet për muri, e ka mbështet veten, se mbas 2 muajve është dashur të vijë këtu tash dhe nuk do të dilni, mund të dilni edhe 1 javë ose 2, por prapë keni për t'u kthyer. Hajdeni bashkë krejt, si opozitë, se i kemi minimalisht 57, e ndoshta 58 vota dhe ta mbështesim pushtetin për muri në kuptimin e interesit të Kosovës sa i përket dialogut. Ditën që i bëjmë votat, po e rrëzojmë qeverinë, por deri atëherë mos u sillni papërgjegjshëm, mos i ktheni gishtat kah kolegët opozitarë, se kemi një pushtet përballë, i cili ka...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Avdullah Hoti replikë, Glauk Konjufca ka kërkuar, Dardan, a i ke përmendur të gjithë këta? Edhe Bilallin po e shoh. Urdhëro, Avdullah Hoti replikë!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Unë e dëgjova me kujdes deputetin Molliqaj, kjo është seancë që është kërkuar më 4 shtator, me këtë rezolutë të njëjtë, pikë për pikë, pozicioni i LDK-së nuk ka ndryshuar tash e dy muaj, i Vetëvendosjes nuk ka ndryshuar, i Alternativës nuk ka ndryshuar. Ka ndryshuar pozicioni i PSD-së. Kanë ndërruar anë, është legjitime, është punë e tyre, nuk është korrekte, nuk është e ndershme, por është legjitime, është veprim politik i tyre.

Dhe, tash të merret ai me opozitën dhe të mbajë ligjërata të tilla, unë mendoj nuk është e ndershme. I kisha lutur shumë që të mos i mbajmë ligjërata njëri-tjetrit, të mos flasim për ‘Zajednicën’ e për akuza të paqena, unë e kam dhënë edhe në përgjigje, mbrëmë edhe ndaj kryetarit të Kuvendit për deklaratimet e tij për çështjet e Asociacionit të Komunave, është marrëveshja e 2015-ës që e ka korrigjuar marrëveshjen e 2013-ës, duke u siguruar që çfarëdo asociacioni që formohet është brenda Kushtetutës së Kosovës. Prandaj, ta lëmë atë diskurs të ‘Zajednicave’, siç i përmendni ju, të bëhemi korrektë edhe të qartë para qytetarëve.

KRYETARI: Po, edhe mua më përmendi, vetëm kisha kërkuar ta bëj publike marrëveshjen e 2013-ës, kolegu, kryetari i grupit parlamentar edhe të 2015-ës, vetëm këtë, pastaj të gjykojnë mediat.

Vetëm le ta bëj publike, pastaj gjykimin e ka publiku, Dardan Molliqaj, kundër-replikë!

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit! Zoti Hoti, nuk di çka po quan “anë”, duhet parë këtë punë, ndoshta e marr vesh më vonë. Po, qëndrimi i PSD-së ka qenë gjithmonë i qartë, madje shefi i grupit e ka bërë të qartë disa herë, e një herë edhe unë vetë. Strategji opozitare që ka zero efekt, faleminderit, strategji opozitare që e rrëzon Qeverinë, eja bëhemi bashkë, me 31 deputetë opozita ka pasur strategji dhe e ka rrëzuar Qeverinë me 87. Prapë po të them edhe sot, nëse jeni gati dhe po doni ta rrëzoni Qeverinë përnjëmend, ulemi e flasim se PSD-ja ka edhe ide, edhe njerëz, edhe përvojë për ta bërë këtë punë. Nëse ju mundeni vetë, vazhdoni këtë farë pune, e shohim, por do t’ju bie shpesh të hyni e të dilni në Kuvend, veç jeni duke e dobësuar rolin opozitar.

Për dialogun kemi konsistencë të plotë sa i përket qëndrimit tonë partiak. S’ju pëlqej juve, në rregull është.

KRYETARI: Glauk Konjufca, replikë!

GLAUK KONJUFCA: Unë mendoj që Dardani krejt ia ‘paska huq’ çështjes së bojkotit të Kuvendit. Bojkoti i Kuvendit prej LDK-së edhe i Vetëvendosjes nuk është çështje programatike e ideologjike, nuk është një parim, prej të cilit ne e kemi fituar zgjedhjet me atë parim. Ai është në nivel të taktikës. Domethënë, ti e bojkoton për një kohë Kuvendin e Kosovës, nëse mendon që ajo është joefektive, nuk e bojkoton më, prapë mund ta bojkotosh, këtu nuk ka çka na moralizon fare ai për këtë farë taktike, pra nuk ka fare nevojë të na mbajë ligjërata për këtë punë. Kjo punë nuk është ideologjike parimore, këto janë veprime, të cilat ne i konsiderojmë për momentin që janë të duhura dhe i ndryshojmë kur ato na konvenojnë. Mbase aq mend politikisht ka për ta kuptuar këtë farë dallimi.

Sa i përket kësaj tjetrës, rezolutës, të cilën e kemi tash në Kuvend këtu. Këtu janë dy rryma politike në Kosovë, tash për tash. Njëra, e cila konsideron që për Kosovën aktualisht çështja më e rëndësishme është ndalja e Hashim Thaçit në projektin e tij, të cilin e ka nisur. Dhe, të gjithëve po ju tërheq zvarrë, e tash vagoni i fundit është edhe PSD-ja, sepse nëse e keni parë propozimin e PDK-së, është shkrirje e propozimeve të PSD-së me PDK-së. Unë kështu e kuptova kur e lexova, të njëjtat propozime që i ka dhënë më herët PSD-ja, i keni krejtësisht tash të integruara në propozimin tuaj. Propozimi alternativë është i Vetëvendosjes dhe i LDK-së, i cili duhet ta ndalë Hashim Thaçin, t'i ndalet ky projekt politik. Nuk mund të flasim për platforma qysh t'ia bëjmë një ekip negociator Hashim Thaçit, ajo është shqetësim i PDK-së dhe i PSD-së, ajo është tjetër gjë.

KRYETARI: Kundërreplikë, Dardan Molliqaj.

DARDAN MOLLIQAJ: Pjesën e parë ma kreu Glauku, pajtohem qind për qind, prej që kam dalë prej Vetëvendosjes s'jam pajtuar më, por sot po. Krejt çështje taktike është, po mirë që e pranoi Glauku që kur s'ka efekt, kthehesh. Krejt çka ju kemi thënë në fillim është që efekti i bojkotit në këtë fazë është zero, e keni marrë një zero, keni ardhur këtu, mirë që keni ardhur dhe vazhdojmë e bëjmë opozitën bashkë. Kështu që, kaq për dijen tënde Glauk, kaq për dijen e Vetëvendosjes me zero efekt në skenën politike për këta dy muaj.

Shumë mirë që PDK-ja e paska marrë rezolutën tonë, mundësisht edhe LDK-ja, edhe Vetëvendosja, AAK-ja, Nisma, edhe minoritetet, krejt merreni. Kjo është fitore jona, unë nuk frikohem kur kundërshtari pajtohet me mua, unë kam problem kur kundërshtari s'pajtohet me mua, për ditë le të pajtohet PDK-ja me neve, mundësisht të bëhet edhe e majtë, të ketë qëndrime të kundërta për krejt çështjet e tjera, shumë mirë është kjo punë. Kështu që jemi të gëzuar, Glauk, për këtë punë, e alternativa, a e di cila është alternativa e Glauk Konjufcës?

Në fjalën time unë e thashë të njëjtën, që e tha Dardani. Unë thash po, opozita nuk është kundër dialogut, por një herë zgjedhje e pastaj dialog. Domethënë, nuk po tregojnë çfarë do të bëjnë ndryshe, sikur të jenë në pushtet. Pozita po thotë, "po dua me vazhdua në qeverisje, jam i vetëdijshëm që kam nevojë, jo për vete po për procesin e dialogut për opozitën, prandaj edhe nuk filloj një proces pa u bërë bashkë". Dhe, unë nuk pashë këtu kundërthënie, as nuk pash mungesë sqarimi nga ana ime, sa i përket kësaj çështjeje.

Ne vazhdojmë të besojmë që në sfidën të cilën e kemi me Serbinë duhet të jemi bashkë. Çka nëse sot, ta zëmë se fiton qasja e pozitës, shkojmë në zgjedhje edhe ndërrohet roli, bëjmë një rokadë. Çka do të ndodhë pastaj me opozitën e ardhshme, e cila thotë "tash unë nuk dua dialog, sepse ju i keni vetëm 61 a 62 vota, nuk dua të bëhem pjesë e dialogut, sepse jam në opozitë dhe dua zgjedhje." A do të hyjmë në një qark të mbyllur, që vazhdimisht opozita të kushtëzojë procesin e forcimit të subjektivitetit shtetëror e dialogut me Serbinë për interesa partiake, duke kërkuar

vazhdimisht zgjedhje. Pra, unë jam kundër kësaj qasjeje, sepse besoj që vendi nuk do të ketë një qeveri me 80 deputetë, si dhe se nuk do të ketë më nevojë për opozitë. Rrjedhimisht, meqë nuk besoj në koalicione të tilla, atëherë jam ithtar i asaj që sot të merremi vesh, të bëjmë një platformë, jo vetëm të sanksionojmë çka nuk duhet, po edhe çka duhet të ndodh në procesin e dialogut.

Kur të arrijmë të merremi vesh për këto, atëherë mund të merremi vesh edhe të caktojmë një datë të mundshme, një kalendar të zgjedhjeve. Faleminderit!

KRYETARI: Dardan Molliqaj, kundër-replikë!

DARDAN MOLLIQAJ: Përgjithësisht pajtohem me Bilallin, ndoshta edhe që jemi socialdemokratë të dytë, po për këtë çështjen e dialogut edhe në takimet tjera.

Ka edhe një problem logjik shumë opozita çfarë po thotë. Pajtohem po thotë me partitë politike për shkëmbim teritorësh e krejt këto. Problemi është Hashim Thaçi dhe ne duam të shkojmë në zgjedhje. Pas zgjedhjeve kush është president? Hashim Thaçi. Pra, çka po duan këta. Veç me qenë ne në Qeveri, se Hashimi prapë s'është problem. Se Hashim Thaçi vetëm nëpërmjet tri mënyrave hiqet prej presidentit, të japë dorëheqje, me vdesë, ose të bëjë shkelje kushtetuese, e pastaj të votohet me 2/3-at, se edhe po t'i kemi 2/3-at, pa e bërë shkeljen ne s'mund ta heqim.

Kështu që Salihu po thotë edhe me qenë i sëmurë, ndoshta. Kështu që, e futa aty te ky problemi me vdekjen, kështu që problemi logjik është shumë i madh. "Jemi kundër Hashim Thaçit, por kur të jemi ne në Qeveri shkojmë në dialog me Hashim Thaçin, veç ne duhet me qenë në Qeveri".

KRYETARI: Faleminderit! E vazhdojmë seancën. E keni përmendur zëvendëskryeministrin dhe ka e ka të drejtën e gjysmë-replike, e keni përmendur disa herë.

ZËVENDESKRYEMINISTRI FATMIR LIMAJ: Një sqarim!

Unë besoj që kërkesën tonë, pozicionin e Qeverisë së Kosovës merreni si përkushtim dhe një nivel i ngritur i përgjegjësisë, kur kërkojmë të bëhemi bashkë, se po që se me u kthye në lutje, ju i dini kompetencat e Qeverisë së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka nevojë të vijë ta lusë Parlamentin për të zhvilluar negociatat. Por, kjo që ne po bëjmë sot, po duam një format diçka tjetër, po duam të jemi të përgjegjshëm, sepse s'ka pasur nevojë hiç për të ardhur këtu e për të kërkuar as vota, as kurrgjë, për të zhvilluar negociata, siç ka ndodhur në të kaluarën, por rezultatet i kemi keq. Unë kisha kërkuar më tepër të shikoni një reflektim, reflektim të kësaj Qeverie të përgjegjshme që po do, ka dëshirë, duhet që Parlamenti i Kosovës, të gjitha grupet, të jemi bashkë dhe ky proces të jetë edhe transparent edhe i përgjegjshëm dhe në fund me rezultat pozitiv.

Unë besoj që kështu duhet ta shihni qëndrimin tonë si Qeveri e Republikës së Kosovës e jo siç u tha, si lutje.

KRYETARI: Faleminderit! Daut Haradinaj e ka fjalën. Shkojmë me rrjedhë se ka shumë debatues të interesuar.

DAUT HARADINAJ: Po më vjen mirë, më në fund!

Faleminderit, kryetar!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Unë i mora tri rezolutat e ofruara, duke filluar prej Partisë Socialdemokrate që e kemi pothuajse rezolutën e parë, po ashtu e kemi të Lidhjes Demokratike para tekstit të rezolutës, pothuajse është përmbajtja e njëjtë, mandej kemi rezolutën e koalicionit, ose më saktësisht e prezantuar prej shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së. Nëse i shohim brendapërbrenda në përmbajtje, pothuajse asnjë gjë nuk ndryshon brenda teksteve, e para.

E dyta, ndoshta dikush këtu prej kolegëve të mi është i shqetësuar pse pozita është kundër diskutimit të shkëmbimit, ose korrigjimit të kufijve. Ndoshta këtë shqetësim e kanë, se kishin pasur dëshirë që ne të jemi të pozicionuar ndryshe. Qëndrimet tona kanë qenë të qarta, duke filluar prej kryeparlamentarit, kryeministri, shefave të grupeve parlamentare, po ashtu edhe të deputetëve këtu ku jemi, se nuk ka të drejtë kurrkush, as nuk ka mandat me diskutua rreth kufijve. Pra, nëse lexojmë në përmbajtje këto tri rezoluta që unë i kam para vetes, çka u mungon këtyre që të bëhen tri në një. Do të thotë, a ka vullnet që këto tri rezoluta të përmbliqen në një të vetme dhe siç e tha, s'po ia përmend emrin deputetit të mëhershëm, tha se duhet të ketë platformë politike, se pastaj kur po hyjnë në replika s'po ndalen.

Do të thotë, është paraparë brenda rezolutës që të ketë një komision parlamentar i përbërë prej shefave të grupeve parlamentare, që do ta mbikëqyrë dialogun e që do të kërkojë raport brenda përbrenda Parlamentit të Kosovës se çka po diskutohet. Ne nuk po flasim këtu për shkëmbime ose jo të territoreve, sepse ne e kemi bërë të qartë, e kemi Kushtetutën e Republikës së Kosovës e cila nuk i jep mandat kurrkujt për të diskutuar për këtë punë. Por, hajde kolegët tanë edhe nga opozita edhe pozita, merrni këto tri rezoluta, shkrijini në një, nxirreni të fundit edhe ne jemi të gatshëm edhe për t'i dhënë përkrahje.

Të gjithë janë të interesuar edhe po shihet se në secilin tekst flitet për “marrëdhënie të mira”, “marrëdhënie të mira”... Domethënë, jemi dakord që rrugë tjetër s'ka pos me qenë në tavolinën e dialogut, sepse kemi akoma gjëra të pa pastruara me Serbinë. Po flitet që do të ketë njohje reciproke, anëtarësim në Kombe të Bashkuara... Shpresojmë se do të ndodh ashtu. Po flitet që Lugina e Preshevës mund të ketë represalie prej Serbisë dhe atë ne e dimë se Serbia historikisht nuk ka qenë kurrë miqësore me shqiptarë dhe këtu s'po flasim për patriotizëm sot, por në rast se

këto të tria i shkrijmë në një atëherë unë jam i sigurt se del një e gjetur e mirë dhe i japim mandat ekipit tonë negociues, po ashtu i çojmë përfaqësues edhe nga partitë tjera opozitare dhe të shkojmë si njerëz, sikurse e patëm te ushtria unitetin e përbashkët ta kemi edhe në dialog me Serbinë.

Ata zotërinjtë janë duke ecur me të madhe, janë në avancim para Kosovës. Kosova nuk është duke avancuar çka është duke iu kërkuar. Ne mund të diskutojmë këtu dhe dikush ndoshta fiton ndonjë votë, por mos harroni që edhe populli “nuk han barë”, është duke e parë mirë. Lojërat politike, ne në politikë jemi, kemi të drejtë të bëjmë opozitarizëm, por në raport me Serbinë mos të bëjmë opozitarizëm, se Serbia nuk na sheh ne si parti politike, po ajo i ka pretendimet e veta territoriale historike dhe nuk ka hequr dorë. Ju e dini, që edhe brenda Kushtetutës së tyre ne vazhdojmë të mbetemi si pjesë e Serbisë.

Edhe një herë, unë miqësisht i kisha lutur, edhe zotin Hoti, edhe Glaukun, që të bashkohen, të ulen bashkë, ta gjejnë një formë të përbashkët, ta harmonizojnë një rezolutë të përbashkët dhe të ecim tutje, se koha nuk po na pret.

Ndërsa, sa i përket presidentit, mos t’i përsëris fjalët, presidenti është zgjedhur në Parlament dhe po ju garantoj, se sot me bo me ia nis me e shkarkua, nëse e shkel Kushtetutën, e me i bë 2/3 këtu ndonjë parti politike thotë “jo, nuk e shkarkojmë se ju vet e keni zgjedhur”. E tash, lërin ato, më mirë ta kryejmë rezolutën.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Zoti Enver Hoxhaj e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

Shumë të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Zoti zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Me thënë të drejtën edhe është kah më pëlqen debati, po edhe prania fizike. Ne javën e parë të shtatorit kemi bërë përpjekje për të hyrë në dy seanca të ndara, herë ne kolegët në Qeveri me 50 e diçka deputetë, herë ju në opozitë me 50 e diçka deputetë. Kam dëshirë t’ia konfirmoj profesor Avdullah Hotit, shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së, edhe shefit të Grupit Parlamentar të VV-së, Glauk Konjufcës, ne sot si partnerë të koalicionit kemi hyrë në seancën e juaj të javës së parë të shtatorit, kur atëherë s’mund merreshim vesh. Do të thotë, ne jemi në seancën e juaj edhe në seancën e PSD-së. Teknikisht ta shpjegoj, se nuk ka ndodhur para 20 vjetësh, ka ndodhur para dy muajsh. Ne jemi në fund të tetorit, po kjo ka qenë situata e javës së parë të shtatorit dhe jemi në rregull me të gjitha që u thanë, edhe majtas, edhe djathtas, edhe këtu në qendër.

Problemi është: Çka duam të bëjmë më tutje? Ku duam ta lëvizim këtë vend në të ardhmen?

Kjo seancë mund të shndërrohet në diçka të mirë, fillim i ri, një nismë e re, sa i takon dialogut i cili është në njëloj bllokade për situatën tonë të brendshme, nëse na merremi vesh, jo vetëm çka deklarojmë e themi këtu, po nëse ne merremi vesh se çfarë po dëshirojmë të arrijmë. A duam të kemi platformë të përbashkët?

Ne jemi gati që të ulemi dhe ta bëjmë një platformë të përbashkët, edhe për temat e dialogut, edhe për afatet e dialogut, edhe për pritje të dialogut. Mua më ka rënë këto ditë të bisedoj me disa prej udhëheqësve të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, i kam pyetur a duhet me e nis ne çështjen e suksesionit me Serbinë? E kemi njëfarë “fajli”, por nuk është shumë i plotë dhe nuk jemi gati për shumë tema, as për dëme të luftës. Nuk jemi gati për shumë tema, po them në mënyrën më të sqartë edhe si Qeveri, se si t’i ngremë këto tema.

Mandej, unë ju dëgjova me vëmendje, po thoni: “Ne jemi të gjithë për dialog”. Po s’ma merr mendja që jeni për deklarata se jeni të gjithë për dialog. A doni të merrni pjesë në proces të dialogut apo doni veç të bëni deklarata, se ne nuk e zgjidhim një temë që s’kemi mundur ta zgjidhim që dhjetë vjetët e fundit, çështjen e njohjes së ndërsjellë. Do të thotë, a duam të prodhojmë veprim të ri politik apo duam të mbetemi në deklarata, qysh jemi deri më tash.

Në këtë drejtim, i shoh dy-tri elementë që janë të rëndësishëm. Së pari, konsensusi i brendshëm politik, jo vetëm që duhet të jetë këtu deklarativ, po konsensusin e brendshëm politik duhet ta bartim prej këtij Kuvendi në tavolinë në Bruksel. Atëherë, do të kemi konsensus politik, jo si deklarata. Nëse bartemi prej këtu në Kuvend të përballemi me Serbi edhe në Këshill të Sigurimit me Rusi. Së dyti, është njëfarëloj krize e besimit, të cilën unë të ju them të drejtën nganjëherë nuk po e marr vesh. Kam qenë dhe jam gjatë në Qeveri, kushdo që është në opozitë ka krizë të besimit me u besua atyre që janë në pushtet. Shembulli më interesant është procesi i demarkimit të kufirit me Malin e Zi. Kurrë s’ka ndryshuar, para dy-tri vjetësh kemi pasur krizë besimi në këtë temë, po. Dhe, kjo temë u mbyll, tash në fund të 2018-ës nuk do të ishte temë. Do të thotë, raporti ynë me krizën e besimit në politikë nuk ka të bëjë shumë me parime, ka të bëjë me funksionin tonë fizik ku jemi, nëse jemi në Qeveri jemi në rregull, nëse jemi në opozitë, s’kemi besim, as në temat në të cilat kemi qenë e procesit edhe vet. Për mendimin tonë, nëse dikush i ka grahur këtij procesi politikisht, ka qenë edhe PDK-ja, po edhe LDK-ja e edhe AAK-ja, e cila po ashtu në vitin 2013 e ka votuar marrëveshjen e prillit, çka në atë kohë ka krijuar vërtet një kohezion të ri.

Ju jeni deputetë të Kuvendit të Kosovës, të gjithë po thoni se duhet në fund të procesit Serbia me e njohtë Kosovën, është krejt në rregull. Po, ne do ta kemi një marrëveshje, të cilën mund ta nënshkruajnë ata që shkojnë në Bruksel në emër të shtetit të Kosovës. Ne do të kemi marrëveshje, që jo vetëm duhet ta ratifikoni ju në Kuvendin e Kosovës, nëse Serbia njih

Kosovën, por kanë me e ratifikua edhe kolegët e juaj në Parlamentin e Serbisë. Ne do ta kemi një marrëveshje, e cila do të duhej të miratohet në Këshill të Sigurimit, nëse duam të bëhemi shtet anëtar. Për këtë temë jemi duke folur.

Prandaj, jemi kthyer në seancën e javës së parë të shtatorit, nëse duam ta mbyllim. Në këtë drejtim, çka tha edhe zoti Krasniqi, shefi i grupit parlamentar edhe zoti Veseli, ne jemi të gatshëm të ulemi dhe ta bëjmë jo vetëm një tekst, po të merremi vesh për atë që kjo seancë të mos mbetet veç një seancë ku ne debatojmë, nja tre muaj vazhdojmë të shkëmbejmë pikëpamje në opinion publik dhe pa e ditur se ku jemi në raport me dialogun.

Një gjë qëndron, me krejt dobësitë që i ka dialogu, me krejt gabimet që i ka dialogu, me krejt arritjet që ka dialogu, dialogu ne na ka mundësuar t'ia kushtëzojmë Serbisë anëtarësimi i BE-së të kalojë përmes Prishtinës. A do të vazhdojë në pafundësi që Bashkimi Evropian ta kushtëzojë Serbinë që të kalojë përmes Prishtinës, unë nuk besoj.

Dhe së fundmi, çfarë BE-je do të kemi më 2019, kur të zgjidhet Parlamenti i ri Evropian dhe institucionet e BE-së, çfarë BE-je do të kemi? Dhe së treti, unë i kam më shumë frikë zbatimit të marrëveshjes, se sa përmbajtjes së marrëveshjes. E dini, Pakoja e Ahtisaarit ka dështuar në zbatim, s'ka dështuar për shkak të neve, as në Prishtinë, ka dështuar në Nju Jork, në Këshill të Sigurimit. Zbatimi i marrëveshjes do të varet më shumë prej faktorëve ndërkombëtarë, se sa çka mendojmë ne në Prishtinë.

A kalon në fund marrëveshja jonë në Këshillin e Sigurimit a jo, është dilemë të cilën unë ende nuk e di. A duhet të nënshkruajmë marrëveshje të keqe? Absolutisht jo. Po, a duhet të kemi një situatë pa marrëveshje? Përsëri nuk është e favorshme për Kosovën.

Prandaj, në këtë drejtim ne kemi vendosur që të hyjmë në një seancë që ndoshta do të hynim javën e parë të shtatorit, po çka? S'ma merr mendja që me një pikë, me një rezolutë, e zgjidhni këtë problem. Nëse e keni përnjëmend, hajdeni ulemi, merremi vesh edhe për formulën e përfaqësimit, edhe për parimet, edhe për platformën dhe shohim se cila do të jetë ajo që nxjerrim në dialog, nëse duam kështu seriozisht t'i qasemi kësaj teme. Nëse jo, mund të shihemi pas tre muajsh dhe e provojmë potencialin tonë retorik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Është një problem shumë i madh, nga ana e disa deputetëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Kur e kanë votuar Hashim Thaçin për president kanë harruar që Hashim Thaçi nuk është Atifete, po është Atifet. Tash ju ka dalë Hashimi Atifet dhe ky është problem shumë i madh. Është

problem identik sikur në perëndim, mundesh me shkua në një diskotekë dhe të duket një femër shumë e bukur, e veshur me fustan e me gjokse, por është mashkull. Tash, me këtë femrën mashkull ju keni problem. Ju s'jeni kah diskutoni fare këtu nuk është shqetësim çështja e dialogut, as e rezolutave, sepse ne e dimë të gjithë që ne kurrëgjë, veç e japim një opinion këtu dhe rezoluta nuk është fare obligative. Këtu është krejt problemi i urrejtjes ndaj, jo presidentit, po ndaj individit, i cili quhet Hashim Thaçi. Kjo është e para. Duke e përjashtuar Rexhep Selimin, që e din që nuk është qashtu, sipas Rexhës. Por, unë mendoj që është ashtu, Rexhë. Do e argumentoj mendimin tim.

E dyta, tha një koleg deputet, që Hashim Thaçi na ka futur krejt mazhorancën në xhep. Unë i them atij kolegut, se ka raste kur krimbit i është dukur vetja që është shqiponjë. Ju kish pas lëshua shqiponja me e hëngër njëherë krimbin e krimbi thotë, mos më ha se është turp për ty, po pas tre muajsh kur hip në majë të bjeshkës krimbi, shqiponjës i erdhi inati e i tha, tash nuk të lëshoj, kam me të hëngër. Krimbi i tha, mos më ha, bre, se po më duket vetja bash si shqiponja. Por, krimbi ka ngel krimb, nuk u bë kurrë shqiponjë.

Ata njerëz që në raport me Hashim Thaçin e ndjejnë veten krimba, mendojnë që Hashim Thaçi na fut neve nëpër xhepa. Mua nuk më fut Hashim Thaçi në xhep, as Famir Limaj, as Kadri Veseli, as njeri i gjallë në këtë vend, sepse të gjithë kemi bërë diçka në atë peshoren tonë patriotike për këtë vend, aq sa kemi mundur. Dikush ka punuar për Serbi e Jugosllavi, dikush ka punuar për shqiptari, dikush ka punuar... sikur një grua e Shkodrës doli një natë në një dokumentar, nuk dinte serbisht, tha: ky burri im ishte çetnik i mirë, se edhe ky kish luftuar për Kosovë. Nuk e dinte ajo, as çka është çetniku, as kurrëgjë, po ia jepte meritat edhe atij që kishte punuar për Kosovë.

Tash, do të kthehem te çështja. Grupi negociator u tha këtu se qysh me e ndal Hashim Thaçin. Hashim Thaçin mundemi me e ndal veç me e bë një rezolutë kundër Behxhet Pacollit që po e sjell me aeroplan, me i thënë, mos e kthe më me aeroplan në Kosovë, se ndryshe... E tha Dardan Molliqaj shumë mirë, ne s'kemi fare fuqi me e ndal. Imagjinoni, duke dëgjuar debatet mu fut në kokë një skenar i filmit. Vjen Shakira dhe Shakirën me e fut në delegacion të bisedimeve në Bruksel, me e relaksua pak situatën, se këtu nuk u fol, as për Vuçiqin, as për faktorin Serbi, as pse Vuçiqi tha “na nuk e pranojmë Famir Limën”. Dhe, imagjinoni duke këndua Shakira me iu tekë Serbisë dhe NATO-s, Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës: Tak, me e ngrit murin atje e me mbet Shakira andej... Zot mos e bëj, edhe gruaja ime që e ka qejf Shakirën... unë këndej muri me Vjosën, gruaja ime dhe Shakira në atë anë muri.

Pse po e them këtë? Se edhe idioti më i madh e di që fuqitë e mëdha e kanë nda Berlinin bash përgjysmë. Meqenëse e kam profesorin tim këtu në shkenca politike, e din, e kam pas shpjegua njëherë çështjen e organizatës për siguri dhe bashkëpunim evropian e ma merr mendja janë 98% këtu në sallë nuk e dinë, se ideja e krijimit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian

ka ardhur prej Brezhnjev. Domethënë, ideja ka qenë e rusëve, por Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kampi i perëndimit, kanë menduar që ka qenë një ide brilante dhe e kanë përqafuar atë ide dhe vendi i fundit që e ka nënshkruar marrëveshjen e kësaj organizate ka qenë Ramiz Alija, në vitin '91 që e ka bërë në Helsinki. Deri më sot nuk kam dëgjuar, jo një fjalë, po asnjë presje që e ka thënë presidenti Thaçi që dikush mundet me e kundërshtua. Bile, deklaratat e tij, prej se i kam dëgjuar, aq janë të lezetshme, aq janë të mira, që më vajzës sime Amelias dy vjeçe e gjysmë nuk po ia lëshoj përrallën “Mama dhia me shtatë kecat”, por po ia lëshoj që kemi me e marrë Preshevën, Medvegjën dhe Bujanocin e s’kemi me i dhënë asnjë pëllëmbë territor Serbisë.

A e di pse po e them me atë humorin tim? Se ju krejt keni kallëzua këso përrallash e barsoletash deri tash, tash bile unë po ju relaksoj pak, edhe me Shakirën, edhe me Mama dhinë e shtatë kecat, edhe qysh ia ka prerë barkun e i ka nxjerrë kecat e gjallë. Ne kemi ardhur këtu për të bërë cirkus. Pse kemi ardhur me bë cirkus? Se qytetarët e Kosovës kanë probleme me rrymë, kanë probleme me ujë, kanë probleme me papunësi, kanë probleme me mungesën e barërave, kanë probleme me shkatërrimin e shëndetësisë, kanë një milion probleme qytetarët e Kosovës, për të cilat ne si deputetë të Parlamentit të Kosovës do të duhej të uleshim të bisedonim e të diskutonim.

Qytetari i Kosovës nuk mund të çlirohet nga askush, përderisa ne që sa vjet nuk e kemi bërë vetingun, përderisa ne që sa vjet as nuk guxojmë me e përmend fjalën lustrim. Kështu që, formatin e dialogut me Serbinë nuk e përcaktojmë ne, e përcakton Uashingtoni dhe Brukseli. E tha një deputet i Parlamentit, se Hashim Thaçi e ka injoruar Amerikën dhe Brukselin. Unë e kam thënë në këtë foltore të Parlamentit të Kosovës, mos me ia pas thënë Hashim Thaçit edhe Lutfi Hazirit një njeri i madh prej Uashingtonit dhe Brukselit çështjen e ridisenjimit të kufijve, ata dy as ëndërr s’kishin guxua me e përmend. Po, Thaçi i mençur e ka gjuajtur një karamelë, brum, edhe tash ne po merremi me karamelen e Hashim Thaçit, që quhet “ridisenjim i kufijve të Kosovës”. Ai e di fort mirë, që ne jo që s’mund ta stopojmë, po as nuk do ta stopojmë.

E mira e këtij Parlamenti, po e përfundoj fjalimin tim, është ky. Ta bëjmë platformën, siç tha Dardan Molliqaj me shumë të tjerë këtu, dhe t’i bashkëngjitemi pozitë dhe opozitë delegacionit, i cili do t’i udhëheq bisedimet në Bruksel. Dëshëm e s’dëshëm, përfundimi nuk ka me e lënë Kosovën çështje si e Palestinës. Ne e dimë që Dejtoni, Milosheviqi, Tugjmani dhe Izetbegoviqi, janë detyruar prej fuqive të mëdha gjoja të arrijnë Marrëveshjen e Dejtonit. Një gjë të tillë do ta kemi edhe ne.

Prandaj, mbi bazën e kësaj, u bëj thirrje të gjithë kolegëve, pozitë e opozitë që të bashkohemi, ta ndërtojmë platformën dhe të shkojmë në Bruksel bashkërisht.

Çdo iniciativë që do ta ketë të mirë opozita, unë do ta mbështes. Edhe rrëzimin e Qeverisë kur të doni, unë jua jap nënshkrimin dhe e rrëzojmë edhe Qeverinë bashkë me Zafir Berishën. Veç nuk

mund ta imagjinoj diqysh të rrëzohet Qeveria e të vijë kryeministër Avdullah Hoti, nuk mund ta imagjinoj se Avdullahu mund të nënshkruajë kur të fillojë arrestimi i Gjykatës Speciale për ta çuar në burg Hashim Thaçin, ose Kadri Veselin, ose mua.

Jo e provojmë, gajle mos ke, kemi për ta provuar ne. Por, janë disa procese, hajde le të ecin këto procese dhe shkojmë në zgjedhje shtatorin e vitit të ardhshëm. Para shtatorit kur të shkojmë në zgjedhje kemi për të humbur, edhe LDK-ja edhe na krejt.

Faleminderit dhe shpresoj që do të shkojmë në koncert të Shakirës te Ura i Ibrit.

KRYESUESI: Zoti Glauk Konjufca, replikë!

GLAUK KONJUFCA: Imagjinojeni një situatë kështu, kur je duke shëtitur prej sheshit Skënderbeu, kah Bulevardi Nënë Tereza dhe je duke shkuar në Veternik këmbë. Mund të takosh mijëra njerëz në qytet dhe vetëm njëri prej atyre të ishte drejtuar nga unë dhe me një pëshpërimë të vogël të më thotë këqyre hajni, kur isha kthyer natën në shtëpi e kisha pasur vështirë të flejë pastaj.

Ama nëse të bëhen 907 veta, një kilometër rreshti i gjatë, 907 dëshmitarë e me të thënë këqyre hajni që m'i ka marrë 2-3 mijë euro, kjo me të vërtetë nuk do koment.

907 vetë kanë për të dalë në gjykatë për të dëshmuar kundër teje, këqyre hajni, m'i ka marrë dy mijë ose tre mijë euro për viza. E një njeri i tillë të dalë në foltore të Kuvendit dhe të mbajë ders, kjo me të vërtetë në asnjë shtet të botës nuk ndodh pos në Republikën e Kosovës.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Zeka!

MILAIM ZEKA: Unë dola në foltore që të them në qoftë se Prokuroria e ka një dëshmitar, veç një dëshmitar që ia kam marrë një euro, jo deputet, por unë në jetë time as gazetar nuk punoj.

Ti e dëshmove se je një psikopat, je një i sëmurë mental dhe je një budalla aq i madh, dhe një hajvan që gjysmën e deputetëve tuaj i ke me aktakuza.

KRYESUESI: Regjia, ndalja fjalën! S'ka ofendime! Milaim, të lutem! Të lutem Milaim, mos ofendo!

Fjalën e ka zonja Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit!

Po e kam fatin gjithë në sfida të flas pas disa folësve shumë temperamentë. Populli thotë gazi i madh kthehet në vaj, mos ta bëjmë as shumë gaz as shumë për vaj këtë Kuvend se kështu ashtu

jemi mbledhur për një temë e cila me të vërtetë e kërkon edhe fokusin, edhe seriozitetin që i përket.

Në fakt, diskutimet e vazhdueshme që i pamë, një gjë po anashkalohet. Ajo gjë është se ne sot vetëm jemi duke interpretuar ose duke u munduar të interpretojmë Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kushtetuta, dokumenti bazë i një shteti, neni 1, pika 1 dhe pika 3 në vete të dyja e tregojnë dhe e përkufizojnë krejt atë çfarë ne sot me një rezolutë po mundohemi ta parandalojmë.

Është një fjalë e cila thotë se dështimi për të planifikuar është planifikim për të dështuar. Faktikisht ne kemi dështuar. Sot, përderisa mundohet dikush të luajë lojën e fajit, kush e ka fajin më shumë e kush më pak, unë mund të them se 120 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës nëse shikohemi në pasqyrë çdo mëngjes, mund t'i themi vetes se jemi deputetë të dështuar. Jemi deputetë të dështuar për arsye se kemi ardhur të diskutojmë për një temë, e cila është e gravuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Nuk kemi arritur ta ndalim një njeri të cilin e ka votuar ky Kuvend, që të fillojë dhe të diskutojë për ndryshim të kufijve dhe shkëmbim të territoreve.

Zëvendëskryeministri Hoxhaj nga kjo foltore pak minuta më parë foli sa e madhe ka për të qenë marrëveshja finale, qysh ka për t'u votuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe qysh ka për t'u votuar në Kuvendin e Republikës së Serbisë. Një fakt e la jashtë dhe ai fakt është që për t'u votuar ajo marrëveshje e madhe si në Serbi si në Kosovë, duhet të ndërrohet Kushtetuta.

Ne sot jemi para një dileme të madhe, a jemi në gjendje ta ndryshojmë Kushtetutën e Republikës së Kosovës me dy të tretat apo me dy të tretat duhet ta nisim mocionin e shkarkimit të Presidentit të Republikës së Kosovës.

Serbia duhet ta ndërrojë kushtetutën se nga kushtetuta e saj duhet ta nxjerrë Kosovën. Sot de fakto dhe de jure, Kosova është pjesë e Serbisë në kushtetutën e Republikës së Serbisë. Nëse është arritur marrëveshja diku që dy shtetet do ta votojnë një marrëveshje finale, ajo marrëveshje finale e përfshin gjithashtu edhe ndryshimin e kushtetutës së Kosovës dhe asaj të Serbisë.

Gjithashtu u tha se Presidenti i Republikës ka qenë shumë i kujdesshëm dhe nuk e ka përmendur shkëmbimin e territoreve. Shikoni në llogarinë e Presidentit në twitter, jo më larg se 23 orë më parë Presidenti e shpërndan një artikull të sponsorizuar të Financial Times, nga bordi editorial i kësaj reviste prestigjioze për të cilën paguhen mjete nga buxheti i Republikës së Kosovës, gjegjësisht nga taksapaguesit tanë, me interpretimin e tij në të cilin thotë: është një analizë shumë e rëndësishme dhe me vlerë nga Financial Times. Në analizë gjëja e parë që përmendet është miratimi, gjegjësisht dakordimi i dy presidentëve Thaçi e Vuçiq, dy presidentëve respektivë, në

një marrëveshje historike e cila do të përfshijë edhe korigjimin e kufijve edhe shkëmbimin e territoreve. Do të thotë që të dyja janë pjesë e këtij editoriali që zyrtarisht është shpërndarë nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës me qëndrimet e tij shpërndan një artikull i cili promovon dhe tregon për një marrëveshje e cila ka për bazë korigjimin e kufijve dhe shkëmbimin e territoreve, si nuk qenka kjo shkelje e Kushtetutës? Presidenti e konfirmon se ai është në prag të një marrëveshje historike përmes një artikulli i cili është i sponsorizuar në Financial Times dhe kjo marrëveshje historike i përfshin që të dyja.

A shkojmë pak më lart? A tregojmë se çka na thonë diplomatët e huaj neve që vijnë këtu se çka ka të bëjë marrëveshja historike e dy njerëzve që ulen në tavolinë dhe në mes e kanë një zonjë, zonjën Frederika Mogherini? Përfshin ndarjen e një pjese të Preshevës, disa fshatra të Preshevës dhe tri komuna të Kosovës në veri. Cili është arsyeimi, se Kosova nuk ka bërë asgjë për serbët në veri.

A është kjo e saktë? Unë do të thosha se është e saktë, por është gjithashtu është me faj të plotë të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Po a kemi bërë diçka për shqiptarët në Preshevë? Asgjë!

Është po ashtu e saktë se vetëm kur ka filluar shkëmbimi i territoreve, si temë përmendet Lugina e Preshevës si pjesë e Kosovës. Sa herë është bërë kërkesë në dy mandate të tij si Kryeministër i Republikës së Kosovës, nga shqiptarët e Luginës në takime zyrtare me kryeministrin Thaçi atëherë, dhe sot presidenti Thaçi dhe nuk ka arritur të takohen. Ose nuk kanë arritur të adresohen këto çështje në Bruksel.

Hiç më larg se sot janë ndaluar një delegacion i Kosovës për të marrë pjesë në një konferencë rajonale në Beograd për të drejtat e romëve në Ballkan. Nuk kanë dhënë arsyeim për këtë ndalesë.

Është po e njëjta Serbi me të cilën Presidenti e konsideron si marrëveshje historike korigjimin e kufijve dhe shkëmbimin e territoreve. Nuk janë në gjendje një delegacion ta lënë të marrin pjesë në konferencë. Ku është besimi për çfarë po flasim.

Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës pa përjashtim të të gjitha partive, pozitë e opozitë, Deri tash kemi dështuar. Nuk është problem shumë i madh për ta pranuar dështimin, se të paktën e konsiderojmë se kemi gabuar deri tash dhe tash e tutje mundemi hapat tonë t'i korigjojmë dhe të bëjmë diçka të mirë për këtë vend. Kjo është për të liruar së pari oksigjenin që të merremi edhe me tema të tjera përveç dialogut, përderisa po na ndodhin njëqind probleme të tjera socio-ekonomike në vend.

E dyta është për të kuptuar a jemi në gjendje sot me veten tonë, a jemi të gatshëm të ndryshojmë Kushtetutën e Republikës së Kosovës apo për ta shkarkuar Presidentin. Nuk kemi problem me emrin Hashim Thaçi. Absolutisht jo! Publikisht e them e kam pasur edhe shef dhe i kam shërbyer në qeverinë në mandatin e tij të dytë si kryeministër. Absolutisht jo! Problemin e kam me temat që ai i merr përpara dhe i diskuton, problem e kam me faktin se ne si deputetë këtu nesër prezantohemi para dikujt dhe i themi jo nuk e duam këtë çështje në dialog, e atëherë cila është zgjidhja juaj? Kjo është ajo çka neve na pret. Duhet ne të ofrojmë zgjidhje alternative në atë se çka nëse shkëmbimi i territoreve dhe korrigjimi i kufijve hiqet nga tavolina.

Deputetë të nderuar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Shkëmbimi i territoreve, korrigjimi i kufirit është në agjendë. Kur flet presidenti i një vendit, vendet e tjera që kanë sisteme normale dhe demokraci funksionale, e marrin seriozisht, se thonë se ky njeri e paska mbështetjen. Kjo derisa e kuptuan tash që ky njeri ose ky institucion, mos ta abstraktojmë me një njeri, nuk e ka mbështetjen.

Tash çka është përpjekja e radhës? Përpjekja e radhës është që të na bindin neve që ne duhet ta pranojmë një të vetmen zgjidhje që ky po flet që disa muaj për të.

Ne të gjithë e konsiderojmë besoj dhe e dimë se gjendja në veri nuk është në rregull. Nuk është gjendja në veri as kur po i njëjti institucion e merr motoskafin dhe del në Ujman. Nuk është në rregull as situata kur vendos dhe i dërgon forcat ROSU vetëm kur i teket për të bërë aksion si në filma aksion dhe për të marrë vëmendjen e mediave për një javë.

Por, nuk është në rregull mbi të gjitha që të vendoset në “kockë” fati i Kosovës. Jo vetëm yni, por edhe i fëmijëve tanë dhe i gjeneratave të ardhshme.

Kosova është një dhe e pandarë. E thotë Kushtetuta e Republikës. Bile është e Zyrës së Presidentit kjo kopje, neni 1, pika 1. Neni 1, pika 3 thotë: Kosova nuk ka aspirata territoriale ndaj asnjë shteti. Serbia është shtet. Lugina e Preshevës zyrtarisht është pjesë e Republikës së Serbisë, zyrtarisht si pjesë e shtetit. Ata njerëz që jetojnë atje shqiptarë të cilët sot e çdo ditë edhe në të kaluarën edhe në të ardhmen do t’ju shkelen të drejtat janë sakrifica që fatkeqësisht në rast se kalon kjo marrëveshje që është promovuar nga një institucion i Kosovës dhe një institucion i Serbisë, do të jenë viktima më e madhe. Nuk kemi për të qenë ne.

A e dini kush do të jenë viktimat më të mëdha? Do të jenë shqiptarët e mbetur andej vijës së kufirit dhe serbët e mbetur këndej vijës së kufirit. Se ndarja etnike bëhet, ose është bërë në shekullin XIX dhe shekullin XX. Vlerat evropiane të cilat janë promovuar për njëzet vitet e fundit, multietniciteti, bashkëjetesës, ndërtimi i të ardhmes së përbashkët bien krejt në ujë, për arsye se atëherë vija e kufirit ka për t’u ndarë a je ti serb a je shqiptar, a je këndej a je andej. Le

të më thotë dikush që serbët në Graçanicë askush nuk ka për t'i rrezikuar, ose serbët në Shtërpçë. Kanë për t'u thënë shkoni andej vijës së kufirit se atje është bërë kufiri.

Nëse kjo është zgjidhje paqësore dhe nëse kjo është çka ne sot dështojmë për të parandaluar si zgjidhje paqësore të promovuar, atëherë ne me të vërtetë nuk kemi më arsye të vijmë dhe të ulemi këtu e të diskutojmë për projektligje, për kuorum apo për çështje të tjera të cilat janë tepër me rëndësi, por të cilat fatkeqësisht nuk do të jenë funksionale për arsye se do t'i kemi edhe dhjetë vite të tjera me të cilat ne do të përfaqësohemi me kriza të njëpasnjëshme si rezultat i një marrëveshjeje të cilën ne bashkë këtu kemi dështuar ta parandalojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Besa Gaxherri. Le të përgatitet Ilmi Reçica.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju dy ministra që jeni këtu,

Unë vërtet e kam përgatitur një fjalë të shkurtër, por pas debatit dhe kur dëgjon përfaqësuesit e partive politike të cilat janë në koalicion vërtet nuk ke çare pa e pyetur veten ku jam dhe këta vërtet a e kanë njëmend apo janë duke parë ëndrra me sy çel.

Në bazë të debatit të tyre, përfaqësuesit duke filluar prej Kryetarit të Kuvendit, zotit Limaj e zotit Hoxhaj, e kështu me radhë, po del se opozita është problemi i unitetit në Kosovë, opozita është problemi i dialogut në Serbi dhe opozita është definitivisht problem, i cili nuk po shkojnë proceset si duhet në Kosovë. Kjo është jo vetëm patetike, por është e paqëndrueshme, është qesharake dhe është cinike.

Situata në Kosovë është e rëndë dhe është nga ky koalicion qeverisës. Ne vërtet sot po debatojmë për veprimet dhe për deklaratat e Presidentit të Republikës së Kosovës, por Kosova nuk mund të funksionojë duke u marrë vetëm me dialogun me Serbinë. Ne kemi probleme të shumta në Kosovë që po ju them këtyre përfaqësuesve që na u drejtuan se opozita qenka problemi se Kosova ka probleme të përditshme dhe prandaj ju keni problem me votat në Kuvend, ju keni problem të kaloni ligje të thjeshta. Ju e dini se i keni mbi 100 pika të rendit të ditës të cilat nuk po kalojnë, sepse nuk keni numër të mjaftueshëm dhe nuk keni konsensus politik brenda koalicionit qeverisës.

Megjithatë, unë po kaloj te tema, dhe këtë fjalën që ia kam drejtuar, s'po di a të them Hashimit a Presidentit, sepse vërtetë ne e kemi pas votuar për President, por ne si LDK nuk kemi bërë kurrë analizë psikologjike të askujt dhe nuk e kemi menduar që vërtet Presidenti ose personi Hashim mund të devijojë deri në këtë masë, sa vërtet t'i bëhet një analizë të thjeshtë nëse ka probleme mendore.

Të nderuar kolegë deputetë dhe qytetarë të Republikës së Kosovës,

Lidhja Demokratike e Kosovës kërkon me muaj të tërë që të mbajë një seancë të jashtëzakonshme pasi që në Kosovë është një gjendje e jashtëzakonshme nga deklaratat e jashtëzakonshme dhe të papërgjegjshme të Presidentit të vendit, i cili po terrorizon me muaj të tërë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Nga sjelljet e tij të fundit, bërë një analizë të thjeshtë, thash del që Hashimi është duke punuar për Serbinë për arsye të tij personale, po ka probleme me shëndetin mendor. Për këto dy shkaqe apo shkaktarë, Kushtetuta jonë jep mundësinë për shkarkim të Presidentit. Broçkullat e Hashim Thaçit se do të bëjë korrigjim të kufijve dhe jo shkëmbim të territoreve, sipas tij do të marrë Luginën e Preshevës, Medvegjën e Bujanocin, janë deklarata që na fyejnë inteligjencën dhe dinjitetin personal të secilit prej nesh.

Hashim Thaçi për shtatë vjet dialog me Serbinë nuk qe në gjendje të kërkojë të drejta të barabarta për shqiptarët e Preshevës, Medvegjës e Bujanocit me ato të minoritetit serb në Kosovë. Nuk qe në gjendje të ofrojë asnjë ndihmë financiare, morale e politike për ata shqiptarë, ndërsa tash kur duhet të përmbyllet ky dialog me Serbinë, me një marrëveshje ndërkombëtare obliguese për të dy shtetet, Hashimi me deklaratat e tij befason shqiptarët, befason SHBA-të, BE-në dhe të gjitha vendet mike të Kosovës.

Të nderuar kolegë,

Kemi dëgjuar këto ditë të shokuar e të terrorizuar se SHBA-të nuk e përkrahin Thaçin, SHBA e përkrah Thaçin, BE nuk e përkrah Thaçin, BE e përkrah Thaçin, Merkel nuk e përkrah Thaçin, Merkel e përkrah Thaçin etj.

Kolegë, një gjë duhet ta dimë secili prej nesh këtu se në qoftë se ky Kuvend pajtohet t'ia falë territorin Serbisë për të arritur paqe, asnjë vend në botë nuk mund ta ndalë këtë proces, por zoti Thaçi prandaj Kuvendi është mbledhur sot në seancë të jashtëzakonshme që ta bëjë me dije se ti nuk je feudal i këtij vendi, i këtij populli, se Kosova nuk është shtet presidencial, por parlamentar, se ti nuk ke të drejtë dhe nuk do të lejojmë që luash me sovranitetin dhe territorin e Republikës së Kosovës për të shpëtuar lëkurën tënde. Populli shqiptar nuk të ka asnjë borxh dhe nuk do të të lejojë të shkosh tutje.

Ju zotëri Hashim Thaçi je një politikan i cili pati ngritjet e veta shumë të dyshimta, referuar shumë raporteve ndërkombëtare dhe veprimeve tuaja skandaloze, duke shkelur edhe mbi kufomat, duke vrarë kundërshtarët tuaj politikë, duke i burgosur shokët e tuaj të luftës, duke i degraduar luftëtarët e lirisë, duke zhvatur këtë popull, të vuajtur, të varfër, duke bashkëpunuar me agjunkturën e huaja dhe tërë kësaj maskerade ia hoqe vetë maskën me dorën tuaj, fytyrës suaj. Kur këto ditë po tenton që ta realizosh qëllimin tuaj antikombëtar të falësh territorin e fituar me mund e gjak të gjeneratave të tëra të popullit shqiptar. Këshilltarët tuaj vendorë e ndërkombëtarë,

ata nga Fondacioni Soros, nga Greqia, Turqia e deri te Izraeli është dashur të të këshillojnë për dy gjëra elementare, korrigjimi i kufijve apo shkëmbimi i territoreve nuk mund.

KRYESUESI: Besa, të lutem në qoftë se ke debat me Hashimin, thirr një seancë tjetër. Sot e kemi këtë rezolutën që po duam ta miratojmë. Akuzat janë tepër të rënda.

BESA GAXHERRI: Sot ne po flasim për veprimet e Hashimit, ose Presidentit i quajtur Hashim. Unë po i drejtohem atij dhe po u drejtohem qytetarëve të Republikës së Kosovës, edhe kolegëve deputetë. Nëse edhe këtë ju doni ta ndaloni, atëherë s'është problem.

KRYESUESI: Jo, të mos fyeri se kemi qenë në koalicion. Edhe ti ke përfituar pak nga koha kur kemi qenë bashkë, edhe kur ke votuar.

BESA GAXHERRI: S'ka asnjë fyerje i nderuar, unë po flas me argumente.

Të kisha lutur mos më ndërhyj dhe unë kur përfundoj mund të drejtohem, e pastaj dialogojmë edhe ne.

Korrigjimi i kufijve apo shkëmbimi i territoreve nuk mund të bëhet pa e njohur Serbia pavarësinë e Kosovës, të cilën në këta kufij e kanë njohur më shumë se 100 vende më të zhvilluara të botës. Vetëm dy shtete që njohin dhe respektojnë sovranitetin e njëra-tjetrës mund të diskutojnë me pajtimin e popujve të tyre shkëmbim të territoreve apo korrigjim të kufijve si dhe ky proces kërkon analizë të thellë dhe kohë të gjatë. Këto procese nuk mund të ndodhin brenda natës nga individë kushdo qofshin ato.

Ju me sjelljet dhe veprimet tuaja po e vëni në pikëpyetje ekzistencën e Republikës së Kosovës. Shtetet që e kanë njohur Republikën e Kosovës janë të fyera dhe të shokuara nga deklaratat e juaja. Ndërsa, ato vende që nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës, jo vetëm që po hezitojnë, por po e konfirmojnë qëndrimin e tyre se Republika e Kosovës ende nuk ekziston. Deri tani për këtë gjendje ka punuar Serbia dhe Rusia dhe tani i është bashkëngjitur edhe Presidenti jonë, madje publikisht.

Veprimi i dytë elementar për një politikan është që mos të deklarojë kurrë publikisht kompromiset që është në gjendje të bëjë me qëllim që të përfitojë te kundërshtari politik, në këtë rast në Serbi. Ndërsa ti President, me padijen tuaj dhe paturpësinë tuaj merr guximin që i vetmuar pa përkrahjen e asnjë partie politike të Republikës së Kosovës, me përjashtim të PDK-së, jo që pajtohet PDK-ja me Presidentin po nuk guxon t'ia prishë dhe hesht e që besoj shumë që sot shumë kolegë deputetë edhe nga PDK-ja do ta votojnë rezolutën e cila do të stopojë veprimet e tuaja të rrezikshme dhe të turpshme për shqiptarët.

Rezoluta që do ta bëjë me dije ty dhe gjithë miqve dhe kundërshtarëve të Republikës së Kosovës se ti nuk ke legjitimitet kushtetues për dialog dhe marrëveshje me Serbinë. Pas kësaj rezolute, ty të mbetet rruga e vetme që t'i kërkossh falje popullit shqiptar dhe të japësh dorëheqje. Nëse nuk do të bësh këtë veprim, LDK-ja do të përdorë të gjitha mundësitë demokratike dhe kushtetuese pa përjashtim që ti të largohesh nga posti i të parit të vendit. Këtë veprim Lidhja Demokratike e Kosovës i ka borxh Republikës së Kosovës, sepse është parti e cila vuri themelet e këtij shteti dhe duhet të revidojë vendimin që pati marrë për të bërë ty president.

LDK i garanton qytetarët e Republikës së Kosovës se nuk do të lejojë asnjë individ kushdo qoftë ai që të merr vendim jokushtetues, krye në vete dhe të dëmtoj sovranitetin, integritetin dhe territorin e Republikës së Kosovës. Prekja e kufijve të Kosovës do të thotë luftë dhe pasiguri në tërë regjionin e Ballkanit dhe më gjerë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Nëse ne sot duam të reflektojmë për të mirën e vendit, duhet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar të këtij vendi,

Realisht gjersa po e dëgjoj këtë debat, po rikthehem shumë thellë në histori se pse jemi të vonuar në histori.

Pse tash diskutojmë ne a të njihet Kosova, a të mbrohet tërësia territoriale edhe gjëra të tilla. Diskutimet e tilla, mentaliteti i tillë, angazhimet e tilla, papërgjegjësia e tillë na ka sjellë këtu ku jemi, të vonuar në histori. Ne kurrë nuk kemi njohur autoritete, përveç atyre autoriteteve që na janë imponuar. Atyre ju kemi shkuar zvarrë, dhe nuk ka pasur pak të tillë gjatë historisë sonë.

Ne tash, në këtë seancë dhe në këtë kohë e cila është ftuar për ta mbrojtur kinse tërësinë territoriale të Kosovës, për ta garantuar këtë tërësinë territoriale të Kosovës, ne flasim për çështje krejt tjera. Ne kemi biseduar edhe më herët në këtë sallë. Kemi biseduar në korrik. Kemi biseduar edhe në muajt tjerë paraprak. Kemi bërë ftesë Partia Demokratike e Kosovës, deputetët e saj edhe unë konkretisht kam bërë ftesë shumë konkrete që ky Kuvend ta marrë rolin të cilin i takon.

Ky Kuvend të jetë faktor i pakapërcyeshëm për të gjitha çështjet dhe veçanërisht për çështjet që janë shumë jetike dhe janë shumë të rëndësishme për këtë vend dhe për këtë shtet dhe për këta

qytetarë. Unë dua veç ta lexoj një citat, po e citoj vetën, çfarë kam thënë në korrik: “Bëj ftesë që Kuvendi të marrë përgjegjësi (është në procesverbal të asaj seance), të jetë strumbullari i dialogut me Serbinë. Kuvendi të jetë ai i cili duhet të përcaktojë, të krijojë, të ndërtojë dhe të përcjellë zbatueshmërinë e një platforme që do të jetë obligative për të gjithë. Për të gjitha institucionet cilado qofshin ato. Dhe në kuadër të kësaj, mendoj se ne duhet të merremi vesh dhe mund të merremi vesh shumë lehtë, për tri-katër çështje; ta ruajmë sovranitetin dhe integritetin e Kosovës, të marrim qëndrim të qartë se nuk ka shkëmbim as ndarje të Kosovës, që nuk ka organizëm të ndryshëm jashtë asaj që është përcaktuar me Kushtetutë, organizimin e brendshëm të Republikës së Kosovës, që nuk ka pushtet të tretë”.

Këto qëndrime i kemi deklaruar edhe në debate të ndryshme, qoftë në Parlament, qoftë para mediumeve. Kanë qenë të gjithë përfaqësuesit e partive politike opozitë dhe pozitë kur kemi pasur debat në Tv Dukagjini, dhe kemi thënë shumë qartë, jemi të interesuar që ky Kuvend ta marrë këtë rol. Dhe pse nuk e kemi bërë deri tash atë? Kush i ka fajet? Kush i ka fajet që ne nuk kemi ndërtuar diçka të qëndrueshme?

Ne, ju më tepër sesa krejt ne. Ju që jeni të interesuar që më shumë të flisni për zgjedhje sesa për integritetin territorial të Kosovës. Ju që e keni ftuar këtë seancë. Ne kemi thënë dhe e deklarojmë këtu haptas; asnjë marrëveshje nuk mund të jetë e zbatueshme nëse nuk votohet në këtë Kuvend. Pse janë zvarritur marrëveshjet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mbështetjen financiare të Kosovës? Pse nuk janë votuar nga 2/3 këtu në Kuvend? Dhe janë zvarritur për tre-katër muaj edhe më gjatë.

Kjo është esenciale, kjo është e qartë, kjo është e kuptueshme.

Pse ne duhet t’i fyejmë vazhdimisht institucionet të cilat janë votuar këtu, janë zgjedhur këtu? Kush përfiton? Me gjuhën e përdorur këtu, unë mendoj që përfiton më së shumti Serbia në të cilën ne po thirrmi këtu, po kërkojmë këtu që realisht të jemi unik sa i përket raportit me të.

Kush përfiton nëse dobësohen institucionet e Kosovës? Qoftë institucioni i presidentit, i Qeverisë, i Parlamentit, i opozitës i të gjithë të tjerëve, se edhe opozita është institucion në vete? Përfiton Serbia. Dhe pse ne nuk marrim një qëndrim të qartë që këtu ta ndërtojmë unitetin, ta krijojmë unitetin. Kemi shumë rezoluta. Kemi pasur dhe do të kemi rezoluta të ndryshme. Pse nuk e bëjmë një rezolutë që deklarohet shumë qartë, se çfarë është roli dhe rëndësia e këtij Kuvendi? Pse ky Kuvend duhet ta marrë përgjegjësinë për përmbylljen e dialogut me Serbinë?

Ne i kemi tani tri rezoluta. Po a mund t’i përmbylлим me një rezolutë të tri ato? Si grupe parlamentare të pozitës, përmes kryetarit të grupit parlamentar e propozuam një rezolutë gjashtë pikëshe. Dhe është një rezolutë që i përmbush të gjitha ato nevoja dhe kritere që i kemi diskutua ne këtu. Pse nuk ulemi dhe ta harmonizojmë këtë dhe të shkojmë tutje.

Pa diskutim që nga ky debat do të dalin gjëra të mira, dhe mendoj që më e mirë do të jetë që opozita ose së paku një pjesë e opozitës do të rikthehet për t'i votuar ato projektligje dhe për t'i shndërruar në ligje. Dhe për t'i votuar të gjitha ato raporte të cilat i sjellin këtu agjencitë që i përgjigjen këtij Kuvendi. Edhe kjo nuk është pak. Edhe kjo është një e arritur shumë e madhe. Dhe duhet të mbesim pas fjalëve të cilat i kemi deklaruar këtu. Nuk janë zgjedhjet zgjidhje.

Askush nuk i frikësohet këtu dhe jashtë kësaj salle zgjedhjeve të mundshme. Po nëse ne e thërrasim një debat parlamentar për të diskutuar për tërësinë territoriale të Kosovës edhe flasim për zgjedhje, cili është qëllimi. Deklaroni hapur. Ftoni një seancë parlamentare veç për zgjedhje edhe diskutojmë, dhe merremi vesh. Po, kush do ta mbrojë tërësinë territoriale? Kush do ta mbrojë tërësinë territoriale të Kosovës, ata që nuk kanë dhënë asnjë argument, asnjë fakt deri sot në jetën e tyre, 30, 40, 50, 60 vjeçe. Ata do ta mbrojnë tërësinë territoriale të Kosovës? Ata të cilët po të varej pavarësia e Kosovës, liria e Kosovës prej tyre, kurrë nuk do të kishte as liri as pavarësi.

Është hipokrizi e qartë. Është hipokrizi e dukshme edhe duhet të jenë të turpëruar ata që deklarojnë gjëra të tilla. Njerëzit që janë të dëshmuar gjatë gjithë jetës së tyre për angazhim në shërbim të këtij vendi, të akuzohen se po duan ta shesin Kosovën sot.

Unë edhe njëherë ju bëj ftesë që nga ky debat, se duhet të fillojë me debat dhe duhet të përmbillet me marrëveshje çdo debat. Dhe duhet t'i largojmë duhet t'i anashkalojmë interesat që janë thjesht të ngushta. Po duhet të mendojmë për këtë vend, duhet të mendojmë për të ardhmen e këtij vendi, dhe sado që të jemi ne unik që s'jemi tash fare duhet ta kemi parasysh që e kemi një kundërshtar shumë të fuqishëm përballë. Edhe po ta kemi nivelin më të lartë të unitetit do ta kemi problem të përballohem me Serbinë dhe jo të tillë çfarë jemi tani.

Dëshmoni që e doni këtë vend. Dëshmoni se e doni tërësinë territoriale të këtij vendi me angazhime konkrete jo me llafe koti, jo me angazhime të pasinqerta për të thënë edhe ndonjë fjalë tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Gjërat mund të jenë pak më të thjeshta sesa ne mund t'i interpretojmë e sidomos kur kërkojmë unitet, se jo pak edhe nga mazhoranca po kërkohet unitet. Po a të mendojmë njëherë për çka po na kërkoni unitet? Për çka po na kërkoni konsensus? Sepse uniteti e konsensusi e ka vlerën e qëllimit të saj. Nëse qëllimi është i mirë, uniteti, konsensusi është i mirë. Nëse qëllimi është i keq, uniteti për të keqin është i keq.

Andaj, le të kuptohemi njëherë se për çka po na thërret mazhoranca me qenë të unifikuar. Nëse thirrja në unitet pra, nëse na ftojnë në unitet për të bërë keq ose na kërkojnë konsensus në këtë rast me Serbinë për të bërë keq, atëherë mendoj që po na kërkohet për të bërë konsensus me të keqën edhe ne nuk e bëjmë, edhe bëjmë mirë që nuk e bëjmë. Edhe do të vazhdojmë që të mos e bëjmë.

Pra, mos kërkonit prej nesh konsensus dhe unitet për të keqen se kurrë nuk do ta keni. Edhe është mirë që nuk do ta keni kurrë. Por, nëse doni unitet nëse doni konsensus është një rrugë krejt tjetër më e thjeshtë, vendi është ky e kuptoj, madje në disa raste ose në të shumtën e rasteve mbetet vendi i vetëm. Ky është vendi ku neve duhet të na kërkohet konsensusi dhe uniteti, po për çka? Nëse doni konsensus prej nesh, ne duhet ta arrijmë këtë konsensus kundër Serbisë, duke e kundërshtuar Serbinë dhe do ta keni këtë konsensus, por nëse kërkonit qoftë edhe këtu qoftë edhe diku tjetër për të vazhduar në kursin e njëjtë të bisedimeve me Serbinë e keni gabim. Ne nuk e japim kontributin tonë për atë konsensus për të keqen.

Është mirë që u diskutua, por është mirë edhe në një kuptim tjetër që edhe u panë pozicionet tona se në cilat pozicione jemi momentalisht. Veç refuzimi kundër konsensusit për interesa të Serbisë nuk duhet të nënkuptohet e as të interpretohet që ky është refuzim edhe për aleatët tanë strategjikë siç u tha këtu më herët. Pra, kur i themi jo Serbisë nuk i kemi thënë jo edhe Bashkimit Evropian nuk i kemi i thënë jo edhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, mendoj është e kundërta. Kur i themi jo Serbisë mendoj që kjo është në vijën e duhur edhe në mbrojtje të interesave të republikës së qytetarëve, po edhe në mbrojtje të interesave të raporteve tona me aleatët strategjikë.

Që të mos i bie shumë rrotull. Nëse doni që të diskutojmë të arrijmë konsensus kundër Serbisë, atëherë duhet të ndalet ajo që ka nisur. Ndalenit Thaçin fillimisht kthejeni këtu diskutojmë, sepse jo që me ne nuk do të keni konsensus për këtë çështje po as ju mes vete nuk keni konsensus për këtë çështje. As ju mes vete si mazhorancë nuk jeni unikë për këtë person e për këtë emër. Nëse jeni unik ma thuani këtu, por unë di që nuk jeni unik. Pra, ju po e kërkonit njëfarë uniteti prej mesh ku edhe vet ju nuk jeni unik.

Atëherë, nëse kërkohet një gjë e tillë, unë kam të drejtë të mendoj që ju po na thirrni në njëfarë bashkëfajësie më shumë sesa një bashkëveprimi kundër Serbisë. Veç një gjë është e evidente, këtë Parlament edhe krejt spektrin politik shqiptar dhe të subjekteve tjera parlamentare të pakicave po ndanë Serbia. Serbia na ka futur në mes. Serbia po na ndanë o njerëz, prandaj që të bashkohemi duhet ta heqim Serbinë fillimisht nga aty ku e ka vënë Qeveria e jonë ditë pas dite. Pra, Serbia është problem në mos unitetin tonë. Serbia paradoksalisht mund edhe të na bashkojë nëse ne e kundërshtojmë atë. Pra, jemi në një situatë ku po kërkohet diçka që ne në të vërtetë nuk mund ta japim.

Përfaqësuesi i Qeverisë zëvendëskryeministri e tha që si mendoni që një Parlament të mos i besoj Kushtetutës së tij. Tash unë mund ta kthej ndoshta në formë jo retorike po, pse ju a po besoni Thaçit? Si mendoni që ju t'i besoni pra një individ në këtë rast. Nuk kemi personale diçka. Kolegu e tha këtu që kemi problem me individin.. Jo, jo nuk kemi problem me individin, nuk kemi problem personal, nuk kemi problem me ermin, ai mund ta kishte emrin ndryshe. Kemi problem me një pozicion me një individ që ka kapur këtë pozicion dhe në emër të të gjithë qytetarëve të Kosovës, nganjëherë edhe në emër të Parlamentit po i bën të këqija Kosovës.

Përtej kësaj, ju po na kërkon që, mirë hajde tash ta bëjmë një platformë së bashku. A nënkupton kjo që vërtetë ne jemi duke biseduar me Serbinë pa platformë? Po. Pra, ju vetë po pranoni që atje në këtë fazë të bisedimeve pa platformë. Dhe tani neve na kërkon që në emër të njëfarë platforme të na fusni në ekipin tuaj. Dhe e gjithë kjo çfarë gabimisht po e bënë Qeveria, nuk është as strategjike kjo çfarë po bën Qeveria, po na kërkohet edhe neve.

Pra, Qeveria e ka ndërtuar një ekip negociator dhe e ka dhënë si dekor në fotografinë e Thaçit atje. O njerëz, nuk mund të bisedosh me Serbinë ndryshe përderisa Serbia po na e dikton krejt agjendën e këtyre bisedimeve. E nëse doni platformë, atëherë është e thjeshtë. Mund ta ndalim këtë proces nëse është i keq siç është i keq. Të kthehemi që t'i hapim rrugë të së mirës, e rruga e së mirës hapet nëse ne e bëjmë një listë të borxheve që na i ka Serbia dhe kjo do të ishte platforma më e mirë, që një listë me borxhet që i ka Serbia Kosovës të jetë në tavolinë dhe të jetë përballë Serbisë kurdo që ne do të bisedonim me Serbinë.

Dhe është e kuptueshme që Vuçiqi nuk e do Limajn në bisedime. Nuk është pse ai nuk e do Limajn ose e do Limajn. Unë mendoj se ai nuk e do Limajn. Por, përtej kësaj jo pse ai nuk e do Limajn por ai e ka të pazëvendësueshëm Thaçin. Askënd tjetër nuk e do në tavolinë përderisa po i shkon puna mirë, përderisa e ka vënë në terezi dhe përderisa po e shtyn në agjendë të përbashkët si joproblematik.

Me këtë qasje që ne e kemi, pra që Qeveria e Kosovës dhe Kosova e ka ndaj Serbisë e kemi lidhur vetën nyje me Serbinë. Pra, ne duhet të shkëputemi nga kjo lidhje që e kemi bërë me Serbinë. Pra, ne e kemi vënë vetën në dispozicion të Serbisë për t na mbajtur peng. Pra e kemi lidhur fatin tonë me Serbinë dhe pastaj kërkojmë që Serbia të na e dijë hallin neve. Po normalisht Serbia për Kosovën ka qenë, është, dhe siç duket edhe në një të ardhme të papërcaktuar do të jetë armik i pavarësisë së Kosovës. Armik i shqiptarëve. E ne vazhdojmë akoma të shpresojmë në miqësi me Serbinë dhe dashamirësinë e Serbisë për Kosovën.

Po, qytetarët kanë probleme edhe me ujin edhe me rrymën. Kanë probleme edhe me gjendjen ekonomike dhe nuk duhet neve që t'ju themi qytetarëve; ju keni mjaft probleme, mos na shikoni dhe mos dëgjoni se çfarë po bëjmë ne, përkundrazi nëse ata kanë probleme të tilla ne nuk duhet

t'ua shtojmë edhe ndonjë problem dhe kjo do të ishte arsye akoma më e madhe që ne të merreshim me problemet e qytetarëve duke e ndalur procesin e së keqes e jo duke e avancuar atë.

Andaj, sot kolege, kolegë deputetë nëse nuk keni përgjigje për rezolutën e dhënë nga sponsorizuesi në këtë rast nga opozita. Pra, nëse nuk e keni kurajën për të thënë qoftë po qoftë jo, atëherë përgjigjja e juaj nuk do duhej të ishte një kundër rezolutë, sepse ajo kundër rezolutë nuk na bën bashkë neve, përkundrazi na ka ndarë edhe më shumë.

Ajo çka ne po kërkojmë është që me Serbinë kurrë, kundër Serbisë gjithmonë. Këtu na keni sa herë ju të bëni diçka kundër asaj Serbie, e cila po e shkatërrohet ose po mundohet ta shkatërrojë materien e pavarësisë së Kosovës, materien shtetërore të Republikës së Kosovës. Këtu jemi kurdo që t'ju mbushet mendja ne do ta japim mbështetjen tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po shihet që edhe propozuesit nuk janë të interesuar të qëndrojnë në seancë. Po shkojmë në pauzë, pastaj në 15:15 kthehemi. Shpresoj që do të ketë interesim më të madh për të qenë në sallë. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Po vazhdojmë. Radha është te Nisma, nuk është askush. Prej AAK-së, kush është? Zonja Emilija Rexhepi, e keni fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se podpredsedniče parlamenta!

Postojanje jedne nezavisne države, njene državne zaštite kao što je suverenost i ustavnost, teritorijalne i institucionalni integritet, mir i stabilnost zahteva nacionalni konsenzus svih političkih partija i svih zajednica koje se nalaze u ovom parlamentu Republike Kosova.

Za mene je proces dijaloga sa Srbijom proces koji zahteva dosta vremena s obzirom da se ove dve zemlje bile ratom zavođene, prošlost se ne zaboravlja, ali svi mi zajedno moramo naše poglede usmeriti prema budućnosti zbog nas samih, naših građana ali pre svega zbog mlađih generacija.

Takođe znamo da kroz istoriju sva loša dešavanja su na kraju okončana dijalogom.

Za to koristim priliku da sve vas ovde i moje kolege u Skupštini, premijera Vlade i predsednika države zamolim za nacionalni konsenzus gde ćemo naći najbolje moguće rešenje za sve nas.

Takođe istom porukom, odnosno istu poruku bi htela da pošaljem i predstavnicima Republike Srbije, jer ovo nije dijalog samo dva predsednika, ovo treba biti dijalog naših naroda i ne samo Albanaca i Srba, nego i svih drugih kojih žive u obe zemlje.

Gospodo poslanici,

Dok mi danas od ujutro raspravljamo o nekom dijalogu pogledajte situaciju u opštini Prizren, pogledajmo ovu sliku koja je ispred Doma kulture u Prizrenu, hiljade i hiljade mladih čekaju u red za aplikaciju jednog radnog mesta u Nemačkoj.

Ova slika koju ja držim u ruci svima nama treba biti pokazatelj o čemu treba mi danas da govorimo i šta treba da uradimo za našu zemlju da se ona ekonomski razvije, zaposlimo naš mlad potencijal i bavimo sa svojom i svojim unutrašnjim problemima i delimično zaustavljamo emigraciju, jer proces vize liberalizacije nas je sve umorio i prosto stvorio veliko nepoverenje u Vladini institucije.

Poštovani građani,

Što se tiče bilo kakvih korekcija granica ili razmene teritorija koja se zadnjih meseci u veliko spominje, i po svim medijuma se plasira nerealno samo od vas koji dolazite iz albanskih partija. Želim javno istaći da je za nas Bošnjake Kosova ni u kom slučaju prihvatljivo i nerealno

menjanje granica, posebno za sve ostale manjinske zajednice jer ovo je najveći problem u posle ratnom periodu.

Svi smo svedoci kako su se u prethodnom periodu crtale granice na nekim običnim salvetama i znamo kakav je bio ishod toga.

Lako je to reći ili predložiti sa udaljenosti od nekoliko hiljade kilometara, ali u praksi je to u opšte nespojivo i mi poučeni svojom višem vekovnom iskustvom kako naših pradedova, dedova, takođe i nas samih koji znamo koliko je cena svega toga ne smemo našoj deci i unucima da ostavimo takvu budućnost.

I ako je možda fizički izvodljivo premeštati žive ljude sa jedne teritorije na drugu, mada je to po meni u XXI veku u opšte i neshvatljivo, mi gospodo svoje grobove ne možemo i ne trebamo da premeštamo zbog velikih patnji naših predaka a takođe je neizvodljivo da premeštamo istorijske spomenike i naše bogomolje.

Poštovani predsedavajući,

Kolege poslanici,

Ovo je bilo moje viđenje na proces dijaloga između Kosova i Srbije i ja kao poslanik iz redova Bošnjake nacionalne zajednice ne mogu podržati vladin predlog oko imenovanja pregovaračkog tima zato što u tom timu nema Bošnjaka. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dukagjin Gorani e ka fjalën.

DUKAGJIN GORANI: Deputetë të nderuar,

Sot e kam hetuar që gabim i madh është nëse nuk fol në fillim sa herë që mbahen këto seanca. Meqenëse ajo që sot filloi si përpyetje për bashkëpunim, tash e ka ndërmend të shndërrohet në pengesë për çfarëdo marrëveshje, dhe këtë më duhet ta konstatoj me një keqardhje, meqenëse në këso klime që u ndërtua pas diskutimeve dhe konfrontimeve të sotme, pak gjë mund të thuhet e re, edhe më pak mund të thuhet diçka që ka ndonjë kuptim.

Megjithatë, meqenëse kam vendosur të flas, atëherë më duhet ta them edhe atë që mendova që do të jetë fjalim imi.

Atë e kisha nisur me bindjen që dëmin më të madh që e ka bërë diskutimi mbi kufijtë është që na ka detyruar të flasim për territore, e jo për qytetarë dhe për njerëz. Na ka detyruar të flasim për fatin e tokave, e jo për fatin e popullit që jeton në to, edhe kjo është territorializim i një çështjeje të komplikuar politike, dhe ky territorializim i bisedës e ka dëmtuar edhe e ka deformuar mënyrën se si e kuptojmë fqinjësinë edhe normalizimin e rajonit, e ka helmuar mendimin politik

duke na kthye në banalitetet e dekadës së luftërave dhe shkatërrimeve. Sot flasim për territore, duke mos llogaritur në njerëzit, të cilët ato territore i banojnë.

Negociata pa tjetër do të ketë, mirëpo fokusi i tyre duhet dhe do të jetë gjetja e zgjidhjes për bashkëjetesë mes popujve, për mirëkuptim mes qytetarëve dhe për njohje mes shteteve.

Megjithatë, sot jemi të detyruar të flasim për atë që e refuzojmë, e jo për atë që e përkrahim.

Sot e kemi të qartë se çfarë nuk duhet të flasim dhe kurrë më larg s’kemi qenë dhe kurrë më pak haber s’kemi pasur se për çka e kemi ndërmend të flasim.

Diskutimi për territore dhe kufij e ka nxjerrë në hap një absurd rreth pronësisë mbi procesin e dialogut.

Ky opinion publik edhe është maltretuar, edhe është detyruar që katër muaj të konfrontohet, duke u futur në lojë të përcaktimit të pronarit të negociatave dhe të bajraktarit të popullit.

Pra, nëse është një individ i vetëm, e në këtë rast bëhet fjalë për Presidentin, apo nëse pronar është një institucion suprem, çfarë është Kuvendi, mendoj që kjo një dilemë false, është një dilemë e paqenë.

Mirëpo kjo e folme e përçudnuar na i ka humbur katër muaj në interpretime të kota rreth asaj nëse një njeri i vetëm ka të drejtë të shesë dhe të blejë troje në emrin tënd. Mbase territoret edhe mund të përmenden gjatë procesit negociator, mirëpo ato nuk do të përmenden dhe nuk guxojmë t’i lëmë të përmenden ndaras nga vullneti i qytetarëve, ndaras prej fatit të banorëve. Jo ndaras nga Kushtetuta dhe jo ndaras nga ligjet e shtetit, jo përtej Kuvendit dhe jo përtej rendit demokratik.

Korrigjimi i kufijve u përdor për ta manipuluesin sentimentin etnik të shqiptarëve në Kosovë, duke luajtur me ndjenjën e tyre historike të humbjes, të padrejtësive dhe të viktimizimit, edhe përmes një lloje të fjalëve ky opsion absurd u interpretua si akt i fitores.

Sipas këtij formulimi, Kosova fiton territor dhe nuk humb asgjë. Mirëpo, dinakërisht kjo formë mes të folmes e lë të hapur definicionin e asaj që e quajmë Kosovë. Përmes tij thuhet që Lugina e Preshevës do t’i bashkohet Kosovës, po të njëjtin kohë nuk qartësohet nëse komunat e veriut konsiderohen territor i Kosovës.

Kësisoj, nëse e bashkojmë Luginën e Preshevës, thotë kjo mendësi, ndërkohë do ta kuptojmë se veriu nuk paska qenë kurrë territor i Kosovës dhe duke qenë që s’paska qenë kurrë territor i Kosovës, ne nuk humbin asgjë.

Ky konstatim e ka sjellë banalizimin e plotë të çfarëdo diskutimi të arsyeshëm. E gjithë kjo punë, procesi i dialogut dhe konsensusi ndërpartiak u reduktua në beteja absurde fjalësh, deklaratash, e qysh e pashë sot, edhe ofendimesh.

E gjithë kjo fazë duhet të ndërpritet, e unë shpresova që ndërpritet sot.

Diskutimi mbi dialogun duhet të kthehet në diskutim mbi jetën e përbashkët dhe shoqërinë funksionale përtej dallimeve etnike edhe politike, asnjë individ apo përfaqësues institucional nuk do të jetë pronar i këtij procesi, as shoqëria kosovare, e as politika shtetërore nuk duhet dhe nuk do të jenë peng i një individi.

Në këtë gracë të bajraktarizmit dhe personalizimit nuk duhet të bjerë as rezoluta e sotme. Ajo duhet ta saktësojë parimin që fati kolektiv është përgjegjësi edhe përkushtim i përbashkët, e jo e drejtë individuale.

Duke synuar pajtim sa më të gjerë të deputetëve, ajo rezolutë duhet ta përcaktojë qartë parimin, duke mos u ngatërruar në emërtim të personit. Nëse qëllimi i kësaj rezolute ka qenë konsensusi, atëherë ka qenë dashur të ekzistojë sado pak një përpjekje për një emërues të përbashkët dhe për një kompromis. Edhe ajo që filloi me shpresë si mundësi e arritjes së një konsensusi, në këtë pasditen e sotme kurrë më larg s'ka qenë prej përçarjes dhe kurrë më larg s'ka qenë prej marrëveshjes.

Sot ndodhemi para një situatë, në të cilën lehtë kemi mundur të mos vijmë. E mbajtëm një seancë, në të cilën vetëm sa u konfirmua mungesa e vullnetit, mungesa e ideve dhe dëshira për të folur për atë që nuk e pranojmë, e assesi guximi që të flasim për atë që duhet të pajtohemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gorani! Zonja Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Debati i deritanishëm është thellësisht zhgënjyes, në pjesë të caktuara të tij.

Prandaj edhe do të tentoj të fokusohem në temën, të cilën ka synuar ta trajtojë rezoluta e propozuar, që është mbrojtja e integritetit territorial, por nga një prizëm pak më tjetër.

Do të flas më shumë për fatet e njerëzve, për fatet e atyre njerëzve që jetojnë në ato territore, për të cilat ne po diskutojmë sot.

‘Lufta ka mbaruar’, janë fjalë që dëgjojmë shpesh edhe brenda këtij Kuvendi, brenda dhe jashtë Kosovës, por për një pjesë të njerëzve të Republikës së Kosovës e vërteta është shumë larg kësaj, sepse sfidat e sigurisë për ta nuk kanë mbaruar kurrë.

Çdo ditë zgjohen në mëngjes me frikë, pra me frikën e ngjashme me atë që e kemi pa secili prej nesh frikën e luftës dhe çdo natë bien në gjumë me po të njëjtën frikë.

Mbrojtja e pragut të shtëpisë mbetet realitet për ta sot e 19 vjet, frika për jetën e fëmijëve të tyre, pasiguria për të shkuar në shkollë apo thjesht për të blerë një bukë në dyqanin më të afërt është ankth në vetvete. Pra, është jetë në luftë që nuk ka mbaruar asnjëherë, ata janë shqiptarët e veriut të Kosovës.

Nezir Voca, Shqipe Voca, Niman Sejdiu, Bashkim Rukeci, Sebiha Abrashi, Selime Berisha, Muharrem Sokoli, Nderim Ajeti, Nerimane Gjaka, Remzije Canhasi e shumë të tjerë janë vetëm disa nga fëmijët, gratë e burrat civilë të vrarë në veri të Mitrovicës, pas luftës, pasi për shumicën prej nesh këtu në Parlament e jashtë tij lufta në fakt kishte përfunduar.

Ata u vranë vetëm pse qëndronin në shtëpitë e tyre dhe këto shtëpi gjenden në atë copë territori që sot dikush e quan ‘dhuratë nga Rankoviqi’. Përfshirë pra fëmijët pas luftës, pas të ’99-së, në po ato territore.

Lista, në fakt, është shumë e gjatë asaj liste iu bashkua edhe heroi i Kosovës, Enver Zyberi, duke mbrojtur po atë copë territori që sot quhet ‘dhuratë nga Rankoviqi’.

Këta janë shqiptarët që edhe sot vuajnë nga padrejtësitë historike, për të cilat po dëgjojmë këto ditë.

Qindra banesash, shtëpi të shqiptarëve nga veriu mbesin të uzurpuara, nuk u lejohet familjeve të dëbuar as të ofrohen, as të marrin ndonjë libër apo ndonjë fotografi të fëmijëve të tyre të zhdukur, sepse me qindra djem të rinj u rrëmbyen nga Mitrovica, kryesisht nga veriu, nga forcat paramilitare serbe në dy ditët e fundit të luftës.

Mijëra familje e kishin fatin e dëbimit vetëm në shkurt të vitit 2 000, edhe kur u kryen masakra ndaj civilëve, janë dëbuar 1 694 familje shqiptare. Janë torturuar qindra prej tyre dhe sot e kësaj dite janë mysafirë në shtetin e tyre, në mëshirë të fatit, janë refugjatë në shtetin e tyre. Nuk munden madje as të vizitojnë varret e më të dashurve të tyre në veri të Kosovës.

Dhe tani del dikush dhe na flet për padrejtësi historike, pa u marrë asnjëherë të vetme guximin për të trajtuar padrejtësitë historike brenda territorit të Republikës së Kosovës të shpallur si shtet

më 17 shkurt 2008. Është e tmerrshme, është e turpshme që ato toka të jenë thjesht një copë territori, të cilat sot dikush pra i quan ‘dhuratë nga Rankoviqi’.

Arsyeja pse sot po flas për këtë temë është sepse për vite të tëra dhe sidomos së fundi, kur flitet për Mitrovicën, kur flitet për komuna të tjera të veriut flitet si për një copë territori sikur të ishte vend pa njerëz, sikur fatet e njerëzve të mos ishin përcaktuar atje.

Tani, të kthehem te ajo se çka po ndodh sot.

Komisioni për Punë të Jashtme, të cilin e udhëheq, ka mbajtur diku mbi 30 takime dhe në mbi 80% të tyre është trajtuar tema e dialogut. Problemi është që sot s’ka kush të vijë të raportojë në Kuvend, sepse këtë proces e ka uzurpuar presidenti pa mandat kushtetues dhe Qeveria e Kosovës i ka ikur po atij mandati që ia përcakton Kushtetuta dhe diku nja 7-8 rezoluta të miratuara në këtë Kuvend.

Po cila është një gjë, për të cilën jemi pajtuar të gjitha partitë, pavarësisht a janë në pushtet apo pozitë. Tema për të cilën pajtohemi është që në dhjetëra marrëveshje të arritura në këtë proces mes Kosovës dhe Serbisë, në mbi 90% të rasteve Serbia nuk i zbaton ato marrëveshje.

Madje, edhe sot Ministria e Punëve të Jashtme lëshon komunikatë, ku e akuzon Serbinë për shkeljen e marrëveshjes për lëvizje të lirë dhe shkeljen e marrëveshjes që ka të bëjë me pjesëmarrjen e Kosovës në organizata rajonale.

Në këto 7-8 rezoluta që i ka miratuar ky Kuvend i Kosovës, ne, ndër të tjera, jemi pajtuar para pak muajsh, në maj dhe qershor po të këtij viti, që, në një, çështja e zbardhjes së fatit të pagjeturve të jetë parakusht për vazhdimin e dialogut. Po e shohim që kjo çështje tani ka mbetur tërësisht anash, tërësisht e anashkaluar nga kryenegociatori i vetëshpallur, President i vendit.

Po ashtu jemi pajtuar që për çështjen e energjisë të jenë një sërë kushtesh, edhe ato po anashkalohen tërësisht nga kryenegociatori i vetëshpallur, i cili, siç e thanë kolegët, jo vetëm që shpërndan artikuj të sponsorizuar, të shkruar nga të tjerët pro ndarjes së Kosovës, por në fakt këtë temë e ka pranuar herë drejtpërdrejt, e herë tërthorazi nga Austria e deri në Kosovë, tash besoj edhe në Bjellorusi apo ku ishte është duke bërë po të njëjtën dhe po të njëjtën ne të gjithë besoj mund ta parashohim që do ta bëjmë më 11 nëntor.

Madje, unë besoj që së shpejti të gjithë do ta kuptojmë, qartë dhe me fakte, që për ta promovuar këtë ide janë dhënë edhe para të taksapaguesve të Republikës së Kosovës, kjo besoj do të faktohet së shpejti.

Tani sa i përket Qeverisë, Qeveria ka një mandat të qartë me Kushtetutë, me rezolutë e cila është akoma në fuqi, por unë nuk besoj që dikush mund të mashtrohet dhe të miratojë një ekip që quhet ekip negociator, por nuk negocion. Ekipi negociator që do të miratohej këtu përballë kryenegociatorit të vetëshpallur nuk do të mund të negocionte, sepse pyetja është kush ulet përball Serbisë në këtë proces.

Do të kishte kuptim sikur presidenti të largohej nga ky proces unilateral dhe pa përkrahje që e ka filluar, mirëpo jo në rrethanat e tanishme.

Mirëpo, përtej këtyre ndasive që ne mund t'i kemi, unë besoj që sot secili prej nesh e kemi mundësinë të tregojmë në qoftë se i dalim zot betimit tonë, pavarësisht cilës parti politike i takojmë, ne të gjithë e kemi lexuar tekstin e njëjtë të betimit dhe ai betim thotë “që ne të mbrojmë integritetin territorial të vendit tonë”! Natyrisht që përtej betimit ne e kemi për obligim të kujdesemi për të drejtat e shqiptarëve që jetojnë në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, por këtë nuk do të mund ta bëjnë ata që kurrë nuk i vizituan, këtë s’do të mund ta bëjnë ata që qytetarët e Luginës sot akoma i trajtojnë si qytetarë të Angolës apo të ndonjë shteti tjetër, kur dëshirojnë të aplikojnë për ndonjë dokument, këtë nuk do të mund ta bëjë i njëjti person që donte ta bllokonte rezolutën e Lidhjes Demokratike të Kosovës për të drejtat reciproke të shqiptarëve të Preshevës, Medvegjës e të Bujanocit. Jo, këtë nuk mund ta bëjnë politikanë që e hapin temën e territoreve dhe nën tavolinë e negocion fatin e vet politik.

Pra, sot secili prej nesh e kemi mundësinë të dëshmojmë në qoftë se me të vërtetë e përnjëmend jemi kundër ndryshimit të kufijve, jemi për të mbrojtur integritetin territorial, por jemi edhe për të mbrojtur fatin e atyre njerëzve që kanë rrezikuar e sakrifikuar çdo gjë për ta mbrojtur jo vetëm prapun e shtëpisë së tyre, por për ta mbrojtur shtetësinë tonë, por edhe dinjitetin tonë, për ta bërë atë që s’ka mundur ta bëjë asnjë politikan tjetër.

Prandaj, ashtu siç treguam unitet të plotë në Komisionin për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, ku të gjitha partitë politike pranuan amendamentin tonë, i cili qartë thotë që “territori i Kosovës është i panegociueshëm dhe është i pandarë”, të njëjtën gjë në qoftë se e kemi bërë në shtator, nuk ka asnjë arsye të mos e bëjmë edhe sot.

Të nderuar kolegë deputetë,

Përpara përballjes e fitores ndaj secilit prej jush, unë personalisht dua të dal fituese në përballjen ndaj Serbisë. Në qoftë se mendojmë kështu, në qoftë se mendojmë që ne duhet të dalim mbi të gjitha fitues në përballje ndaj Serbisë, qoftë ajo edhe e fundit që ne e bëjmë në politikë, atëherë gjithçka tjetër tejkalohet dhe votohet një fjali e vetme, por një fjali që na mundëson t’i dalim zot betimit tonë për mbrojtje...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kur dëgjon nivelin e diskutimeve në këtë Kuvend, je në dilemë a të diskutosh a të mos diskutosh fare, u ka humbur vlera diskutimeve.

Ne i kemi irrituar njerëzit, të cilët janë jashtë kësaj salle dhe na dëgjojnë, sidomos atë gjeneratën e re, e cila po rritet në frymën e lirisë.

Të akuzosh tjetrin për vrasje pa fakte, është përgjegjësi, është e dënueshme në shtetet me demokraci të mirëfilltë dhe me sundim të ligjit.

Ta quash tjetrin të sëmurë mendor kot së koti thjesht që nuk i ke vlerat atdhetare e kombëtare, të cilat i ka ai dhe t'i si ke, është e shëmtuar është e dënueshme. Këtë e bëjnë vetëm ata që s'kanë vlere morale dhe s'kanë vlere njerëzore.

Disa herë në këtë Kuvend ne mbajtëm seanca me të njëjtën temë, debati, dialogu e nuk morëm asnjë vendim, por nuk morëm asnjëherë asnjë vendim, por i mbyllëm seancat me fyerje, me sharje, me denigrim të njëri-tjetrit dhe, si përfundim, nuk u arrit asgjë në asnjë seancë. Në një kohë kur Serbia po bën çmos për ta zhbërë shtetin tonë, kur çështja e Kosovës është në tavolinat e Evropës e botës, në një kohë kur po lëvizet me shpejtësi drejt ndryshimeve globale.

Ne jo vetëm që nuk po arrijmë të bëjmë asgjë të vlefshme, siç po kërkojnë qytetarët nga ne, besa edhe të shqetësuar e të frikësuar nga paniku që po bëjnë këtu deputetët e këtij Parlamenti. Ne sa herë debatojmë për këtë temë luajmë lojën e pingpongut, kush po ia hedh kujt, edhe njëri-tjetrit. Ne si deputetë nuk e kemi komoditetin e veprimeve të tilla të papërgjegjshme përballë kërkesave në rritje të qytetarëve tanë për t'i hapur perspektivën vendit tonë, përballë Serbisë që po bën çmos për ta zhbërë shtetin e Kosovës. E dhimbshme, të mos ketë unitet të faktorit shqiptar përballë kundërshtimeve dhe luftës që po bën Serbia kundër shtetit tonë. Në vend se të ndërtojmë konsensusin nacional, ne duhet të merremi me agjenda ditore të partive politike në luftë për pushtet. Në vend se të hartojmë platformën si të dalim fitues në dialog e të zgjedhim çështjet në interes të shtetit tonë në këto momente kyçe, në të cilat ndodhet vendi ynë, ne duhet të merremi me politikën e fyerjes, të sharjes, të paragjykitimit, të anatemit, të denigrimit dhe komprometimit nga ana e opozitës, të individëve me të cilët lidhet historia e lirisë dhe e pavarësisë së vendit tonë, e në veçanti të subjektit tonë politik si metodë e vetme kjo e opozitës për ta stigmatizuar Partinë Demokratike të Kosovës për qëndrimin e saj konsistent, të qartë dhe vizionar që në asnjë mënyrë, me kurrfarë çmimi nuk lejon cenimin e sovranitetit, integritetit territorial dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Është i natyrshëm sulmi i subjekteve kundërshtare në pikat e forta, të cilat i kanë subjektet e tjera politike. Partia Demokratike e Kosovës e ka pikë të fortë shtetformimin dhe shtetndërtimin, e ka pikë të fortë atdhetarizmin dhe sakrificën për shtet, por është hipokrizi, është e ndaluar, e dënuar që lufta politike për pushtet t'i tronditë themelet e shtetit, siç po bëjnë subjektet politike në Kosovë. Ata, të cilët sot janë politikanë, e dje nuk e kishin gatishmërinë për t'u sakrifikuar e për të kontribuar në kauzën tonë të lirisë, të pavarësisë së shtetit, ata të cilët ishin besa edhe lojalë të regjimit serb, ata që nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës e nuk i respektojnë sot as simbolet e shtetit, ata që gara e brendshme partiake për kryetar partie i ka çorientuar dhe nuk po dinë se çfarë po bëjnë e çfarë po flasin, ata që spekulojnë për ndarje pa asnjë fakt, vetëm për të shkaktuar panik e huti te qytetarët, nuk mund t'ua hedhin këtë kaq lehtë, këtë filozofi të tyre destruktive qytetarëve të Republikës së Kosovës, këtë filozofi të luftës së tyre politike për pushtet, sepse qytetarët e këtij vendi janë pjesëmarrës të sakrificës për liri dhe pavarësi, ruajnë gjurmët e gjakut në familjet e tyre, kërkojnë çdo ditë të afërmit e tyre të pagjetur, ata që ishin bashkë në jetë a vdekje, ata janë gjykuesit e historisë, ata njerëzit e thjeshtë, të cilët janë jashtë kësaj sale dhe e kanë treguar këtë disa vjet me radhë, duke i fuqizuar me votë pikërisht ata njerëz, të cilët ata i kanë vlerësuar se i kanë vlerat morale dhe atdhetare.

Bazuar në këtë që them me përgjegjësi se juve dy partive opozitare, Lidhjes Demokratike të Kosovës e Vetëvendosjes, që po përpiqeni t'i rrëmbeni e t'i stigmatizoni benefitet morale e atdhetare të Partisë Demokratike të Kosovës për t'u fuqizuar politikisht, për të zgjidhur problemet brendapartiake, një veprim i tillë do t'u kthehet bumerang, sepse qytetari i këtij vendi di të dallojë keqbërësit dhe di të dallojë edhe vizionarët e këtij vendi, që e kanë çuar dhe e çojnë përpara procesin e shtetndërtimit dhe të integritit. Subjekte të caktuara politike, për të cilat nuk lidhet asnjë e arritur e vendit tonë, as ato politike, as ato ekonomike, për beteja politike apo për interesa të kushedi kujt, po përdorin politikën nacionale si çelës për të forcuar veten, po bëjnë luftën kundër shtetit të Kosovës, kundër të arriturave të Kosovës që nga viti 2015 përmes metodave të tyre të dezinformimit dhe të frikës.

Qytetarët e këtij vendi kanë nevojë për punë, për mirëqenie, siguri e jetë më të mirë, kanë nevojë për guxim, vizion e maturi për të çuar përpara interesin e shtetit tonë të pavarur dhe sovran, e jo për frikë, pasiguri e huti.

Ju që keni ngritur në Kuvend temën e ndarjes, kë e keni dëgjuar se po flet për ndarje? A po ofroni vetëm një dëshmi të vetme, ju keni rënë në agjendën e Serbisë, vetëm ata e diskutojnë temën e ndarjes së Kosovës, edhe pse edhe ata e dinë që Kosova është shtet i pavarur dhe sovran, ashtu siç e dini edhe ju që nuk ka ndarje të Kosovës. Në takimet e partive politike, të cilat vetë i keni iniciuar, nuk keni ofruar asgjë që vlen për t'u debatuar e që është në interes të qytetarit të vendit tonë, e vetmja temë juaja ishin zgjedhjet, për të cilat as vetë nuk ishit të interesuar për t'u mbajtur.

Partia Demokratike e Kosovës ka ofruar platformën konsensuale dhe gjithëpërfshirëse, dokumentin kornizë mbi dialogun, ju ka ofruar parimet mbi bazën e të cilave Kosova do të dialogojë si shtet i pavarur dhe sovran. Dokumenti përmban edhe synime dhe objektivat e Kosovës në dialog, e çka është më e rëndësishmja, në pikën katër të platformës është e theksuar qartë se Kosova nuk negocion mbi shtetësinë, sovranitetin dhe integritetin e saj. Të gjithë e keni gojën plot fjalë të bukura për Preshevën, Medvegjën e Bujanocin. Pse nuk u dashka dikush të ngre çështjen e diskriminimit të shqiptarëve atje? Pse qenka e frikshme të hedhet në tavolinën e diskutimit rikthimi i kësaj pjese në Kosovë, aty ku ka qenë. E ai që përmend, sipas deputetëve destruktivë, qenka një problem në vete dhe qenka njeriu që po diskuton çështjen e humbjes së territorit të Kosovës. Kjo është hipokrizi, të nderuar kolegë deputetë. Ju ftoj të ndërpriten lojërat e këqija në dëm të shtetit e t'u kthehemi debateve të punës në interes të shtetit dhe të qytetarëve të këtij vendi, t'i kryejmë detyrat tona, për të cilat jemi këtu dhe të japim kontributin tonë në ndërtimin e konsensusit dhe të një platforme dialoguese që çon Kosovën drejt Bashkimit Evropian, Organizatës së Kombeve të Bashkuara e NATO-s.

Rezolutat kurrfarë efekti nuk kanë, nuk kanë pasur as rezolutat, të cilat janë miratuar më parë, as këto të cilat do të miratohen tani e tutje. Efekt në këtë vend ka Kushtetuta, për vetë faktin që ne kemi Kushtetutën, e kemi për obligim ta respektojmë Kushtetutën tonë dhe të veprojmë sipas asaj që vetë e kemi votuar përmes. Prandaj, unë ju ftoj që të gjithë të bashkohemi për Kosovën dhe për shtetin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismajl Kurteshi e ka fjalën. Replikë, zonja Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Unë në fjalën time u jam referuar raporteve ndërkombëtare dhe veprimeve konkrete të Presidentit aktual. Unë kisha pasur dëshirë që ta kemi një president që respekton Kushtetutën, të jetë institucion i unitetit, të mos jetë vetëm e kundër të gjithëve, por realiteti është tjetër, fatkeqësisht dhe i dhimbshëm. Argumentet flasin vetë, s'kam ndërmend t'i numëroj një nga një, se s'kam as kohë. Kot mundoheni të bëheni zëdhënësit e tij.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zonja Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Ne kemi pasur rastin ku dy presidentë në Republikën e Kosovës e kanë shkelur Kushtetutën dhe të dy ata, të cilët e kanë shkelur Kushtetutën i kemi hequr prej të qenit president. Ky President i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi, nuk ka bërë shkelje të Kushtetutës, prandaj nuk ka kurrfarë fakti për ta hequr nga pozita në të cilën ai është.

Duhet të jemi të kujdesshëm në fjalën që e themi këtu. Çdo fjalë, e cila thuhet në Kuvend, është përgjegjësi, përgjegjësi për atë të cilin e thotë përpara mikrofonit këtu, para qytetarëve të

Republikës së Kosovës dhe ndaj gjithsecilit, i cili pa kurrfarë bazash fyen, akuzon e quan tjetrin me fjalët më fyese, më denigruese, duhet të përgjigjet para drejtësisë dhe para ligjit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit! Bazuar në deklaratat e përfaqësuesve ose kryetarëve të partive politike, madje edhe të udhëheqësve të institucioneve të vendit, përjashtuar njërin nga këta udhëheqës, del se uniteti në mes të subjekteve politike në Kosovë është shumë i lartë. Por, kur vijmë këtu në Kuvend, shohim diçka krejt tjetër. Unë i kisha lutur disa nga deputetët, duke përfshirë këtu edhe diskutuesen e fundit, t'i analizojnë fjalimet e veta dhe të vlerësojnë se sa janë unifikuese fjalimet, të cilat ata sot i kanë përgatitur për këtë seancë, e cila për synim ka përafrimin e subjekteve politike për të nxjerrë dokumente të përbashkëta.

Në një tryezë të organizuar nga KFOS-i, më 20 tetor të këtij viti në Tiranë, në të cilën u diskutua për pozitën e Kosovës në dialogun me Serbinë, ku ishin të pranishëm përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike shqiptare të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, të gjithë u pajtuam se me Serbinë duhet të dialogohet, por nuk duhet hapur çështja e kufijve. Aty u konstatua se para fillimit të negociatave për marrëveshje me Serbinë është e nevojshme analiza e dialogut të gjertanishëm, si dhe listimi i kërkesave që duhet drejtuar Serbisë që janë të domosdoshme të plotësohen si kusht për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe të Serbisë. Po ashtu, do të duhej të përmenden edhe dëmet dhe të kërkohet kompensim i tyre që kanë ndodhur gjatë luftës së fundit. Në këtë tryezë po ashtu të gjithë e konsideronin të paanashkalueshëm rolin e Kuvendit të Kosovës si në hartimin e platformës për negociata dhe për zgjedhjen e delegacionit që do të negociojë me përfaqësuesit e Serbisë në emër të Kosovës. Në takimin e Tiranës fitohej përshtypja se uniteti për çështje më të rëndësishme që kanë të bëjnë me dialogun me Serbinë tanimë ekzistojnë, mirëpo në Prishtinë apelet për unitet, sidomos nga pozita, nuk kanë të sosur. Në këtë drejtim shquhet kryetari i Kuvendit të Kosovës zoti Veseli që është edhe kryetar i Partisë Demokratike, ai kohët e fundit shpesh po e përsërit apelin për unitet, duke e ndërlidhur atë me nevojën që po imponon aktualiteti politik.

Kërkesa për unitet për interesa të vendit në parim është e drejtë, por shumë me rëndësi është qasja dhe serioziteti i apeluesit, e qasja e zotit Veseli dhe e një numër të konsiderueshëm të deputetëve të pozitës nuk po i kontribuon unitetit të nevojshëm për arsyet në vijim: zoti Veseli, si kryetar i Kuvendit, ka për obligim përherë t'i respektojë opozitën, ashtu siç e respekton pozitën dhe ta respektojë secilin deputet veç e veç, e jo vetëm atëherë kur ka nevojë për atë. Ai shpesh i nënçmon e i fyen partitë opozitare, duke thënë se kurrë nuk ka parë ndonjëherë opozitë më të dobët e sihariqe të tjera të ngjashme që nuk korrespondojnë me sjelljen e kryetarit të Kuvendit, e aq më pak me sjelljen e dikujt që apelon për unitet.

Zoti Veseli dhe disa deputetë të pozitës po sillen kështu në kohën kur pozita nuk është në gjendje të bëjë asnjë punë në Kuvend pa opozitën. Ai dhe pozita në përgjithësi kur po e ftojnë opozitën ta votojë rezolutën e pozitës dhe ekipin për dialog me Serbinë, të propozuar nga Qeveria, në të vërtetë nuk po ftojnë për unitet, por po i ftojnë këto subjekte që ta ndihmojnë pozitën që t'i arrijë synimet, për të cilat pozitës i mungojnë votat. Po të angazhohen për unitet, pozita do t'i ftojë partitë parlamentare ta hartojnë një dokument të përbashkët, të formojnë një ekip të përbashkët negociator, si dhe ta emërojnë kreun e ekipit. Natyrisht, të gjithë këta hapa duhet të marrin miratimin e Kuvendit të Kosovës, kështu do të arrihet uniteti karshi Serbisë, ekipi do ta respektojë plotësisht platformën e votuar në Kuvend nga pozita dhe opozita.

Nëse pozita dhe kryetari i Kuvendit seriozisht angazhohen për unitet, ata duhet ta kuptojnë se është e pamundur të deklarohen kundër ndryshimit të kufijve dhe, në të njëjtën kohë, t'i dalin në mbrojtje idesë së presidentit Thaçi për ndryshim të kufijve, duke e përmendur shpesh rrezikun që mund të vijë nga Zajednica me kompetenca ekzekutive që mund të imponohet si alternativë e idesë së Presidentit për korrigjim të kufijve. Mirëpo, ideja për Zajednicën me kompetenca ekzekutive është e vdekur nga momenti kur Serbia ka pranuar që statuti i Zajednicës të shqyrtohet në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe sidomos pas shqyrtimit të këtij statuti në Gjykatën Kushtetuese, ku janë konstatuar mbi 20 shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Nëse të njëjtit seriozisht janë kundër ndryshimit të kufijve, atëherë t'i hyjmë analizës, ta bëjmë listën e kërkesave dhe ta hartojmë platformën, e cila do të votohet në Kuvend, bashkë me përbërjen e ekipit dhe kreun e saj.

Zoti Veseli dhe të tjerët, nëse doni vërtetë t'i kontribuoni unitetit karshi Serbisë, angazhohuni në këtë drejtim pa bujë, sepse me video vetëpromovuese nuk arrihet as uniteti, as promovimi.

Kolegë deputetë,

Është detyrë jona ta pengojmë projektin e Serbisë, të përkrahur kohët e fundit nga Presidenti Thaçi, e ai është copëtimi i Kosovës. Është detyrë jona, para se të merremi me njëri-tjetrin, që konkretisht të angazhohemi, sepse kjo edhe është në dorën tonë që këtë projekt ta bëjmë të pamundshëm dhe të fillojmë të merremi me probleme të tjera, për të cilat ka nevojë të merret Kosova. Fjalën time po e përfundoj me një thënie kineze, e cila i shkon kësaj situatë, në të cilën thuhet: “Më mirë ta ndezësh një qiri, se sa ta mallkosh errësirën”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Haradinaj.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryesues, zoti Haliti,
Zëvendëskryeministër,
Ministra,

Më lejoni të them veç 2-3 fjalë për seancën e sotme. E para, është interes nacional të dëshmohej që për çështje të interesit të përgjithshëm shtetëror mundemi dhe dimë të gjejmë gjuhë të përbashkët. E di se varësisht kush e thotë, po shihet kjo me paragjykime ose me dyshime, po nuk kemi rrugë tjetër, në çfarëdo etape të jetës sonë, pa marrë parasysh sa jemi të ndarë në Parlament, pa e gjetur ndonjë formulë që t'i mbrojmë çështjet e interesit nacional.

Demokracia, pozita, opozitëbërja do të vazhdojnë tërë jetën, po do të jemi të detyruar në një moment të themi po ose jo për interesin e vendit tonë. Edhe mendoj që njëra prej temave që kemi nevojë ta gjejmë momentin të themi atë çka mendojmë të gjithë bashkë, është çështja e dialogut me Serbinë. Po ashtu, nuk ka dilemë që Kuvendi i Kosovës është autoriteti suprem, pa të cilin asnjë marrëveshje ndërkombëtare nuk mund të jetësohet. Këtë duhet ta dimë të gjithë, kushdo, çdo pushtet, çdo institucion, çdo individ, vetëm Parlamenti është ai që merr vendime të këtij karakteri. Unë mendoj që është legjitime që secili subjekt politik në Kuvend të paraqesë një rezolutë. Sot e kemi po ashtu edhe një ide të tillë, mirëpo ju siguroj që pa marrë parasysh si quhet dokumenti dhe sa është përmbajtja e tij, çka përmban ai dokument, nganjëherë simbolikat flasin vetë. Vota e gjithë atyre që ishin prezentë për ushtrinë mendoj që është më e madhe se sa vetë ligjet për ushtrinë. Pra, mendoj që ju jeni shumë më të fuqishëm, deputetët që keni votuar atë ditë, se sa vetë ligjet. Se një votë e atij kapaciteti, pra atij numri dhe një porosi e tillë është shumë më e fuqishme se sa vetë përmbajtja e ligjit dhe e kisha lutur Parlamentin që ta gjejë ndonjëherë një moment të tillë për ndonjë situatë të tillë nacionale, pra ta gjejë atë formulë nëse ekziston.

Ne e dimë se rrugëtimi ynë tutje, pra edhe i dialogut, po na trumbetohet si kompromis, kompromis i radhës, mirëpo të mos harrojmë se themelet e një kompromisi i kemi në Kushtetutën tonë, ajo është pakoja e Ahtisarit dhe ato kompromise të atëhershme janë të gjalla e prej neve pritet t'i zbatojmë, edhe vetë zbatimi i tyre në të ardhmen dhe qëndrimi në ato, po i quaj obligime të pakos së Ahtisarit, është kompromis për Kosovën. Nuk mendoj që ne duhet harruar faktin se në themel të ekzistencës tonë dhe në funksionim të vetvetes ne i obligohemi kompromisit, i cili na ka bërë këta që jemi, pra të tillë çfarë jemi, e që është pakoja e Ahtisarit, që është në Kushtetutën tonë. Si Qeveri dhe si kryetar i Qeverisë mendoj se në tema nacionale kam bërë kujdes, por edhe do të bëjmë, megjithatë vendimet e Parlamentit janë të Parlamentit, janë tuajat. Unë kam pasur nderin disa herë në këtë foltore t'ju drejtohem juve. Nuk e kam menduar veten as të koalicionit qeverisës, të PDK-së, të AAK-së, Nismës e të tjerëve, kryesisht e kam menduar veten si një prej juve. Ju lus, ju bashkë nëse mbërrini të gjeni një moment të tillë, ju lutem veproni në një moment të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Fjalën e ka zoti Blerim Kuçi.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Tash qëndrimi ynë si parti rreth kësaj çështjeje apo temave të këtij debati dihet, e ai është qëndrimi i kryetarit të Aleancës, zotit Haradinaj.

Mirëpo, ne po flasim për diçka tjetër sot, edhe ajo që mua më ka brengosur, këto rezoluta njëra pas tjetrës. PSD-ja, para 3-4 muajve, më duket në korrik, e pati një rezolutë, tre muaj pra kanë shkuar e patëm një rezolutë pothuajse të ngjashme me këto rezolutat që kanë pasuar. Pastaj, filloi gara kush po e bën edhe një rezolutë tjetër, kjo ishte shenjë që asnjë rezolutë për këtë temë nuk ka për t'u aprovuar në këtë Kuvend. Nuk ka vullnet politik, sepse po të kishte dëshirë edhe vullnet politik, e kishim kryer me rezolutën që e ka pasur PSD. Po ashtu, po të kishte vullnet politik, është një formë krejt tjetër, jo me rezoluta. Ne kemi institucionet tona, Kosova e ka presidentin e vet, e ka kryetarin e Kuvendit, e ka kryeministrin.

Në këto tema kaq të rëndësishme, pa marrë parasysh kush është president, a është zoti Thaçi, a është një zotëri tjetër, me këto tema kaq të rëndësishme presidenti është dashur me i thirr partitë politike, liderët institucionalë me u takua, me debatua, me u mbyll, me u marrë vesh, ose mos me u marrë vesh. Asnjë intencë e tillë nuk ka qenë dhe s'po shihet vullneti i tillë. Po të ketë vullnet politik, nesër le ta thërrasë zoti Thaçi një takim të tillë me liderët politikë, ne duhet me shkua. Ata që nuk shkojnë, për mua, në një debat të tillë, në një takim të tillë, atëherë vërtet nuk është në rregull me ta.

Unë e di se ka disa që zotin Thaçi, sidomos në këto rrethana, nuk e duan. I kanë arsytet e veta, por ai është president i vendit, e ka të drejtën me i thirr, duhet me i thirr edhe me u takua, me u mbyll, me e bërë një platformë edhe gjithçka, se ka shumë elementë të tjerë të cilat nuk duhet thënë në publik para se të vijmë deri te platforma. Kjo nuk po ndodh edhe nuk e di pse s'po ndodh.

Unë nuk besoj sot, përshtypja ime, me keqardhje po them, që ka vullnet politik për ta pasur një rezolutë të përbashkët. Nuk besoj! Do të ishte befasi e llojit të vet në qoftë se kjo ndodh, se po të kishte një vullnet të mirë është ky sendi më i thjeshtë i mundshëm. Nuk është e thjeshtë të kryhet dialogu, por të merremi vesh për dialog është shumë e thjeshtë, kur ka vullnet politik. Përshtypja ime është se nuk ka vullnet politik për t'u marrë vesh për diçka të përbashkët për dialogun, pa marrë parasysh që temat, ose idetë fillestare mund të jenë krejt të kundërta, po ne kemi një kushtetutë, e kemi një kornizë, e kemi kuvendin, e kemi mundësinë e monitorimit të këtij procesi, gjithçka kemi, përveç vullnetit politik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kuçi! Fjalën e ka zoti Islam Pacolli.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, nënkryetar!

Kolegë të nderuar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Me të vërtetë, sot po e përcjell që nga mëngjesi një seancë e cila më shumë ka fjalë, se vepra.

Gjithë ky debat, vullneti është i mangët. Nëse ne si qytetarë, si deputetë, nuk e kemi një vullnet të tillë, asnjëherë nuk kemi për të arritur asnjë marrëveshje. Kur bisedojmë për çështjet nacionale

duhet me i lënë inatet politike anash. Ne duhet të ulemi bashkë, ta gjejmë një kompromis, ta marrim një vendim të gjithë së bashku.

Mendoj që për fatin e Republikës së Kosovës nuk vendos vetëm një njeri, s'mund vendos as presidenti, as kryeministri, po asnjëri vetëm. Do të thotë, ne duhet të jemi të gjithë së bashku. Prandaj, nëse nuk e kemi këtë vullnet, mos të humbim kohë, mos t'i rrejmë qytetarët që i kemi atje e që na kanë prurë deri këtu, se nesër do të shkojmë te shtëpia dhe duhet të na vijë marre para familjeve tona. Ne duhet me e marrë seriozisht këtë çështje, me i lënë inatet anash dhe me diskutua e me e nxjerrë një platformë. Është një moment shumë i rëndësishëm, të cilin sot diskutohet edhe për territorin e Republikës së Kosovës.

Territori i Republikës së Kosovës, mendoj se e kemi në një Kushtetutë, i cili nuk e ka të drejtën askush që ta lëvizë, prandaj këtu është e nevojshme që të ketë kompromis, t'i gjejmë arsyet, ta nxjerrim të gjithë së bashku dhe të shkojmë përpara, por jo në këtë formë. Unë me të vërtetë jam i zhgënjyer tërë ditën duke e dëgjuar, pasi që e shoh se vullneti mungon. Po bëjmë seancë, për çka? Kujt po ia adresojmë këtë seancë? Secili po thotë diçka, por në fund të ditës nuk jemi në gjendje që ta nxjerrim një vendim së bashku.

Përderisa nuk ka një vendim së bashku ne nuk mund të vendosim asgjë. Sigurisht se çdo vendim që nxirret edhe nga Presidenca po edhe nga Qeveria, duhet të kalojë nga Parlamenti. Prandaj, vjen prapë e njëjta gjë sikur dikur më herët dhe për të mos e prurë deri në atë pikë dhe me të vërtetë, pastaj secili me i thënë jo njëri-tjetrit, ne duhet me u ulë sot, duhet me diskutua, ama jo në këtë formë, për arsye se po e shoh që po e shkelim lartë e poshtë, po asnjëherë konkret temën për çka edhe jemi të thirrur.

Ju lus të gjithëve, ju bëj thirrje, t'i lëmë inatet, t'i bashkohemi të gjithë. Për këtë çështje nuk ka ngjyrë politike. Ngjyra politike është vetmja, është e Republikës së Kosovës, mos t'i harrojmë edhe ata që kanë shkuar më herët dhe e kanë lënë edhe jetën e vet, më të dhimbshmen, dhe ne sot nuk jemi në gjendje të gjejmë një unitet.

Ju bëj thirrje të gjitha partive, Qeverisë dhe Presidencës, që ne të ulemi së bashku dhe të marrim një vendim. Mos të shkojmë kështu, se ne po i ngadalësojmë proceset tona, prandaj në çdo hap po kemi vështirësi. Edhe mos të diskutohet gjithçka për Republikën e Kosovës, pa marrë një aprovim edhe në Parlamentin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Korab Sejdiu e ka fjalën.

KORAB SEJDIU: Faleminderit!

Të dashur qytetarë,

Të nderuar kolegë,

U përmend më herët, se përderisa ne po debatojmë për këtë çështje me mijëra qytetarë, veçanërisht të rinj të këtij vendi janë duke tentuar me çdo kusht me e lëshua këtë vend të pashpresë. Faktikisht, kjo ndjenjë që është krijuar është kryesisht rezultat i veprave të një njeriu në bashkëpunim me bashkëpunëtorët e tij të ngushtë, të cilët nuk dinë të ekzistojnë në rrethana normale dhe “modus operandi” i tyre është krijimi i një krize pas tjetrës, e kështu me radhë.

Dhe, aktualisht po ballafaqohemi me krizën e radhës të krijuar nga ai që sërish kërkon nga të gjithë ne, si përfaqësues dhe institucione të këtij vendi, të shpërqendrohemi nga problemet e qytetarëve dhe me qëllim që t’i mënjanojmë dëmet e shkaktuara dhe që po shkaktohen dita ditës nga ky njeri.

Sot është vetëm një ditë, nga të gjitha ditët që do të jenë, por po e parafrazoj Heminguejin, çka do të ndodh në të gjitha ditët tjera që vijnë varet nga ajo çka bëjmë sot. Po citoj një nga fjalimet mortore për mikun e madh shqiptar, të ndjerin senatorin Xhon M’Kejn dhe kush e ka përcjellë këtë ceremoni të dizajnuar nga vet i ndjeri, ndoshta edhe e sheh paralelizmin dhe arsyen pse ai e ka organizuar në atë mënyrë dhe pse këto fjalë janë thënë. Është më se i duhur një krahasim i tillë sot kur ne jemi mbledhur ta shpëtojmë Kosovën nga një tragjedi, ta shpëtojmë nga zhbërja, sot kur është shumë afër saj.

Thënë të drejtën, desha sot të argumentoj për nevojën për unitet në radhët e opozitës, mirëpo ne si duket kemi nevojë për unitet shumë më të gjerë. Po flas për unitet kombëtar.

Qytetarë të këtij vendi,

Ka mbi një vit që kemi filluar mandatin dhe ndoshta sot është dita e parë që gëzohem që e kam këtë përgjegjësi, sepse si kurrë më parë ne po qëndrojmë të gatshëm për me i dal zot vendit. Është e rëndësishme sot të tregohet se po bëhet fjalë për shumë më shumë, se sa për veprimet e një autokrati të dehur nga pushteti që synon, asgjë tjetër përpos mbijetesës personale. Po bëhet fjalë për betejën në pikën në mes të mirës e të ligës, autokracisë e demokracisë, në mes tiranisë dhe lirisë, betejë në të cilën nuk jemi të vetëm, sepse po bëhet në tërë globin, por për ne është edhe betejë ekzistenciale.

Pra, nuk bëhet fjalë vetëm për veprimet e një njeriu, po për rrënimin e themeleve mbi të cilat është ndërtuar ky shtet yni, Kosova. Injorimi dhe cenimi serioz i përgjegjësive dhe kufizimeve kushtetuese, qytetarë, ua kanë vendosur atyre që i mveshin me pushtet. Prandaj, ka ardhur koha të vendosim një vijë që tregon se kush është pro shtetit dhe pavarësisë dhe kush është kundër shtetit dhe kundër pavarësisë. Ky është momenti kur ne vendosim se Kosova jonë e porsalindur a bëhet shtet i mirëqenë i qytetarëve të saj apo shndërrohet në plaçkë lufte të gëlltitur nga grabitqarë autokratë të Kosovës e rajonit.

Sot me këtë prezencë kjo vijë po definohet dhe do të shihet qartë kush është në anën e qytetarëve. Sot themi se Kosova është e qytetarëve të saj dhe po tentojmë t'i dalim ballë këtij unioni serbofil, që po e sulmon Kosovën nga jashtë e ajo që është edhe më e rrezikshme, nga brenda. Dhe, ky debat e kjo rezolutë është vetëm fillimi. Vendit i nevojitet më shumë, i nevojitet unitet i forcave reformatore. Ju, në anën e qendrës së majtë ideologjike, po edhe ju të qendrës së djathtë, liderë të të dyja anëve, ju lus që të na bashkoheni për hir të popullit. Na bëni sot e tutje bashkë dhe tregoni se atdheu është më i rëndësishëm se ideologjitë politike apo programet elektorale, se Kosova ka shumë më shumë rëndësi se inatet eventuale që mund t'i kenë nga e kaluara, sado të rëndësishme dhe legjitime që mund të jenë ato, tregoni se jeni në anën e popullit kundër tiranisë.

Të nderuar kolegë,

Sot qytetarët presin nga ne unifikim për të luftuar kundër atyre që vendosin veten mbi kushtetutën dhe shtetin tonë. Qytetarët kanë parë se si uzurpatorët e shtetit të bashkuar nën petkun qeverisës mund ta çojnë shtetin drejt greminës, prandaj presin shumë nga të gjithë ne, veçanërisht nga Lidhja Demokratike dhe Vetëvendosja si forca kryesore opozitare. Presin që ju ta udhëhiqni këtë betejë me veprime konkrete dhe të koordinuara mirë. Ky unifikim bëhet edhe më i domosdoshëm, kur pritet që skena gjeopolitike të pësojë ndryshime të mëdha në pesëvjeçarin që po vjen dhe këto ndryshime mund të mos jenë të favorshme për Kosovën. Rrjedhimisht, uniteti ynë pa vonesa karshi sfidave kombëtare është jetik, jo vetëm për zhvillim, por edhe për mbijetesë.

Në fakt, kjo që po bëjmë sot është vetëm hapi i parë, siç e thash edhe më herët. Tentativat e njerëzve pa mandat kushtetues dhe pa legjitimitet nga shumica shqiptare për të bërë koncesione territoriale në emër të Kosovës kërkon kundërveprim të ashpër dhe populli është gati për të na mbështetur, i mbushur me mllëfin e dy dekadave nën thundrën e abuzimit. Por, kemi një problem, ky përfaqësim në këtë parlament, me këtë shumicë të pakicës që është bërë mundësues dhe bashkëkryerës i aferave skandaloze të presidentit nuk mund të krijojë unitetin e domosdoshëm, prandaj zgjedhjet janë parakusht për përfaqësim real të vullnetit të qytetarëve në Parlament dhe për Qeveri të mandatuar nga një shumicë shqiptare.

Prandaj, sa më herët që shpërbëhet ky Kuvend dhe bie kjo Qeveri, aq më shpejt do t'i krijojmë rrethanat për unitet të plotë të brendshëm në ballafaqimin tonë me sfidat e interesit kombëtar. U tha më herët se kjo është vetëm çështje e opozitës për të dashur që të vijnë në pushtet, por ka një dallim të madh, uniteti pas zgjedhjeve dhe ai që po e kërkon ju sot. Ku dallojnë? Në konstelacionin aktual qeverisës shihet qartë se vartësia është e plotë nga regjimi në Beograd, përpos asaj është i kidnapuar në tërësi nga presidenti Thaçi. Të vetmin negociim që mund ta bëni në këtë stad ju dhe ekipi që po tentoni ta themeloni është se ku të renditen në foto me Mogerinin. Çfarëdo tentative për të negociuar më tepër do të ju bie juve drejt rrëzimit të Qeverisë nga brenda.

Qytetarë të dashur,

Ne e kemi një borxh të madh ndaj jush, që sot ta bëjmë të qartë një porosi, thjesht jemi zëri juaj, porosi që duhet të dëgjohet nga të gjithë, se Kosova ka dhënë krejt çka mund të japë, se Kosovës i kanë të tjerët borxh e jo anasjelltas, se Kosova është shumë më e rëndësishme se mbijetesa dhe avancimet personale të kujtdo qofshin, se ky vend është i qytetarëve dhe miqve të saj dhe i askujt tjetër, se Kosova përcaktohet edhe një herë që të jetë vend demokratik, të jetë shtet i të së drejtës dhe jo i të fortëve. Dhe, këtë borxh, të dashur qytetarë ua shpaguajmë vetëm nëse bashkohemi kundër këtyre dëmeve që po i shkaktohen vendit nga presidenti dhe sejmenët e tij. Në të kundërtën, mbesim peng i lëngimeve që na dëmtuan përgjatë historisë, mbesim spektatorë të edhe një tragjedie kombëtare.

Përfaqësues të popullit, veçanërisht ju liderë politikë, heshtja dhe mungesa e kundërshtimit të ashpër nga ju në këto momente nënkupton miratim të asaj që po ndodh. Përçarja në mes nesh rezulton me koncesione shtesë ndaj Serbisë. Mungesa e rezistencës së ashpër është aprovim i vazhdimit të kapjes së shtetit nga armiqtë e të së ardhmes sonë. Mungesa e unifikimit është mandati që të vazhdohet me rrënimin e Republikës. E di që nuk e keni lehtë, e di që keni presion nga të gjitha anët, nga brenda dhe jashtë subjekteve, nga brenda dhe jashtë Kosovës, por ta dini se qëndrimi juaj stoik në këto momente mbështetet fuqishëm në vullnetin e popullit tonë për të jetuar i lirë dhe për të gëzuar shtetin për të cilin kanë sakrifikuar aq shumë. Kurrë mos iu frikoni rezistencës kur e keni popullin prapa, ashtu siç qëndron sot.

Të bëjmë atë që është e domosdoshme. Ta kalojmë këtë rezolutë që ndal presidentin, në fakt që eliminon atë nga të qenit faktor në skenën politike vendore dhe ndërkombëtare, të mbajmë zgjedhje, të krijojmë qeveri të shumicës shqiptare dhe pastaj të bashkuar të ballafaqohemi me sfidat e Kosovës, përfshirë edhe dialogun me Serbinë. Sfidat e kërcënimeve kemi shumë e kohë kemi pak. Të veprojmë sa nuk është bërë tepër vonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Sejdiu! Fjalën e ka zoti Hajdar Beqaj. A është kështu?

HAJDAR BEQAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Partia Demokratike në vazhdimësi ka marrë iniciativë konkrete për të përafruar qëndrimet politike, ndërpartiake dhe për të arritur konsensus nacional për temat e rëndësishme nacionale, në veçanti për të hartuar një platformë të përbashkët shtetërore për dialogun Kosovë - Serbi, me qëllim si shtet të kemi qëndrime unifikuese, që t'i arrijmë qëllimet tona integruese, si në integrimin evropian, anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, në OKB, NATO, në Interpol, UNESCO dhe në të gjitha organizatat tjera.

Por, sot unë nuk e pata shumë për qëllim të bisedoj, por ne kemi dy rezoluta, një të propozuar nga opozita, e cila ka një pikë që thotë, territori i Republikës së Kosovës është një dhe i pandashëm dhe as presidenti dhe askush tjetër nuk ka mandat të negociojë për territorin e Republikës së Kosovës. Realisht, territori i Republikës së Kosovës është një dhe i pandashëm këtë e thotë Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 1, respektivisht pikën 1 të Kushtetutës, do të thotë territori i Republikës së Kosovës është një, i pandashëm, demokratik dhe do të thotë është një copy paste nga Kushtetuta.

Ne e kemi edhe rezolutën e propozuar nga koalicioni e cila është më gjithëpërfshirëse, por sot mund të them lirisht, nuk e pata plan me fol po si deputet i Kuvendit të Kosovës e pash më shumë këtu në seancë sa shumë deputetë, më shumë kemi bërë tv-novela apo i kemi frikësuar qytetarët e Republikës së Kosovës me ato interesimet tona për unifikim, se sa kemi bërë ndonjë veprim konkret. Mendoj që sot është dashur t'i harmonizojmë rezolutat, të bisedojmë në nivel shfaqsh të grupeve apo të kryetarëve të partive dhe të votojmë një rezolutë të përbashkët, që është në harmonizim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ne sot edhe nga shtruesi i rezolutës u përmendën disa nene të Kushtetutës që realisht bien në kundërshtim ndoshta edhe me rezolutën e propozuar, sepse në Kushtetutë të Republikës së Kosovës janë pushtete të ndara, po të njëjtën kohë edhe presidenti i Republikës së Kosovës është njëri nga institucionet kredibile, i cili e krijon unitetin e brendshëm po të njëjtën kohë e përfaqëson Republikën e Kosovës, si brenda edhe jashtë vendit.

Ne sot nuk jemi këtu, mendoj, të bëjmë shumë vetëm zhurmë, por është mirë të bëjmë një vendim konkret, ta bëjmë një rezolutë të përbashkët që shihet se jemi shumë larg, por mua më shumë më befaso fakti i disa deputetëve të opozitës e në veçanti të deputetëve nga Lidhja Demokratike apo respektivisht Besa Gaxherri e cila shkoi aq larg sa që akuzon presidentin e vendit për vrasje të rivalëve të tij politikë. Kjo për mua është non sens edhe mendoj se është diçka për Prokurorinë, po është interesant kjo është për LDK-në që akuza të tilla bën me korrespondencë. Ne kemi qenë shpeshherë partnerë me LDK-në. Në moment kur LDK-ja ka qenë në Qeveri dhe e ka pasur ministrin e Drejtësisë, respektivisht ministren, nuk ka bërë një veprim të tillë. Në moment kur ka qenë në koalicion me ne dhe e ka pasur kryeministrin, e ka pas edhe ministrin e Brendshëm, prapë në ato tri vjet ka heshtur. Edhe është interesant, sa herë LDK-ja të mbetet në opozitë njerëzit që kanë udhëhequr PDK-në apo procese të mëdha janë “Vrasës” për këta.

Unë e di që ndoshta më shumë LDK-së u dhemb ajo “inatet personale” që zoti Thaçi kur ishte lider i Partisë Demokratike i ka mundur shpesh. Nja shtatë palë zgjedhje a dhjetë palë, s’e di, lokale e qendrore, në tëra zgjedhje e ka mundur LDK-në e ndoshta hala janë në atë garë. Po, të njëjtën kohë e ka bërë një veprim të madh, ne e dimë në 2014, me të vetmin qëllim me e zhbllokua Kosovën edhe me thënë që edhe pse jemi larg partia më e madhe, i kemi pasur 37

deputetë, ju kemi thënë “merre, udhëhiqe vendin” edhe kanë qenë pjesë e shumë negociatave jashtë vendit edhe shumë rezolutave të njëjtën kohë edhe të asociacionit të komunave, që ka marrë në këtë rast patentën për të zoti Isa Mustafa, të cilin e ka rrëzuar në disa pika Gjykata Kushtetuese.

Nuk është mirë ne këtu, nuk besoj që sot jemi në këtë takim për të treguar as CV-në e kurnjërit nga neve, as liderëve tanë politikë, por mendoj që është vullnet politik për të bërë një zgjidhje politike që të jemi sa më unifikues në raport me Serbinë. Asnjë deputet të opozitës nuk e dëgjova këtu duke komentuar asnjë deklaratë të ndonjë zyrtari të lartë të Serbisë, as presidentin serb, i cili çdo ditë del e deklaron dhe thotë që Kosova “është pjesë e jona, ose një pjesë e Kosovës është e jona” edhe ne nuk ulemi me e bë një strategji apo platformë për me negociua të gjithë bashkë, ashtu qysh na jep edhe kushtetuta, sepse duhet të jemi të qartë për qytetarët.

Kushtetuta është ajo që e obligon presidentin, institucionet, jo rezoluta. Rezoluta është vetëm një vullnet politik. Nuk kemi pa asnjë... krejt jemi të mllëfosur mas një individ, bën ky, s’bën ky, çlirohet Kosova nëse hiqet ky... po, unë i kuptoj se ndoshta disa parti kanë edhe probleme që tash janë në procese zgjedhore apo kanë mungesë lidërshipi apo kanë pasur probleme të ndarjeve e i kanë lënë ende pasoja dhe duan t’i mbulojnë problemet politike të brendshme me tema të mëdha nacionale, por nuk është mirë ne t’i maltretojmë qytetarët e vendit me kurrgjë hiç, sepse ne duhet të kemi me të vërtetë një konsensus konkret, veprime konkrete, po jo të humbim kohën e popullit tonë apo qytetarëve tonë. Asnjë njeri këtu nuk e dëgjova sot, asnjë deputet nuk e dëgjova sot duke komentua asnjë deklaratë, po e përsëris, të asnjë zyrtari të shtetit Serb. E komentojmë zotin Thaçi, i cili thotë duhet me iu bashku, është mirë me iu bashkua Lugina Kosovës. edhe unë mendoj që Lugina ka qenë e Kosovës dhe duhet të jenë në Kosovë, se edhe kanë luftuar atje njerëzit për të qenë e Kosovës.

A e lejon Serbia, a s’e lejon, unë nuk e kam dëgjuar, është çështje tjetër. Asnjë rast nuk e kam dëgjuar zotin Thaçi duke potencuar se “ne do të ndërrojmë territore” e kam dëgjuar duke thënë se ne do të jemi të interesuar të bëjmë korrigjimin e kufirit. Më mirë është sot dikush prej opozitës t’i komentojë deklaratat e Vuçiqit, që thotë veriu është i joni, ose thotë, Ujmani është yni. Por, po më duket kjo nuk e pengon opozitën. Opozitën e pengojnë problemet lokale, ndoshta keni edhe arsyetim, se tha njëri prej deputetëve që e keni bërë edhe çështjen e vrasjes së pasluftës LDK-ja e ke bërë me korrespondencë, po edhe parlamentin e Republikës së Kosovës e keni bërë si opozitë me korrespondencë. Kur të ju interesojë vini sa për t’i kryer obligimet e juaja, kur nuk ju intereson nuk vini apo vini me ndonjë propozim hajde... koti.

Unë edhe një herë kërkoj prej grupeve parlamentare, respektivisht prej shëfave të grupeve që mos t’u humbim kohë qytetarëve, të ulen ta bëjnë një harmonizim të rezolutës, i kemi disa rezoluta, prej PSD-së e deri te rezoluta e koalicionit sot që ishte gjithëpërfshirëse dhe ta kemi një rezolutë në interes të vendit e cila do të jetë e respektueshme për të gjithë ne po edhe për

institucionet. Në të kundërtën, po shihet se nuk ka vullnet të përbashkët, as nga ata që kanë sponsoruar rezolutën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ali Lajçi e ka fjalën. A, replikë? Ismeti. Zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Sinqerisht, është për të ardhur keq nga disa kolegë se sa lehtë etiketojnë dhe fyejnë një parti politike, njerëzit e saj që për 30 vjet gati, sivjet 29, kanë bërë çmos dhe kanë dhënë kontribut për shtetndërtimin e Republikës së Kosovës. Me të vërtetë, kishte fjalë të rënda, të cilat as nuk kanë vend e as nuk qëndrojnë dhe nuk janë as ministrat e LDK-së e as ministrat tjerë ata që duhet vënë para drejtësisë përgjegjësit e krimeve, që të gjithë e dinë që ka ndodhur ndaj shumë njerëzve dhe shumë veprimtarëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Përmendja e tyre nuk duam të themi se ne duam ta marrim apo të vihem në pozitën e viktimës, por kemi qenë viktimë. Kanë qenë viktimë, janë familjarët që iu kanë vrarë. Ne po kërkojmë nga organet e drejtësisë dhe sa herë të na jepet rasti ne kemi për të kërkuar, sepse është një e drejtë elementare, të dihet pas sa e sa vitesh se kush e bëri, ose kush i bëri këto krime.

Unë jam që organet e drejtësisë këtë ta bëjnë, po tash të mos sillen dhe të thonë shikoni tash po na akuzoni, por në kohën kur ju i keni pasur ju ministrat, nuk e keni lypur këtë. More e kemi lypur, por ministrat nuk e bëjnë këtë punë. Pikërisht është problemi që po ndërhyhet në organet e drejtësisë dhe prandaj po vihet në pikëpyetje edhe pavarësia e organeve të drejtësisë. Kjo është më se e qartë.

Ne duhet të mësohemi që së paku të jemi korrektë ndaj njerëzve që kanë humbur më të dashur dhe të jemi korrektë edhe ndaj atyre që i kërkojnë llogari nga organet e drejtësisë për këtë çka ka ndodhur. Prandaj është mirë të na kursejnë sepse pa Lidhjen Demokratike të Kosovës, ju pëlequ apo s'i pëlqeu kujt do qoftë, këtu nuk ka perspektivë dhe zhvillim të këtij vendi.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Beqa!

HAJDAR BEQA: Unë zoti Beqiri nuk e kuptoj a më e rëndë është fjala vrasje a të akuzosh për vrasje dikë në këtë vend, respektivisht Presidentin e këtij vendit, a të flasësh një fjalë, një realitet që unë nuk thash asgjë më shumë sesa ka qenë.

Ju keni qenë në pozitë dhe sa herë keni qenë në pozitë, nuk ua ka dëgjuar askush zërin, as kur e keni pasur kryeministrin, as ministrin e brendshëm, as ministrin e drejtësisë në këtë rast.

E para. E dyta, ne kemi qenë krejt populli i Kosovës kemi qenë viktimë, po kemi qenë viktimë e Serbisë, kemi qenë viktimë e një mekanizmi shtetëror paramilitar dhe militar serb.

Mua më vjen keq se ndoshta ti nuk ju takon atyre të LDK-së, po shumica edhe sot dhjetë vjet pas vdekjes në zotit Rugova, veç të marrin ndonjë votë, edhe atëherë të gjithë e keni kundërshtuar, thirreni në emër të Rugovës. Kur flasim ne në emër të liderit tonë, që ka qenë lider historik, zoti Thaçi, thoni e pse ju po e përmendni Thaçin. Kjo nuk është korrekt prej juve, duhet të bëheni korrektë se çdo gjë është për një votë në këtë vend, jo interes qytetar.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Pas gjithë këtyre diskutimeve sot është pak vështirë të mbash edhe gjakun ftohtë dhe të mos prekësh mandej askund.

Ne e kemi hapur një temë, propozuesi i një rezolute e ka nxjerrë një tekst dhe atë tekst e kam këtu para vetes dhe unë i pyes krejt kolegët deputetë dhe koleget deputete që duhet të vendosin rreth këtyre çështjeve, a pajtohen me këtë tekst: territori i Republikës së Kosovës është një dhe i pandashëm. Mendoj se pajtohen krejt me këtë tekst.

Pastaj as Presidenti e askush tjetër nuk ka mandat të negociojë për territorin e Republikës së Kosovës. A janë dy çështje për të cilat pajtohen të gjithë? Nëse ka dikush që thotë jo me këto çështje, me këtë propozim nuk pajtohem, shumë është në rregull. Mirë është të thuash nuk pajtohem edhe fund. Mirëpo, ky është një minimum për të cilin nuk ka mundësi dikush në këtë parlament të thotë nuk pajtohem.

Tash, si është çështja? Çështja është se ne dëgjuam një varg fjalimesh dhe shpesh thuhet ne po bëjmë politikë dhe po e dëgjoj sa herë. Në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në një parlament bëhet vetëm politikë. Ne nuk kemi ardhur për biznes, nuk kemi ardhur për të shtruar çështjet ekonomike tonat personale, por për të bërë politikë qoftë nga aspekti ideologjik apo qoftë nga ndonjë aspekt tjetër, por jo për të bërë biznes në parlament.

Prandaj që është krejt në rregull që secili bën politikë me çështje të ndryshme.

Unë e dëgjova me shumë kujdes fjalën e zotit Veseli nga pozita e deputetit, e kryetarit të Kuvendit, dhe vërtet unë prisja nga ai që e shtron një bazë për t'u pajtuar. Çka bëri ai? Duke folur për singeritetin, duke folur për mossingeritetin, duke gjuajtur me gurë në personalitetin dhe moralin e njerëzve këtu, qoftë të opozitës, qoftë të personave të veçantë, në të vërtetë ai vetëm e futi flakën për një luftë që mandej mori kah tjetër. Kjo mua ma qon mallin sikurse ajo faza e Revolucionit Francez, Robespierit, nëse nuk ke diçka të thuash për çështjen, atëherë bëj sulme morale ndaj personit, individit apo subjektit dhe mos u merr me çështjet dhe çështja pastaj të

vjen vetvetiu, sepse e ke denigruar moralisht kundërshtarin. Kjo nuk ishte ajo çështje që pritej nga zoti Veseli. Ai madje përmendi edhe erën me gaz lotsjellës të tepihëve të parlamentit. Edhe mandej kur thua jo këtyre tepihëve ju vjen edhe era gjak, pse po na thoni?

Po cila është çështja, a kemi ardhur të flasim për erën e tepihëve, apo kemi ardhur të flasim për tekstin e një rezolute në lidhje me një çështje shumë të rëndësishme?

Cila është çështja më e rëndësishme? Çështja më e rëndësishme është çështja që e ka hapur Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në lidhje me shkëmbimin, ndërrimin e territoreve të Republikës së Kosovës me Serbinë. Kjo është çështje e thjeshtë.

Unë dëgjova nga kolegët s'po them vetëm të pozitës, po nga kolegët dhe koleget e mia deputetë, tha ofroni dëshmi. Unë po ju ofroj juve një dëshmi ndërkombëtare për të cilën po ju them ku mund ta gjeni. Kërkoni gazetën Financial Times të datës 27 shtator dhe lexojeni shkrimin autorial në gjuhën angleze të Hashim Thaçit si President i Republikës së Kosovës. Ashtu është botuar. Autori është President i Republikës së Kosovës. Merreni dhe lexojeni atë artikull në gjuhën angleze, unë e di që ai nuk e ka shkruar se e di sa e njeh gjuhën angleze, por ka bashkëpunëtorë të jashtëm që e njohin në mënyrë perfekte gjuhën angleze. Në atë artikull thuhet shprehimisht shkëmbim i territoreve mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Në atë tekst shprehimisht e thotë në tekstin që e ka nënshkruar vetë, jo shkëmbim i territoreve me Shqipërinë, por me Serbinë. Në atë tekst askund nuk e gjejmë asnjë fjalë për bashkimin e Luginës së Preshevës. Tekstin e keni, origjinalin e keni, ju lutem merreni lexojeni dhe shikojeni për çka bëhet fjalë.

Çështja tjetër. Zonja Kusari e përmendi për artikullin editorial të Financial Times dje. Ky artikull i botuar dje në Financial Times bazohet drejtpërdrejt edhe shprehimisht në artikullin apo shkrimin autorial të Hashim Thaçit. Në këtë editorial të Financial Times, në përkthimin tim nga gjuha angleze thuhet kështu në një vend: hollësitë nuk janë bërë të njohura nga bisedimet kur dy burrat janë marrë vesh dhe kanë diskutuar për shkëmbimin e pjesës së Kosovës veriore të banuar kryesisht me serbë për një pjesë të Luginës së Preshevës në Serbi të banuar kryesisht nga shqiptarët. Ju lutem merreni këtë, e keni Financial Times të datës 27 shtator dhe 30 tetor. Merrni këta artikuj, lexoni. 27 shtator dhe 30 tetor janë dy artikuj që i keni aty. Këto janë që po i them unë. Nëse nuk janë këto, ne i përkthejmë krejt dhe i botojmë. Unë po them këta dy artikuj i keni në origjinal në gjuhën angleze, kur të doni përktheni. Jo mos m'i trego aty, po përktheji, kërko t'i përkthesh dhe t'i nxjerrësh.

Edhe unë po them faktet se zoti Thaçi ka folur në mënyrë të fshehtë për shkëmbim të territoreve, për cenim të integritetit territorial të Republikës së Kosovës, i keni në shtypin botëror. Ato çka i thotë për konsumim të brendshëm, bashkimi i Luginës së Preshevës, është një gënjeshtër, një gënjeshtër për mashtrimin e shqiptarëve në Luginën e Preshevës.

Çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë se është detyrë e këtij parlamenti, deshëm ne apo s'deshëm, që ta bëjmë një rezolutë me të cilën i ndalohet çdo marrëveshje, çdo diskutim për ndryshim të territorit, për shkëmbim të territorit të Republikës së Kosovës me një shtet.

Po kthehem sërish te pyetja fillestare. Në rezolutën që e ka propozuar propozuesi thuhet: territori i Republikës së Kosovës është një dhe i pandashëm. A pajtoheni të gjithë me këtë konstatim? Nëse dikush nuk pajtohet le të thotë jo. Pastaj thuhet: as presidenti e askush tjetër nuk ka mandat të negociojë për territorin e Republikës së Kosovës. Nëse ne nuk jemi në gjendje të pajtohemi me një fjali, konstatim dhe obligim të tillë sot kur faktet ekzistojnë dhe mund t'i botoni dhe mund t'i nxirrni, atëherë edhe unë po pajtohem me shumicën këtu që në të vërtetë nuk ka mundësi për pajtim për asnjë çështje.

Zoti Kryeministër e kërkoi që të pajtohemi për një minimum që mund ta gjejmë. Ky minimum është një fjali që e ka ofruar propozuesi me subjektet LDK, Vetëvendosje dhe Alternativa. Unë kërkoj nga ju që ta votoni këtë tekst të rezolutës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën kush e ka. Ethem Arifi s'është këtu. PSD-ja nuk e ka askënd të paraqitur. Zoti Fidan Rekaliu e ka fjalën.

FIDAN REKALIU: Faleminderit zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Lindja e shtetit të Kosovës në kufijtë e sotëm e ka pasur një çmim të rëndë, janë angazhuar e sakrifikuar breza e breza nga të gjitha kategoritë e shoqërisë. Ideja e shtetit të Kosovës kishte marrë përmasa pasi shumë njerëz u goditën rëndë, por kurrë nuk u ndalën. Kjo ide kishte dy diga, mbrojtje të parrëzueshme që ishte legjitimiteti i plotë sepse kishte prapa vetes shumicën dërmuese të popullit të Kosovës dhe kishte në krye të saj një udhëheqje vizionare, me një qartësi pa asnjë dyshim se si duhet të ishte Kosova e lirë dhe e pavarur.

Qartësia politike në njërën anë dhe përkrahja e madhe popullore në anën tjetër ishin binomi i parë i strukturës së shtetit të Kosovës. Qytetarët e Kosovës asnjëherë nuk u ndien mosbesues ndaj të ardhmes së Kosovës para vitit 2006. Pavarësia e Kosovës ishte kompromisi i shqiptarëve të Kosovës por edhe arritja më e madhe e shekullit që një marrëveshje shoqërore për jetesë të përbashkët për të gjitha komunitetet që jetojnë në vend, e cila është përqafuar nga shumica e qytetarëve.

Sot Kosova po përballlet me mungesë besimi, mungesë besimi nga qytetarët e Republikës së Kosovës, mungesë besimi i partnerëve ndërkombëtarë ndaj udhëheqësve politikë në Kosovë, të cilët kanë cenuar të arriturat e deritanishme. Sot dialogu me Serbinë në vend që të qartësonte Serbinë për realitetin e shtetit të Kosovës dhe të kufijve të saj po rrezikon të kthehet në burim

mjegulle për atë se çfarë është Kosova dhe ku e sa është Kosova. Serbia po arrin suksese në arritjet dhe qëllimet e saj, sepse pjesë e kësaj melodie e përpjekjeje është bërë edhe vetë kreu i shtetit, garanti i Kushtetutës që është shndërruar në qytetarin e Kosovës që e shkel më së shumti Kushtetutën e Kosovës me secilën deklaratë që jep.

Në vend se të negociojmë për të krijuar kushte më të favorshme dhe të drejta pozitive që lehtësojnë jetesën e qytetarëve serbë dhe në vend që ndikon te ta për ta pranuar më lehtë shtetin e Kosovës, Presidenti i vendit ka filluar të negociojë për qenësinë e shtetit të ri në këtë formë e përmbajtje. Njeriu i cili ka udhëhequr dhe ka qenë pjesë e çdo procesi të negociatave të deritashme po konteston të arriturat, duke i vlerësuar ato si të pakta për të ndryshuar gjendjen në terren. Por gjendja është gjithsesi më ndryshe. Vërtet duhet ende punë për ta ndërtuar komunikim dhe gjetjen e bashkëpunimit dhe pranimi për komunitetin serb, por është bërë punë në këtë drejtim.

Negocimi në kushte të tilla është në dëm të shtetit dhe si i tillë duhet sanksionuar me ligj. Tashmë është konfirmuar se gjendja nuk mund të vazhdojë kështu sepse kësaj qeverie i mungon legjitimiteti.

Kosova nuk ka territor për të humbur dhe mbështetjen për këtë e merr edhe nga miqtë e partnerët tanë ndërkombëtarë.

Kuvendi si organi më i lartë përfaqësues dhe vendimmarrës do të duhej që sot të sanksionojë dhe deligjitimojë propozimet e z. Thaçi duke i treguar qartë atij e të tjerëve se i njëjti nuk paraqet interesin dhe qëndrimin e qytetarëve të vendit. Vendi duhet të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme për të siguruar një qeveri me shumicë stabile, e cila me një zë garanton parimet mbi të cilat duhet negociuar e mbi të cilat është siguruar shtetësia e Kosovës.

Çdo kompromis mbi këto parime rrezikon qenësinë tonë dhe shkon në favor të Serbisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Izmaqu e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të respektuar qytetarë,

Edhe unë si kolegët e mi deputetë sot kam ardhur në seancë e përgatitur të flasim mbi një debat që do të përfshinte ide se si të bëjmë një platformë të përbashkët për të përmbyllur bisedimet me Serbinë. Këtë seancë e ka ftuar opozita dhe prita ide të qarta mbi këtë debat, por fatkeqësisht në shumicën e rasteve deri tani mbizotëruan vlerësime morale dhe diagnoza edhe shëndetësore me diskurs që shpeshherë nuk i bën nder as grupit politik nga vijnë ato diskutimeve dhe as vetë Kuvendit.

Muajve të fundit kemi dëgjuar shumë shpesh deklarata të ndryshme se fundi i bisedimeve me Serbinë do të jetë i vështirë dhe i dhimbshëm, ashtu edhe mund të jetë. Por po aq i dhimbshëm është edhe gjithë ky proces i dialogimit, i cili po zgjat që 19 vjet pas luftës dhe 10 vjet pas pavarësisë. Loja nga një pjesë e opozitës me ndjenjat e qytetarëve duke mbjellë frikë dhe ankth se dikush po do pra ta shesë territorin. Është shumë e padrejtë. Meqenëse është një paranojë konsideroj e pajustificueshme, ne po pajtohemi të gjithë së paku në parim se ky nuk është një proces i cili duhet t'i takojë vetëm një lideri, një koalicioni apo një parti politike.

Ky proces sido që të përfundojë, edhe për pasojat, por edhe për të mirat e tij në epilog, përgjegjësitë do t'i bartim të gjithë. Andaj mendoj se në tavolinë duhet të jemi të gjithë. E fatkeqësisht për këtë përgjegjësi deri tani nuk e dëgjova asnjë nga kolegët e mi deputetë nga opozita. Nuk mund t'i ikën askush këtij procesi sepse ne jemi të zgjedhur të popullit dhe ata na kanë zgjedhur që të merremi me të gjitha problemet dhe jo të barrikadohemi tani në teoritë tona që shpesh nuk përkojnë hiç me këtë realitet.

Bisedimet me Serbinë do të duhej të mbyllen sa më shpejt, në mënyrë që këtë çështje ta hedhim pas krahëve dhe të merremi me integrimin evropian të vendit, të merremi me problemet reale që prekin qytetarët tanë siç janë zhvillimi ekonomik dhe sigurisht hapja e vendeve të reja të punës. Të gjithë e dimë se sa më shumë që të merremi me vetveten, me këtë çështje, aq më larg do të jetë integrimi ynë. Andaj, duke u bashkuar drejt këtij qëllimi, ne mund t'ia shkurtojmë vetes rrugën drejt BE-së. Ka edhe këtu në mesin tonë që nuk i kanë besuar as bisedimet e Rambujesë, as bisedimet që Kosova përfaqësohej nga grupi i unitetit, por u pa që në të dyja këto raste Kosova doli fitimtare.

Unë besoj plotësisht se nuk ka sot një deputet në mesin tonë që nuk i besoj të ardhmes më pozitive për të gjithë. Përballja me të kaluarën nuk na ka trembur dhe nuk duhet t'i frikohemi as sot.

Këto bisedime që po bëhen në nivel presidentësh, por edhe ato në nivel kryeministrash, kanë pasur dhe mund të kenë edhe tutje defekte, sepse bisedimet nënkuptojnë edhe kompromise, dhe ato edhe mund të mos na pëlqejnë shpeshherë. Neve nuk na ka pëlqyer as lufta, por jemi detyruar të përballemi dhe sot jemi ku jemi, pra në këtë Kuvend.

Konsideroj se është koha e fundit, jo për ta marrë të gjithë fajin nëse ndëshkohemi në këto bisedime apo nëse i humbim, por është koha e fundit që të bashkohemi të gjithë dhe ta nxjerrim më të mirën nga këto bisedime, sepse ne të gjithë këtu do të jetojmë, këtu do t'i rrisim fëmijët tanë dhe këtu besoj duhet të bëhet unifikimi për shkak të interesit nacional dhe jo për çështje e interesa të ngushta partiake ose edhe inate të tjera tërësisht të pajustificuara. Ne edhe si PDK erdhëm sot në këtë seancë për të shprehur vullnetin tonë për të tejkaluar ndasitë në një çështje me interes më të madh të partitë e tona. Por, askush nga asnjë tabor nuk ka të drejtë të vendosë

kushte për të qenë bashkëpjesëmarrës në një proces për të cilin njëjtë si unë si kolegët e mi deputetë kemi kërkuar përgjegjësi. Kemi kërkuar vota, kemi kërkuar vota nga qytetarët. Ju e dini që nuk ju kanë zgjedhur për të parë seancat nga shtëpitë tuaja, por të jeni këtu në sallë, dhe jo vetëm sot, por edhe për problemet e tjera që diskutojmë.

Nëse duam të tejkalojmë ndasitë duhet të jemi të gjithë racionalë, sepse asgjë s'ka përfunduar në këtë temë, jemi ende në kohë, pikërisht sot jemi në sallë për këtë çështje. Të vendosim pra në letër pikat më të forta që na bashkojnë dhe të tejkalojmë kundërshtitë në këtë rast sepse varet kjo nga forcimi i shtetësisë sonë nga ky reagim. Unë besoj që ekziston ky vullnet dhe kam ende shpresë sepse mbi interesat e ngushta në këtë sallë, po besoj që prapë në këtë sallë ka njerëz që kanë dhënë shumë për lirinë e vendit dhe duhet ta kenë edhe sot këtë rol. Ftesën ta bëjnë këtu për unifikim, ashtu siç e bëri edhe kryetari i partisë sime, Kryetari i Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari u pa përfundimisht edhe sot që sa i përket dialogut me Serbinë dhe po ashtu kësaj ndërmarrjes së rrezikshme të Hashim Thaçit, këtu ka dy qëndrime. Në fakt, pastaj këto dy qëndrime prodhojnë edhe dallime të mëdha ndërmjet pozitës dhe opozitës apo subjekteve politike.

E përmendi edhe shefi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje Glauk Konjufca që ne si Vetëvendosje nuk e pranojmë që Hashim Thaçi të jetë prijës e madje as pjesë e dialogut me Serbinë. Roli i Presidentit është që të shpërndajë dekorata, le ta bëjë atë punë dhe të heqë dorë nga procesi i dialogut me Serbinë. Kjo jo vetëm pse na është tekur, por sepse ky person mban përgjegjësi për gjendjen në të cilën ndodhet Kosova, qoftë në aspektin politik, qoftë në aspektin ekonomik, por edhe social.

Tash kur ka nisur ky proces i dialogut me Serbinë, tash në vitin 2011 po flas sidomos për këtë proces gjashtëvjeçar, ky person na ka thënë që përmes këtij procesi të dialogut, Serbia do ta njohë Kosovën, do të ketë integrim të serbëve në jetën shoqërore politike, do të ketë po ashtu integrim të Kosovës në Bashkimin Evropian.

Nëse vlerësojmë sot se çka ka ndodhur është se asnjëra prej këtyre nuk ka ndodhur. Përkundrazi, nga ky proces do të doja që t'i përmendja vetëm disa prej dëmeve që ky person i ka bërë gjatë këtij procesi. E para është krijimi i Listës Serbe, pra krijimi i një subjekti politik i cili e lufton Republikën e Kosovës në mënyrë aktive, që është dorë e zgjatur e Serbisë përbrenda territorit dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Amnistimi i kriminelëve serbë. Tash së fundmi kemi parë një deklaratë të zonjës Vafije Krasniqi dhe unë e analizova pak rastin edhe në procese gjyqësore dhe njëri prej dhunuesve

fatkeqësisht deri vitin e kaluar kishte qenë pjesë e policisë në veri. Pra u amnistuan ata që kryen krime gjatë luftës në Kosovë përmes këtij procesi të dialogut dhe pikërisht njëri prej këtyre ka përfituar edhe me Ligjin për amnisti. Kështu është një prej vendimeve të Gjykatës së Apelit nëse nuk gaboj apo supremes. Pastaj ndarja në dysh e buxhetit, ndarja në dysh e drejtësisë, marrëveshja për energjinë, Zajednica, por edhe falja e territorit. Pra, Hashim Thaçi është personi i cili e ka nënshkruar një marrëveshje që i falë mbi 8 200 hektarë Malit të Zi. Kjo është ajo që ne si “Vetëvendosje” e kundërshtojmë, pra për shkak se ky mbanë përgjegjësi politike për shumë marrëveshje të dëmshme.

Në anën tjetër ajo çfarë pamë këtë është një qëndrim i koalicionit dhe fatkeqësisht i një grupi tjetër të opozitës siç është PSD. Njëfarë tendence për ta rehabilituar Hashim Thaçin. Pra, të harrojmë se çfarë ka bërë Thaçi. Po deri tani ka gabuar, por le ta udhëheqë këtë proces. Ne e monitorojmë përmes një komisioni e nëse rastësisht nënshkruan diçka që është e dëmshme ne nuk e votojmë atë.

Por, nga ky person nga i cili nuk paskeni frikë, po flas për ata të cilët nuk po ju pengon Hashim Thaçi. Ata duhet ta dinë që Hashim Thaçi me këtë ndërmarrjen e tij po e kërcënon demokracinë. Po e kërcënon karakterin e republikës dhe po i kërcënon interesat tona kombëtare. Pra, ne kemi një president të Republikës së Kosovës i cili nuk beson në integritetin territorial dhe sovranitetin e vendit. Dhe ka marrë në mënyrë autoritare udhëheqjen e këtij procesi, madje në kohën kur Kuvendi ishte në zgjedhje të jashtëzakonshme.

Ky person po thotë qartë; do të ketë kompromise të dhimbshme dhe nuk ka vija të kuqe në procesin e dialogut. Por, Kosova është Republikë parlamentare dhe Hashim Thaçi nuk ka të drejtë të jetë pjesë e këtij procesi edhe ligjërisht, por edhe politikisht për shkak të dëmeve që i përmenda. Ka shumë po i përmenda vetëm disa.

Deklaratat se Hashim Thaçi është i pashmangshëm që vijnë nga deputetët e Kuvendit, për mua janë të papranueshme. Një deputet të theksojë këtu në Kuvend që ne nuk kemi fuqi me ndalë presidentin, kjo përnjëmend është skandaloze.

Protesta e 29 shtatorit i ka dhënë mesazh të qartë Hashim Thaçit. I ka treguar se kush e ka mandatin e sovranit. Ajo protestë që dikush e quajti koncert ishte dëshmi edhe për Bashkimin Evropian, por edhe për Shtetet e Bashkuara të Amerikës që qytetarët e Kosovës nuk pranojnë pazaret e Hashim Thaçit. Ka qenë mesazh edhe për Qeverinë sesi ndalet Hashim Thaçi. Pasi që deklaratat e Haradinajt kundër shkëmbimit janë të pamjaftueshme nëse ky nuk e ka guximin t'i thotë “ndal” Hashim Thaçit, dhe mirë që erdhi edhe kryeministri tash. Madje ne na vijnë informacione, sesi Thaçi e kërcënon Haradinajn që në qoftë se ndërmerr veprime për ta ndaluar Hashim Thaçin ai përdor deputetët e tij përbrenda këtij Kuvendi nga radhët e PDK-së për ta rrëzuar Haradinajn, dhe Haradinaj e ka dëshmuar që për të është shumë më e rëndësishme

karrigia e kryeministrit sesa Republika e Kosovës apo në këtë rast territori i Republikës së Kosovës.

Këtu u tha që Hashim Thaçi se ka përmendur shkëmbimin, u përmend nga Kadri Veseli. Por, nëse ai thotë se do të ketë kompromise të dhembshme dhe nëse qëllimi i tij qenka bashkimi i Luginës shtrohet pyetje e thjeshtë, ku është dhembja këtu? Pse duhet të jetë kompromis i dhembshëm bashkimi i Luginës? Cili qytetar i Republikës së Kosovës e kundërshton bashkimin e Luginës? Cili nuk e respekton vullnetin qytetarëve të Kosovës Lindore? Unë nuk besoj që ka të tillë. Prandaj është mashtrim i Hashim Thaçit. Ky person ka udhëhequr gjashtë vite procesin e dialogut dhe a e dini që asnjëherë në asnjë takim nuk i ka përmendur qytetarët e Kosovës Lindore, asnjëherë.

Qytetarët e Luginës shtypen përditë, diskriminohen, por ai asnjëherë nuk e ka kthyer kokën nga ata. Madje, edhe një rezolutë që e pati propozuar “Vetëvendosje!” dhe që ka kaluar në Kuvend para disa kohësh për reciprocitet të plotë ekonomik, politik e tregtar me Serbinë, ai e ka rrëzuar me një kundër rezolutë tjetër. Ky është Hashim Thaçi që tani po mashtron dhe po luan me ndjenjat e qytetarëve të Kosovës Lindore.

Unë do të doja ta përmendja vetëm edhe në çështje që u përmend më parë që ka të bëjë me efektet e bojkotit. Është e vërtetë që opozita prej kohës kur nuk është lejuar kjo seancë, ne kemi bojkotuar në mënyrë aktive Kuvendin e Kosovës. Pro, mund të kenë të drejtë ata që thonë ky bojkot nuk ka pasur efekt. Për shkak se pikërisht ata që thonë kështu kanë mundësuar atë që bojkoti të mos ketë efekt, sepse kanë qëndruar në sallë, pra e kam fjalën për PSD-në e cila ka qëndruar në sallë dhe janë bërë bisht i Qeverisë. E kanë mirëmbajtur këtë Qeveri.

Vetëm paramendojeni një situatë kur opozita të gjitha subjektet politike opozitare nuk do të vinin në seancë, në asnjë seancë. Do të ishte e pamundur funksionimi i kësaj Qeverie prandaj vendi do të shkonte në zgjedhje. Por, ata nuk janë të interesuar të shkojnë në zgjedhje, sepse e dinë që mandatet e vjedhura që sot i mbajnë nuk do të mund t'i kenë asnjëherë. Pra, karriget e deputetit nuk do të mund t'i shohin më. Prandaj, edhe nuk janë të interesuar të shkojnë në zgjedhje dhe janë në gjendje të pranojnë edhe këtë Qeveri të skandaleve, vetëm e vetëm që vendi të mos shkojë në zgjedhje.

Ajo çfarë pata edhe për zotin Limaj, sepse e dëgjova me vëmendje çfarë tha, një pyetje të thjeshtë; në qoftë se do të votohej zoti Limaj si kryesues i ekipit të dialogut, a do ta takonte ai Vuçiqin apo Hashim Thaçi? Apo ai do ta kishte rolin e Avni Arifit apo të Edita Tahirit? Sepse kjo është çështja. Ata janë thjeshtë vagonë të Hashim Thaçit. Prandaj, ne e kundërshtojmë si ekip dhe ne kemi qëndrime të qarta, e a doni a nuk doni t'i merrni vesh ajo është diçka tjetër.

“Vetëvendosja!” ka vite që ju ka treguar që kjo mënyrë e dialogimit është e dëmshme për Kosovë, andaj ky format i dialogut duhet të ndërpritet sa më parë. Faleminderit!

KRYESUSI: Faleminderit! Zoti Sherifi, replikë! Se kam dëgjuar ta këtë përmendur emrin po në rregull.

BILALL SHERIFI: I shtroi një pyetje zëvendëskryeministrit Limaj i cili vazhdon të jetë kryetar i Nismës, prandaj thash të marr mundin që shkëlqesisë së saj t’ia jap një përgjigje.

Delegacioni i cili do të votojë në Kuvend do të shndërrohet në delegacion shtetëror. Sepse Qeveria dhe opozita do të përbënin një delegacion shtetëror dhe kryesuesi i tij do të udhëhiqte delegacionin e Kosovës këdo që do ta dërgonte Serbia në Bruksel për të zhvilluar negociatat. Unë nuk e di pse po e paragjykon kjo që do të jetë Vuçiqi, nga e di Albulena që Vuçiqi do t’i udhëheqë bisedimet në emër të Serbisë. Ndoshta edhe e ndërrojnë nga momenti kur ne e ndërrojmë, nuk i dihet asaj.

Prandaj, të mos paragjykojmë se kush vagon i kujt do të jetë. Mbani vagonët tuaj në rend se një nga një janë duke ju shkëputur, do të mbesni vetëm lokomotivë në vete pas asnjë vagon. Në mënyrë që të mbeten në Kuvend se kështu si e keni nisur çdo vagon që nuk ju pëlqen ta hiqni nga lidhja, ju do të mbeten vetëm lokomotivë në vete. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj, kryeministri e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Edhe diskutimi, edhe rreth pikëpamjeve që i kam jo vetëm për shkak të diskutimeve këtu. Unë e shoh punën e shpërndarë nuk e shoh të koncentruar në një adresë për çështjen e dialogut me Serbinë edhe të temave.

Për shembull në pjesën e ekspertizës e asaj që është teknike që e udhëheqë Avni Arifi. Që është një djalë që ka kryer shkollë në Holandë. Që nuk është i njohur për ndonjë përfshirje të çfarëdo natyre në aspektin negativ në jetën shoqëror, politike apo ekonomike. Që është një ekspert korrekt.

Ne kemi mbërri që materien e dialogut ta kthejmë në një materie po e quaj ashtu të parametrave realë dhe kemi mbërri që ta informojmë Parlamentin. Pra, me një raport që mendoj që është një kontribut për transparencë edhe për saktësinë e saj çka po ndodh në atë dimension të dialogut që është trashëgimi e obligimeve të mëhershme të dhëna nga ky Parlament i vendit.

Një pjesë e rëndësishme pos kësaj pjesës së ekspertizës nëse e marrim shembull vetëm borxhin ndaj Bankës Botërore të cilin Kosova e ka marrë e servison po nuk merr trashëgimi. Nëse e

marrim këtë lëndë, dëshirojmë ta kthejmë këtë në një kontratë mes Kosovës dhe Serbisë për obligimet potenciale në të ardhmen dhe si gjendet balanca e kësaj, prapë barra bie mbi ekspertizën, mbi ekspertët e vendit.

Mirëpo, mendoj që ne kemi mbërri në njëfarë situate kur nuk po mbërrimë që ta shohim totalin e dialogut, edhe kryesisht po shohim vetëm një aspekt për të cilin ju e dini qëndrimin tim. Pra, për pozicionin e presidentit të vendit ose idenë që marrëveshja të arrihet me ndryshim të kufijve, korrigjim, korrektim si të doni demarkim që është kamuflazh për ndarje. Për këtë nuk kam nevojë që të ma konfirmoni ju se e kam konfirmuar në mënyra të duhura në vendin e duhur edhe atë e besoj me bindje. Mirëpo, po ashtu për juve e kam fjalën për deputetët për Parlamentin pa marrë parasysh grupet politike; a është Aleanca a është “Vetëvendosje!” a PDK-ja, LDK-ja a PSD, ju lutem edhe ju merrni përgjegjësinë. Një pjesë është e Parlamentit, ju siguroj që është një pjesë e Parlamentit përgjegjësi e juaja. Pse? Presidenti përfaqëson në këtë rast në bazë të mandatit kushtetues ose e shkarkojmë ose ka kompetencat e veta, por nuk ka kufizim kompetencash për një udhëheqës të shtetit, nuk njihet ai instrument.

Përderisa keni President të zgjedhur nga ky Parlament në procedura demokratike, sa përket pikëpamjes ose idesë që me korrigjime terriore të mbërrihen marrëveshjet nuk besoj që kam nevojë t’ju arsyetohem juve ose dikujt sepse mendoj se kam kryer detyrën time. Por, po dua të flas diçka, në konstalacionin e sotëm ne mund të vazhdojmë të ankohemi që kemi një president që nuk po na unifikon që nuk i besojmë, që po na përfaqëson keq që ka ide të gabuara. Por, çfarë po bëjmë ne të tjerët ju lutem? Kush çfarë është duke bërë? Ja për shembull, nëse është bash ashtu si po thoni, si po themi edhe si është mendimi im që nuk mund të mbërrimë marrëveshje me korrigjim të kufijve, atëherë ta merr secili institucion pjesën e vet të përgjegjësisë.

Qeveria e merr ekspertizën atë qo bëjmë, Parlamenti do duhej ta votonte edhe platformën edhe delegacionin. Dhe tani e vetmja gjë që Parlamenti në njëfarë mënyre mund të thotë që nuk po e bënë, është që nuk po shkon të dalë në fotografi me Vuçiqin. Pra, t’i paraqesë ato që i kemi para tij. Ne nuk kemi nevojë që të bëjmë garë kush po shkojmë me dalë në fotografi me një burrshtetas të cilido vend e lëre më fqinjët tanë që i kemi konteste të hapura, tragjedi e të kaluar shumë të dhembshme. Pra, nuk është aty qëllimi.

Unë ju siguroj që sikur ta gjenit një ndjenjë një momentum të tillë çfarë e kemi gjetur kur ishte në pyetje ushtria e t’i venim disa korniza të asaj se për çfarë qëndrojmë si Parlament, si LDK, si PDK, si Aleancë, si “Vetëvendosje!”, si PSD, ne do t’ia lehtësonim kujtdo qoftë që është i Kosovës që ta përfaqësojë temën e me atë temë ne nuk e zgjidhim gjendjen në shëndetësi as në arsim as në punësim, plotë probleme që i kemi të këtij vendi, po të paktën të sigurohemi që nuk do të kemi befasi, njëkohësisht edhe i kufizojmë ata përfaqësues tonë, pra i kornizojmë, çka po çka jo.

Besoj që kjo ide e kësaj seance mund të jetë po ai moment, nuk e di sot a do të mbërrimi që ta përmbyllni këtë debat me një produkt se unë e shoh që edhe mungesa e kuorumit e ku di unë, por nëse vazhdon kjo seancë ju lutem mbërrini te një qëndrim i caktuar, jepni ato konkluzione të qarta, lehtësojani unë po them lehtësojani po mund ta merrni lehtësojani edhe në thonjëza, atyre që na përfaqësojnë që ta kemi të qartë se për çfarë mund të na përfaqësojnë.

Edhe ruani kompetencat e Parlamentit që është i vetmi organ që e ka vendimin pra përfundimtar që është autoriteti suprem. Këto diskutimet pastaj me kush sa e ruan pushtetin e sa e ka e sa ato, kemi raste të tjera kur prapë do t'i bëjmë. Unë jam këtu edhe nesër mund të vijë edhe veç për qeverisjen veç për pushtetin veç për marrëdhëniet në koalicion, ju siguroj që sa herë që të doni vij që t'i sqarojë, por sot nëse mundeni veproni pra në këtë temë.

Unë e shoh që ndoshta nuk mundemi sot figurativisht, po shfrytëzoni këtë seancë të sotme të thirrur nga një subjekt politik në këtë rast nga LDK-ja, disa janë thirrur më herët, shfrytëzoheni këtë momentum të këtillë të mbërrimë te një qëndrim që është yni, i Parlamentit. Nuk do të ketë humbës në këtë rast. Sikurse nuk do të ketë fitues pos Kosovës, ne si vend do të fitojmë.

Si do që të veprojë Parlamenti, qëndrimet e mia nuk ndryshojnë. Pra, unë i kam bindje ato edhe nuk ndryshojnë sado që do të falënderohem apo do të kritikohem për to apo do të kërcënohem nga kushdo qoftë di që të jetoj me qëndrime të mia.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk e di a ta ka përmendur emrin. Nuk ta ka përmendur emrin, Albulenë. Unë ta jap fjalën, por e di që emrin nuk ta ka përmendur.

Kanë të drejtë në replika oj Teutë kanë të drejtë njerëzit në replika. Se as mua nuk me pëlqen e ndonjëherë as ty, kështu shkon puna. Atëherë, zonja Albulena Haxhiu ka replikë.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Disa çështje, e para në momentin kur zoti Haradinaj ka marrë drejtimin e Qeverisë në raport me dialogun ka theksuar që nuk merr vesh prej kësaj pune.

Kjo është një deklaratë skandaloze kur vjen prej një kryeministri të vendit, por që unë besoj që nuk merr vesh prej kësaj pune. Tash, domethënë arsyeja se pse ka thënë kështu është për shkak se nuk e ka guximin që ta ndalë Hashim Thaçin në mënyrë jo kushtetuese e ka marrë ose e ka kidnapuar siç u tha edhe në seancë më parë, procesin e dialogut me Serbinë. As nuk ka mandat nga Kuvendi e sa këtë mandat nuk ia njeh Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Mos e ngatërmoni përfaqësimin si përgjegjësi të presidentit me politik bërje. Kosova është Republikë parlamentare jo presidenciale. Dhe për këtë kompetencën mund ta ketë Qeveria edhe e ka, por jo presidenti i vendit.

Ta zëmë, cili ka qenë roli i Atifete Jahjagës në procesin e dialogut me Serbinë? Në atë kohë Hashim Thaçi ka qenë kryeministër dhe ai e ka përfaqësuar Kosovën në negociata me Serbinë, pse nuk e ka përfaqësuar Atifete Jahjaga? Sepse nuk e lejon Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Andaj, është e qartë, Hashim Thaçi po bënë shkelje kushtetuese, kush ta evidentojë këtë? Kush ta evidentojë? Gjykata Kushtetuese? Që i keni dërguar njerëzit tuaj aty. Që e keni dërguar një person i cili ka të kaluar kriminale. Ky person ta evidentojë që Hashim Thaçi, po, po e shkelë Kushtetutën. Dhe po zoti Haradinaj, nëse ju theksoni që shkarkojeni presidentin, a jeni në gjendje që të kërkonin nga deputetët e partisë suaj që ta votojnë mocionin për shkarkim të Hashim Thaçit? Thuaje këtë. Në qoftë se e ke guximin atëherë...

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj nuk është kryetar i Grupit Parlamentar të AAK-së, është kryeministër në këtë rast. Megjithatë, zoti Haradinaj e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I kemi disa plagë të hapura pozitive-opozitive në marrëdhënie mes partive mes liderëve, ato do të vazhdojnë. Nuk besoj që do t'i zgjidhim në ditën e sotme. Ajo që unë kam shpresuar dhe që kam pasur dëshirë të madhe, mos po mbërrin Parlamenti ta japë një provim të vetin.

Ndoshta unë si kryetar qeveri mund të jenë pengesat e mia çfarëdo që ju i vlerësoni. Mund të dështojë shumëkush, po megjithatë mund ta jepni provimin ju si Parlament. Ju siguroj që sot kur po flasim provimi është te ju. Te të zgjedhurit e popullit. Atë që është provim i kryetarit të Qeverisë ju siguroj që unë e ndjej. Mua më vjen keq që nuk po shfrytëzohet e drejta e juaj, ajo pse jeni të paraparë që të jepni ju një provim të caktuar që nesër të jetë mësim për të gjithë të tjerët. E keni këtë mundësi në Parlament, pra nuk e kam as personale as grupe as klanore as partiake ku e di unë, po i ndjej këto momente të rëndësishme për jetën e vendit tonë, për drejtimin e proceseve politike që i kemi.

Kisha pasur shumë dëshirë që Parlamenti ta japë provimin. Mund të dështojë njëri, por fatmirësisht janë disa pushtete. Pra, është Parlamenti është Qeveria, është presidenti është gjyqësori ku e di unë. Po, po e dha Parlamenti provimin ju siguroj që është me peshë të madhe. Ju siguroj që bënë ndikim të jashtëzakonshëm tek të tjerët.

Unë e di që është zor që ta gjejmë një formulë të përbashkët sepse jemi grupe të ndryshme politike, ndoshta udhëhiqemi nga liderë e nga kërkesa, por mos e harroni rëndësinë që e keni në vendimet që mund t'i merrni. Të gjithë ne të tjerët ju detyrohemi juve, ju obligohemi juve. Arsyeja pse edhe njëherë jam kthyer në seancë vërtetë nuk ishte për polemika të ndërsjella, mendojeni deputetë. Po vetëm për dëshirën që mos rastësisht po e gjeni një momentum edhe ta japë provimin një institucion i vendit. Institucioni kryesor, institucioni më i rëndësishëm që është Parlamenti.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Tash fjalën e ka LDK-ja, zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Sigurisht u tha shumëçka, por është e qartë që këta muaj është thënë e folur shumë rreth idesë për ne të rrezikshme dhe të papranueshme për të ashtuquajturin korrigjim që për ne nënkupton këmbim apo ndarje të territorit. Kjo tashmë është e qartë për të gjithë qytetarët e shtetit tonë.

Një mori veprimesh janë bërë nga Presidenti i vendit, sigurisht i pamandatur dhe pa kompetencë për të fituar përkrahjen për idenë e tij, por është mbase e qartë se tani për të gjithë është kjo e qartë se ai nuk e ka mbështetjen për këtë veprim për këtë ide. Kjo ide po zbehet dhe po venitet realisht po mbetet një tentativë dhe e tillë do të mbetet për të shkelur sovranitetin dhe integritetin e vendit.

Unë e dëgjova më vëmendje edhe kryeministrin. Ne do të dëshironim që këto deklarime që janë të partive politike opozitare, grupeve tona Parlamentare dhe deklaratimet ose thëniet së paku në mënyrë deklarative se janë kundër korrigjimit të kufirit edhe disa parti të koalicionit. Do të dëshironim që kjo të konvertohet edhe në votë ose veprim konkret. Çka do të thotë; unë e dëgjova po e them kryeministrin, i cili e tha që kemi bërë mjaft kompromise, dhe jemi dakord. Kemi bërë kompromise me Pakon e Ahtisarit po këtë fjalë mos na e thoni neve po ia thoni atij që po thotë se do të kemi kompromis të dhembshëm. Sepse ne e kemi të qartë e besoj që edhe ju e keni të qartë dhe këtë duhet ta dëgjoi ai i cili po flet për kompromise. Prandaj, për ne është s'ka nevojë që të na e thoni. Vërtetë kemi bërë kompromis dhe falë atij kompromisi sado i dhembshëm ne e kemi shtetin e Kosovës.

Po ashtu të nderuar kolegë deputetë, u miratua ose jo kjo rezolutë, ne jemi të vetëdijshëm që Kushtetuta e Kosovës është garanti kryesor i mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit të Kosovës. Po ashtu jemi shumë të vetëdijshëm që 57 deputetë shqiptarë dhe disa së paku që po e thonë edhe të koalicionit janë kundre kësaj ideje. Së këndejmi është e qartë se kjo ide nuk ka mbështetje. Po ashtu për ne është interesante dhe mendojmë edhe e papranueshme pse do duhej të kemi edhe ekip negociator. Ne kemi institucionet. Në kohën kur nuk kemi pasur institucione është dashur të bëheshin ekupe negociatore të zëvendësoheshin të ishin surrogate të institucioneve.

Ne kemi Qeverinë e Kosovës që në kohën kur ka qenë zoti Mustafa e ka udhëhequr vet dialogun qeveria. Dhe marrëveshjet e mira apo të këqija vijnë në Kuvend miratohen apo nuk miratohen, por nuk ka pasur nevojë as nuk ka që të kemi ekip negociator. Pse? A duhet që pastaj kjo përgjegjësi ose fajësi eventuale të shpërndahet apo çfarë nënkupton. Prandaj, për të gjithë ne është e qartë që Qeveria e Kosovës është kompetente i ka të gjitha autorizimet që të bëjë dialog dhe Kuvendi është ai i cili i voton apo nuk i voton marrëveshjet e mira apo nëse nuk janë të mira normalisht nuk i votojmë.

Por, është shumë e qartë që presidenti në këtë mes nuk e ka as mandatin kushtetues dhe nuk mundemi edhe nëse duam si deputetë t'i japin ne as mandat shtesë të delegojmë diçka që është e drejtë e jona, që është e drejtë e sovranit në këtë rast. E sovrani që përmes votave që ne si deputetë i përfaqësojmë ata në këtë Kuvend.

Të nderuar kolegë,

Edhe LDK-ja edhe partitë opozitare e thashë edhe disa parti ose së paku deklarativisht të koalicionit qeverisës po e thonë që me korrigjimin, jemi për ta ruajtur sovranitetin. Atëherë nuk shohim problem pse do të duhej të mos votohej ose të konvertohej ky qëndrim nga fjalët në vepër me votë për këtë rezolutë, të cilën e kemi propozuar.

Por, problemi është diku tjetër, ne pajtohemi për këto që i thashë rreth korrigjimit me shumicën, por e kemi problemin se ne nuk pajtohemi për mënyrën e dialogut, kohën e dialogut, ngutjen e dialogut, prezantimin ose përfaqësimin në këtë dialog dhe, normalisht që këtu ndahemi dhe ne nuk mund të pranojmë që të futen këto si pjesë, sepse kjo është një tentim për të bërë një lloj tregtie në kuptimin e futjes të asaj që ne nuk pajtohemi.

Do të thotë, ne po pajtohemi: jemi kundër korrigjimit të kufijve, e votojmë rezolutën, ju po e thoni i keni votat për të bërë ekip negociator dhe për të mbijetuar qeverisja aktuale, krejt në rregull, i keni, votojeni edhe ekipin e delegacionit ose ekipin negociator, zhvilloni bisedimet, por pa ne, pa mbështetjen tonë. Ky është qëndrim, të cilin ne as nuk duam, as nuk do të marrim hap që kjo të ndodhë dhe të përkrahet një kërkesë e tillë, kjo është më se e qartë. Ne mund të diskutojmë sa të duam, po ky është një qëndrim për ne i qartë.

Më lejoni në fund të them edhe diçka. Në kohën kur është miratuar Asociacioni, nuk dua ta luaj rolin e avokatit të askujt, por po e them me përgjegjësi të plotë, askush nuk e ka dashur Asociacionin, po ka qenë pjesë e kompromisit, për të cilin po flasim, të bërit shtet dhe marrëveshja e vitit 2013, për të sqaruar opinionin, e ka themeluar këtë Asociacion, sepse ka shumë spekulime, shumë të pavërteta dhe më 2013 deputetët me 2/3 e kanë votuar, mirë apo keq, e kanë votuar.

Çka ka ndodhur ndërkohë? Në vitin 2015, kur zoti Mustafa ka qenë kryeministër, zëvendëskryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme ka qenë zoti Hashim Thaçi dhe të mos harrojmë, të nderuar kolegë, ajo që ka ndodhur në këtë marrëveshje tash, besa e ka bërë një korrigjim, është futur pikë e veçantë që fjalën e fundit për Asociacionin do ta ketë Gjykata Kushtetuese që është korrektues i marrëveshjes me gabime eventuale dhe kjo ka ndodhur, fatbardhësisht, prandaj marrëveshja e dytë është fat që e ka futur këtë pikë, sepse sot flasim për statut, hartim të statutit, për të cilin fare nuk dimë çka po ndodh. Atëherë edhe nëse ka pasur lëshime, e që gjykata i ka përmirësuar, ju lutem, mos gaboni, mos bëni lëshime ju në hartim të statutit, mos jepni kompetenca ekzekutive, nëse paska qenë ky rrezik, sepse është në mandatin

tuaj të mos e bëni këtë. Unë e besoj që vërejtjet e Gjykatës Kushtetuese dhe ajo që është futur në marrëveshjen e vitit 2015 e ka pamundësuar një pushtet të tretë.

Dhe, po e përmbyll me këtë që u tha më herët nga kryeministri, sigurisht ne si Kuvend do ta bëjmë punën tonë, edhe po e bëjmë punën tonë, çfarëdo marrëveshje që vjen që ka të bëjë me fazën finale, siç po thuhet, edhe pse s'e kuptoj këtë që thuhet fazë finale, ne nëse është në dëm të vendit, nuk do ta votojmë, kjo është më se e qartë dhe për këtë nuk ka nevojë asnjë seancë të mbahet, vetëm le të vijë marrëveshja, le të bëjnë dialog ata që janë kompetentë, të negociojnë ata që janë kompetentë, po të mos shkojnë ata të cilët nuk e kanë këtë mandat, sepse këtë mandat as nuk ua jep Kushtetuta dhe as nuk ua jep Kuvendi i Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Beqiri! Fjalën e ka zonja Blerta Deliu.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, nënkryetar Haliti!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

U thanë shumë gjëra dhe ndoshta nuk do të përsëritëm, sepse jemi pothuajse në fund të debatit, edhe 12 diskutues qenkan.

Është e vërtetë që qytetarët e këtij vendi dhe partnerët, miqtë tanë, kanë pasur pritje të tjera nga seanca e thirrur sot nga opozita, por shumicën me të cilët kemi pasur rast të kontaktojmë është parë si mundësi që klasa politike të arrijë një unitet të munguar tash e sa kohë.

Më shumë se sa bashkim në idenë e qëndrimeve rreth dialogut, kjo seancë edhe një herë shpërfaqti ndarjen që ekziston ndërmjet subjekteve politike në raport me dialogun, e veçanërisht qasjen jokonstruktive të subjekteve politike opozitare.

Është thënë që në fillim qëndrimi i Partisë Demokratike të Kosovës, edhe nga kryetari i Partisë, Veseli, edhe nga zoti Krasniqi, të cilët sot u munduan që në seancë të përçojnë një mesazh të unitetit dhe dëshmuar se Partia Demokratike e Kosovës nuk do me çdo kusht që të marrë primatin, sidomos kur bëhet fjalë për çështje të rëndësishme dhe çështje me interes nacional.

Partia Demokratike e Kosovës është ndër subjektet e para, e cila u mundua t'i kontribuojë unitetit, e dorëzoi propozimin apo platformën për dialog partive politike, e cila ishte shumë konkrete, madje kishte edhe vijat e saj të kuqe për dialogun.

Ka pasur thirrje të vazhdueshme që partitë opozitare të marrin përgjegjësi, por opozita ka gjetur qasjen e saj më të lehtë, pa asnjë alternativë konkrete që është ikja e saj nga përgjegjësia.

Edhe thirrja e kësaj seance sot nuk po duket aspak që është thirrje e sinqertë, por nga diskutimet e mëhershme të kolegëve deputetë të partive opozitare u pa qartë që fokusi i tyre i vetëm sot është ‘gjuetia e shtrigave’ ndaj një figure legjitime të zgjedhur me votën e deputetëve të këtij Parlamenti, që është Presidenti i Republikës së Kosovës.

Sot edhe një herë u bë e qartë që opozita nuk është absolutisht e interesuar që të shtyjë përpara interesin madhor të Kosovës dhe kjo nuk ka se si të shpjegohet ndryshe teksa edhe sot u pa që me dezinformata e manipulojnë qytetarin, duke bërë thirrje se territori i Kosovës qenka në rrezik, njëjtë pothuajse sikurse që u provua të manipulohet edhe marrëveshja e demarkimit të kufirit me Malin e Zi, e cila u votua nga ky Kuvend.

Është skajshmërisht e pandershme që për shkak të përfitimit politik të ndërtohet diskursi për ndarje të Kosovës dhe mbi bazën e kësaj propagande të ngritur nga vetë opozita, të përhapet huti e panik te qytetarët e Republikës së Kosovës.

E aq më tepër të thërrasë seancë për të diskutuar për ndarje e shkëmbim të territoreve, duke tentuar që ta legjitimojë këtë temë, e cila ka qenë synim i përhershëm i Serbisë.

Janë një pjesë e tyre që me gjuhë të njëjtë na akuzuan dikur që po shesim tokë, na akuzuan se po e falim territorin e Republikës së Kosovës, në kohën kur ne e votuam demarkacionin e kufirit me Malin e Zi.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky Kuvend do të duhej të diskutojë për platformën e përbashkët të dialogut, të diskutojë për ekipin e unitetit dhe të diskutojë për pika të cilat mund të na bashkojnë si klasë politike pozitive - opozitive.

Partitë opozitare sot duhet ta thonë hapur nëse janë pro apo kundër dialogut. Nëse duan të kontribuojnë bashkë pozitive e opozitive për njohje të Kosovës nga shteti serb, nëse duan që bashkërisht të punojnë për ulësen e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe nëse janë të interesuara që bashkërisht të punojnë për procesin e integritetit evropian.

Partia Demokratike e Kosovës e ka thënë qartë që nuk negocion për shtetësi, për sovranitet e integritet territorial. Këtë qëndrim e ka shprehur qysh në dokumentin e saj bazë për dialog, të hartuar nga kryetari Veseli.

Është kërkuar që të plotësohet ky dokument së bashku në shumë takime që janë mbajtur dhe ka pasur synim të qartë arritjen e një konsensusi ndërmjet partive politike, madje nuk ka pasur asnjë rezultat dhe asnjë kthim të përgjigjeve ose sqarimeve nga partitë në opozitë.

E kemi thënë qartë edhe qëndrimin tonë për Asociacionin e Komunave me shumicë serbe dhe fuqimisht jemi deklaruar kundër një Asociacioni me kompetenca ekzekutive.

Sot me kërkesën e opozitës prapë Partia Demokratike e Kosovës dhe deputetët e partisë Demokratike të Kosovës kanë ardhur në këtë seancë me idenë që do të arrijmë të dalim nga ky pozicion si shtet, duke qenë të bindur se lojërat e pandershme politike nuk mund të bëhen në kurriz të shtetit të Kosovës.

Në kohën kur Serbia në çdo mënyrë po mundohet të përfitojë, duke dëshmuar gjoja pragmatizëm në raport me qasjen e saj ndaj Kosovës dhe ndaj dialogut, ne po humbim kohë me tema të paqena duke e akuzuar njëri-tjetrin.

Nëse kjo seancë sot është thirrur për bashkëpunim, është përgjegjësi jona, e të gjitha partive politike që të punojmë për të ardhmen e këtij vendi dhe të jemi bashkë për të përmbyllur këtë konflikt shumë të gjatë me Serbinë.

Duke përfshirë këtu edhe kërkesën tonë si Parti Demokratike e Kosovës që Kuvendi është ai që do ta ketë rolin e tij mbikëqyrës dhe vendimmarrës, qëndrim dhe argument që u tha disa herë nga deputetët të Partisë Demokratike të Kosovës.

E kur bëhet fjalë për një marrëveshje ndërkombëtare të obligueshme, si për Kosovën, ashtu për Serbinë, si mund të bëhet një marrëveshje pa u ratifikuar me votat e 2/3 të deputetëve në këtë Kuvend.

Dhe, krejt në fund, nëse kjo thirrje e seancës së sotme është bërë me seriozitet për t'iu qasur kësaj teme dhe për të na bërë bashkë në disa pika, atëherë partitë duhet të dakordohen të paktën për diçka, nëse ndodh e kundërta, atëherë unë i pyes parashtuesit e kësaj kërkesë për seancë të jashtëzakonshme se cili ka qenë qëllimi që ne sot të diskutojmë bashkë: ta thellojmë edhe më shumë ndarjen apo të jemi bashkë mes argumenteve, të cilat mund të na bashkojnë rreth qasjes së Kosovës në dialog.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Lajçi e ka fjalën.

ALI LAJÇI: Të nderuar qytetarë të Republikës,

U fol këtu për rolin e Kuvendit që është i qartë dhe i ditur, po si ne e shfrytëzojmë dhe cili është mjeti për vendime, është një çështje krejt tjetër.

Në këtë Kuvend u tha edhe më parë nga një prej debatuesve këtu se ka humbur vlerën dhe s'ka legjitimitet, e tjetër, si individ edhe mund të japë dorëheqje.

Unë flas në nivel të Kuvendit si institucion i Republikës, pra numër një, vendimet e tij.

Ndoshta mund të themi për shkak të vendimeve se ky Kuvend ka degraduar në rastin kur e ka votuar demarkacionin me Malin e Zi dhe e kemi rrudhur territorin e Republikës sonë me një pjesë të tij me Malin e Zi me votën e 80 deputetëve të Kuvendit të Republikës, vota edhe duar të liga, pa dilemë dhe duhet të mbesin si të tilla në historikun, sepse vendimet shpesh janë shumë të rëndësishme në koherencë, janë shumë të rëndësishme për një proces, janë shumë të rëndësishme në vija politike, kombëtare, e tjera.

Për sa u përket votave që ato mund të jenë legjitime a jo, dihet me numra dhe ka rregullore. Ok-ej! Po në histori dhe në zhvillime të përgjithshme, ju e dini. Ne e kemi pasur edhe një Kuvend në Prizren në korrik të '45-ës, ka pasur vendim aty edhe të deputetëve të asaj kohe dhe janë quajtur legjitim, por ka qenë një vendim ahistorik, i dëmshëm, inkriminues që ne e kemi përjetuar të gjithë.

Mos harroni, ka pasur edhe një vendim të vitit '89-në për suspendimin e autonomisë, i cili po ashtu me disa nga votat e tyre ka marrë legjitimitet, por është ahistorik, mos harroni, sikurse janë edhe këto, tash ku jemi.

Tash jemi në një vijëzim tjetër, në një anë tjetër, me një Republikë tjetër armiqësore, të ditur edhe sot që në mënyrë formale dhe informale vepron edhe sot kur ne e thërrasim për marrëveshje, kur ne jemi të gatshëm t'i stabilizojmë rrathët tona, dhe pse jo me një shtet fqinj, por si? Në mënyrë servile, në mënyrë jolegjitime dhe në mënyrë të ulët, mund të themi, dhe si?

Në këtë moment kur jemi këtu shpesh po përmendet me të drejtë çështja e konsensusit, si jo, jemi në parim. Cili konsensus? Konsensus, i cili faktikisht do të duhej të matej mirë dhe të jetë një kornizë politike kombëtare e koherencës, pra që të kemi sukses.

Por ne nuk mund të bëjmë konsensus me ato rrugëzime, me ato qasje dhe me ato veprime praktike politike, të cilat kanë dhënë vendime të liga për sovranitetin e Republikës dhe tash thirret një konsensus që ne të hyjmë brenda tyre dhe t'i kryejnë ato vendime të liga nëpërmjet neve. E jo. Por ne do të jemi në një konsensus kur do të jetë në nivel dhe në interes të Republikës së Kosovës, të qytetarëve të saj.

Mos harroni, ne nuk shpikëm tema këtu për ndërrime terriroresh, ne nuk bëjmë këtu tema që lindin diku nga ne, se e propozoi dikush nga deputetët apo partitë politike korrigjimin e kufijve.

Korrigjimi i kufijve do të thotë lëvizje e kufijve. A do të jenë pozitiv në atë anë apo në këtë anë, është prekje e identitetit juridik dhe politik të Republikës së Kosovës, tash të sanksionuar me një Kushtetutë, të cilën e dini shumë mirë.

Këto rezoluta që po nxiten e kanë karakterin e vet dhe synim të mirë, dakord, por cili është funksionimi i rezolutave, kemi një vister të tillë të deritashëm. Nuk ka. Më shumë janë të nivelit deklarativ dhe politik dhe ne, në qoftë se këto institucione tona nuk janë në gjendje ta respektojnë Kushtetutën e vendit, e cila në pikën një të saj e garanton unitetin dhe është i pandashëm territori i Republikës, atëherë a mund ta ndalim me një rezolutë, shtrohet puna? Sigurisht edhe kjo e relakson atë, por në qoftë se këto institucione dhe këta njerëz që i përfaqësojnë institucionet tona nuk e respektojnë aktin më të lartë juridik, e që është shumë evidente, atëherë edhe jemi shumë skeptikë me këtë rezolutë, e cila ka një qëllim të mirë, jemi dakord, dhe duhet ta votojmë me të vetmen pikë të rendit të saj, rezolutë e cila është atje, pa asnjë, eventualisht në qoftë se do t'i shtonim diçka dhe që do të jetë sigurisht në kuadër të një ndërrimi të një kornize politike tjetër fare të dialogut me Serbinë, e që unë besoj duhet të jetë ajo, sepse i ka dalë boja këtij kapitulli të këtij dialogut dhe se nuk na ka sjellë diçka.

Të gjitha marrëveshjet me Serbinë, ju e dini se nuk janë respektuar, jo për vullnetin tonë, po të asaj dhe ka shumë pak plusa në ato marrëveshje. A thua do të jetë shumë korrekte në marrëveshjet e reja që do t'i kemi me Serbinë tash? Sigurisht jo.

Dhe, do të duhej të marrim një qëndrim politik: nuk ka dialog me Serbinë pa njohjen e statusit politik dhe juridik të mëvetësisë së Kosovës, sepse atëherë ne bisedojmë për pozita dhe dialogë politik, po kurrsesi teknik, gjë që ka ndodhur, ne kemi bërë pra dialog politik, e kurrsesi nuk kemi bërë dialog teknik. Prandaj, edhe jemi në këto opsione të ndryshme.

Çka mund të themi ndryshe? A mund të dimë se vërtet respekti ynë për relacionet ndërkombëtare dhe shtetet të cilat na kanë ndihmuar dhe kanë dhënë mjaft vepra kapitale në pavarësinë e Kosovës t'i çmojmë, sigurisht po. Por a mund të krijojmë një vetëdije të sovranitetit dhe një vetëdije sovrane kur neve na vijnë vendimet këtu dhe t'i votojmë me mendësi juridike sovrane ato vendime, ende nuk e kemi, kjo është parë.

Dhe, a duhet tash të jemi skeptikë kur do të na vijnë dhe kanë nisur të na vijnë në prapaskenë edhe projekte, me të cilat do ta rrudhim edhe më tej Republikën e Kosovës në territor. Sigurisht ka nisur kjo dhe të gjithë ata, të cilët unë ku jam skeptik që kanë votua për rrudhjen e territorit me një anë tjetër dhe s'ka ndodhur as korrigjim, madje Mali i Zi po punon atje dhe Komisioni Shtetëror nuk ka qasje dhe nuk thirret në ato vijëzime që është duke i bërë dhe nuk jep asnjë përgjigje dhe në këtë rast jam shumë skeptik se edhe pjesa kah Serbia do të jetë në disfavor dhe ka nisur dhe duhet të jemi mjaft me brenga dhe ta ndalim. Si ta ndalim këtë, kur nuk e respekton kryetari i shtetit Kushtetutën, kur nuk e respektojnë shumë institucione, e cila është ndalesa, jo rezoluta, unë mendoj, se s'do ta marrë vesh hiç, por 1/3 e deputetëve me nënshkrime, duke e krijuar një lëndë juridike faktike që gjykata do të thotë se ka bërë shkelje presidenti, atëherë është i obliguar që ai të japë dorëheqje ose të votohet me 2/3 si rekomandim bile.

Në këtë rast, fakti që ka nisur procesi i luajtjes së kufijve, në favor apo jo, është antikushtetues, ju lutem 1/3 e deputetëve t'i bëjmë nënshkrimet dhe ta dërgojmë lëndën në Gjykatën Kushtetuese, unë besoj se është edhe obligim yni.

Kurse sa u përket politikave me Serbinë, do të duhej të kemi një kornizë tjetër, do të duhej të kemi një qasje krejt politike ndryshe, qoftë në ekonomi, në politikë, në sistem juridik dhe të sigurisë.

Po të kishit dashur ju që të merret Presheva dhe Bujanoci atje, do të duhej që Serbia të mos lejonte të futej në Kuvend të Kosovës, do të duhej të ndaheshin së paku nga 5 milionë atje, kthimi i njerëzve, që është obligim edhe humanitar. Do të duhej të ruheshin banesat të mos shiteshin atje dhe krejt ky 10 vjetësh ka kontribuar që ne të kërkojmë opsione të tjera politike, juridike, për çka janë të dëmshëm. Ju lutem, dikush ka përgjegjësi këtu për krejt këtë periudhë të menaxhimit, i cili na ka sjellë në atë gjendje ku ne lypim formula jashtë sistemit kushtetues.

Në këtë rast unë mendoj konkretisht që ky lloj dialogu duhet të ndalet deri në njohjen e pavarësisë nga Serbia, sepse ndryshe bëjnë biseda e dialog në ajër, dhe në qoftë se ai do të na njohë, pastaj do të kemi një dialog konkret, dialog që do të jetë sigurisht reciprok dhe do ta funksionalizonte shtetin dhe Republikën e Kosovës.

Në këtë mes, pa status politik nuk kemi bërë asgjë, kemi përsëritur trend negative, kemi sjellë gjendje të dyshimta, kemi sjellë debate që ky debat të bëhet sot këtu, është mjerim, sepse as nuk duhej të ishte ky këtu, por nuk e shpikëm ne.

Asociacioni që ju po e trajtoni shpesh, si një Asociacion i tillë me nivel të tretë të përgjegjësisë apo jo, jo. Vetëm pse quhet Asociacion i komunave serbe me shumicë, ju lutem, pa hyrë në strukturën e saj është antikushtetues, merrni vesh ju disa palë këtu që e keni votuar më 2013 dhe keni dashur ta votoni ose t'i jepni vijë edhe në 2015-ën, derivat i '15-ës është ai.

Shikoni tash, a kemi në normë kushtetuese apo në sistemin juridik te ne, që kemi edhe komuna me shumicë shqiptare, shikoni ju që e njihni Kushtetutën dhe flitni për të.

Në qoftë se e gjeni si normë kushtetuese se kemi komuna me shumicë shqiptare, ia pafshi hairin edhe këtij emërtimi. Jo, nuk e kemi.

Prandaj, nisma e decentralizimit në baza etnike, ju e dini kush e ka aprovuar, s'po dua t'ju linçoj, por i dini subjektet, ata e kanë pruar deri te Asociacioni apo ndarja në mënyrë serike e juridike Mitrovicën dhe tash ata njerëz tash lypin opsione të reja për ta fshirë atë, t'i ikin përgjegjësisë se një ndarje juridike, por tash po e lypin një ndarje direkte dhe ta fshijnë atje. Ju lutem, as ajo, as ajo nuk janë të pranishëm.

Dhe, këtë gjendje dikush duhet ta marrë përgjegjësinë, sigurisht jo ne, sigurisht jo ata që s'e kanë përfillur këtë kapitull, sigurisht ata që kanë qenë përgjegjës institucionalë, sigurisht opozita është ajo që duhet të korrigjojë, madje t'i kundërshtojë dhe jemi në rolin tonë. Por merrni përgjegjësitë, sepse shpesh po i përmendni dhe mos lejoni që Kosova të vendnumërojë, të vihet në pikëpyetje si status juridik, të jetë në këtë gjendje, përndryshe, janë të deshifruara çështjet e kompetencave, edhe të përgjegjësiave.

Dhe në këtë mes, edhe më tej mund të flasin, po a thua ne u krijuam...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Në momentin që është thirrur një seancë e jashtëzakonshme, vërtet e kemi konsideruar që është e jashtëzakonshme, sepse është një çështje që duhet trajtuar si të jashtëzakonshme.

Dhe qëllimi që partitë në pozitë kanë vendosur të marrin pjesë në këtë seancë ka qenë pikërisht kjo çështje, duke menduar se partitë opozitare do të reflektojnë, në mënyrë që në fund ta kemi një rezolutë të përbashkët, të hartuar nga të gjithë përfaqësuesit e partive politike që janë në Parlamentin e Kosovës.

Nëse vërtet ka qenë një urgjencë e tillë e thirrur, është dashur të mos kemi debat kaq të gjatë, po përfaqësuesit e partive politike, apo të flasin vetëm shifat e grupeve parlamentare, të formohet një komision me përfaqësues të gjitha subjekteve politike dhe në fund të kishim përfunduar këtë debat me një rezolutë të përbashkët.

Mirëpo, nga ajo që u diskutua deri më tash, ne po shohim se një përqindje e vogël ka diskutuar për temën për të cilën jemi thirrur dhe më shumë u diskutua për tema të tjera, qoftë duke bërë promovime politike apo edhe nga debatet që i dëgjuam menduam që dikush dha edhe një farë kushtrimi se Kosova gjendet në një situatë ose në një krizë, sa veç të fillojë lufta, po shqyr që nuk jemi në atë gjendje dhe po vazhdojmë debatin, se nuk paska rrezik.

Qeveria nuk ka qëndruar dhe qëndrimet e Grupit Parlamentar të Aleancës janë të njohura: ne nuk jemi për shkëmbim, as për të dhënë territor, po as të shkëmbejmë e as të korrigjojmë territor. Këtë e tha thënë kryeministri i Kosovës, e kanë thënë të gjithë deputetët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe qëndrojmë prapa këtyre qëndrimeve dhe vendimeve.

Qeveria ka sjellë më herët një rezolutë, ka qenë një rezolutë, ka sjellë platforma, kemi plot rezoluta, të cilat, në fakt, kërkohet që Kuvendi të marrë rol në procesin e bisedimeve, ashtu siç kemi kërkuar dhe t'i japim vija të kuqe dialogimit. Mirëpo, po shohim se në këto çështje nuk ka seriozitet.

Kur është mbajtur një komision i përbashkët që është Kosovë - Bashkim Evropian, që është Komisioni për Stabilizim-Asociim, vërtet aty me dakordim të të gjithë pjesëtarëve që janë përfaqësues të grupeve parlamentare është votuar, në rezolutën që është votuar ka qenë një pikë, ku thuhet që Kosova nuk lejon të ndryshohen kufijtë dhe ajo rezolutë ose ajo pikë është dashur të votohet nga shumica e përfaqësuesve të Parlamentit Evropian, po edhe e deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe, në fakt, ne e kemi një rezolutë të tillë, me një pikë të tillë.

Mirëpo sot po kërkohet një konsensus. Po nga debatet që u pa, ne po shohim se askush nuk është i interesuar të arrihet një konsensus dhe nuk janë të interesuar të hartohet një rezolutë, sepse kemi shumë rezoluta.

Nuk mund të arrish konsensus nëse secili thotë: “Ose le të votohet kështu qysh dëshiroj unë, ose nuk do të votoj”.

Konsensusi arrihet nëse me dakordancën e të gjitha grupeve parlamentare votohet.

Atëherë unë nuk e di nëse nuk e kemi një dakordancë, ne po diskutojmë, po në fund, pas një debati të gjatë e përfundojmë këtë seancë pa një produkt, pa një rezultat, shkojmë në shtëpi dhe cili është rezultati dhe suksesi i gjithë këtij debati, është barazi me zero.

Andaj, edhe një herë, meqenëse janë përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare të ulen dhe të hartojnë një rezolutë të përbashkët, ashtu qysh e kanë propozuar edhe pozita, po edhe opozita, ta gjejmë një konsensus të përbashkët, të votohet, në këtë formë gjithë ky mund, gjithë ky angazhim i deputetëve të mos shkojë barazi me zero, sepse tërë ditën janë lodhur edhe deputetët me këto debate të kota, por i kemi lodhur edhe qytetarët e Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Vërtet sot të gjithë kemi pritur një debat më racional, më kualitativ, më përmbajtjesor dhe vërtet fjala konsensus në këtë Kuvendi ta ketë atë kuptimin e plotë që do të duhej ta kishte, në veçanti për ne si të zgjedhur të popullit.

Po diskutojmë sot për një çështje, në një seancë të jashtëzakonshme, që në fakt nuk do të duhej të diskutonim në seancë të jashtëzakonshme, por do të duhej të diskutonim me koka të ftohta, me urtësi, me vizion që thjesht ky Kuvend si institucioni më i lartë nga i cili dalin të gjitha në institucionet e tjera shtetërore me votë nga po ky Kuvend do të duhej të kishte një rrjedhë komplet tjetër, edhe shtetërore, edhe institucionale, konsensuale, por edhe me interes nacional. Në këtë temë që po e debatojmë sot, dhe si shqetësim i opozitës, thjesht e ka shkaktuar dikush tjetër me deklarata nga pozita numër një e shtetit të Kosovës dhe po vërej nganjëherë kolegë nga pozita që po tentojnë të shesin mjegull. Do të thotë, kjo thirrje e kësaj seance e ka një shkaktar dhe e ka një pasojë pse ne e kemi thirrur këtë seancë. Prandaj, janë tri shtylla kryesore: pakoja e Ahtisarit, Deklarata e Pavarësisë së Republikës së Kosovës që buron nga ajo pako dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Me këto tri shtylla, nga të cilat ka lindur shteti i pavarur i Kosovës, nuk guxon të luajë dhe të manipulojë askush.

Prandaj, duhet ta bëjnë të qartë që çdo tentim për cenimin e sovranitetit, integritetit të vendit dhe rendit kushtetues dhe juridik të Republikës së Kosovës do të jetë i pasuksesshëm, sepse është vullnet i popullit të Kosovës, është vullnet edhe i përfaqësuesve të popullit, të mos harrojmë opozita në këtë Kuvend i përbën 58% të mazhorancës. Është e vërtetë që kemi problem me Serbinë, është e vërtetë që edhe ky dialog nuk do të përfundojë deri në fund të vitit apo në fillim të vitit të ardhshëm dhe është më se e qartë dhe duhet ta bëjnë të qartë të gjithë, nuk do të pranojmë një marrëveshje që nuk është në interes të popullit, në radhë të parë, dhe shtetit të Kosovës. Të gjitha këto, me kërkesë të Serbisë janë sublimuar dhe u ka rënë në ujë kërkesa me vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Ai opinion i ka dhënë fuqi dhe dimension tjetër shtetit të Kosovës dhe në këto premisa jemi njohur nga 116 shtete. Prandaj, në prag të kremtimit të 11-vjetorit të shtetit të Kosovës, kush guxon të luajë me këto shtylla që e mbajnë gjallë këtë shtet.

A ka koordinim së pari mes spektrit politik në pushtet? Jo! Nuk kam dëgjuar viteve të fundit, edhe kur kemi pasur ndarje serioze politike dhe ideologjike, çakordim më të madh mes Presidentit të vendit, kryeparlamentarit dhe kryeministrit e partnerëve të koalicionit.

Të nderuar, uluni së pari merruni vesh mes vete, artikulojeni një qëndrim politik institucional, pastaj në bazë të atij artikulimi të mirëfilltë që ngërthen në vete frymën e deklaratës së pavarësisë dhe parimeve kushtetuese, të ulemi dhe të shohim çka mund të bëjmë tutje. Frikësohem që edhe kjo seancë nuk po e përçon atë mesazhin e singertë të qytetari i vendit që vërtet jemi të interesuar ta gjejmë një konsensus. Tani po tentohet që edhe të fajësohet opozita edhe për mosanëtarësim të mundshëm të Kosovës në një mekanizëm ndërkombëtar të rëndësishëm apo edhe për liberalizim të vizave. Ju lutem, merreni si mesazh të qartë të Bashkimit Evropian: derisa në Kosovë udhëheqin elita të tilla politike, do t'ju mbajnë të izoluar. Këtë mesazh e keni shembull rastin e Kroacisë, ku për vite të tëra, mbi 4 vjet e kanë përmbysur me sukses, i kanë plotësuar kriteret e kapitullit 35, por nuk i kanë pranuar në Bashkimin Evropian.

Prandaj, çka kërkohet se dikush nga kolegët e pozitës më herët tha cila është alternativa. Alternativa është te ndërrimi apo ristartimi i softuerit politik, në mënyrë që hardueri të funksionojë ashtu siç duhet, për arsye se me këtë logjikë qeverisëse, me këtë koncept qeverisës nuk po na akceptojnë as Shtetet e Bashkuara të Amerikës, as Bashkimi Evropian dhe frikësohem që me këtë qasje dhe këtë logjikë ky vend do ta marrë teposhtën dhe më të madhe se sa, në fakt, e ka marrë pas këtij koalicioni. Prandaj, apeli im është që në radhë të parë krerët shtetërorë institucionalë të bien dakord, pastaj ejani dhe të ulemi të bisedojmë çka tutje dhe të mos harrojmë, edhe ju nuk e keni shumicën dhe e dimë të gjithë, por nuk e ka as opozita. Prandaj, duhet t'i respektoni parimet dhe votat e opozitës, sepse tek e fundit, kjo është marrëveshje politike, por në interes të shtetit. Mos luani dhe mos spekuloni se opozita është kundër këtij apo atij procesi, opozita është duke e mbajtur gjallë jetën politike dhe ne i kemi dhënë jetë, ristart këtij Parlamenti, sepse e pati marrë rrugën pa krye. Uroj që kokat e ftohta, që njerëzit e vullnetit të mirë të ulen dhe ta gjejnë një konsensus, i cili do ta zhblokonte dhe ashtu jetën e bllokuar politike dhe institucionale, në radhë të parë në këtë Parlament, pastaj në segmentet e tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje kolegë dhe kolege,

Është mirë që më në fund u mblodhëm për të biseduar për konsensusin dhe rezolutën për dialogun përmbyllës me Serbinë. Rezoluta e ofruar nga Lidhja Demokratike e Kosovës më jep një rast që të bisedojmë së bashku dhe pas gjithë këtij debati që u fol këtu në Kuvend të nxjerrim një konkluzion më të veçantë plotësues të kësaj rezolute.

Përgjegjësia dhe mungesa e dialogut të brendshëm në ndërtimin e konsensusit për marrjen e përgjegjësi është jona, është e të gjithë deputetëve, është obligim edhe në bazë të betimit gjatë marrjes së detyrës së deputetit, pa dallim politik, partiak, nacional dhe pa dallime të tjera. Ne jemi përgjegjës për rolin e institucionit të sovranit që është Kuvendi si të zgjedhurit e popullit të Republikës së Kosovës, sepse Kosova, siç u tha, është Republikë parlamentare. Nervozizmi dhe dyshimet reflektojnë sigurisht edhe nga zbatimi ose moszbatimi i shumë marrëveshjeve të nënshkruara në Bruksel në emër të realizimit ose relaksimit të jetës së qytetarëve të Kosovës apo përmirësimit të kushteve të jetës që duhet të ndodhnin, por përkundrazi, nuk ndodhi ashtu. Serbia vazhdoi ta pengojë Kosovën në promovimin e saj si shtet i ri, sovran dhe i pavarur. Ajo propagandoi te shtetet, të cilat e pranuan Kosovën që t'i tërheqin njohjes e saj. Bëri propagandë të egër për pranimin e institucioneve ndërkombëtare, siç ishte UNESCO, Interpoli dhe të tjera. U përmend këtu edhe shembulli që pengon vazhdimisht edhe në marrjen pjesë në manifestime apo takime të ndryshme të rëndësishme ndërkombëtare ose regjionale, rasti i delegacionit të romëve të Kosovës për të marrë pjesë në Beograd. Unë do të përmendja pengesat që ata u munduan t'i bëjnë gjatë anëtarësimit të Kosovës në Asamblerë Nacionale të Frankofonisë në Kanada, në

korrik, por që nuk patën sukses, ishin shumë ekip i fortë dhe në numër i madh, por thashë nuk patën sukses.

Mospasja e një bashkëpunimi ndërparlamentar të një dialogu të brendshëm në këtë kohë historike për Kosovën, në këtë Kuvend ndihet si një përgjegjësi jona, një dështim yni të gjithëve pa përjashtim, i politikëbërjes sonë të brendshme dhe të jashtme, është një pasqyrë e keqe për ne dhe humbje e kredibilitetit në momentin më të rëndësishëm të shtegtitimit dhe integritetit tonë drejt Bashkimit Evropian, por edhe asociimit në relacionet e ndryshme të bashkësisë ndërkombëtare. Është gjithashtu edhe në relacionin tonë ndaj miqve, siç janë Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe shtetet mike, të cilat edhe na pranuan si shtet i pavarur. Realisht të gjithë mendojmë njësoj, ruajtja e kushtetutshmërisë, sovranitetit, integritetit territorial, por jo të gjithë përdorin të njëjtën rrugë. Edhe ne, si gjeneratat e tjera në historinë tonë, po përdorim gjërat që nuk duhet t'i kishim bërë, e që janë mosmarrëveshjet, edhe pse e dimë çka ndodhi kur nuk u morëm vesh. Siç janë, për shembull, këtu elementet e mosmarrëveshjeve, bajraktarizmi, mungesa e tolerancës, egoja personale, egoja partiake, jo unë po ti i pari ose i dyti, pastaj mungesa e traditës institucionale, siç është trashëgimia e shtetësisë ose përvoja e shtetësisë dhe respektimi i institucioneve, mungesa e të kuptuarit të demokracisë dhe të kuptuarit sa afër janë demokracia me anarkinë, gjë që e kemi provuar edhe në këtë Parlament deri dje, pastaj respektimi i secilit, edhe mendimeve të kundërta dhe duke qenë të gjitha këto ne po e ulim nivelin e debateve tona, s'ka komunikim të duhur parlamentar, por ka bojkot në vendime, në nxjerrjen e ligjeve, në vend të marrëveshjeve, ka fjalë, shumë fjalë, ka fyerje dhe është për të ardhur keq që po emitojnë parlamentet dhe atë në të keqe dhe jo në të mirën e tyre.

Sa me sakrificë e fituam lirinë, e bëmë këtë Parlament, pse dhe me çfarë të drejte guxojmë ta keqpërdorim pozitën tonë dhe t'i japim një ngjyrë të keqe këtij Parlamenti, institucionit më të lartë. Ka shembuj edhe për të mirë, por ne nuk po vazhdojmë nga ato. Erdhën disa rezoluta, por për asnjërën nuk u morëm vesh. Nga secila parti pati rezolutë në vete, por të gjitha kishin një të përbashkët: të merremi vesh dhe të bëjmë me dije presidentin dhe jo vetëm atë, thua se ai nuk e di, se kufijtë e Kosovës janë të paprekshëm, se ne bëmë kompromisin maksimal në marrëveshjen e Ahtisarit dhe s'kemi gjë tjetër që t'i falim Serbisë, se Kosova nuk lejon të preket dhe t'i negociohet sovraniteti i saj, se s'ka Asociacion me kompetencat ekzekutive të komunave serbe. Unë mendoj se me krijimin e komunave me shumicë serbe ose njënacionale në kuptim tjetër, ne bëjmë një politikë të gabuar, kjo nuk është politikë e bashkëjetesës dhe nuk është kompaktibile me politikat nacionale që përdoren në Shtetet e Bashkimit Evropian. Këto komuna, me shumicë serbe që 19 vjet nuk reflektuan dhe respektuan ligjet tona, simbolet e Republikës së Kosovës, këtu ka shumëçka për t'u biseduar dhe për të diskutuar edhe me to bashkë. Ne dështuam sa i përket tolerancës dhe të drejtave të tyre, sepse ato e keqkuptuan rolin e vet, bashkëjetesën dhe këtë tolerancë. Ato hynë në përdorim të shtetit të Serbisë dhe kundër bashkëjetesës në Kosovë.

Të nderuar kolegë, ne duhet t'i shfrytëzojmë kapacitetet tona, t'i shfrytëzojmë ato në bashkëpunim me të gjithë bashkë, domethënë edhe pozita, relacionin pozitë-opozitë dhe këtu natyrisht e pranoj para jush se rolin kryesor e ka pozita, e cila duhet të jetë më tolerante dhe të përdorë gjuhën e duhur edhe ndaj opozitës, që të jemi afër dhe bashkë. Një shembull të tillë e dëgjova sot nga pozita, kur ata propozojnë që në grupin negociues, të përbërë prej përfaqësuesve të Parlamentit ose që i propozon Parlamenti, udhëheqës të jetë përfaqësuesi i opozitës.

Të nderuar kolegë,

Vëllezër e motra,

Në familjen tonë na duhet marrëveshja, të ulemi dhe të bisedojmë së bashku. Është momenti i fundit të marrim përgjegjësitë tona edhe karshi presidentit, ta ndihmojmë presidentin në rolin kushtetues që ka, t'i dalim zot vendit tonë dhe popullit që i kemi lodhur me mosmarrëveshjet tona. Përmendja e Luginës, unë e kuptoj si një mundësi e afirmimit të pozitës së keqe, shkeljes së të drejtave të shqiptarëve në Serbi në krahasim me të drejtat e serbëve që kanë në Kosovë. Zëri i ngritur institucional në këtë rast nga ana e Presidentit e aktualizon këtë çështje dhe e nxit shkallën më të lartë të sigurimit të të drejtave të tyre. E kush tjetër, pos neve, përfaqësuesve të Kosovës dhe të Shqipërisë duhet të ngre zërin për bashkëkombësit tanë në Luginën e Preshevës. Besoj se do t'ia dalim pas këtij debati kaq të gjerë që të nxjerrim një tekst të rezolutës, ku kemi mendimet e përbashkëta dhe do të arrijmë të ngremë rolin e Kuvendit në relacion...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Brovina! Fjalën e ka zonja Fatmire Kollçaku.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit!

Ne sot po diskutojmë me orë të tëra për një rezolutë dhe nuk e di pse ka nevojë të ketë menjëherë një kundërrrezolutë, nëse të gjithë pajtohem që askush nuk guxon të negociojë sa u përket territoreve në këtë moment dhe a po ndodh kjo vërtet. A bëhet fjalë këtu, në fakt, për koncentrimin me vite të pushtetit në duart e individëve të caktuar dhe tani sot krejt ky debat është prapë rreth çështjes se a duhet një individ ta ketë të koncentruar tërë këtë pushtet përsëri.

Si po reflektohet krejt kjo situatë në të gjitha proceset e tjera të ndërlidhura dhe shumë të rëndësishme për vendin, sepse asnjë proces nuk është i ndarë prej proceseve të tjera, në këtë rast nëse flasim për liberalizim të vizave, apo të mos përmend anëtarësimin që as në dukje nuk është. Po pse është i ngutshëm ky, ta quaj, njëfarë finale, dialogu dhe për kënd është i rëndësishëm, për kënd është jetik. Për ne apo për Serbinë? Përderisa po propagandohet këtu që është urgjente të vazhdohet një dialog me një partner, i cili nuk lë rast pa diskutuar për Kosovën në aspektin më negativ të mundshëm, duke deklaruar se nuk do ta njohë asnjëherë Kosovën, duke e penguar anëtarësimin kudo ku ka mundësi ta pengojë Republikën e Kosovës për anëtarësim, ndërsa ne me plot zë këtu flasim për njëfarë përmbyllje të një dialogu shumëvjeçar. Çka po kundërshtojmë ne

sot në këtë rezolutë dhe në parathënien e saj ku thuhet se kjo është vetëm një uverturë, ky debat në Kuvend për një raport 38 faqesh që Qeveria e ka hartuar rreth sfidave dhe arritjeve të dialogut 2011-2017, çfarë ka të keqe që pas miratimit të kësaj rezolute, të ulemi të debatojmë për atë raport, të shohim çka i solli Kosovës ky dialog, cilën të mirë deri tani.

Çfarë ndryshoi, zonja dhe zotërinj, sa i përket procesit të liberalizimit, përderisa ne si opozitë ishim shumë kritikë, ndërsa shumë zyrtarë të lartë nga Bashkimi Evropian thoshin që Kosova është afër përmbushjes së kriterëve apo disa prej tyre edhe se i ka përmbushur, dhe çka ndryshoi këto ditët e fundit kur tashmë, besoni që përkundër dëshirës të madhe që të jemi konstruktivë, t'i kontribuojmë këtij përfundimi sa i përket procesit të liberalizimit, ndërsa shtetet që kanë qenë shumë optimiste, që kanë qenë shumë pozitive karshi neve, tanimë po ndryshojnë qëndrimet e tyre, edhe atë me një shpejtësi marramendëse. A po ndodh ajo që krejt çka po ndodh në vend, njëri ndër to edhe dialogu dhe aventura personale, sepse ju e dini se as fëmija në djep nuk beson që ti mund të marrësh territor prej një shteti që është armiqësor për momentin karshi neve, ndërsa ti të mos i japësh asgjë atij. Këtë as fëmija në djep nuk e beson, e lëre më të na imponohet neve si përfaqësues të qytetarëve, përfaqësues të popullit një opinion i tillë që ne mund të bëjmë korrigjim pa shkëmbim territoreve.

Këtë autorizim nuk e ka askush, e më së paku presidenti aktualisht, prandaj nuk ka kurrfarë të keqe që sot ta miratojmë këtë rezolutë bashkë, pastaj të vazhdojmë ta debatojmë raportin e Qeverisë, të shohim ku dhe çka kemi arritur me dialog, a duhet të vazhdojë ai si i tillë, pse ai nuk duhet të vazhdojë si i tillë, pse ne duhet ta hartojmë një listë kërkesash karshi Serbisë, e cila na ka shumë borxh? Pse ne duhet ta kemi një platformë të qartë me qëllime dhe parime? Dhe, tek në fund, ta miratojmë një grup negociator, i cili pastaj do ta ketë shumë të qartë, do t'i ketë të qarta vijat e kuqe, sepse këtë vend shumë herë janë shkelur vijat e kuqe, sidomos sa i përket sovranitetit dhe integritetit të vendit, apo ka pasur edhe tendenca të tilla.

Do të thotë, skandalet e fundit të qeverisë, me ministra, me aktakuza, me deklaratat e ministrit të Punëve të Brendshme, në të vërtetë ministri i Drejtësisë, i cili thotë se ka ndërhyrje politike dhe do të japë dorëheqje, ikja e prokurorit nga vendi, ndërrimi i ministrave me qejfe të subjektit politik, tre ministra të Brendshëm ndërrohen në kohën kur ka rolin kyç në procesin e liberalizimit. Është njëri ndër ministrat shumë të rëndësishëm në këtë proces dhe krejt kjo rreth dialogut a po mendoni që po na bën serioz karshi partnerëve ndërkombëtarë? Pse po ndërron qëndrimi i tyre, duhet të pyeteni të gjithë këtu që jemi sot. Është momenti i fundit që t'i kthehet kredibiliteti i këtij institucioni, meqenëse jemi Republikë parlamentare dhe jo shtet presidencial, t'i rikthehet dinjiteti deputetit dhe këtij institucioni si organi më të lartë vendimmarrës, si organ prijës sa i përket dialogut, pastaj mund të miratojmë edhe rezoluta të tjera, por nuk po shoh asnjë pengesë për asnjë deputet që është i pranishëm sot që ta miratojmë rezolutën, edhe pse e ka sjellë sot opozita, sepse nuk e di që dikush në këtë sallë e kontestoi apo ka mundësi ta kontestojë rezolutën si të tillë.

Prandaj, nuk dëshiroj të dëgjoj këtu zëra që ne si deputetë po bëjmë debate koti, ndoshta dikush edhe bën debate koti, se e ka detyrë partiake që këtu të bëjë avokati, për shembull, për Presidentin, por ne të tjerët kemi obligim qytetar që të debatojmë për një temë kaq të rëndësishme siç është dialogu me Serbinë, me një shtet siç thashë që nuk na njeh dhe nuk ka plan të na njohë, së paku jo vullnetarisht, por ne mund ta detyrojmë që të na respektojë, mirëpo ne nuk e gëzojmë as respektin, sepse krejt çfarë kemi bërë në dialog të deritanishëm, kemi thënë se na kanë imponuar partnerët ndërkombëtarë, e kjo nuk qëndron nëse ne jemi ata që respektojmë vetveten, nëse ne jemi kredibilë, nëse ne jemi të thirrur për atë çfarë flasim në dialog, atëherë së paku ta gëzojmë respektin nga pala tjetër.

Ftoj të gjithë deputetët që pa humbur kohë ta miratojmë këtë rezolutë, ta thërrasim një debat tjetër parlamentar për raportin e Qeverisë 38 faqesh këtu, të shohim çfarë ka sjellë deri tani dialogu dhe unë mund ta përfundoj që nuk ka sjellë asnjë të mirë deri tani për Kosovën. Normalisht që Serbia e ka shumë për ngut, sepse ajo ka edhe sinjale pozitive nga bashkësia evropiane që do të marrë, të mos them, hap pas hapi, ka sinjale pozitive edhe për anëtarësim, ndërsa ne as liberalizimin nuk kemi gjasa këtë vit, as pëlqimin që ta marrim, e lëre më të lëvizim të lirë. Prandaj, të gjithë ne këtu sot t'ia shtrojmë vetvetes pyetjen çfarë ndryshoi në muajin e fundit, në dy muajt e fundit, te partnerët ndërkombëtarë karshi Kosovës, karshi kredibilitetit tonë dhe pse ne nuk do të lëvizim të lirë, siç po shihet tanimë, së paku deri në vitin 2020. Sipas të gjitha gjasave, edhe pse kemi edhe një muaj e gjysmë kohë, së paku ta vetëkorrigjojmë vetveten dhe kur të shkojmë të llobojmë nëse kemi çfarëdo mundësie të jemi më kredibilë në sy të partnerëve tanë ndërkombëtarë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Driton Selmanaj e ka fjalën.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne në fakt që nga mëngjesi pothuajse po diskutojmë në terma të përgjithshëm ose po flasim sikur nuk kemi informata të sakta rreth asaj çka po ndodh. Ne po i dimë të gjithë që ekziston një projekt tashmë, ai projekt mund të mos jetë i shkruar që ne i kemi parë deri sot, por miqtë tanë po na njoftojnë që zoti Thaçi dhe zoti Vuçiq kanë avancuar bukur shumë me një projekt për shkëmbim terriroresh dhe tash kur po i dëgjoj edhe këtu brenda dhe jashtë këtij institucioni kërkesën tuaj për konsensus, në fakt unë s'po ju kuptoj për çka po kërkon konsensus.

Ne kemi një kërkesë të qartë, ne po duam ta ndalim atë projekt për shkëmbimin e terriroreve, i cili është projekt i draftuar mes Thaçit dhe Vuçiqit dhe juve po ju dëgjoj në diskursin tuaj publik që edhe ju jeni kundër kësaj. Ne e kemi bërë një kërkesë për ta miratuar një pikë të kësaj rezolute, por hajde ta votojmë pra! Nëse ju nuk doni që ta votoni këtë, atëherë deklarojuni, por të thoni në publik diçka tjetër dhe këtu më pas lojë fjalësh gjatë tërë ditës dhe në fund të ditës të mos jeni të gatshëm për të votuar vërtet s'po ju kuptoj, ose kërkesa për konsensus më pas nuk ka

kuptim. Ne në shtator kur e kërkuam seancën e jashtëzakonshme, ju na kërkuat menjëherë një seancë tjetër të jashtëzakonshme, ku në kuadër të saj e sollët edhe kërkesën për një ekip negociator ose një ekip të dialogut të propozuar nga Qeveria. Në fakt, unë s’e kam kuptuar asnjëherë pse këtë kërkesë e bëtë pasi ne kërkuam seancë të jashtëzakonshme për të ndaluar projektin e Thaçit dhe Vuçiqit. Pse kërkesën për ekip negociator nuk e bëtë një vit përpara? Në shtatorin e kaluar ose në janarin e kaluar.

Nuk është ushtrimi i mandatit të kryeministrit të vendit sezonal, ta shohë një sezon si po shkojnë punët, në sezonin tjetër ndoshta unë e kam kompetencë këtë. Kryeministri në momentin kur e ka marrë mandatin, pas një periudhe na ka treguar neve publikisht që s’do të merret me dialog, sepse ka punë të tjera për t’u marrë. E pse iu kujtua në shtator që ai është kompetent për ta trajtuar këtë punë. Në fakt, kjo është njëra nga arsyet që ne s’besojmë që ky koalicion dhe kjo qeveri mund të jetë bartëse e këtij procesi. E dyta, të cilën unë kam dilemat e mija pse kjo qeveri është legjitime për të udhëhequr me dialogun, është sepse, ne mund të kemi respekt për njëri-tjetrin, por kryeministrin e Kosovës e kemi prej grupit të pestë parlamentar që është i renditur në Kuvend dhe kryeministri, edhe pse është i pesti në grup parlamentar këtu në Kuvend, ia delegon këtë të drejtë të gjashtit, as vetë s’guxon ta marrë këtë punë, i thotë “jo, tash i gjashti, Fatmir Limaj duhet ta udhëheqë këtë”. Ne tash po e shohim që kjo nuk është përpjekje serioze për të ushtruar mandatin kushtetues, por është përpjekje për t’u bërë instrument i Presidentit. Sepse, në Kosovë, e kemi thënë me qindra herë, po e themi përsëri, mandatin kushtetues në Kosovë e ka Qeveria, është autoriteti ekzekutiv në këtë vend.

Presidenti i vendi nuk krijon politika të jashtme, as të brendshme. Ai i zbaton! Krijuesi i politikave të jashtme është Qeveria dhe Ministria e Punëve të Jashtme në Kosovë. Paramendoni, sikur të takohet Rusia me Gjermaninë, kush takohet? Takohet presidenti Putin me kancelaren Merkel, nuk e kërkon Presidentin e Gjermanisë, sepse sistemi politik është i ndërtuar i tillë, por kur takohet zonja Merkel me presidentin e Francës takohet me zotin Makron, nuk takohet me kryeministrin. Ose, kur ka të bëjë me Britaninë e Madhe, nuk e kërkon mbretëreshën, po e kërkon Tereza Mej. Prandaj, dijeni këtë punë, presidenti i vendit nuk ka mandat kushtetues të udhëheqë procesin e dialogut dhe kur them tjetrën që kjo qeveri është jolegjitime, e thashë arsyen pse.

Dhe, po e them edhe një detaj, historinë e shqiptarëve të Kosovës, sa herë jemi afruar ne me serbët, fundi ka qenë tragjik për neve. Tendenca për t’u afruar me serbët pa ndërmjetësimin e ndërkombëtarëve, e bartim mesazhin që edhe një fund tjetër tragjik po na pret. T’u thotë presidenti im gjermanëve se për territorin e Kosovës vendos unë, jo ju, e ndërkohë sot kryeministria Barnabiq thotë “vijat e kuqe të Gjermanisë na kanë sjellë telashe në raport me Kosovën në dialogun që po e zhvillojmë me Thaçin”, kjo është shqetësim serioz. Çdo afrim yni me Serbinë ka pasuar historikisht, merreni historinë dhe shiheni, pasoja tragjike për Kosovën.

E, në fakt unë akoma s'po e kuptoj pse po i japim kaq zor kësaj pune? Pse po ngutemi për këtë? Dikush po thotë: "Po Kosova duhet të ecë tutje, duhet të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare", po a është problem Serbia pse neve s'po na liberalizojnë vizat? A është problem Serbia pse ne s'po e luftojmë krimin e korrupsionin? A është problem Serbia që të rinjtë tanë sot në Prizren atje, 2 mijë presin në rend në Shtëpinë e Kulturës dhe nuk mund të hyjnë aty vetëm pse një kompani gjermane ka ardhur t'i prezantojë kushtet për punësim në Gjermani. Kjo është trishtuese, këto pamje janë trishtuese, Serbia s'ka faj për këtë, fajet i kemi ne. FSK-në po e bëjmë tash me miqtë tanë ndërkombëtarë, a po na pengon Serbia? Po, s'mund të na pengojë. Prandaj, ideja që t'i jepet zor kësaj pune është t'i ndihmohet Serisë dhe eventualisht njerëzve, të cilët dikush-dikush ka mundur të jetë i përfshirë në këtë proces. Krejt në këtë proces, në një situatë goxha të rëndë dhe në të cilën besoj jemi duke luajtur me ta, janë njerëzit që jetojnë në Luginën e Preshevës.

Presidenti Thaçi kurrë në tryezat e bisedimeve nuk e ka pasur temë çështjen e shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Ne diku me qindra, të mos them me mijëra qytetarë të Medvegjës i kemi në Fushë-Kosovë pa dokumente identifikimi, s'ju kemi dhënë letërnjoftim, as s'kanë të drejtë të votojnë as në Kosovë, as në Medvegjë. Dhe tash, një moment kujtohet dikush që duhet të merret me këtë temë. Më kthen në vitet e '90-ta kur ne gëzoheshim ose pritnim nga ndonjë zyrtar në Tiranë atje të flasë për Kosovën dhe ne gëzoheshim, por dikur me takimin e Kretës e kuptuam që për ta kishim qenë komunitet, jo më tepër. Prandaj, jemi duke luajtur me sentimentin nacional të atyre njerëzve, e që për fatin e keq, për lojëra perfide krejtësisht të ngushta të Presidentit Thaçi.

Ne duhet ta miratojmë këtë rezolutë me të vetmen pikë që ta ndalojmë fillimisht këtë proces, askush, ama askush të mos ketë të drejtë të bisedojë për territor, më pas të hapim mundësi eventuale për të negociuar diçka tjetër. Por, përsëri po themi, kuptojeni këtë nuk është puna për ta ndërruar këtë qeveri dhe për të ardhur LDK ose dikush tjetër në pushtet, le të vijë një Qeveri legjitime, e cila nuk u ikë përgjegjësisë së saj, por u del në ballë. Kërkesa për konsensus të mos kuptohet si lojë fjalësh, po vërtet atë çka po e thoni edhe në media, edhe në situata të tjera, ejani të artikulojmë në votë dhe të japim përgjigjet përfundimtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe për historinë që e bërë, po nuk është mirë të futesh në disa gjëra që s'i dimë ne, s'e dimë as Kretën, se ka të tillë që kanë shkuar në Beograd te Milosheviqi, në konferenca ndërkombëtare njerëzit takohen, veçanërisht udhëheqësit, kështu që mos e përziej Shqipërinë, se ta dish ti çka ka bërë Shqipëria për Kosovën, nuk e përmend në këtë aspekt. Nuk është mirë. Nejse, mos i përziëni. Zonja Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti!

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Dhe, ju të pranishëm,

Çka do që them, sigurisht se do të përsëris me ndonjërin nga kolegët e mi deputetë këtu, por sidoqoftë do të përpiqem ta përmbledh diskutimin tim dhe më pas në formë të zgjeruar do ta dorëzoj me shkrim.

Sot jemi mbledhur këtu në këtë seancë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për të diskutuar për çështjen e vazhdimit të dialogut, përkatësisht me një temë që për mua ka qenë dilemë të jem pjesë e kësaj seance apo jo, sepse kam pasur përshtypjen se diskutimet nuk do të arrijnë të na për afrojnë mes vete pozitë dhe opozitë, por do të kenë efekt të kundërt. Do të dëshiroja të mos jetë kjo që kam menduar që në fillim. Mendoj se ky Kuvend e ka bërë të qartë tash e disa herë pozicionimin e tij karshi dialogut, sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës janë çështje të panegociueshme dhe kufijtë e saj janë të pacenueshëm. Ky qëndrim i shprehur në mënyrë të përsëritur mendoj që s'ka nevojë të diskutohet më tej. Çdo diskutim i mëtejshëm e kthen këtë Kuvend në një arenë të përplasjeve politike për interesa të ngushta partiake, pa asnjë interes dhe kontribut për shtetin e Kosovës dhe qytetarët e saj, duke besuar në çështjen që e përmenda më lart, përcaktimet e këtij Kuvendi, mendoj se ne kemi çështje më të rëndësishme që duhet t'i diskutojmë në këtë Kuvend dhe duhet t'i marrim më seriozisht, si bie fjala, themelimi i Asociacionit të Komunave me shumicë serbe, që do të jetë vërtetë cenim i sovranitetit të Kosovës. Ne kemi tema shumë të rëndësishme për qytetarët e saj, siç është liberalizimi i vizave, zhvillimi ekonomik e tema të tjera, të cilat do të na bashkonin dhe vërtetë ne Kosovën do ta shihnim më ndryshe, edhe në relacion me bashkësinë ndërkombëtare, edhe në relacion me spektrin e brendshëm.

Polarizimi ekstrem i spektrit politik në këtë rast pozitë dhe opozitë i ngjan sikur gjarprit me dy koka në malin që digjet dhe në këtë rast nuk fiton askush.

Të nderuar deputetë,

Jemi të vetëdijshëm se mbyllja e një kapitulli të mosmarrëveshjeve me një shtet fqinj duhet të jetë pikë që na bashkon. Para së gjithash, përcaktimi dhe arritja e qëllimeve konkrete nga përfundimi, ose nga faza e fundit të dialogut, siç është anëtarësimi i Kosovës në OKB dhe procesi integruar i vendit tonë në Bashkimin Evropian duhet të jenë pikat e konsensusit tonë të përbashkët. Mbi këtë parim duhet të pajtohemi të gjithë dhe të ulemi e të punojmë bashkë, në mënyrë që të ndërtojmë një platformë të përbashkët, të kemi një ekip përfaqësues të përbashkët.

Pozicioni i Kosovës në dialog fuqizohet vetëm nëse arrihet kjo, domethënë që të kemi një gjithpërfshirje. Ne do të jemi shumë më të fortë në këtë rast edhe kur shkojmë në Bruksel e jo të ndarë e të përçarë. E rëndësishme është që ne të mos i ikim përgjegjësisë asnjëri, as pozita e as opozita, sepse kjo temë është ajo e cila nuk fitojmë asgjë në qoftë se ndonjëri nga ne, pozitë a opozitë e fiton ndonjë qytetar apo ndonjë votë, nuk është fare e rëndësishme. E rëndësishme është që në bisedime Kosova të marrë pjesë si shtet i pavarur dhe sovran, kështu që flasim ne aty me zërin tonë pa na përfaqësuar askush, natyrisht me ndërmjetësimin e Bashkësisë Evropiane.

Kështu që, të nderuar kolegë deputetë, unë nuk do ta përsëris, nuk do e zgjas më tutje, siç e thash, do ta dorëzoj me shkrim diskutimin tim, por kërkoj njëherë e përgjithmonë që të jemi bashkë me pikat të cilat e tejkalojnë çdo ngjyrim politik në mes nesh. Ne mund të kemi koncepte të ndryshme për zhvillim ekonomik, për diçka tjetër, por jo për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me sovranitetin dhe integritetin e shtetit tonë, që e kemi ndërtuar me aq mund dhe sakrificë. Faleminderit!

KRYETARI: Arbërie Nagavci qenka në radhë.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë,

Kolegë deputetë,

Është e vërtetë se do të ishte mirë që ne sot të flisnim këtu për mundësitë për zhvillim ekonomik, të shikonim se si do të mund të rrisnim vendet e punës, të përmirësojmë cilësinë e arsimit e të shëndetësisë dhe çështje që janë me interes.

Pajtohem me shqetësimet e shumë qytetarëve, se këto janë të rëndësishme dhe do të duhej të shqyrtoheshin shumë seriozisht, por nuk është aspak e rastësishme situata në të cilën jemi. Edhe sistemi i arsimit dhe i shëndetësisë, që është në një nivel shumë të ulët, edhe papunësia e niveli i ulët i zhvillimit ekonomik janë pikërisht për shkak të kësaj situatë në të cilën na kanë sjellë, në radhë të parë PDK-ja dhe gjithsesi edhe vet presidenti Hashim Thaçi, kur gati njëzet vite pas lufte e më shumë se dhjetë vite pas Pavarësisë, pushtetarët tanë akoma vënë në dyshim sovranitetin e integritetin e vendit. Akoma flitet për kompromise me Serbinë, madje për kompromise të dhembshme dhe është evidente se duhet arritur kompromisi i parë, që duhet të jetë miratimi i kësaj rezolute ia cila pamundëson Thaçit të vazhdojë ta udhëheqë vendin në këtë mënyrë se si po shkon deri më tani.

Pra, Thaçi nuk duhet të negociojë për territorin e vendit, madje bazuar në gjithë këto vite të përvojës me këtë person, jo vetëm që ai nuk është kompetent, por duhet t'i pamundësohet pikërisht për shkak të përvojës që kemi pasur në udhëheqjen që ai e ka bërë në dialogun me Serbinë, sepse ai nuk ka mandatin, por edhe sepse tashmë gjatë gjithë këtyre viteve ka dëshmuar se nuk e ka pasur parasysh interesin e vendit që përfaqëson, por në radhë të parë ka negociuar për interesat e tij personale.

Është pikërisht presidenti Thaçi njeriu që na e ndryshoi kufirin me Malin e Zi, duke i humbur 8 200 hektarë. Pra, ai nuk ka legjitimitet dhe as kredibilitet të na flasë tash për ndryshim të kufirit me Serbinë. Në muajin shkurt e mars është nënshkruar dhe është premtuar ratifikimi e korrigjimi i kufirit me Malin e Zi. Tashmë, jemi në muajin nëntor dhe asnjë hap nuk është ndërmarrë në përmirësimin apo siç u tha, në korrigjimin. Thaçi e nënshkroi në Vjenë demarkacionin me Malin e Zi më 26 gusht 2015 dhe kinse korrigjimin më 16 shkurt 2018 në Podgoricë. Tash, i njëjti njeri,

pra presidenti Thaçi, na flet për korrigjimin e kufirit me Serbinë. Presidenti aktual i Kosovës, zoti Thaçi, nuk duhet të takojë më presidentin e Serbisë, Vuçiq. Ai nuk ka mandat nga Kuvendi dhe populli për aventurat e tij personale, prandaj është shumë e rëndësishme të miratohet kjo rezolutë.

Sa i përket respektimit të së drejtës së shqiptarëve të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, sipas referendumit të tyre të vitit 1992, nuk duhet të jetë e vetmja kërkesë ndaj Serbisë. Është e qartë se kërkesa e shqiptarëve të Luginës është drejtë, por Serbia i ka shumë më tepër borxh Kosovës. Institucionet e Kosovës duhet të kërkojnë që Serbia menjëherë ta njohë Pavarësinë e Kosovës, të kërkojë falje për krimet e luftës dhe të shprehë gatishmërinë për të paguar dëmshpërblimet për vuajtjet dhe humbjet që na i ka shkaktuar.

Mbi dhjetëmijë civilë të paarmatosur janë vrarë. Afër njëzetmijë gra e burra janë dhunuar. Mbi njëmijë e pesëqind persona vazhdojnë të mbeten të pagjetur, shto kësaj edhe 120 mijë shtëpi të djegura, ose të rrënuara, ndërsa kontributet pensionale, depozitat bankare dhe artefaktet kulturore janë plaçkitur e për to asnjëherë nuk është dhënë llogari. Pra, asnjë cent nuk na e kanë paguar për të gjitha këto, asnjëherë nuk kanë kërkuar falje dhe tashmë është krejtësisht e pakuptimtë dhe e palogjikshme që Thaçi të vazhdojë dialogun në mënyrën se si e ka bërë deri më tani.

Është krejtësisht e qartë, se ne kemi nevojë për zgjedhje të reja parlamentare që i hapin rrugë një qeverie të re, për një shtet të së drejtës që nuk e duron korrupsionin e krimin, për një shtet zhvillimor që i jep përparësi prodhimit dhe punësimit dhe po ashtu, Kosova ka nevojë edhe për një president të ri i cili nuk i frikësohet gjykatave dhe që nuk e ka hall veten e vet, por një president që bashkëjeton me hallet e popullit dhe që e ka interesin e përgjithshëm mbi atë personal.

Kur jemi te vazhdimi i dialogut, thjesht dua të sjell, të rikujtoj një sondazh të KDI-së të shtatorit të këtij viti, i cili e mat opinionin publik lidhur me procesin e dialogut, vazhdimin e procesit të dialogut Kosovë – Serbi. Në atë sondazh 77,6% e qytetarëve e kundërshtuan idenë e shkëmbimit të territorit në mes të Kosovës dhe Serbisë. 75,1% e qytetarëve janë shprehur të pakënaqur me kahun që presidenti Thaçi po i jep dialogut Kosovë - Serbi dhe 51,5% e qytetarëve janë deklaruar se do të protestonin kundër marrëveshjes për shkëmbimin e territoreve.

Andaj, është krejtësisht e qartë që ky ngërç i krijuar tashmë duhet të marrë fund, duhet që Kuvendi t'ia ndalojë Thaçit të vazhdojë rrugën që e ka marrë dhe të vazhdojmë përpara me çështjet që janë me interes për vendin. Faleminderit!

KRYETARI: Hykmete Bajrami, urdhëro!

HYKMETE BAJRAMI: Fjalën time e dorëzoj me shkrim, kryetar! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pati diçka pengesa. Drita Millaku, urdhëro!

DRITA MILLAKU: Të nderuar qytetarë,

Kolegë deputetë,

Situata politike në vend po merr kahe të shkëmbimit të territoreve dhe fajtor që e mban vulën e kësaj gjendjeje është Hashim Thaçi.

Disa nga hapat që na sollën në këto ditë tani janë kompromiset e dhembshme, të cilat në vazhdimësi po i thotë Hashim Thaçi. Do t'i filloj disa me radhë:

Më 17 qershor 1999 fillojnë negociatat për çarmatosjen, demilitarizimin e UÇK-së ndërmjet Shtabit të UÇK-së të përbërë nga komandantët, të cilët sot qeverisin dhe KFOR-it. Këta që sot udhëheqin me Kosovën shkuan me duar në xhepa në këto takime, ndërsa gjenerali Xheksion Vinte me një ekip, me një krah dokumentesh. Edhe pse, me kundërshtimin e disa prej ushtarëve dhe miqve tanë ndërkombëtarë në kanale diplomatike dhe jodiplomatike kërkuan të kundërshtohet çarmatosja e UÇK-së, vetëm me dy takime të vetme Hashim Thaçi e Agim Çeku nënshkruan marrëveshjen për çarmatosjen e UÇK-së. Ky ishte hapi i parë i kontributit të Hashim Thaçit dhe tani po bëhen 20 vjet që Kosova është pa ushtri. Me këta njerëz në qeverisje nuk do ta ketë asnjëherë, sepse e patën dhe e dorëzuan.

Akti tjetër i Hashim Thaçit është që tregon haptazi se po punon me agjenturat e huaja antishqiptare, siç është edhe ndalja e protestës së punëtorëve shëndetësor në Mitrovicë. Shpresoj që u kujtohet të gjithëve, kur Hashim Thaçi, i përcjellë edhe nga vetë zoti Veseli, dalin nga autobлиндat e KFOR-it dhe i drejtohen punëtorëve të shëndetësisë me këto fjalë, po i citoj: “Ju duhet të keni besim, se ne shumë shpejt do të ju rikthejmë në institucionet dhe në shtëpitë tuaja.” Pothuajse, kaluan 20 vjet dhe jo që nuk u kthyen në institucione dhe në shtëpi qytetarët, por edhe ata pak shqiptarë që kanë mbetur ende, nuk janë më aty.

Përkundrazi, aty po ndërtohen me donacione të Serbisë, “Lugina e Diellit”, 24 hektarë tokë shtëpi për serbët. Është ky rezultat i 20 vjetëve të pasluftës.

Janë edhe demonstratat e vitit 2001 në Mitrovicë, që janë ndalur pikërisht nga ky njeri, asnjëherë nuk ua ka mundësuar qytetarëve të jetojnë aty.

Tani dua të dal te zgjedhjet parlamentare të vitit 2007/2010, premtimi i zotit Thaçi ka qenë bashkimi i Mitrovicës dhe çfarë ndodhi? Kur Hashim Thaçi bëhet kryeministër, jo që nuk bashkohet Mitrovica, por me vendim qeverie, me vulën e Qeverisë, me nënshkrim të Hashim Thaçit, zyrtarisht na dalin dy Mitrovica, Mitrovica e Jugut dhe ajo e Veriut me kryetar serb. Si mund të cilësohet ndryshe, pos si tradhti?

Që lojërat e Thaçit dhe Vuçiqit të jenë më të sigurta, Hashim Thaçi krijon Listën Srpska, listë që sot pikërisht e përdor si vegël për realizimin e interesave të veta personale dhe atë në dëm të Kosovës.

Për të qëndruar në politikë Hashim Thaçi vetë krijon probleme politike e ndëretnike, siç është rasti i Urës së Ibrit, e cila nga viti 2010 e deri në vitin 2016 janë dhënë gjashtë data për lirim të kësaj ure dhe ura ende qëndron e mbyllur. Ky njeri për poenë politike sakrifikoje edhe Policinë e Kosovës, siç ishte rasti i Enver Zymberit, duke i dërguar policinë të papërgatitur dhe pa ditur se në çfarë aksionesh po shkojnë.

Për të dëshmuar se Hashim Thaçi është i lidhur me Serbinë do të ndalem te privatizimi i ndërmarrjeve. Të gjithë e dimë se privatizimi është udhëhequr nga njerëz të SHIK-ut dhe pronarët realë të fabrikave të privatizuara janë të afërt të Hashimit. Të gjithë e dimë, se në këto fabrika ka pasur makineri të reja e të përdorura, si dhe disa të papërdorura. Mbi 60% të këtyre makinave janë transportuar në Serbi dhe atë për pak para. Hashimi po flet për shkëmbim terriroresh, ndërrim kufijsh, në një kohë jo shumë të largët eshtrat e Isa Boletinit u sollën në Boletin e sipas propozimit të zotit Thaçi për shkëmbim terriroresh i bie që varri i Isa Boletinit të mbetet në terrior të Serbisë.

Në fund, po ju them se kjo Qeveri dhe këta njerëz më herët ishin ndarë për shkak të interesave të tyre personale dhe tani janë bërë bashkë nga frika. Këto janë vetëm disa nga faktet për të cilat ky njeri nuk duhet të lejohet të vendosë për fatin e vendit tonë. Të ndalet! Dhe atë, të ndalet medoemos! Faleminderit!

KRYETARI: Shemsi Syla. Le të bëhet gati Xhevit Haliti, nënkryetar i Kuvendit. Ganimete, nuk e ke kërkuar fjalën. Mundësisht, kisha kërkuar kryetarët e grupeve parlamentare dhe deputetët të kthehen në sallën e Kuvendit, për arsye se jemi në pjesën e përfundimit të kësaj pike të rendit të ditës.

Atëherë, urdhëroni zoti Syla!

SHEMSI SYLA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne i kaluam dekadat e fundit në një mungesë sigurie të paqëndrueshme dhe në një mungesë të forcimit të zhvillimit të shtetit. Besuam se fuqia progresive e globalizmit do t'i kthente në mënyrë të pashmangshme armiqësitë dhe rivalitetet në miqësi dhe partneritete dhe sovraniteti kombëtar dhe qytetaria do të ngriheshin në një komunitet global të pacenueshëm.

Ne përqaftuam pa asnjë hezitim vlerat euroatlantike por nuk vumë në zbatim të shtetndërtimit e mirëqeverisjes asnjëherë këto vlera. Në vend të këtyre vlerave ne ndërtuam klane e grupe klienteliste, që e trashën krimin ekonomik, korrupsionin, nepotizmin, që u bënë mënyrë e qeverisjes në Kosovë. E në anën tjetër, përmes bisedimeve në Bruksel pa asnjë rezultat konkret i mundësua Serbisë që të promovojë marrëveshjet fiktive me Kosovën si rezultate të saj drejt integritetit evropian.

Tash, dalëngadalë po vetëdijesohemi për faktin se Serbia me aleatët e saj i kanë kaluar këto vite duke planifikuar se si ta shkatërrojnë rendin kushtetues dhe shtetësinë e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Ne duhet të konkurrojmë me Serbinë në të gjitha fushat dhe ta pengojmë një lëvizje të mëtutjeshme agresive, ta ruajmë lirinë tonë, arsye për të ju kundërvënë atyre dhe mbi të gjitha, kundërshtarët e shtetit të Kosovës duhet t'i neutralizojmë duke forcuar rendin tonë politik të bazuar në njohjen e të vërtetave tona, që janë të pavarura nga moda dominuese e kohës, e cila i mundëson Serbisë që të eksportojë në Kosovë 500 milionë euro në vit. Sot jemi në një situatë ku presidenti i Republikës së Kosovës, i cili ka për detyrë të përfaqësojë unitetin e popullit, është në fakt përçarësi më i madh. Presidenti i Kosovës duke promovuar idenë e korrigjimit të kufijve si alternativë të vetme për një pajtim me Serbinë e ka përçarë klasën politike dhe ka prishur çdo mundësi të një konsensusi politik, që i duhet patjetër Kosovës në këto bisedime me Serbinë.

Presidenti në një anë hedh ide të dyshimta dhe si të vetme për normalizimin e raporteve Kosovë - Serbi, e në anën tjetër bën thirrje për unitet. Pra, idetë duhet të jenë ekskluzivisht të Hashim Thaçit, kurse uniteti politik rreth këtyre ideve duhet të jetë thjesht formal. Mjafton që të caktohet një grup i njerëzve që i shkojnë prapa në emër të unitetit politik dhe gjithçka është në rregull.

Në radhë të parë marrëveshja Kosovë – Serbi për ndërrimin e territoreve shqiptare të Kosovës me territoret shqiptare të Serbisë, jo vetëm që bien ndesh me përpjekjet shumëvjeçare të kombit shqiptar të Kosovës për liri e pavarësi, por edhe të së drejtës ndërkombëtare. Kosova është shtet sovran dhe i pavarur. Legjitimitetin juridik të shtetit të pavarur të Kosovës ia ka njohur edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Pra, juridikisht Kosova nuk ka mekanizëm tjetër ndërkombëtar që mund t'ia mohojë pavarësinë. Beteja tash e tutje është politike. Kosova ka shpallur pavarësinë e saj duke promovuar veten si shoqëri multietnike. Në Kosovë ka vend për shqiptarët etnikë, ka vend për boshnjakë etnikë, për serbë etnikë, për goranë, turq, romë e të gjithë të tjerët që janë qytetarë të Kosovës, pavarësisht prejardhjes së tyre etnike.

Kjo është bërthama e tanishme e identitetit të Kosovës si shtet, por jo përfaqësimi i pakicave përmes listave të veçanta, siç është rasti me serbët e Kosovës, ku përfaqësuesit e tyre politikë i zgjedh Vuçiqi në Beograd dhe jo me një president që i thotë deputetit gjerman “unë jam president, unë vendos për ndryshime të kufijve, unë bëj këtë, unë bëj atë...”

Për kufijtë vendosin qytetarët e Kosovës, vendos ky Kuvend i cili sot duhet të vendos një vijë të kuqe për secilin që do të përfaqësojë Kosovën në bisedimet e ardhshme, se për çfarë ka legjitimitet të bisedojë dhe për çfarë Kosova nuk bisedon me askënd, kur është në pyetje sovraniteti, integriteti dhe subjektiviteti i shtetit. Ideja e shkëmbimit të territoreve është një opsion me pasoja të paparashikueshme dhe ndarje të tilla territoriale kurrë nuk kanë ndërtuar paqe të qëndrueshme. Ne duhet t'i mbrojmë kufijtë aktualë të Kosovës dhe duhet të jemi unikë që Serbia ta njohë pavarësinë tonë në këto kufij që i kemi tani. Këmbimi i territoreve nuk është kusht vetëm i Serbisë për ta njohur Kosovën, ka edhe kërkesa të tjera shumë më të rrezikshme, siç është statusi dhe gjoja prona e Kishës Ortodokse dhe Zajednica për serbët e mbetur në jug të Kosovës.

Po flitet se shumë diplomatë të ndryshëm kanë deklaruar se duhet të jepet diçka, t'i jepet diçka Serbisë për të na njohur si shtet. Të nderuar deputetë, ne i kemi dhënë 13 mijë qytetarë që Serbia i ka vrarë e masakruar, 20 mijë femra të dhunuara, rreth 1 milion qytetarë të dëbuar nga shtëpitë e tyre, mijëra shtëpi të djegura e miliarda dollarë pasuri të grabitura e të plaçkitura në luftë, i kemi përjetuar në kurrizin tonë 25 elaborate shtetërore për shfarosjen dhe asimilimin e qenies sonë kombëtare në këto 120 vitet e fundit, e kemi paguar shumë shtrenjtë lirinë tonë. Nuk mund t'i japim më tepër, përveçse gatishmërisë sonë me paqe e respektim reciprok. Faleminderit!

KRYETARI: Xhavit Haliti e ka fjalën. Të bëhet gati deputeti Shkumbin Demalijaj.

XHAVIT HALITI: Zoti kryetar,

Zonja deputete, zotërinj deputetë,

Unë nuk desha të flas më herët për shkak se nuk doja të flisja për televizor.

Sidoqoftë, seanca e sotme mendoj se ka pasur një temë mjaftë interesante, për të cilën kemi debatuar qe disa muaj dhe kemi trajtuar përmes rezolutave që i kanë sjellë të gjitha grupet parlamentare pothuajse, nga një, për të dhënë mendimet e tyre, ose për të miratuar rezolutë. Dhe, nuk e kam ditur që krahas Qeverisë që opozita dëshiron ta rrëzojë, tani ka shpallur edhe një armik të brendshëm, që e ka tradhtuar Kosovën, që e ka tradhtuar Kombin, e ka përçarë skenën politike dhe çka s'paska bërë. Dhe, ky njeri është një njeri, e paska emrin Hashim Thaçi.

Në qoftë se, është kështu, legjislacioni i Kosovës, Kushtetuta e Kosovës parasheh rregullat për të cilat Parlamenti dhe Gjykata Kushtetuese mund ta thërrasë në përgjegjësi dhe mund të konstatojë se ku e ka shkelur Kushtetutën zoti Thaçi. Është mirë dhe unë jam dakord, në qoftë se dikush ka argumente, edhe unë si një deputet mund ta qes firmën në kërkesën për ta shqyrtuar tradhtinë e zotit Thaçi në Gjykatën Kushtetuese dhe këtu në Kuvend. Sa i përket Thaçit, unë kam kaq.

Por, desha të ndalem tek çështjet që po i bisedojmë dhe desha ta falënderoj për fjalimin e saj një zonjë deputete këtu që ka folur më herët, s'po ia përmend emrin dhe mendoj se është dashur që të keni vëmendjen në fjalimin e saj.

Nuk jemi aq të fortë sa po e prezantojmë veten. Nuk jemi ata që i vendosim çështjet që kanë të bëjnë me të ardhmen e Kosovës në mënyrën qysh ne po dëshirojmë, ose qysh ne po diskutojmë. Dhe, këtë e dini edhe ju shumica, e di edhe presidenti, edhe Qeveria, për situatën në të cilën jemi, për mundësitë tona dhe fuqinë tonë. Dua të ju them, sa i përket procesit para pavarësimit, se askush s'ka parë ëndërr që ndodhë kaq shpejt liria e Kosovës. Ka pasur lojëra të ndryshme, edhe nga Bashkësia Ndërkombëtare, edhe nga miqtë që ne mendojmë se... ose të flasin thujse ata na kanë thënë “futuni ju në luftë, se neve na keni mbrapa...”. Nuk është kështu. Procesi ka qenë i vështirë, besoni, ju e dini shumë mirë që ka pasur emisarë të cilët janë përpjekur që çështjen e Kosovës mos ta zgjedhin përmes konferencës ndërkombëtare po të shkojmë të merremi vesh qatë në Beograd, “që ku është Millosheviqi aty, ta bëjmë marrëveshjen për Hashimin, ta bëjmë marrëveshjen për autonominë, Serbia është e gatshme me të lëshime, me ia dhënë Kosovës autonominë, ndoshta edhe më shumë se që ka pasur në kuadër të asaj federatës Mali i Zi dhe Serbi, edhe e pushojmë luftën”.

Na kanë lutur që t'i zhbllokojmë rrugët dhe të rrimë jashtë rrugëve, po të qarkullojnë forcat e ushtrisë dhe të policisë së Serbisë nëpër rrugë. Nuk kemi pranuar. Është mbajtur një konferencë ndërkombëtare, udhëheqës i delegacionit të Kosovës në të cilën ka qenë Hashim Thaçi. Dëshëm, ose s'dëshëm me e pranua, kështu ka qenë. Edhe ne kemi qenë aty, ata që kanë qenë, dhe e dimë procesin. Unë nuk kam konstatuar që zoti Hashim Thaçi në Rambuje ka tradhtuar ndonjë send. Ndoshta, edhe po të donte nuk do ta lejonim, s'do të lejonte as interesi i Kosovës, po ka qenë, po them se ka qenë në nivel të një atdhetari të madh, të një patrioti të madh, të një njeriu që vërtet është përplasur edhe me ne, është përplasur edhe me delegacionet e huaja.

Por sidoqoftë, po ua them një diçka, kur e kemi filluar konferencën jemi ndarë në grupe. Unë kam qenë shef i grupit për siguri. Edhe të gjithë, qysh kemi qenë delegacionet kemi biseduar bashkë me ndërkombëtarët. Kur ka ardhur drafti i parë i marrëveshjes, s'jemi pajtuar asnjë. Edhe e kemi përpunuar materialin, e kemi bërë aq mirë, sa besoni, sikur të ishte miratuar qaj material do të ishte shumë mirë për ne, ishim gëzuar të gjithë, edhe sot, edhe atëherë. Kur e kemi lexuar draftin e delegacionit serb, që ka qenë në një sallë tjetër, edhe e kemi krahasuar, jemi trishtuar. Dhe ka ardhur drafti tjetër ndërkombëtar. Edhe po them, që procesi ka qenë shumë pozitiv. Të metat janë të meta janë tonat. Gabimet, 90 për qind janë tonat, jo veç të Qeverisë, jo veç të Presidentit ose të presidentëve, por të të gjithë neve të cilët nuk kemi ditur të ulemi të bëjmë politika të shtetit dhe të dimë se çfarë mund të flasim në Kuvend në raportet për të cilat notat më negative i ka marrë ky Kuvend, edhe neve si politikanë kur kemi folur keq dhe jemi përparë me të pazotë që janë sot.

Zotimi ynë ka qenë mos harroni që komuniteti serb në Kosovë do të trajtohet më mirë sesa do të trajtohen serbët në Serbi dhe kjo mendoj se ka qenë politikë e domosdoshme dhe është dashur ta bëjmë këtë, nuk e kemi bërë. Nuk e kemi bërë dhe u kemi dhënë mundësi atyre që të ankohen dhe ju kemi dhënë fuqi dhe hapësirë që të na përçajnë dhe të mos jemi të aftë të mendojmë se cila është lufta speciale që zhvillohet kundër Kosovës brenda në Kosovë. Unë nuk frikësohem kurrë as sot as nesër që ushtria serbe do të futet as në veri, as në jug, as askund hiç, s'ka shans ta sulmojë Serbia Kosovën. Kosovën jemi duke e dëmtuar ne kosovarët, duke përfshirë edhe ato grupet parlamentare që nuk janë këtu sot.

Hajde të bëjmë presion te Qeveria, te Presidenti, në Parlament këtu që të bëjmë politikë shtetërore për çështjet që na interesojnë. Zgjedhjet edhe nëse mbahen, edhe nëse i fiton njëri ose tjetri, s'është me rëndësi shumë, ta kenë një busull të politikë shtetërore, e cila Kosovën e çon në drejtimin që e ka marrë. Dilni jashtë Prishtinës ose edhe brenda në Prishtinë shihni se sa po e ndërtojmë evropianizimin e Kosovës. Shihni, shihni! Çka po ndërtohet në Kosovë, çfarë mesazhi po i japim Evropës ne si popull evropian dhe pastaj mund të flasim se s'po dua t'i hap kartat.

Besoni që nuk ka çka na bën Serbia. Jemi po them, siç po themi ne e kemi aleat strategjik NATO-n, por NATO-n për ta pasur aleat strategjik dhe për të qenë në të duhet kryer disa detyra, jo për të tradhtuar vendin, jo për të tradhtuar interesat kombëtare, por duhet të sillemi siç sillen në raportet me pakicat, me komunitetet edhe vendet evropiane, pastaj ne kemi mundësi të kërkojmë llogari prej të tjerëve pse po na përzihen në punët e brendshme. Ju i keni parë lajmet, e keni parë që Vuçiqi i ka ndarë 50 milionë euro për investime në Kosovë, në zonat e banuara me serbë. Tash mund të themi se është përzier në punët e brendshme. Jo s'është përzier se ai e ka të drejtë, ka të drejtë me Kushtetutë me rregullat që janë nënshkruar.

Unë mendoj se duhet të gjenden rrugë edhe me Presidentin që të ulen partitë politike, dhe edhe ai të sqarojë edhe pjesën që i takon, jo ndoshta, se s'ka nevojë gjithmonë para mediave, po të sqarojë dhe të sqarohemi me njëri-tjetrin. Pa biseduar me njëri-tjetrin, duke u gjuajtur nga larg, duke e paragjykuar njëri-tjetrin me argumente apo pa argumente dhe pa i trajtuar të gjitha temat që janë të domosdoshme për t'i trajtuar dhe për t'i realizuar si institucione të Kosovës, si Kuvend i Kosovës, si Qeveri e Kosovës, neve ata që janë të interesuar të na mbajnë në këtë gjendje do të vazhdojnë të na fusin edhe thikat e tjera të ngatërresave edhe më të mëdha mes nesh dhe në fund të fundit humbja do të jetë e jona dhe jo e atyre që ne po përpiqemi t'i mundim.

Kosova e thashë edhe një herë orientimin deklarativ e ka nga perëndimi, veprat nganjëherë më duken janë tjetër orientim.

Edhe një perëndimor po të vijë në Kosovë dhe po të dalë të lëvizë rrugëve të Kosovës, ka për t'u çuditur se si ne deklarojemi evropianë dhe çfarë shohin në të gjitha anët e Kosovës, duke përfshirë qytetet dhe fshatrat e Kosovës. Gjeneri mundësinë, unë nuk po ju thërras as si lider as si

diçka, por po dua t'ju lus, së pari kryetarët e grupeve parlamentare, së dyti Presidentin e Republikës, së treti grupet që mund të asistojnë dhe të mund të jenë prezente në një takim të përbashkët, hapni kartat dhe zotohuni që nuk i nxirrni për media si të dilni prej aty dhe ta gjejnë një rrugë për çështje që na interesojnë. Askush më shumë kundër nesh s'është duke punuar sesa ne kundër vetvetes.

Faleminderit!

KRYETARI: Shkumbin Demaliaj e ka fjalën dhe dy deputetë ndërkohë janë Ganimete Musliu dhe Nait Hasani.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, kryetar!

Nuk po zgjatem shumë për shkak se vetëm një pjesë të madhe të përmbylljes së kësaj për ta freskuar ditën e sotme, e foli nënkryetari i Kuvendit, meqenëse sponzorizuesi janë dy partitë më të mëdha opozitare, kërkoj që unifikimi i Kuvendit sonte le të bëhet, sepse opozita nuk ka pjesëmarrje në Qeveri dhe kërkesa më e mirë e mundshme është që secili mandat lidhur me çështjet e negociimit përfundimtar me Serbinë t'i mbetet Kuvendit, ashtu edhe siç i kemi ofruar draft rezolutës. Kuvendi t'i merr këto përgjegjësi.

Është vetëm një element që personalisht edhe besoj shumë njerëz të këtij vendi kanë për ta kuptuar se është tmerruese, 540 minuta biografi për Hashim Thaçin ky Kuvendi jonë po i fol sot për të. Mendoj se mund të jetë një ndër liderët me biografinë më të madhe në botë. Prej orës 10:00 deri në 17:00 dhe gjatë pauzës kanë folur për këtë çështje.

E konsideroj a kanë folur a mirë a keq veç për një biografi, jem mbledhur për diçka krejt tjetër, e kanë kthyer në biografinë e Presidentit të Kosovës. A është mirë a është keq, le ta vlerësojnë vetë, por unë mendoj se me këtë opinion nuk e di ku mundemi të ecim dhe ku mundemi të shkojmë.

Unë konsideroj se përfundimi i propozuesit ka për ta thirrur këtë unitet të Kuvendit dhe t'i marrim obligimet tona, se nuk mundemi të presim kaq gjatë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën. Bëhet gati Nait Hasani. Deputet tjetër s'ka për fjalë.

Atëherë deputetë, kthehuni në sallë se do të kemi paraqitjen nga propozuesi të finales.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit i nderuari kryetar!

Të nderaura kolege dhe ju kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Është bërë shumë bujë këto ditë, jo bllokada jo zhbllokada jo thirrje e unitetit. Unë uroj dhe shpresoj shumë që Presidentin e Republikës së Kosovës mos ta ketë mbërthyer lemza sot se aq shumë e kemi përmendur në këtë Parlament të Republikës së Kosovës, ndoshta s'ka mundur t'i zhvillojë edhe takimet shumë të rëndësishme që është duke i zhvilluar atje.

Sot në këtë Kuvend u tha e çka nuk u tha, por asnjëherë nuk dëgjova nga ata të cilët e thirrën këtë seancë në emër të konsensusit, në emër të unitetit, në emër të ruajtjes së kufijve të Kosovës, nuk dëgjova që të thërrisnin për unitet, përkundrazi ata thirrën në përçarje, thirrën në vëllavrasje, thirrën në gjithçka tjetër, por vetëm në mbrojtje të kufijve jo.

Ne si shtet e kemi një Kushtetutë të Republikës së Kosovës dhe ju e dini shumë mirë që asnjë rezolutë dhe asgjë tjetër nuk mund ta shfuqizojë Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Është një kushtetutë aq mirë e shtjelluar dhe e drejtë saqë i garanton kufijtë e Republikës së Kosovës dhe Presidenti i Republikës së Kosovës deri më tani është dëshmuar që e ka respektuar në çdo pikë Kushtetutën e vendit.

Sot në këtë Kuvend u akuzua edhe për vrasje dhe u provua që të emitohen kolegët e tyre. Kemi Vjosa Osmanin këtu e cila unë dua ta përgëzojë sepse ka mbajtur një qëndrim permanent çdo herë edhe duke e sharë Presidentin e Republikës së Kosovës ia ka dalë që të jetë femra më e votuar në Parlamentin e Republikës së Kosovës dhe kolegët e saj thjesht duke u munduar që ta emitojnë atë, dolën shumë keq, sepse janë ato që pikërisht atë ditë janë shkarravitur këtu në kuvend për t'u munduar për t'ia bërë votat Presidentit të Republikës së Kosovës. Elektorati i Lidhjes Demokratike të Kosovës nuk besoj që është aq i pamënçur që të dijë se ata njerëz që dje e votuan Presidentin e Republikës së Kosovës, sot qesin lot krokodili kundër atij Presidenti. Ata dinë mirë të vlerësojnë.

Sot këtu u tha që Presidenti i Republikës së Kosovës ka vrarë njerëz dhe është gjynah që duke u munduar të përdoren ato familje dhe ato viktimat në Kosovë, për vota dhe thjesht për të fituar elektorat. Unë publikisht nga kjo foltore i ftoj të gjitha ato familje të cilat kanë humbur më të dashurit e tyre që të shkojnë direkt në shtëpinë e deputetes Besa Gaxherri dhe t'i kërkojnë përgjegjësi dhe llogari që të tregojë atë çka e di. Të tregoj me emër dhe me mbiemër, sepse ka kaluar koha që ne dalim, shajmë, akuzojmë dhe inkriminojmë dhe të heshtim në emër të politikës. Publikisht i ftoj të gjitha familjet të cilat kanë humbur më të dashurit e tyre dhe sot u përmendën në këtë foltore t'i drejtohen direkt shtëpisë së Besa Gaxherrit dhe të kërkojnë përgjegjësi. Pastaj po ashtu ato lëndë të cilat ajo do t'i japë informacionet t'i drejtohen edhe Prokurorisë së Shtetit dhe të zbardhen njëherë e përgjithmonë fati i atyre vrasjeve se nuk mundemi ne në çdo seancë, në çdo debat parlamentar pavarësisht çfarë teme ka të merremi me viktimat dhe t'i terrorizojmë ato familje. Ose le të tregojnë atë çka e dinë ose pretendojnë se e dinë, ose le ta mbyllin gojën dhe t'i lënë rehat ato familje.

Lidhja Demokratike e Kosovës kisha pasur dëshirë një herë të dëgjoj çka ka në programin e saj, sepse tashmë është dëshmuar që ose për të marrë vota, për të mbajtur vëmendjen e elektoratit të vet, ose duhet me ia lëkund në çdo debat eshtrat Presidentit të ndjerë Ibrahim Rugova, ose duhet sharë Presidentin aktual zotëri Hashim Thaçin. Kështu që është mirë të tregojë se çka kanë ata prioritet, cili është projekti i tyre për shtetin, cili është plani i tyre për shtetin. Mjaft më me viktima, mjaft më me njerëz të vdekur, të viktimizohen dhe të kërkojnë që ta mbajnë elektoratin gjallë dhe politikën e tyre viktimizuese siç ka ndodhur deri më tani.

U munduan shumë këtu që Hashim Thaçi të shpallet edhe tradhtar i Kosovës se gjoja ai po do ta shesë Kosovën. Nuk e di kujt i pengon kaq shumë hapja e temës së bashkimit të Luginës së Preshevës me Kosovën. Ne e dimë mirë se ka vite e vite, më shumë se një dekadë, që këtu në çdo debat është folur për bashkimin kombëtar. Nuk e di si e paramendojnë dhe si e kanë të projektuar ata njerëz të cilët janë sjellë si baballarë të bashkimit kombëtar, si e kanë të projektuar idenë e bashkimit kombëtar nëse nuk korrigjohen kufijtë. Thjesht është mirë të na tregojnë se si e shohin apo kanë vetëm ëndrra dhe mendojnë t'i kenë në sirtarët e tyre ato ëndrra të mbyllura, sepse nuk e kanë pasur kurrë përnjëmend bashkimin kombëtar dhe nuk e kanë as sot he frikësohem se dikush ka mundësi që ta realizojë këtë çështje të tillë.

Edhe një herë, qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e garanton këtë vend për tërësinë e saj territoriale dhe asnjëherë nuk do të lejojë që ajo kushtetutë të shkelet. Ne kemi pasur rast kur presidentët e vendit e kanë shkelur Kushtetutën dhe janë përgjigjur ligjërisht shkeljeve të tyre, sot nuk janë më. Kështu që mos bini pre edhe viktima të debateve politike.

Po e përmendi edhe një herë Vjosa Osmanin e cila në diskutimin e saj, për mirë Vjosë po të përmendi mos u merakos, në diskutimin e saj, sot e tha që këtu po flitet për të bërë politikë me këtë rezolutë, politikë ditore sepse është Kushtetuta ajo që e rregullon dhe është shumë e drejtë sepse ligjërisht dua të besoj se Vjosa di diçka sa i përket ligjeve dhe thjesht nuk guxojmë ne ta shfuqizojmë Kushtetutën me një rezolutë. Ne nxjerrim rezoluta ditë e natë, por është Kushtetuta e Republikës së Kosovës ajo që e garanton tërësinë territoriale të vendit.

Pat këtu edhe aso ide të cilat kërkuar që të niset një mocion për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Kosovës, zotit Hashim Thaçi. Veç një po ju them, nuk kam dëgjuar që nxënësit e mirë e shajnë dhe e përqeshin profesorin, gjithmonë janë nxënësit e dobët ata të cilët e shajnë arsimtarin e tyre. Prandaj atyre që sot e ngritën tezën që duhet të ngrihet mocion për të rrëzuar apo për të shkarkuar Presidentin e Republikës së Kosovës, Hashim Thaçin, ju kisha thënë që keni mësuar boll prej politikës së tij, keni përfutur boll, i keni gëzuar të gjitha privilegjet nga po ai President dhe partia e tij mbështetëse. Nëse kurrëgjë tjetër, të paktën të jeni mirënjohës dhe atë dije që e keni marrë ta shfrytëzoni për mbarë dhe jo të mendoni diçka që s'mund ta arrini asnjëherë. Faleminderit!

KRYETARI: Zotëri Hoti, a dëshironi replikë, apo deputetet që janë përmendur. Deputetja që është përmendur ka kërkuar ndërkohë. Vetëm kthehu prapa dhe shikoji. Besa Gaxherri po kërkon fjalën, të cilat janë përmendur. Atëherë Besa Gaxherri e ka fjalën pasi është përmendur. Vjosa Osmani pastaj kryetar emri s'është përdor, veç nëse do për parti, unë po e bëj prapë.

BESA GAXHERRI: Të them të drejtën, më vjen shumë keq, po më duhet të reagojë për hir të qytetarëve, se kolegja ime nuk e vlen hiç të merrem me të, me vlerësimet me gjykimet tuaja aq të ulëta dhe që shndërrohen në avokat të kujtdo tjetër.

Unë jam krenar për veten time që kurrë s'kam qenë avokat i askujt dhe shtëpia ime dhe unë fatbardhësisht nuk i kemi borxh askujt. Fatbardhësisht, askush nuk ka nevojë të më drejtohet në shtëpinë time. I kemi ngritur disa institucione të cilat i keni kapur dhe nuk po i lëshoni hiç. Le të drejtohen atje le të shkojnë. Edhe Hashimi është i mësuar që të shkojë nëpër oda për këto çështjet e vrasjeve dhe le të shkojë prapë e unë i respektoj institucionet e mia dhe guxoj të them atë që e kanë thënë raportet ndërkombëtare kolege, merri lexoj. Unë nuk kam qenë me të, nuk e di kush i ka bërë, por përgjegjësinë institucionale e ka gjithkush, edhe unë, edhe ti, edhe Kuvendi, edhe Presidenti, edhe krejt.

Mua nuk po më interesojnë emrat e askujt, përgjegjësi kanë dhe duhet të japin. Raportet i kemi lexuar të gjithë dhe unë i jam referuar atyre raporteve e tash që ju vjen kaq keq, unë nuk kam çka ju bëj. Më keq ka qenë kur janë bërë veprat se t'i thuash sot.

KRYETARI: Ganimete Musliu. Vetëm ju kisha lutur, mos devijoni, po devijoni prej çështjes tërësisht. Nuk kam qenë prezent në diskutimet, shumicën e rasteve Kuvendi po abuzohet. Janë çështje çka janë për çështje të gjyqësisë, çka janë për çështje politike, ju kisha lutur të ktheheni në temë. Kjo është veç për t'u kthyer në temë.

Kundër-replikë, urdhëroni zonja Musliu!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit kryetar,

E nderuara zonja Gaxherri,

Në fjalën tuaj thatë që e di, nuk thatë se u bazuat në raporte ndërkombëtare. E thatë në dy replika, po në fjalën tuaj thatë e di. Unë prapë po e përsëris atë që e thash, të lutem tregoj atyre familjeve për të vërtetën që e di. Fole për institucione, prokuroria është një nga institucionet e këtij vendit, respektoje, shko depono dëshmitë që ke dhe të mbyllet kjo temë.

E thatë e di. Edhe një herë po të them shko, përndryshe prapë apeloj te ato familje që i kanë humbur më të dashurit e tyre, shkoni në shtëpi, kërkon llogari për fjalën e dhënë sepse po thirrret në emër të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: A ka mundësi të kthehemi te tema dhe mos ta abuzojmë këtë foltore? Vjosa Osmani, replikë!

VJOSA OSMANI: Mendoj se është i nevojshëm një sqarim meqenëse u tentua të citohet një pjesë e fjalimit tim. Në fakt në asnjë moment unë nuk kam thënë që tentimi për të nxjerrë rezolutë po shfrytëzohet për politika ditore. Ajo që e kam thënë është që përderisa Kushtetuta e përcakton qartë vijat e kuqe edhe për dialogun por në veçanti për integritetin territorial, ne sot nëpërmjet rezolutës dërgojmë mesazh të fuqishëm politik se kur kemi të bëjmë me interes të shtetit dhe të territorit tonë, ne flasim me një zë. Pra kam folur për mesazh politik dhe assesi për politika ditore.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Hoti a dëshironi edhe ju në emër të partisë? Urdhëroni, replikë.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit kryetar i Kuvendit.

E kam për borxh të përgjigjem ndaj deputetes Musliu dhe gjithë të tjerëve sepse sa herë që përmenden vrasjet politike të pasluftës, e akuzojnë LDK-në pse po i përmend. Unë po ju tregoj që të shtunën që shkoj ne kemi marrë pjesë në përvjetorin e vrasjes së Ukë Bytyçit dhe pas luftës janë disa zyrtarë të lartë, unë nuk po hyj me emra, që janë vrarë, nuk e dimë kush i ka vrarë, por janë në mënyrë sistematike të LDK-së, nuk janë zyrtarë të lartë të PDK-së, të AAK-së ose të ndonjë subjekti tjetër. Derisa nuk zbulohen, ne nuk kemi për t'u ndalur për të kërkuar drejtësi për ta. Këtë desha ta them. Faleminderit!

KRYETARI: Po veç është mirë për tema të tilla, mos të flasim për çështje të tilla. Është mirë, unë mendoj kështu, vetëm për hir për të mos rënduar opinionin. Kryetari i grupit, ideja më e mirë është që të marrim një vendim, të mbajmë një seancë të veçantë vetëm për atë çështje dhe i thërrasim mediat, i thërrasim prokurorët. Ka çka të flitet. Ti e përmende AAK-në diçka, por përmendma konkret. Mos e përmend AAK-në, e ka edhe ai një vëlla në të njëjtën situatë, mos se po e rëndoni. Ka edhe dhjetëra të tjerë të cilët janë në këtë situatë, të cilat familje të caktuara i keni atakuar shpesh. Ganimete ta lëmë këtë çështje. Shkojmë në një debat, por mosni se po rëndohet. Po flasim për kufirin e shtetit e tash dalim në tema krejt të tjera.

Megjithatë unë veç po ju lus, bëjeni kërkonte flasim pikërisht për atë çështje dhe është e drejtë e plotë dhe pastaj kanë çka flasin secili. Gjithë ne kemi çka flasim, edhe për raporte ndërkombëtare, edhe kombëtare, edhe për denoncime, edhe për në Strellc, në kallamboq, edhe për Drenicë dhe të gjitha pjesët, por politikisht s'është mirë. Jemi për kufirin.

Jo Ganimete, si kolege, si dëshiron, po vetëm po rëndohet dhe po i rëndojmë qytetarët e Kosovës. Për mua, unë kujt s'ia ndali fjalën. Ia jap fjalën, s'ia ndali askujt.

Sali Zyba e ka fjalën, në ndërkohë u lajmëruan edhe Liburn Aliu e Naiti.

SALI ZYBA: Përshëndetje të pranishëm!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Po flasim për Hashim Thaçin, për termin që e ka përcaktuar ai korrigjim i kufijve. Së pari duhet të dimë se i njëjti nuk është në gjendje dhe nuk e ka kompetencë jo vetëm përcaktimin apo korrigjimin e kufijve, por sot e ka edhe një pafuqi të veten të pushtetit të korrigjojë gabimet që i ka bërë qofshin në komunat njëetnike që i ka krijuar në kuadër të territorit të Republikës së Kosovës, qoftë edhe vendime të tjera që u përmendën shumica prej kolegëve tanë si vendime të dëmshme në procese të cilat i ka bartur i njëjti.

Për hir të disa qytetarëve që më kanë shkuar gjatë ndjekjes së kësaj seance, po detyrohem të citojë zëvendëskryeministrin Enver Hoxhaj, i cili në fjalimin e tij tha: më ka rënë këto ditë të bisedoj me disa prej udhëheqësve të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, i kam pyetur a duhet ta nisim çështjen e bisedimeve etj., të cilat i tha ai. Ku janë këta persona që u konsultuaka zëvendëskryeministri apo çka ka marrë sugjerim tash qoftë si Qeveri, qoftë si një zyrtar i subjekti politik. Tjetra që tha: e kam më shumë frikë zbatimin e marrëveshjes sesa përmbajtjen e asaj marrëveshje. Iu referua edhe Pakos së Ahtisarit. Nëse i njëjti për përmbajtjen nuk e ka qëllim dhe interesim, për procedurën do të flas duke e përmend subjektin e tij apo mazhorancën, duke ia kujtuar se i njëjti disa herë tha se mazhoranca ka ardhur në seancën tuaj. T'i provojë mazhoranca seancës sonë, seancës së kërkuar si seancë e jashtëzakonshme t'ia mbivendosë një orë më përpara një seancë urgjente dhe duke propozuar një listë me emra, emra të cilët Vetëvendosjen e kanë shqetësuar.

Bartës i asaj liste është edhe Fatmir Limaj. Si Vetëvendosje, po përmendi veten këtë rast, kur Fatmir Limaj ishte bartës apo bashkëveprues i disa proceseve negative, ua rikujtoj disave, unë personalisht dhe një grup të tjerë tashmë aktivistë të shquar vendosëm të shkelim ligjin qëllimisht duke ua sjellë në kujtesë të gjithë qytetarëve, po në veçanti atëherë pushtetit, grupeve të subjekteve politike që në emër të një uniteti, po për të cilën tash zëvendëskryeministri është caktuar në listë i emëruar si bartës i kësaj liste për procesin e negociatave, i njëjti pat deklaruar mundohem ta citoj: është hera e parë në këto bisedime, atëherë në Vjenë, thoshte Kosova është në momentin e parë historik ku është si dhënë në këtë rast në bisedimet me Serbinë. Çka ka ndërruar zëvendëskryeministri prej atëherë që nuk do t'i japë territor të Kosovës Serbisë. I njëjti ka dhënë komuna, i njëjti ka dhënë zona të veçanta, e ka dhënë pjesën e historisë së lashtë dhe i njëjti zotohet për një proces, për të cilin nuk ka ndryshuar as kundërshtari, në këtë rast negociatori përballë dhe i njëjti nuk ka asnjë ndryshim, asnjë pendesë.

Sulmi që iu ka bërë në këtë rast iniciuesit, sidomos subjektit LDK-së për një të kaluarën, unë e çmoj më shumë pendesën e tyre në raport me mundësinë që ia ka dhënë këtij Presidenti i cili sot po shkakton pasoja të tjera. Këtu mazhoranca nuk është për t'i bërë numrat opozitës. Cilado prej qëndrimeve që kalon këtu ky Kuvend nuk është bartës edhe përgjegjësi e subjekteve veç e veç. Është përgjegjësi e Kuvendit dhe e institucioneve të tjera për të cilat sot Presidenti nuk i ka.

Në fjalimet e disa kolegëve kur e sulmuan Vetëvendosjen si mosnjohëse të shtetit, apo vlerave e flamurit e diçka, po flasim për një President i cili në emër të pavarësisë, ka kontrabanduar dhe ka imponuar edhe simbole, edhe rend tjetër përkundër vullnetit të shoqërisë dhe qytetarëve të Kosovës.

Unë do të detyrohem të ndërpres këtu për shkak të angazhimit për harmonizim të rezolutës, kështu që faleminderit edhe një herë.

KRYETARI: Nait Hasani dhe Liburn Aliu. Me aq sa po e shoh nuk ka tjetër deputet.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Po besoj që nuk janë lodhur deputetet. Për mua është me rëndësi që një pjesë e madhe e shoh se i janë gëzuar ardhjes së Prokurorit të Gjykatës Speciale në Kosovë dhe pretendimit për të folur për raste të veçanta të vrasjeve apo të krimeve.

Mendoj se atë që e tha shefi i Grupit të LDK-së, kanë qenë në pushtet, kanë mundur t'i bëjnë, e kanë pasur edhe kryeministrin, të gjitha. Ndërsa, ata për Fatmir Limajn kanë qenë në koalicion për ta rrëzuar qeverinë herën e kaluar bashkë, tash janë prishur prapë flasin njëjtë.

Por ajo që është me rëndësi është që një rezolutë që ka ardhur a do ta zgjidh këtë problem apo jo. Për mua mund të them jo e plotë që mund ta zgjidhë një problem një rezolutë. Çështja e territorit nuk është çështje e një rezolute. Çështja e territorit është çështje e shtetit, është çështje e Kushtetutës, çështje e deputetëve, çështje e qytetarëve, çështje e popullit të Kosovës.

A mund ta zgjidhim dhe a duhet të bisedojmë? Ky Kuvend ka miratuar marrëveshje të ndryshme për normalizim me Serbinë. Këto marrëveshje i kanë mbështetur, përveç “Vetëvendosjes!”, thuajse të gjithë. E tani a duhet të ecet më tutje në këto marrëveshje? Unë besoj që po. Pa a duhet të jemi bashkë në këto marrëveshje? Mendoj që po. Po a duhet të harmonizohen? Po ashtu mendoj që po. E për të arritur deri te një pikë e përbashkët e shoh që nuk ka një gatishmëri. Po për të arritur te një dialog që duhet ta zgjidhë këtë çështje e shoh që po ashtu ka një gatishmëri, por jo në perceptione të njëjta.

Kushtetuta është elementi kryesor bazë i shtetit akt juridik. Brenda asaj Kushtetute e kemi Pakon e Ahtisarti, edhe bisedimet e Vjenës, edhe ato zona edhe ato ndihma që iu kanë lejuar Serbisë. Ky Kuvend në 2007 e ka miratuar atë Pako dhe tani e kemi këtë Kushtetutë me këto të mira dhe këto defekte që i ka.

Çështja e territorit a duhet të angazhohet Kuvendi? Mendoj që Kuvendi e ka fjalën e vet vendimtare edhe përfundimtare. Po kush duhet të angazhohet në këtë, Kushtetuta e përcakton mjaft mirë kush janë përfaqësuesit, cilët janë përfaqësuesit që duhet ta mbrojnë shtetin e

Kosovës. Po nëse hapet çështja e kufijve, nëse hapet çështja e territorit, a është e mjaftueshme vetëm Presheva, Medvegja e Bujanoci. Nëse është vetëm kjo pjesë, ne kemi luftuar për ta bashkuar, ne kemi një qëllim e kemi pasur një qëllim për bashkim dhe ai qëllim mund vijë.

Qëllimi për bashkim është, pikërisht nëse hapet çështja e kufijve besoj se shqiptarët në Maqedoni nuk do të rrinë. Nëse hapet çështja e kufijve po ashtu shqiptarët në Mal të Zi nuk do rrinë. Cili është ai që do t'ju thotë që ju nuk keni të drejta të bashkoheni. Mendoj që duhet t'ju jepet mundësi. Për t'ju dhënë këto mundësi të gjitha shtetet e dala nga Jugosllavia kanë shqiptarë. Edhe për këtë e mira e së mirës është të ketë një konferencë të ketë një Dejton që do t'i trajtojë të gjitha këto probleme edhe t'i zgjidh.

Ajo që është në rend të ditës sot nëpër botë edhe që ne merremi me çështje ndoshta shumë dytësore është krijimi i rendit të ri botëror, ku e krijojnë fuqitë e mëdha dhe janë duke i vizatuar hartat e botës, e ne po merremi me çështje mjaft dytësor. Për mua është që dialogu duhet të përfundojë. Dialog nuk duhet të bëhet me territorin e Kosovës. Dialog duhet të bëhet me Serbinë për Serbinë për territoret shqiptare atje edhe për t'i bashkuar ato me Kosovën.

Mendoj që kjo rezolutë që e ka sjellë këtu opozita është për t'u mbështetur, por jo edhe qëllimi i saj tendencioz jo i drejtë. Prandaj, krijoni një ekip që do ta përfaqësojë Kosovën, ta mbrojë Kosovën ashtu siç ka ditur ta mbrojë shumë herë në Rambuje apo edhe më këndeje. Prandaj, me rezoluta besoj që nuk do t'ia arrijmë po do t'ia arrijmë me aktivitetin politik që duhet ta mbrojmë shtetin tonë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti i fundit i paraqitur është Liburn Aliu edhe nuk ka deputetë tjetër. Më fal Liburn. Në qoftë se ka mundësi deputetë thërras në mënyrë publike edhe administrata zilja le të bie për arsye se tani propozuesi për seancë na jep edhe propozimin për draft-rezolutë, dhe pastaj shkojmë në votim.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Edhe në seancën e sotme është folur mjaft për unitetin. Pra, po kërkohet të ketë unitet dhe kjo është një shprehje jashtëzakonisht e mirë dhe unë mendoj që ka mundësi të bëhet. Është shumë i mundshëm uniteti. Po a është e ngutshme që tani të kemi patjetër vazhdimin të negociatave dhe të kërkohet unitet për këtë? Unë këtë e shoh totalisht të papranueshme dhe mendoj që duhet të kemi unitet për ta ndalur këtë dhe pastaj mund të flasim për unitet në aspektin tjetër.

Thaçi këmbëngul medoemos që ta gjejë një shteg që të fillojë patjetër negociatat tani. Fillimisht ai e përmendi ulësen në OKB e tash e përmend këmbim territorial apo siç e quan ai korrigjimin e kufirit. Po që se e shikojmë përvojën e deritanishme ne mund shumë qartë të besojmë që edhe ky

vazhdim i negociatave sikur të bëhej, do të ishte jashtëzakonisht i dëmshëm për Kosovën sikurse kanë qenë ato deri më tani.

Pra, nuk po dua të hyjë në detaje se çka ka ndodhur në të kaluarën, gjithë ato premtime edhe për njohje edhe për të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc edhe Medvegje, por po flas si rezultate që gjithmonë kanë qenë të dëmshme. Hajde që po e zëmë që të gjitha këto edhe pse kemi të drejtë të mos besojmë prapë ta zëmë që ndoshta Hashim Thaçi do të bënte diçka të duhur tani pas tërë atyre dështimeve. Po për ta besuar këtë unë publikisht pata kërkuar që Hashim Thaçi të bëjë një marrëveshje konkrete me përfaqësuesit politik të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjes.

Ta kemi ne të qartë për çka po flet. Kështu blanco mbështetje. Janë mashtruar shumë herë. Janë mashtruar shumë herë qytetarët atje. Pse do duhet t'i besojmë ne tash që ky tash paska për të bërë diçka. Pra, le të bëjë marrëveshje konkrete me ta e cila bazohet në referendumin e vitit 1992 të qytetarëve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjes dhe po ashtu në luftën e UÇPMB-së.

Mbi këto dy shtylla ta ketë një marrëveshje dhe atëherë ulemi e flasim. Kjo do të krijonte menjëherë mundësi që ne të ulemi dhe të flasim, por ja që një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe nuk besoj që ka për të ndodhur.

Nga ana tjetër, kur flasim për unitetin nëse do të flisnim për vazhdimin e negociatave çfarë është kërkuar këtu në vazhdimësi që të vazhdohet pra i tërë procesi i deritanishëm, atëherë nuk ka kuptim uniteti se është një proces tanimë i filluar. I filluar me dëme të shumta, ku shumëkush sot e pranon që ka qenë një proces i dëmshëm madje, madje edhe nga ndërkombëtarët. Madje edhe vet ideatorët e procesit negociator teknik të Brukselit e konsiderojnë si një proces të dështuar i cili nuk ka sjellë fare rezultate.

Pse? Sepse ka ndodhur pa ndodhur fillimisht njohja e Kosovës. Sepse ka ndodhur pa u bërë negociatat mbi bazat e reciprocitetit me Serbinë. Pra, pa njohje dhe pa reciprocitet çfarëdoj negociate me Serbinë sjellë marrëveshje çfarë i kemi pasur deri tani e të cilat do të jenë të dëmshme për Kosovën. Prandaj, është e domosdoshme që së pari këto negociata të deritanishme të ndalen. Të rishikohet i gjithë procesi i deritanishëm dhe të bëjmë presion për njohjen sepse mu tani në këtë moment edhe në faktorin ndërkombëtar ka shumë e shumë shtete ndërkombëtare të cilat sot i bëjnë presion Serbisë për njohjen e Kosovës, dhe pra është një moment jashtëzakonisht i rëndësishëm për ne.

E pse ne duhet të ngutemi tani në këtë moment kur e kemi një lloj përkrahjeje më të madhe se deri më tani, ne tash të bëjmë negociata të ngutshme t'i japim blanco përkrahje diku që ai të shkojë dhe të bëjë atje një marrëveshje të cilin pastaj do ta sjellë këtu në Kuvend me dëme të shumta sikurse kanë që deri tani.

Si duhet ta bëjmë këtë? Unë mendoj që është një moment kthese i rëndësishëm, meqenëse të gjitha negociatat e pas shpalljes së pavarësisë janë negociata të dëmshme dhe kjo tashmë po shihet botërisht, pa pasur një pikë reflektimi këtu nga të gjithë faktorët politik nuk mund të ndodhë çfarëdo lloj uniteti dhe nuk mund të ketë përparim.

E para, është marrëveshja e prillit 2013. Unë kërkoj nga subjektet politike këtu edhe nga Partia Demokratike edhe nga Lidhja Demokratike edhe nga Aleanca edhe nga të gjithë të cilët asokohe marrëveshjen e prillit 2013 e kanë votuar. Fillimisht më kujtohet LDK-ja nuk e ka përkrahur, por pastaj e ka votuar. Tani është momenti kritik që ne të bëjmë një reflektim mbi atë marrëveshje. Aty është themeli i asaj që sot të gjithë po thonë tash rreziku i krijimit të Bosnjës. Atë rrezikun e krijimit të Bosnjës ne e kemi përmendur më herët. Kemi thënë vazhdimisht, madje edhe kur është votuar marrëveshja e prillit në 2013 ne kemi qenë kundër. Dhe aso kohe kemi thënë që kjo do ta bosnjëzojë Kosovën. Tani që po shihet kjo, tash është momenti i reflektimit dhe i tërheqjes pikërisht nga kjo pikë.

Subjektet politike duhet të reflektojnë mbi këtë marrëveshje. Të dalin dhe të thonë të jenë kritik nga marrëveshja e prillit 2013. Ky do të jetë moment historik i kthesës tek ne dhe për të vazhduar negociatat duhet që fillimisht të ndodhë njohja e Kosovë dhe negociatat të ndodhin mbi baza të reciprocitetit.

Kohëve të fundit nëse është përmendur këmbimi i territorial edhe ka pasur qarqe në Serbi, madje edhe vet Presidenti i Serbisë që e ka përmendur çështjen e këmbimit territorial është hapi i parë, është një rast ndryshe nga cilado negociata deri tani kur Serbia flet në njëfarë mënyrë për reciprocitet. Pra, paska çështje të shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. E nëse ka çështje të shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës të gjitha negociatat që janë bërë deri tani, janë bërë pa i përfillur fare të drejtat e atyre atje. Pra, pa i përfillur të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë. Prandaj janë negociata dhe marrëveshje të padrejta të cilat duhet të hidhen poshtë, duhet të shikohet një lloj reflektimi nga të gjithë këtu. Të vendoset tash një bazë reciprociteti me Serbinë dhe nëse ulemi e flasim me ta, flasim si forca të barabarta ku ata do ta njohnin fillimisht Kosovën dhe do të kishim marrëdhënie të plotë reciprociteti.

Në këtë rast të drejtat e shqiptarëve të Preshevë, Bujanocit dhe Medvegjës do duhej të ishin si pikë e parë në tavolinë dhe kjo duhet jetë kusht para negociatave dhe jo të shpresojmë që pasi që të fillojnë ato të bëhen pikë. Pra, këtë rezolutë natyrisht që duhet ta votojmë. Kjo është si pikë e nisjes që mund të ndërpriten këto negociata të deritanishme, po pastaj krijohet mundësia që të reflektojmë të gjithë bashkë dhe të ndërtojmë unitet për njohjen e Kosovës, për reciprocitet me Serbinë dhe fillimisht për hedhjen poshtë të marrëveshjeve të deritanishme, duke filluar edhe nga marrëveshja e prillit 2013. Faleminderit!

Diskutim i dorëzuar me shkrim

LIRIJE KAJTAZI: Shqetësimet për mundësinë e devijimit të dialogut me Serbinë si duket ishin të arsyeshme dhe rezervat tona si grup parlamentar i LDK-së që në fillimet e këtij procesi gjithnjë po vërtetohen kur kihet parasysh rrjedhoja e ngjarjeve të cilat ndodhën në vazhdimësi, dhe çdo ditë që ka kaluar deri tani ka provuar se “dialogu teknik”, i filluar me Serbinë, ishte një kamuflim i fillimit të procesit të një dialogu të pastër politik.

Ky është fakti i parë që kryeministrin e atëhershëm dhe presidentin e tanishëm e Hashim Thaçi e privon nga e drejta për t’u marrë me tutje me këtë proces, pasi nga rrjedha e procesit del se ai e ka mashtruar Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe popullin e Kosovës. Një president mashtrues nuk ka kredo ta përfaqësojë shtetin në bisedime me një shtet armiqësor, siç është Serbia.

Prërkujtimi dhe degradimi deri në këtë nivel i bisedimeve politiko-teknike me Serbinë është rezultat i atyre që me paratë e taksapaguesve kosovarë e dizajnuan keq mënyrën e bisedimeve me Serbinë si shtet armiqësor i Kosovës, i cili nuk ka hequr dorë nga pretendimet që ta pushtojë këtë vend dhe ta shfarosë këtë popull.

Deri tani nga dialogu ka përfituar vetëm Serbia, e cila së pari e fitoi statusin të kandidatit në BE, së dyti fitoi kohë për konsolidim të brendshëm politik dhe ekonomik, së treti krijoi iniciativë në planin ndërkombëtar për t’i penguar njohjet e Kosovës, dhe së katërti e krijoi instrumentin e sabotimit të institucioneve të Kosovës - Listën Srpska.

Kjo hapësirë e krijuar nga Serbia për manovrim politik-diplomatik në dëm të Kosovës po vërehet gjithnjë e më shumë në përditshmërinë tonë. Shto këtu edhe devijimet e mëdha të kësaj qeverie me shumë ministra e zëvendësministra, e me skandale të përditshme, kanë krijuar efekte psikologjike negative në popullatën e Kosovës; kanë ulur në minimum besimin ndaj institucioneve tona shtetërore, e kanë venitur perspektivën e popullatës në këtë vend, e kanë krijuar një klimë të pakënaqësisë popullore që është me rrezik për vendin.

Ky është realiteti ynë, ky nuk është një realitet i shikuar nga prizmi opozitar, ky është një realitet i matur nga përditshmëria qytetare.

Ne me kohë kemi tërhequr vërejtjen që temat që duhet të bisedohen me Serbinë të jenë thjesht teknik dhe humanitare. Të jenë tema që bisedohen me një shtet armiqësor, të jenë tema që shpërfaqin natyrën e vërtetë të klasës politike dhe shtetit serb si një vend që ka pasur plane për shfarosjen e një populli, dhe si një vend që mban në territorin e vet persona civilë, fëmijë, gra e pleq të kidnapuar në shtëpitë e tyre, fati i të cilëve edhe pas 20 vjetëve nuk dihet.

Nga ky dizajnim i keq i bisedimeve, i atyre që i filluan keq këto bisedimeve, ne kemi ardhur në gjendjen ku presidenti aktual i vendit, institucioni kryesor i vendit që është i thirrur për ta mbrojtur sovranitetin, integritetin, tërësinë territoriale të vendit, publikisht në fillim thotë: “Kompromisi do të jetë i dhimbshëm për Kosovën”, pastaj “Do të ketë këmbim terriresh”, pastaj “korrigjim të kufirit”, për të ardhur deri te “bashkimi i Luginës së Preshevës”, pa treguar se cila do të jetë kundërvlera.

Të arrish në këtë pikë, pasi shteti ka marrë njohjen ndërkombëtare të mbi 115 vendeve, njohjen nga superfuqitë botërore, pasi një gjykatë ndërkombëtare ka vërtetuar se Kosova e ka shpallur pavarësinë sipas procedurave dhe rendit të së drejtës ndërkombëtare, të arrish në këtë pikë kur sigurinë nga agresioni i jashtëm e bën aleanca më e fuqishme ushtarake e botës..., në radhë të parë është papërgjegjësi dhe injorancë, të tjerat do t'i lë që në dritë t'i nxjerrë koha. Shpresoj shumë të jem e gabuar në atë që mendja më shkon.

Ata që kanë qenë pjesë e aktiviteteve politike që në fillim të shpërbërjes së Jugosllavisë, i është i njohur opsioni i ndarjes së Kosovës, dhe që atëherë ai është kuptuar si hile e Serbisë. Gjithashtu edhe kërkesa e vazhdueshme e palës serbe për ta shmangur faktorin ndërkombëtar nga bisedimet eventuale me Kosovën, pasi kjo konsiderohej si çështje e brendshme e Serbisë. Dhe çuditërisht presidenti Thaçi pas 20 vjetëve bie në këto agjenda, ai në Austri, dhe sikur sot në Bjellorusi vazhdon të thotë: “Na lini, ju lutem, vetëm mua dhe Vuçiqin...”

Dhe, që atëherë diplomacia jonë e udhëhequr nga presidenti Rugova arriti ta thyjë këtë teori, sepse ajo ishte hilja që në procesin përfundimtar të shpërbërjes së Jugosllavisë të thyhej rendi konstitucional që Kosova kishte në Federatën jugosllave, që faktikisht ishte baza mbi të cilën GJND-ja vendosi në favor të Kosovës. Dhe, tani të besosh se Serbia të falë Luginën e Preshevës, ndërkohë që mban që 20 vjet trupat e 1600 shqiptarëve të kidnapuar në shtëpitë e tyre, është absurditet.

Efekti më i keq i krijuar nga ky format i bisedimeve është fakti se ne tani si politikanë, si media, dhe si popull kemi filluar ta krijojmë diskursin e ri, ose t'i paraprijmë krijimit të diskursit për ndarje të Kosovës, i cili është antikushetues, është armiqësor, është shkatërrues për Republikën e Kosovës, për jetën e saj si shtet i pavarur. Është përdhunim i gjakut të derdhur të mbi 12 mijë shqiptarëve të vrarë kryesisht me torturë nga shteti i Serbisë.

Këto që po i them nuk janë imagjinare, edhe një herë po them se nuk janë të shikuara nga prizmi opozitar; në çështje si këto më së paku gjërat i shikoj nga prizmi opozitar. Këto që po i them fatkeqësisht janë reale, dhe ne si deputetë, si forca politike duhet t'i parandalojmë, duhet ta gjejmë modusin për ta vënë në rrugën e duhur lëvizjen e shtetit të Kosovës.

Në këtë stad ku gjërat kanë arritur, ne me shpejtësi duhet të veprojmë, në radhë të parë për ta ndërruar formatin e bisedimeve, për ta kthyer atë në rrugën e natyrshme që është në favor të Kosovës. Mendoj që këtë format nuk mund ta ndryshojë ky format i kombinimit që qeveris vendin. Së pari, ky format qeverisës, përpos që ka grumbulluar në Qeveri militantë partiakë, ka dëshmuar se nuk ka kapacitete për ta lëvizur vendin as një centimetër në drejtim të zhvillimit ekonomik, që është qenësor për t'i ndenjur karshi një vendi armiqësor; së dyti, ky format qeverisës i varur nga subjekti politik Lista Srpska, që është instrument i Serbisë në realizimin e qëllime armiqësore kundër Kosovës, nuk mund ta garantojë proces normal të zhvillimit politik në vend, dhe për rrjedhojë edhe dialog me Serbinë në dobi të Kosovës.

Prandaj, e vetmja mënyrë që në të jemi në nivelin e detyrës është që si deputetë, si forca politike, të dialogojmë sesi ta dërgojmë vendin në zgjedhje në mënyrë të kontrolluar, për t'i minimizuar efektet shkatërruese të Serbisë nëpërmjet instrumenteve të saj.

Mendoj se mënyra më e mirë është që bisedimet të ngrihen, të bëhet urgjentisht një ligj i ri zgjedhor, pastaj vendi të shkojë në zgjedhje.

KRYETARI: Faleminderit! Tani nuk ka asnjë deputetë për debat. Edhe njëherë po pyes në qoftë se ka dikush për arsye se...Nuk ka asnjë deputetë edhe njëherë po e konstatoj. Atëherë ftoj propozuesin e çështjes zotërinë Avdullah Hoti për ta paraqitur propozim-rezolutën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit kryetar i Kuvendit!

Më lejoni të paraqesë rezolutën e përgatitur nga Grupi Parlamentar i LDK-së, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje!” dhe deputetët e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila dhe Ilir Deda.

Duke i marrë parasysh rezolutat e Kuvendit të Kosovës të datave 10 mars 2011, 28 korrik 2011, 18 tetor 2012, 6 qershor 2013 dhe 26 dhjetor 2016. Duke e marrë parasysh që nuk kemi ende një debat dhe vlerësim mbi dialogun e mëparshëm me Serbinë gjatë viteve 2011-2017 përfshirë këtu raportin e Qeverisë së Kosovës të datës 9 korrik 2018 mbi arritjet dhe sfidat e marrëveshjeve të këtij dialogu. Duke e marrë parasysh nevojën për debat e konsensus të brendshëm para fillimit të dialogut me Serbinë.

Duke e marrë parasysh se nuk kemi formulim zyrtar e institucional të kërkesave të Republikës së Kosovës për Republikën e Serbisë e cila nuk e njeh pavarësinë e Republikës së Kosovës dhe është përgjegjëse për humbjet, dëmet dhe vuajtjet që i ka shkaktuar popullit të Kosovës gjatë okupimit dhe luftës.

Të vendosur për ta ruajtur dhe mbrojtur shtetësinë dhe pavarësinë, sovranitetin dhe kushtetutshmërinë, integritetin territorial e institucional të Republikës së Kosovës. Të përkushtuar për integrim dhe anëtarësim të Republikës së Kosovës para së gjithash në BE,

NATO dhe OKB. Të angazhuar për fqinjësi të mirë me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimorë, përfshirë këtu Republikën e Serbisë. Në dijeni për shqetësimin e popullsisë për tensionimet e mundshme, përfshirë këtu praninë dhe aktivitetin e shtuar të xhandarmërisë serbe në komunat; Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. Duke e marrë parasysh që nuk kemi një qëndrim apo vendim të përbashkët për parimet, agjendën dhe formatin e dialogut të ri me Serbinë.

Duke e marrë parasysh që Presidenti i Republikës së Kosovës zoti Hashim Thaçi pa një mandat paraprak nga Kuvendi i Republikës së Kosovës tashmë ka diskutuar me homologun e tij nga Serbia çështje që lidhen me integritetin territorial të Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 61.1 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 44 paragrafi 4 pika D të Rregullores së Kuvendit, pas debatit parlamentar të mbajtur në seancën e jashtëzakonshme të datës 31 tetor 2018, miraton këtë:

R E Z O L U T Ë

Territori i Republikës së Kosovës është një dhe i pandashëm dhe se as presidenti e askush tjetër nuk ka mandat të negociojë për territorin e Republikës së Kosovës.

Unë ju falënderoj për vëmendjen për debatin dhe ju ftoj të gjithëve që ta miratojmë këtë rezolutë.

KRYETARI: Faleminderit! Propozuesi e ka paraqitur propozim-rezolutën. Në princip, zakonisht në raste të tilla jemi munduar çdoherë që të kemi edhe qëndrimet e grupeve parlamentare. Tash do tua japë fjalën. A është krijuar harmonizim. Po unë ua jap fjalën grupeve parlamentare. LDK-ja a mund të konstatojë se Lëvizje “Vetëvendosje!”, LDK-ja edhe Alternativa kështu ishte. Ishin bashkë në propozim. Po. Atëherë urdhëro Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca dhe Nisma qëndrimin.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Fillimisht e përshëndesim debatin në lidhje me këtë çështje edhe pse mund të konstatohet lehtësisht që më së paku u debatua për temën për të cilën është folur, më së shumti është diskutuar për presidentin e Kosovës. Sidoqoftë, e drejta e fjalës është e secilit. Unë e kisha të paqartë këtë që e bëri kolegu Avdullah Hoti tash në fund, sepse qysh në fjalën time në emër të grupit parlamentar dhe në emër të koalicionit propozova disa pika për një rezolutë të përbashkët.

Dhe ka qenë jo vetëm vullneti i mirë i përfaqësuesve i deputetëve në fakt të koalicionit qeverisës që kemi ardhur bashkërisht në këtë seancë që është planifikuar që prej 4 shtatorit. Që të gjejmë një mundësi për të arritur një pajtueshmëri apo një konsensus në lidhje me çështjen e dialogut. Dhe qysh në fillim thamë që shpresojmë që edhe vullneti i opozitës i shprehur publikisht do të jetë i singertë për ta arritur një konsensus dhe nuk do të jetë një formë e kushtëzimit merre ose leje, për çka situatën e njëjtë e kemi pasur deri më tash.

Nëse nuk ekziston vullneti për ta dakorduar rezolutën me pikat të cilat unë sot i kam lexuar, atëherë unë besoj që kjo është një mënyrë e qëllimshme e pamundësimit të daljes nga situata aktuale. Po ashtu nëse nuk refuzon që ta diskutojë që të ulemi bashkërisht shifat e grupeve parlamentare ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare për ta diskutuar një rezolutë të përbashkët gjithëpërfshirës, atëherë unë kisha kërkuar nga kolegët e opozitës të na tregojnë cilat pika janë të papranueshme për ta nga pikat që ne i kemi propozuar. Dhe ne nuk kemi propozuar rezolutë. Ne kemi propozuar pika për rezolutë.

Deri tash, dhe jo vetëm këtë legjislaturë, por gjithmonë praktika e Kuvendit të Kosovës ka qenë që para përfundimit të diskutimeve, përfaqësuesit e grupeve parlamentare të mbledhen dhe të diskutojnë pavarësisht se cila është tema, dhe të tentojnë të arrijnë një harmonizim. Kjo sot nuk ka ndodhur, sepse ne pritëm që iniciuesi do ta ndërmarrë një hapë të tillë. Jam i befasuar me mungesën e kësaj iniciative. Shpresoj që nuk është e qëllimshme.

Ne do të ishim të gatshëm që për një gjë të tillë të takohemi edhe sot edhe nesër edhe kurdo qoftë. Sepse mendojmë që një rezolutë e Kuvendit të Kosovës duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe të trajtojë të gjitha çështjet, të cilat i kemi diskutuar sot.

Ne kemi propozuar që të flitet për qëllimet e Kosovës në këtë dialog duke përfshirë njohjen e ndërsjellë me Serbinë edhe anëtarësimin në OKB për shpejtimin e procesit integruar në NATO dhe në Bashkim Evropian. Kemi thënë që Kuvendi duhet ta ketë rolin qendror dhe vendimtar. Unë nuk besoj që ka deputetë që është kundër kësaj, që ta specifikojë që asgjë nuk është e vlefshme pa u miratuar me 2/3 këtu, dhe që Kuvendi duhet të punojë për platformën e përbashkët që i përshinë parimet themeltare deri te ato që i kemi quajtur vija të kuqe.

Kemi kërkuar që të themelohet një komision i veçantë i Kuvendit meqenëse është e drejtë opozitës të vendos se a do që të marrë pjesë apo jo në ekip. Dhe, ata që po deklarohen se janë për dialog dhe nuk duan të jenë pjesë e ekipit besoj nga deklaratimet publike të tyre kemi ardhur në këtë përfundim. Mund të jenë pjesë e një komisioni që e mbikëqyrë ekipin e propozuar nga Qeveria. E kemi obliguar ekipin e Qeverisë që t'i raportojë Kuvendit sipas propozimit tonë në baza të rregullta. Dhe po ashtu kemi thënë që përveç territorit nuk diskutohet as për karakterin unitar të shtetit tonë.

A ka dikush që është kundër që të ruhet karakteri unitar, sepse nëse ka të tillë që janë kundër i bie që duan ta krijojnë Asociacionin me kompetenca ekzekutive. Atëherë, po e përfundoj duke thënë; të ulemi bashkë kur të doni sonte, nesër, në mëngjes. E kemi edhe seancën vazhdimin pas kësaj që sot se besoj që vazhdon, por nesër nëse e vendosni. T'i diskutojmë këto pika.

Ka edhe pika të tjera që janë diskutuar ose që janë përsëritur qëndrimet ndryshme gjatë këtij debati dhe të arrijmë në harmonizim e një teksti që i përfaqëson në përgjithësi qëndrimet e

shumicës nëse jo të të gjithëve. Edhe ta qesim për votim me shpresën që mund t'i marrë jo vetëm shumicën po pse jo edhe 2/3 e deputetëve gjë që është vërtetë e realizueshme sa na përket neve nëse opozita e ka më të vërtetë qëllimin që të arrijmë diçka të përbashkët dhe jo ta shfrytëzojë për një konsum ditor politik, çështjen e këtij debati të sotëm. Të thotë; ne e qitem këtë e nuk e votuam, sepse atëherë edhe ne do të themi se edhe ne i qitem gjashtë pika po ju nuk i votuat, edhe mbetemi në një rrugë pa fund, duke mos i ofruar zgjidhje as Kosovës as qytetarëve në lidhje me çështjen e dialogut, por duke e vazhduar kryeneçësisht garën e inateve politike që kaq muaj janë duke e lënë vendin në ngecje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ahmet Isufi, urdhëroni!

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Sot u fol për temën e cila ka të bëjë me dialogun mes Kosovës edhe Serbisë edhe çështjen e territorit të Kosovës. Prandaj, të gjitha tjerat që u thanë përjashto ato që ishin jashtë kësaj teme, shihet që edhe pozita edhe opozita kanë një qasje, prandaj duhet harmonizim i qëndrimeve të grupeve parlamentare. Të bëjnë një rezolutë të përbashkët me pikat të cilat jemi dakorduar që duhet të jenë themelore edhe e votojmë.

Kjo mund të bëhet edhe një ditë tjetër nuk është e thënë që sonte meqë e kemi edhe debatin që ka zgjatur shumë, dhe duhet me kokë të kthjellët të harmonizohen qëndrimet të nxirret rezoluta edhe të votohet. Faleminderit!

KRYETARI: Keni parasysh në fund duhet përmbledhja e propozuesit, pastaj vendoset seanca. Urdhëro, Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Tash debati këtu në Kuvend përfundoj e vazhdojmë të zhvendoset në studio televizive nga ora 20:30. Nuk ka përfunduar krejt veç zhvendoset. Besoj që shumica apo një numër i madh i deputetëve jemi të ftuar e vazhdojmë atje.

Ajo që unë desha ta them është që po të isha unë në vendin e opozitës edhe dhjetë pika të tjera mazhorancës do t'ia pranoja në rezolutë veç ta fus që territori i Kosovës është i panegociueshëm dhe i padiskutueshëm. Edhe dhjetë të tjera do t'i kisha pranuar... Sikur të isha në vendin e tyre, po nuk jam në vendin e tyre dhe kërkoj që në procesin e harmonizimit që jo sonte, por nesër se nëse e harmonizojmë sonte bien debatet. Çka të flasim atje? Si ta shajmë njëri-tjetrin nëpër debate? Atëherë nesër të vazhdojmë me harmonizim të kësaj dhe le të na tregojë se cilat janë ato pikat të papranueshme të mazhorancës.

Sepse ne pranuar, kërkesë e opozitës është në propozimin e përbashkët të partive të mazhorancës është aty. Territori i Republikës së Kosovës është i pandryshueshëm dhe i

panegociueshëm, shtojmë edhe terme të tjera të cilat e hermetizojnë këtë çështje pa asnjë problem, por le të dalim nga zhargoni i asaj se çka nuk duhet të bëjmë dhe të fillojmë të flasim çka duhet të bëjë ky vend. Çka duhet të bëjmë ne si deputetë dhe si duhet të ecim përpara.

Shpresoj që pasi të kemi kryer debatet televizive nesër do të mund të ulemi dhe të shohim sesi mund të arrijmë tek një rezolutë e përbashkët siç ka qenë traditë, harmonizimi i imputeve siç është bërë zakon të thuhet nga të gjitha grupet parlamentare, mirëpo në asnjë mënyrë që të iket nga esenca e kësaj. Cila është esenca e krejt këtij debati që procesi i ardhëm i dialogut në asnjë mënyrë nuk guxon të përfundojë në dëm të Kosovës. Por, për ta arritur këtë qëllim nuk besoj, së paku është parë që asnjëra nuk i mjafton vetvetes.

Mazhoranca ka nevojë për opozitën, opozita ka nevojë për mazhorancën. Nëse e pranojmë këtë fakt, atëherë mund të ulemi dhe të gjejmë një zgjidhje të përbashkët. Nëse nuk pranojmë këtë fakt dhe vazhdojmë të themi; opozita njëherë zgjedhje pastaj dialogu, pra asgjë në përmbajtje nuk dallojmë, por njëherë zgjedhje pastaj dialogu, pra asgjë në përmbajtje nuk dallojmë, por njëherë zgjedhje pastaj dialogu dhe mazhornaca thotë jo, jo gjithsesi tash dialog dhe pas dialogut zgjedhjet, atëherë do të mbesim në këto pozicione dhe asnjëra nuk mund të lëvizë përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kemi filluar pas orës 10 tani është ora 20. Ky është epilogu i kësaj situate. Propozues të projektrezolutës a pranoni që të uleni bashkërisht ta harmonizoni a dëshironi të shkoni në votim? Dëshironi të shkoni në votim edhe pse ta them pjesën tjetër, ka një mungesë serioziteti vet fakti...Tash do ta konstatojmë po është iniciuar nga opozita ka pak deputetë edhe pozita ka pak deputetë. Ky është një realitet. Vetëm ta marrë edhe gjendjen sa deputetë janë, 58, 54 deputetë imagjinoni.

Imagjinoni i kemi maltretuar qytetarët me seriozitetin tonë për kufirin. Urdhër Avdullah Hoti, kryetar i grupit parlamentar. Që ta drejtojë për arsye se pas kësaj pastaj në qoftë se shkojmë në votim. Jo konstatojeni, unë e konstatoj të mbyllur diskutimin, shkojmë vetëm në votim mbetet. E kam hallin pastaj pas kësaj seance, kjo është.

AVDULLAH HOTI: Duke qenë se nuk ka kuorum sonte për ta nxjerrë në votim këtë rezolutë, unë propozoj që nesër në fillim të seancës ta nxjerrim në votim. Më lejoni të konstatoj që nga të gjitha diskutimet gati pa përjashtim askush nuk tha diçka që bie në kundërshtim me këtë pikë të rezolutës që ne e kemi propozuar si opozitë.

Më lejoni ta kryej!

KRYETARI: Vazhdo, ju e keni fjalën.

AVDULLAH HOTI: Pra, askush nuk është kundër kësaj pike të rezolutës, të gjithë janë për. Bashkë me këtë kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së sot i lexoi edhe gjashtë pika të tjera. Mirë, unë ju ftoj që të bëhemi bashkë ta votojmë këtë rezolutë që e kemi propozuar ne si opozitë. Këto pika që i keni nxjerrë ju, të nënshkruajnë 62 deputetë që jeni në koalicion qeverisës edhe dërgojani opozitës do ta shqyrtojmë me kujdes, po së pari duhet ta nënshkruajnë 62 veta si deputetë të opozitë e mandej ne mund të ulemi të diskutojmë propozimin e pozitës.

Prandaj, kryetar ju kisha lutur që këtë pikë ta shtymë...Nesër pra të jetë pikë e parë e rendit të ditës dhe të hedhet në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe njëherë, vetëm pak. Të nderuar kolegë deputetë, ka të bëjë proceduralisht vetëm pak. Propozuesi, ju thoni që të shkojmë në votim. Ta shtymë për nesër apo të shkojmë në votim? Do të thotë hapësira për konsensus nuk ka. Për arsye se... Vetëm pak, më falni. Unë e ka, proceduralisht, nuk e kam hallin çka po ndodh. Politikisht e mbaj qëndrimin tim. Vetëm ta konstatoj, nuk do të ketë përpjekje më për konsensus për votim për arsye se edhe kështu nuk janë 61 deputetë.

Vetëm edhe njëherë që të jem korrekt, pastaj të mos thuhet që kryetari i Kuvendit nuk po e sjellë që të harmonizohet. Si është qëndrimi?

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Unë kërkoj që nesër të jetë pikë e parë e rendit të ditës, të hedhet në votim. Deri nesër përpara se ta nxjerrim në votim, para së të fillojë seanca në orën 10, ne mund të ulemi të diskutojmë, por insistimi ynë si propozues është që kjo të hedhet në votim. Pro, ne mund të ulemi nesër prapë ta diskutojmë bashkë.

KRYETARI: Faleminderit shumë! Sa deputetë janë sallë? 51. Nuk ka kushte për ta vënë në votim sipas propozuesit. Nesër do të kemi nga ora 10 Kryesia ka përcaktuar seancë të re plenare. Do të shikojmë, vazhdojmë me këtë seancë, vazhdojmë me seancat e parapara nga Kryesia në votim pastaj vazhdojmë edhe me seancën e rregullt.

Mirupafshim nesër, në orën 10:00! Faleminderit!

* * *

E enjte, 1 nëntor 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 31 tetor 2018

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Zonja dhe zotërinj deputetë,

Po e fillojmë seancën,

Në sallë janë 66 deputetë, kemi kuorum të mjaftueshëm për t'i vazhduar punimet e seancës së djeshme dhe pastaj për ta vazhduar seancën që ka mbetur më herët.

Ka ngelur sipas diskutimeve të mbrëmshme që të bëhet harmonizimi i Projektrezolutës të propozuar nga 42 deputetë përfaqësues, nuk është me rëndësi sa.

Atëherë, në qoftë se nuk dëshiron dikush ta marrë fjalën nga grupet parlamentare, propozoj që kryetarët e grupeve parlamentare ta marrin një gjysmë ore kohë, e ne të vazhdojmë me punimet. Të shkojnë N/10, salla është e lirë për harmonizim. Fjalën e ka kërkuar zoti Hoti, si propozues i projektrezolutës.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Dje mbaroi seanca ashtu si mbaroi pa kuorum të nevojshëm për ta votuar këtë rezolutë në shenjë tregimi të vullnetit të opozitës që ne mund të ulemi dhe të bisedojmë. Ne mund ta dakordojmë për 15-20 minuta, të ulemi me shefat e grupeve parlamentare, por ngjarjet që ka ndodhur dje në Gjermani e bëjnë urgjente që kjo rezolutë të kalojë sa më parë. Por, sido qoftë, le të dakordohemi që në orën 11:00, pra pas këtij konsultimi, të dalim në votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Krasniqi, a jeni dakord të dilni apo si e keni mendimin ju si grup parlamentar?

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Edhe sot normalisht që e përsëris qëndrimin tonë të qartë dhe konsistent që për sa i përket çfarëdo lloji rezolute që ndërlidhet me çështjen e dialogut. Ne besojmë që duhet të jetë një rezolutë gjithëpërfshirëse që i trajton të gjitha çështjet relevante dhe besojmë që kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet harmonizimit të qëndrimeve të diskutuara dhe të shprehura gjatë ditës së djeshme dhe po ashtu të shprehura edhe nga ne si koalicion, por edhe nga opozita. Besoj që kjo është e vetmja rrugë që mund vërtet ta nxjerrë një dokument që do të jetë korniza kryesore që do ta drejtojë delegacionin e Kosovës dhe shtetin e Kosovës në fazën finale të dialogut me Serbi, kështu që besoj duhet ta provojmë, ta gjejmë këtë harmonizim dhe dakordim sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca, a keni ju ndonjë qëndrim, ose a jeni dakord me harmonizimin?

GLAUK KONJUFCA: Po, zoti Haliti, kemi qëndrim.

KRYESUESI: Jo, a doni të dilni ta harmonizoni, a çka doni...?

GLAUK KONJUFCA: Po, gjithsesi!

Këtu u pa edhe dje shumë qartë që dallimi është evident, ose do të jemi në këtë pikë për ta mbrojtur interesin shtetëror, ose do ta mbrojmë verbërisht presidentin e Kosovës.

Tash kushdo që e ka përcjellë seancën e djeshme e di pak a shumë edhe rezultatin e votimit.

Mua më është dukur mazhoranca e barrikaduar në pozicionin e saj që të shkojë në faza të mëtutjeshme për të krijuar platformë, për të krijuar ekip bashkë me presidentin dhe presidenti të na përfaqësojë në dialogun me Serbinë.

Me këtë opsion nuk pajtohet opozita, kështu që jemi në pozicionet e mëparshme ku kemi qenë.

KRYESUESI: Faleminderit! PSD-ja, zoti Sejdiu?

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderur përfaqësues të mediave,

Ajo çka u shpërfaq dje në seancë ishte e qartë që ka mendime dhe hapësirë për të shtuar në këtë rezolutë pika tjera, bile edhe parafolësi im i dha disa shtesa dje gjatë diskutimit të tij. Kështu që besoj që duhet dhënë hapësirë diskutimit për ta harmonizuar këtë rezolutë.

Pra, ne e kemi përkrahur këtë rezolutë edhe me nënshkrime herën e parë, kur është sjellë në Kuvend. Nuk kemi asgjë kundër tekstit të kësaj rezolute, porse ta keni parasysh që e kemi paraqitur një rezolutë që ne mendojmë gjithashtu që ka përmbajtje në të dhe do të ishte mirë që të kishte shtesa në këtë rezolutë.

Rrjedhimisht, si PSD jemi që shefat e grupeve parlamentare të ulen, ta harmonizojnë tekstin me shtesa dhe të tillë ta sjellim në seancë për votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Isufi, urdhëro!

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Dihet që çdo rezolutë ose vendim që duhet ta marrë Parlamenti kërkon konsensusin e të gjitha grupeve parlamentare. Prandaj, të mos barrikadohet askush në këtë çështje, por përkundrazi ta harmonizojmë rezolutën bashkë, ta votojmë bashkë dhe të tregojmë që vërtet e kemi njëmend për

ta pasur një rezolutë, e cila e çon delegacionin e Kosovës në bisedime dhe Kosova fiton. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Po, edhe ne jemi të gatshëm që ulemi dhe ta shohim mundësinë e harmonizimit të rezolutës së bashku me propozuesit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, i kisha lutur kryetarët ose të ngarkuarit e grupeve parlamentare që të shkojnë. Grupi 6+ nuk është paraqitur... Shtype, o Damka! Zoti Damka, në emër të 6+.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar 6+ është për një koordinim dhe që të harmonizohet teksti, edhe ne jemi për.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë ju kisha lutur që ne kemi mundësi ta marrim ta marrim një pauzë prej 20 minutash që ta kryeni, ose të vazhdojmë t'i votojmë çështjet që kanë ngelur për votim, si të doni.

Atëherë, ju kisha lutur përfaqësuesve të grupeve parlamentare që të shkoni dhe të bisedoni dhe t'i harmonizoni në qoftë se mund të arrini, salla 90 është e rezervuar për ju.

Ne po marrim pauzë 20 minuta si parlament. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Atëherë të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,
Po vazhdojmë me seancën e filluar. Në sallë janë 62 deputetë, besoj që. Zoti Hoti mund të paraqesë atë që janë marrë vesh ose s'janë marrë vesh e besoj edhe përfaqësuesit e grupeve të tjera. Zoti Hoti e keni fjalën, pastaj shohim.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit kryesuesi i Kuvendit!

Të gjitha grupet parlamentare diskutuam për të parë nëse mund të arrijmë ndonjë dakordim. Nuk kemi arritur të dakordohemi. Megjithatë, si propozues i kësaj rezolute, ne kemi shprehur gatishmërinë që pikën 6 të rezolutës të propozuar nga PDK ta riformulojmë bashkë me pikën tonë të rezolutës dhe të duket kështu si po e lexoj tash.

Pra, ky është prapë propozimi ynë, i propozuesit, të jetë pikë e tillë:

R E Z O L U T Ë

Kuvendi i Republikës së Kosovës rithekson se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, sovraniteti shtetëror, integriteti territorial dhe karakteri shtetëror unitar i Republikës së Kosovës janë të pacenueshme. As Presidenti dhe askush tjetër nuk ka të drejtë të negociojë për territorin e Republikës së Kosovës.

Pas diskutimeve, ne si propozues jemi të gatshëm që këtë ta hedhim në votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Hoti do të ishte mirë që t'ia jepni atë të shkruar sekretarisë që deputetët në qoftë se e kërkojnë, ta kenë. Në qoftë se e kërkojnë, në qoftë se jo, për mua është në rregull.

Zoti Memli Krasniqi, në emër të përfaqësuesit të PDK-së dhe kryetarit të grupit.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Vërtet ne u takuam dhe them me keqardhje që nuk pati vullnet që të arrijmë një dakordim. Insistimi që të ketë vetëm një pikë rezolute dhe të mos merren parasysh propozimet e koalicionit, pra po e përsëris të koalicionit sa për përmirësim të zotit Hoti, jo vetëm të PDK-së, realisht neve na e pamundësoi nga situata që ishte edhe dje, nga kushtëzimi që ose të votohet një pikë ose fare. Ne e kishim të paqartë se cilat pika, se ne nuk kemi propozuar rezolute dje. Kam qenë i qartë në fjalën time dhe kolegët po ashtu që ne kemi propozuar pika për rezolutën që del nga debati. Unë nuk besoj që ka arsye të mos përfshihen e aq më pak të mos votohen pikat të cilat i kemi propozuar dje, sepse ato ndërlidhen edhe më shumë me procesin, flasin edhe më shumë për atë

çka duhet të bëhet në fazën e ardhshme dhe jo vetëm për atë çka s'duhet bërë, i jep apo e rishpreh edhe njëherë rolin qendror, vendimtar dhe të patejkalueshëm të Kuvendit të Kosovës me të gjithë hapat që e presin këtë proces dhe kështu me radhë.

Unë e shpreh edhe mendimin tim personal që është për keqardhje që pas një debati të gjerë dhe të gjatë, kryesisht korrekt, shumë herë edhe jokorrekt, dhe shumë 'ad hominem' dje, megjithatë ne arritëm ta përmbyllim këtë diktum. Ne si koalicion dolëm nga situatat e bunkerizuara që na kanë përcjellë dy muaj dhe përkundër asaj që data 4 shtator nuk u mbajt asnjë seancë, ne erdhëm dje në seancën e jashtëzakonshme të opozitës, jo për t'u dorëzuar, por për të hapur një mundësi të komunikimit më shumë për të arritur një konsensus. Ne kështu e kemi lexuar këtë situatë dje dhe kemi besuar që me të vërtetë ka vullnet të singertë dhe këtë e kam thënë edhe në ditët para seancës që shpresoj që ka vullnet të singertë të opozita që të arrijmë një marrëveshje. Fatkeqësisht nuk ka. Fatkeqësisht jemi prapë në një situatë të lojës politike ku opozita insiston që të thotë ju vetëm e votoni këtë pikë ose hiç, për të na thënë nesër valla që e votuat apo s'e votuat.

Përtej debatit ditor, përtej politikës momentale, përtej atij materialit që ia japim njëri-tjetrit për të folur në studio televizive, ne nuk po i japim zgjidhje as Kosovës as qytetarëve. Ne po vazhdojmë të jemi në këtë situatë ku jemi. Këta ankohen pse po shkon Presidenti në Bruksel vetë dhe me këtë kryeneçësi pikërisht ia mundësojnë që Presidenti të vazhdojë të shkojë vetë me mandatin kushtetues që ka, se nuk krijohet mundësia as për të themeluar një komision të Kuvendit që e mbikëqyrë dialogun, as për t'i dhënë dritën e gjelbër Qeverisë që të vazhdojë me obligimet kushtetuese që të jetë pjesë qendrore e këtij dialogu.

Neve na vjen keq, por ne nuk heqim dorë dhe nuk dorëzohemi nga kërkesa dhe insistimi ynë që megjithatë nëse jo sot, në ditët në vijim të gjejmë një mundësi për t'u harmonizuar me qëndrimet tona dhe për të vazhduar tutje. Sa i përket procesit të votimit ne nuk do të marrim pjesë fare në votim, sepse ky kurth absolutisht i padrejtë, në të cilin po mendon propozuesi ta fusë koalicionin pavarësisht që unë nuk e... mund të jetë legjitim, ne normalisht nuk do të biem në të. Nëse këta mendojnë se do ta hedhin në votim e do të shohin a po votojmë, ne nuk votojmë kundër sovranitetit të Kosovës.

Siç tha edhe dje kryetari Veseli, ne nuk po duam ta mbrojmë më shumë se këta Kosovën, as nuk po duam me e dashtë më shumë se këta Kosovën, ne vetëm po duam ta duam përafërsisht sa këta, ose sa këta Kosovën edhe me iu ndihmua ta mbrojnë, se mos po lodhen duke e mbrojtur vet. Kjo është qëllimi ynë, kurrëgjë më shumë. Dhe, për këtë arsye s'do të marrim pjesë në votim, do të votojmë kur të ketë harmonizim dhe gjithëpërfshirje në një rezolutë që i trajton të gjitha temat që kanë të bëjnë me dialogun. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Ne po mendojmë që mazhoranca po e mbron verbërisht presidentin në qëndrimet e tij politike. Ne nuk e kemi me presidentin thjesht pse e ka emrin Hashim Thaçi, mund ta kishte edhe ndryshe emrin, por po ta kishte thënë që është për këtë temë dhe që ka projekt këtë që të lëvizën kufijtë e Kosovës, unë mendoj se do të kishim reaguar njëjtë, pavarësisht cili do të ishte personi.

Kurse, këta janë lidhur me emrin e tij, me personin, duhet ta mbrojnë sepse mendojnë që kjo ka konsekuenca politike në jetën dhe në jetëgjatësinë e kësaj Qeverie. Kështu që, ky është dallimi kryesor dhe unë mendoj që ky është thelbi i problemit. Pra, vetëm pse problemi është Hashim Thaçi janë edhe këto dallimet tona. Sa i përket kësaj çështjes së temës për të cilën po flasim, atëherë kjo padyshim që ne nuk mund të shkojmë në një platformë tash ta shkruajmë për dialogun e ardhshëm me Serbinë apo për ekipin negociator ta krijojmë, qysh po do mazhoranca. Kjo nuk i takon kësaj legjislature, kjo legjislaturë nuk i ka as kushtet elementare për të kaluar në ato tema të ardhshme, as për të krijuar platformë të dialogut me Serbinë, as për të krijuar ekip negociator. Kjo s'shkon në faza të mëvonshme. Situata në të cilën ndodhemi tash kërkon vetëm masa preventive dhe vetëm kaq. Cilat janë masat preventive? Janë që presidentit Thaçi t'ia ndalojë Kuvendi i Kosovës të merret me atë temë. E këtu s'po mund ta marrim edhe mbështetjen e mazhorancës në këtë aspekt.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sejdiu, në emër të PSD-së.

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Qytetarë të Republikës,

Ne si Parti Socialdemokrate qysh me 20 korrik e kemi iniciuar një mocion përmbajtjesor, i cili e kthen dialogun në Kuvend, pra Kuvendi bëhet hisedar dhe institucioni i vetëm, i cili mund të trajtojë çështjet e dialogut. Dhe, kështu kemi tentuar aso kohe që të sigurohemi që asnjë person, qoftë ai edhe presidenti i Republikës të mos futet aventurave në dialog.

Në atë kohë nuk kemi gjetur përkrahje nga asnjë subjekt politik, fatkeqësisht, sepse ky diskutim nuk do të ekzistonte sot, por do të ishim duke ecur me tema të tjera. Në anën tjetër, gjithashtu më 7, saktësisht më datën 2 shtator, nëse s'gabo, ose 1 shtator, zoti Hoti më ka kontaktuar lidhur me një rezolutë, e cila esencialisht është kjo sot që po e shohim këtu. Në atë kohë ne si PSD e kemi përkrahur këtë rezolutë dhe edhe sot në takim të shëfave të grupeve parlamentare unë kam shprehur qëndrimin pro kësaj rezolute, por nuk besoj që duke qëndruar të barrikaduar në pozicione partiake ndërtojmë situatë, me të cilën e tejkalojmë ngërçin të krijuar tashmë duke mos dashur t'i kthejmë dialogun Kuvendit. Ne si PSD do të angazhohemi edhe më tutje, që Kuvendi të jetë vendi, arena, mënyra dhe institucioni në të cilin dialogu kthehet dhe te i cili merren vendimet e ndërtohen idetë. Dhe, në këtë frymë po e them dhe po e ripërsëris, PSD do të

përkrahë këtë rezolutë që është sjellë sot këtu, meqë e kemi përkrahur edhe një herë, por gjithsesi nuk mendoj që qëndrimi në pozicione të ngurta e në këtë situatë po duket se kjo është çështja edhe në takim ashtu dukej, krijon hapësirë për tejkalim të problemit.

Në çdo rrethanë gjithmonë do të ketë pozitë dhe opozitë, por besoj që duhet si Kuvend të gjejmë mënyrën dhe mekanizmin, që për tema si këto të gjejmë tekstin që na bashkon dhe rrugën e cila bëhet e lehtë apo e bëshme për secilin prej nesh. Edhe një herë po e përsëris, e përkrahim rezolutën.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi, në emër të AAK-së.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe pse, ne u dakorduar që të bëjmë një marrëveshje rreth harmonizimit të kësaj rezolute duke u përmbledhur pikat edhe nga iniciuesi, por edhe nga koalicioni qeveritar, nuk pati gatishmëri që të bëhet ky harmonizim dhe fatkeqësisht ende po vazhdojnë me avazin e vjetër, duke u pozicionuar dhe duke u bllokuar vetëm në atë që thonë vet. Ne e kemi thënë, se askush nga personalitetet shtetërore të vendit nuk ka të drejtë që të bisedojë për territorin e Republikës së Kosovës, sepse kjo është e përcaktuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Dhe i kemi ofruar të gjitha ato që i ka thënë edhe opozita, elemente kushtetuese të cilat duhet të jenë pjesë e rezolutës e që nuk pati gatishmëri edhe përkundër insistimit edhe angazhimit tonë, që të heqim ndoshta edhe diçka edhe nga pikët që u ofruan.

Prandaj, këtu ka një interesim që vetëm një interes politik të shikohet dhe jo të shikohet vërtet interesi i vendit për çka ne po flasim. Prandaj, unë konsideroj që është e kotë që flasim për unitet, për harmonizim qëndrimesh dhe për rezolutë të përbashkët e në të njëjtën kohë pozicionohemi vetëm për atë që them unë, ose tjetri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi, nga Grupi Parlamentar Nisma.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Për hir të sqarimit objektiv të asaj çka ka ndodh gjatë përpjekjes për të harmonizuar rezolutën nuk është e saktë që ne ishim kundër pikës së propozuar nga propozuesi. Ne, të gjitha partitë e mazhorancës u dakorduar që pika e propozuar nga dy partitë opozitare të mbetet, madje jo vetëm që pranuar të mbetet, por pranuar që edhe të përforcohet, të hermetizohet siç ka dëshirë kolegu shpesh të përdorë, por jo të barrikadohet.

Pra, ftesat për të mos u barrikaduar si duket vlente vetëm njëanshëm jo edhe për ta, pak ata u barrikaduan ose vetëm në këtë pikë ose nuk ka rezolutë. Ne ishim të gatshëm, madje që të heqim dorë edhe nga disa pika, të cilat i kemi propozuar gjatë ditës së djeshme dhe gjatë përpjekjes për

të harmonizuar sot. Pra, ne nuk kishim rezolutë në vete për të propozuar, ne nuk erdhëm me kundër rezolutë ne erdhëm me pika për të cilat ishim të gatshëm të diskutojmë. Ata nuk pranuan, madje as të diskutojnë për asnjërën nga ato pika, por vetëm rezolutën me pikën e vetme dhe ne mendojmë që ajo nuk është rruga e duhur për të ndalë pikërisht atë çka ata duan të ndalin, bisedimet për territorin e Kosovës. Ne mendojmë që rruga e vetme për të ndalë një gjë të tillë, një proces të tillë është që të harmonizojmë, ky Kuvend të harmonizojë dhe të nxjerrë një platformë dhe një delegacion si zëvendësim për gjithë atë që është duke u zhvilluar në rrafshet joformale. Pra, pa krijuar një rrafsh formal zyrtar juridik nga Parlamenti i Kosovës vështirë që do të mund t'i ndalim ato tjerat, dhe kjo mua më asocion si një lojë ku kërkoj punë, po lus Zotin të mos gjejë. Kërkojë që të kalojë kjo rezolutë, por ishalla nuk kalon.

Unë, më duhet të them që jam thellësisht i zhgënjyer nga mungesa e gatishmërisë që problemi, çështja të shihet në tërësi dhe jo në mënyrë parciale qysh u pa sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Më duhet të them se me të vërtetë ishte një orë e pak më tepër me diskutim, por jo me shumë vullnet për të ardhur te një zgjidhje e përbashkët. Tash si një prej nënshkrueseve të Rezolutës së opozitës, konsideroj se ajo çfarë e propozoi shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së për pikën e 6, të Rezolutës ose të propozimit të pozitës ishte si fillim i mirë që të jetë pika e parë dhe e sforcuar, e përbashkët e këtij Kuvendi. Përderisa, gjithashtu edhe në takim kam propozuar që tri pika, të cilat janë sot në propozimin e pozitës të merren parasysht si shenjë e vullnetit të mirë dhe e bashkëpunimit të këtij Kuvendi në një pikë që shkon përtej vijave politike, partiake apo edhe agjendës ditore.

Dhe, ato pika kanë të bëjnë me rikonfirmimin e rolit të Kuvendit për dialogun dhe asnjë pikë ose presje më tepër, as nuk kanë të bëjnë me delegacionin e emëruar nga Qeveria, as nuk kanë të bëjnë me komisionin e veçantë të Kuvendit, ato të jenë në një diskutim tjetër. Sot, bëj thirrje edhe një herë të gjitha palëve që të kuptojmë një gjë se dështimi i rezolutës sot është vazhdim i punës dhe i përpjekjeve që bën Presidenti Thaçi apo edhe diskutimit për ndarjen e kufijve. Vetëm dështimi sot i rezolutës e vazhdon mandatin e tij dhe angazhimin e tij në këtë temë. Nëse ne ulemi dhe besoj që duhet ta kuptojmë që kalimi i një rezolute të tillë sot shkon përtej mandateve individuale ose politike të secilit ne mundemi ta ndalim dhe të vijmë te një pikë në të cilën prezantohet Parlamenti atë që kemi folur dje gjithë ditën. Parlamenti ose Kuvendi i Republikës së Kosovës është i vetmi institucion që jep orientim ose jep drejtim dhe e mbikëqyr dialogun apo përmbylljen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Prapë po them, mendoj që diferencat nuk janë aq të mëdha sa po prezantohen. Mendoj se edhe pozita e ka treguar vullnetin e vet, por edhe opozita ka ardhur me gatishmërinë, fakti që jemi të

gjithë këtu në sallë është mjaftueshëm argument që ne ta vazhdojmë punën në një projekt rezolutë të përbashkët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani i dëgjuam propozimet dhe qëndrimet e të gjitha grupeve parlamentare. Unë dua ta dëgjoj mendimin e zotit Hoti a dëshiron ta fus në votim meqenëse në sallë janë 91 deputetë, projektrezolutën. Në qoftë se po, atëherë e futim në votim.

AVDULLAH HOTI: Po, sigurisht duke qenë se ka kuorum, unë sugjeroj që ju ta nxirrni në votim pikën ashtu siç e lexova, për të treguar vullnetin e propozuesve që të marrin parasysht disa elemente të propozuara nga grupet tjera parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, zonja dhe zotërinj deputetë, në sallë janë 91 deputetë. Unë kam për obligim pa marrë parasysht qëndrimeve që ta hedh në votim projektrezolutën. Diskutimet janë kryer.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani! Faleminderit!

Në sallë janë 90 deputetë, për kanë votuar 50 (VËREJTJE: +1 votë e deputetit Korab Sejdiu, sipas shkresës zyrtare me nr. 06/2227/Do -1196, d.m.th. gjithsej për janë 51 vota, v. j.), asnjë kundër, asnjë abstenim. Gjendja është e tillë, rezoluta nuk është miratuar.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*